FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 130

Tiranë – E enjte, 29 shtator 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 65/2022, datë 15.9.2022	Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III).....	16173
Dekret i Presidentit nr. 13853, datë 26.9.2022	Për shpallje ligji.....	16275
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 606, datë 14.9.2022	Për miratimin e Programit Kombëtar për Aktivitetet jashtë Orarit Mësimor dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2022, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Sportit	16276
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 28.9.2022	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 165, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", të ndryshuar.....	16293
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 627, datë 28.9.2022	Për disa ndryshime në vendimin nr. 234, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike".....	16298
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 385, datë 8.9.2022	Për zbatimin e rekomandimit ICCAT, "Për ndryshimin e rekomandimit 19-04 për ndryshimin e rekomandimit 18-02, për hartimin e një plani menaxhimi shumëvjeçar për tonin në Atlantikun Lindor dhe detin Mesdhe" [rec. ICCAT 21-08].....	16299
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 235, datë 22.9.2022	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Smart Trade & Consulting" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017.....	16349

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 236, datë 22.9.2022	Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë "Bindi" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017.....	16350
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 237, datë 22.9.2022	Mbi licencimin e shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit.....	16351
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 238, datë 22.9.2022	Mbi licencimin e shoqërisë "Egnatia Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	16353
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 239, datë 22.9.2022	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë të operatorit të sistemit të shpërndarjes OSSH sh.a.....	16354
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 240, datë 22.9.2022	Mbi një ndryshim në vendimin nr. 194, datë 21.7.2022, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Green Energy Bilisht' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë, me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar".....	16355
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 243, datë 23.9.2022	Mbi kërkesën e OST sh.a., për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023 dhe periudhën 2023–2025.....	16356
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 613/4, datë 26.9.2022	Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Studim projektim rruga Berat–Ballaban" (faza II).....	16358

LIGJ
Nr. 65/2022

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES FINANCIARE KUADËR TË PARTNERITETIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA KËSHILLI I MINISTRAVE I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, DHE KOMISIONIT EVROPIAN PËR RREGULLAT SPECIFIKE TË ZBATIMIT TË ASISTENCËS FINANCIARE TË BE-së PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NË KUADËR TË INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN E PARAANËTARËSIMIT (IPA III)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja financiare kuadër e partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III) sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 15.9.2022

Shpallur me dekretin nr. 13853, datë 26.9.2022 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

MARRËVESHJE FINANCIARE KUADËR E PARTNERITETIT

NDËRMJET

KOMISIONIT EVROPIAN

DHE

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËRFAQËSUAR NGA

KËSHILLI I MINISTRAVE I REPBLIKËS SË SHQIPËRISË

PËR

RREGULLAT SPECIFIKE TË ZBATIMIT TË ASISTENCËS FINANCIARE TË BE-së PËR REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NË KUADËR TË INSTRUMENTIT PËR ASISTENCËN E PARA-ANËTARËSIMIT (IPA III)

Pasqyra e Lëndës

SEKSIONI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
Neni 1 Interpretimi
Neni 2 Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë e paqëllimshme
Neni 3 Përkufizime
Neni 4 Qëllimi dhe objekti
Neni 5 Parimet e përgjithshme për asistencën financiare në kuadrin e IPA III
Neni 6 Roli i Koordinatorit Kombëtar IPA
Neni 7 Metodat e zbatimit
Neni 8 Marrëveshjet e financimit
Neni 9 Marrëveshjet sektoriale
SEKSIONI II RREGULLAT E MENAXHIMIT INDIREKT NGA PËRFITUESI IPA III
TITULLI I SISTEMET E MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT
Neni 10 Ngritja e strukturave dhe autoriteteve për menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III
Neni 11 Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave dhe autoriteteve
TITULLI II DISPOZITA SPECIFIKE PËR T'I BESUAR PËRFITUESIT IPA III DETYRA TË ZBATIMIT TË BUXHETIT
Neni 12 Kushtet për t'i besuar Përfituesit IPA III detyrat e zbatimit të buxhetit
Neni 13 Besimi i detyrave të zbatimit të buxhetit
Neni 14 Masat nëse Strukturat Menaxhuese, Autoritetet Menaxhuese dhe Organet e Ndërmjetme nuk respektojnë nenin 12, pikat (2) dhe (3) dhe Shtojcën B
Neni 15 Pezullimi ose anulimi i pjesëve të marrëveshjes së financimit për detyrat e besuara për zbatimin e buxhetit
SEKSIONI III RREGULLAT PËR PROGRAMIMIN
Neni 16 Programimi i asistencës
Neni 17 Miratimi i programeve dhe ndryshimet në to
SEKSIONI IV RREGULLAT PËR ZBATIMIN
TITULLI I RREGULLA TË PËRGJITHSHME DHE PARIMET E ZBATIMIT
Neni 18 Procedurat e prokurimit, dhënies së granteve dhe procedura të tjera
Neni 19 Rregullat e shtetësisë dhe origjinës për procedurat e prokurimit, granteve dhe kontraktimeve të tjera
Neni 20 Pjesëmarrja në programet dhe agjencitë e BE-së
Neni 21 Parimet e zbatimit të mbështetjes buxhetore për Përfituesin IPA III
Neni 22 Parimet e zbatimit për binjakëzimin
TITULLI II TRANSPARENCA DHE VIZIBILITETI
Neni 23 Informimi, publiciteti dhe transparenca
Neni 24 Komunikimi strategjik dhe vizibiliteti
TITULLI III MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KONFIDENCIALITETI
Neni 25 Mbrojtja e të dhënave
Neni 26 Konfidencialiteti
TITULLI IV OFRIMI I LEHTËSIRAVE DHE TAKSIMI
Neni 27 Ofrimi i lehtësirave për zbatimin e programeve dhe ekzekutimin e kontratave
Neni 28 Rregullat për taksat, tarifat doganore dhe ato fiskale
SEKSIONI V RREGULLAT PËR MENAXHIMIN FINANCIAR TË ASISTENCËS IPA III
TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
Neni 29 Pranueshmëria e shpenzimeve
Neni 30 Bashkëfinancimi i programeve IPA III

TITULLI II RREGULLAT PËR MENAXHIMIN INDIREKT NGA PËRFITUESI IPA III
Neni 31 Rregullat specifike për pranueshmërinë e shpenzimeve për IPARD-in
Neni 32 Gjurma e auditit
Neni 33 Pagesat e kontributeve të BE-së
Neni 34 Parafinancimi
Neni 35 Pagesat e ndërmjetme
Neni 36 Pagesa e balancës përfundimtare
Neni 37 Anulimi i fondeve të papërdorura në rastin e programeve shumëvjeçare me buxhet të ndarë
Neni 38 Ndërprerja e pagesave
Neni 39 Pezullimi i pagesave
Neni 40 Rikuperimi i fondeve
Neni 41 Rregullimet financiare nga Përfituesi IPA III
Neni 42 Shqyrtimi dhe pranimi i procedurave të llogarisë
Neni 43 Korrigjimet financiare nga Komisioni
Neni 44 Procedurat për korrigjimet financiare
Neni 45 Ripërdorimi i kontributit të BE-së
Neni 46 Shlyerja
TITULLI III MBYLLJA E NJË PROGRAMI
Neni 47 Mbyllja e një pjese të programit të zbatuar me menaxhim indirekt nga Përfituesi IPA III
Neni 48 Mbyllja e një pjese të programit të zbatuar në menaxhim direkt dhe atë indirekt me subjekte të ndryshme nga përfituesi IPA III
Neni 49 Ruajtja e dokumenteve
TITULLI IV MBIKËQYRJA, KONTROLLI, AUDITI DHE MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARË
Neni 50 Mbikëqyrja, kontrolli dhe auditimi nga Komisioni, Zyra e Luftës Kundër Mashtrimit në BE dhe Gjykata Evropiane e Llogarive
Neni 51 Mbrojtja e interesave financiare të BE-së
SEKSIONI VI MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI
TITULLI I MONITORIMI
Neni 52 Komiteti Monitorues IPA
Neni 53 Komitetet monitoruese sektoriale
TITULLI II VLERËSIMI
Neni 54 Vlerësimi i asistencës IPA III
Neni 55 Vlerësimet e Komisionit
Neni 56 Vlerësimet e Përfituesit IPA III në menaxhimin indirekt
TITULLI III RAPORTIMI
Neni 57 Përkufizime shtesë për raportimin
Neni 58 Gjuha dhe formati
Neni 59 Kërkesat bazë për raportimin nga KKIPA
Neni 60 Kërkesa raportimi nga KKIPA në menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III
Neni 61 Kërkesa raportimi për ZKA-në në menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III
Neni 62 Kërkesat e raportimit për Autoritetet Menaxhuese në menaxhimin indirekt nga përfituesi IPA III
Neni 63 Kërkesat e raportimit për Autoritetin Auditues në menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III
SEKSIONI VII DISPOZITAT PËR PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR
TITULLLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME
Neni 64 Format e bashkëpunimit ndërkufitar
Neni 65 Përkufizime shtesë për bashkëpunimin ndërkufitar

Neni 66 Bashkëfinancimi
TITULLI II RREGULLAT PËR PROGRAMIMIN
Neni 67 Prioritetet tematike dhe përqendrimi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA III
Neni 68 Shtrirja gjeografike
Neni 69 Përgatitja, vlerësimi, miratimi dhe ndryshimet në programet e bashkëpunimit ndërkufitar
Neni 70 Marrëveshjet dypalëshe ndërmjet përfituesve IPA III për menaxhimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të zbatuara me menaxhim indirekt
TITULLI III OPERACIONET
Neni 71 Përzgjedhja e operacioneve
Neni 72 Përfituesit
Neni 73 Asistenca teknike
TITULLI IV ZBATIMI
Neni 74 Modalitetet e Zbatimit
TITULLLI V STRUKTURAT DHE AUTORITETET E PROGRAMIT DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE
Neni 75 Strukturat dhe autoritetet për menaxhimin e BNK-së
Neni 76 Strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar dhe Autoriteti Menaxhues IPA
Neni 77 Autoriteti Auditues
Neni 78 Komiteti i Përbashkët Monitorues (KPM)
Neni 79 Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT)
TITULLI VI RAPORTIMI
Neni 80 Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit
SEKSIONI VIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE
Neni 81 Komunikimi
Neni 82 Konsultimi
Neni 83 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, arbitrazhi
Neni 84 Mosmarrëveshjet me palët e treta
Neni 85 Njoftimet
Neni 86 Shtojcat
Neni 87 Hyrja në fuqi
Neni 88 Zbatueshmëria e marrëveshjes kuadër për IPA II
Neni 89 Ndryshimet
Neni 90 Pezullimi nga Komisioni dhe zgjidhja e Marrëveshjes
Neni 91 Masat kufizuese të BE-së
SHTOJCA A
SHTOJCA B
SHTOJCA C
SHTOJCA D
SHTOJCA E
SHTOJCA F
SHTOJCA G
SHTOJCA H

Komisioni Evropian, në vijim i referuar si "**Komisioni**", që vepron për dhe në emër të Bashkimit Evropian

nga njëra anë,

dhe
Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë që vepron në emër të Republikës së Shqipërisë, në vijim i referuar si **"Përfituesi IPA III"**,

nga ana tjetër,

dhe bashkërisht të referuara si **"Palët"**.

Duke pasur parasysh se:

(1) Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit[1] ("Rregullorja IPA III") përbën bazën ligjore për dhënien e asistencës financiare përfituesve që renditen në Shtojcën I të Rregullores IPA III ("Përfituesit IPA III");
(2) Rregullorja e IPA III synon të mbështetë përfituesit IPA III në miratimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike që u kërkohen këtyre përfituesve për të qenë në përputhje me vlerat e BE-së dhe për të përafruar gradualisht rregullat, standardet, politikat dhe praktikat ("*acquis*") e BE-së, me qëllim anëtarësimin në BE, duke kontribuuar në këtë mënyrë në stabilitetin, sigurinë dhe prosperitetin e tyre.
(3) Sipas nenit 9(1) të Rregullores IPA III, Kreu III i Titullit II të Rregullores (BE) 2021/947[2] ("Rregullorja NDICI"), përveç nenit 28(1) të kësaj Rregulloreje, zbatohet për Rregulloren IPA III.
(4) Neni 130 i Rregullores (BE, Euratom) 2018/1046 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit[3] ("Rregullorja Financiare" i lejon Komisionit të miratojë marrëveshje financiare kundër partneriteti për bashkëpunimin afatgjatë me përfituesit.
(5) Më 15 dhjetor 2021, Komision miratoi Rregulloren Zbatuese (BE) 2021/2236 për rregullat specifike të zbatimit të Rregullores (BE) 2021/1529 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që krijon Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA III)[4], (në vijim e referuar si "Rregullorja Zbatuese IPA III") që përcakton dispozitat e zbatueshme për menaxhimin dhe kontrollin.

BIEN DAKORD SI MË POSHTË:

[1] Rregullorja (BE) 2021/1529 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit që krijon Instrumentin e datës 15 shtator 2021 që krijon Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA III) (GZ L 330, 20.9.2021, f. 1).
[2] Rregullorja (BE) 2021/947 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 9 qershor 2021 për krijimin e Instrumentit të Fqinjësisë, Zhvillimit dhe Bashkëpunimit Ndërkombëtar – Evropa Globale që ndryshon dhe shfuqizon Vendimin nr. 446/1014/BE të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit dhe që shfuqizon Rregulloren (BE) 2017/1601 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit si dhe Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 480/2009 (GZ L209, 14.6.2021, f. 1).
[3] Rregullorja (BE, Euratom) 2018/1046 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 18 korrik 2018 për rregullat financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të BE-së që ndryshon Rregulloret (BE) nr. 1296/2013, (BE) nr. 1301/2013, (BE) nr. 1303/2013, (BE) nr. 1304/2013, (BE) nr. 1309/2013, (BE) nr. 1316/2013, (BE) nr. 223/2014, (BE) nr. 283/2014 dhe Vendimi nr. 541/2014/EU dhe që shfuqizon Rregulloren (BE, Euratom) nr. 966/2012 (GZ L193, 30.7.2018, f. 1).
[4] Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2021/2236 për rregullat specifike për zbatimin e Rregullores (BE) 2021/1529 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit që krijon Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA III), GZ L450/10, 16.12.2021, f. 10.

SEKSIONI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1 Interpretimi

(1) Në rast të ndonjë dispozite të shprehur që bie ndesh në këtë Marrëveshje, termat e përdorur në këtë Marrëveshje kanë kuptimin që iu atribuohet në Rregulloren NDICI, në Rregulloren IPA III dhe në Rregulloren Zbatuese IPA III.

(2) Në rast të ndonjë dispozite të shprehur që bie ndesh në këtë Marrëveshje, referencat në këtë Marrëveshje merren ashtu siç janë ndryshuar, plotësuar apo zëvendësuar herë pas here.

(3) Nëntitujt e kësaj Marrëveshjeje nuk kanë domethënie ligjore dhe nuk ndikojnë në interpretimin e saj.

Neni 2 Pavlefshmëria e pjesshme dhe mangësitë e paqëllimshme

Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme apo nëse kjo Marrëveshje përmban mangësi të paqëllimshme, kjo nuk cenon vlefshmërinë e dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje. Palët zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë të vlefshme apo akt mirëkuptimi që i afrohet sa të jetë e mundur qëllimit dhe objektivit të dispozitës së pavlefshme. Palët plotësojnë çdo mangësi të paqëllimtë me një dispozitë apo akt mirëkuptimi që i përshtatet më mirë qëllimit dhe objektivit të kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me Rregulloren IPA III dhe Rregulloren Zbatuese IPA III.

Neni 3 Përkufizime

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termat më poshtë kanë këtë kuptim:

(a) "program" nënkupton një masë apo plan veprimi njëvjeçar ose shumëvjeçar, siç përcaktohet në nenin 9 të Rregullores IPA III dhe Kreun III të Titullit II të Rregullores NDICI;

(b) "përfitues IPA III" nënkupton njërin prej përfituesve të renditur në Shtojcën I të Rregullores (BE) 2021/1529;

(c) "marrëveshje sektoriale" nënkupton një marrëveshje që lidhet ndërmjet Komisionit dhe përfituesit IPA III për zbatimin e një programi specifik të IPA III, ku përcaktohen rregullat dhe procedurat që duhen respektuar, të cilat nuk përfshihen në këtë Marrëveshje apo në marrëveshjet e financimit;

(d) "marrëveshje financimi" nënkupton një marrëveshje njëvjeçare apo shumëvjeçare që lidhet ndërmjet Komisionit dhe një përfituesi IPA III për zbatimin e asistencës IPA III;

(e) "autoritet" nënkupton një organ apo ent publik qendror, rajonal apo vendor i një përfituesi IPA III ose një Shteti Anëtar;

(f) "projekt madhor" nënkupton një projekt që përbëhet nga një sërë punimesh, aktivitetesh apo shërbimesh që në vetvete synon të përmbushë një detyrë të përcaktuar dhe integrale me natyrë ekonomike apo teknike, i cili ka objektiva të identifikuar qartë dhe kostoja totale e të cilit tejkalon koston e specifikuar në marrëveshjen korresponduese sektoriale apo të financimit;

(g) "qëndrueshmëri e asistencës së IPA III" nënkupton masën në të cilën rezultatet e realizuara dhe të ndikuara drejtpërdrejt nga asistenca financiare vazhdojnë apo mund të vazhdojnë edhe pas përfundimit të periudhës së zbatimit të veprimit/projektit;

(h) "marrës" nënkupton përfituesin e grantit (përfshirë kontraktues binjakëzimi), kontraktuesin që përfiton kontratë shërbimi, furnizimi ose punimesh, përfituesin në kuadrin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, palën kontraktuese në një marrëveshje kontributi me menaxhim indirekt apo çdo person fizik apo juridik që merr asistencë financiare;

(i) "vit financiar" nënkupton periudhën nga 1 janari deri 31 dhjetori të një viti të caktuar, siç përcaktohet në nenin 9 të Marrëveshjes Financiare.

Neni 4 Qëllimi dhe objekti

(1) Për të ndihmuar përfituesin IPA III në miratimin dhe zbatimin e reformave politike, institucionale, ligjore, administrative, sociale dhe ekonomike që kërkohen për të qenë në përputhje me vlerat e BE-së dhe për të përafruar gradualisht rregullat, standardet, politikat dhe praktikat BE-së me qëllim anëtarësimin në BE, Palët bien dakord të zbatojnë veprime brenda prioriteteve tematike të përcaktuara në nenin 3, pikat (3) dhe (4) dhe në Shtojcat II dhe III të Rregullores IPA III, si dhe të kontribuojnë në arritjen e objektivave specifikë të renditur në nenin 3(2) të asaj Rregulloreje.

(2) Programet financohen dhe zbatohen brenda kuadrit ligjor, administrativ dhe teknik të parashikuar në këtë Marrëveshje dhe sipas parashikimeve më të hollësishme në marrëveshje sektoriale apo financimi, nëse ka.

(3) Dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje zbatohen për programet e financuara në kuadrin e Rregullores IPA III.

(4) Dispozitat e përcaktuara në këtë Marrëveshje nuk zbatohen për programet e bashkëpunimit ndërkufitar IPA III ndërmjet një apo disa përfituesve IPA III dhe një ose disa Shteteve Anëtare, për programet e bashkëpunimit transnacional dhe ndër-rajonal apo për masat që krijohen dhe zbatohen në kuadrin e Rregullores (BE) 2021 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit [5] (Rregullorja Interreg), përveç rasteve kur marrëveshja e financimit apo programe të tilla i referohen shprehimisht kësaj marrëveshjeje apo një dispozite të saj.

(5) Administrata e përfituesit IPA III merr të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e programeve.

(6) Kjo Marrëveshje zbatohet për të gjitha marrëveshjet sektoriale dhe të financimit të lidhura ndërmjet Palëve për asistencën financiare në kuadrin e Rregullores IPA III.

Neni 5 Parimet e përgjithshme për asistencën financiare në kuadrin e IPA III

[5] Rregullorja (BE) 2021/1059 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 24 qershor 2021 për dispozitat specifike për objektivin e bashkëpunimit territorial evropian (Interreg) të mbështetur nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal dhe instrumentet e financimit të jashtëm (GZ L 231, 30.06.2021, f. 94).

(1) Asistenca e IPA III jepet në përputhje me kuadrin e politikës së zgjerimit të përcaktuar nga Këshilli Evropian dhe Këshilli, si dhe pasqyron siç duhet Komunikatën e Komisionit për Strategjinë e Zgjerimit dhe raportet që bëjnë pjesë në paketën vjetore të zgjerimit të Komisionit, si dhe rezolutat përkatëse të Parlamentit Evropian.

(2) Parimet që udhëheqin asistencën financiare të BE-së në kuadrin e IPA III janë:

(a) respektimi i parimeve të koherencës, komplimentaritetit, koordinimit, përqendrimit; autorësisë, partneritetit dhe "mos shkakto dëm"; përputhshmëria me parimet buxhetore të përcaktuara në Rregulloren Financiare;

(b) përputhshmëria me politikat dhe mbështetjen e BE-së për harmonizimin gradual me *acquis* të BE-së;

(c) përfituesi IPA III garanton qëndrueshmërinë e asistencës IPA III;

(d) asistenca IPA III mban parasysh mësimet e nxjerra nga instrumentet e mëparshëm për asistencën e para-anëtarësimit;

(e) asistenca IPA III jepet në partneritet me përfituesin IPA III mbi bazën e kuadrit programues të IPA III, ndërsa përfituesi IPA III ruan autorësinë mbi programimin dhe zbatimin e asistencës IPA III;

(f) asistenca IPA III garanton vazhdimësi me qasjen sektoriale që ka synuar të rrisë koherencën ndërmjet strategjive kombëtare, politikave sektoriale, alokimit të burimeve dhe praktikave të shpenzimit. Gjatë IPA III do të vazhdojë fokusi tek garantimi i koherencës ndërmjet planifikimit, monitorimit, raportimit dhe kuadrove të menaxhimit financiar publik të reformave sektoriale dhe politikave horizontale kombëtare;

(g) vizibiliteti i mjaftueshëm i asistencës IPA III duhet të sigurohet dhe të promovohet në mënyrë proaktive;

(h) gjatë zbatimit të asistencës duhet të parandalohet çdo diskriminim me bazë seksi, race ose origjine etnike, përkatësie fetare ose besimi, aftësie të kufizuar, moshe apo orientimi seksual;

(i) asistenca planifikohet me objektiva të qartë dhe të verifikueshëm, të cilët duhet të arrihen brenda një periudhe të caktuar. Rezultatet e arritura duhet të vlerësohen përmes treguesve që duhet të jenë relevantë, të pranueshëm, të besueshëm, të thjeshtë për t'u monitoruar dhe të plotë (RACER) si edhe specifikë, të matshëm, të arritshëm, realistë dhe brenda një afati (SMART);

(j) Asistenca IPA III diferencohet në objekt dhe intensitet sipas performancës së përfituesit IPA III, veçanërisht në varësi të përkushtimit dhe ecurisë së zbatimit të reformave, si edhe në varësi të nevojave. Vlerësimi i performancës së përfituesit IPA III dhe vendimi për asistencën që jepet u kushtojnë vëmendje të veçantë përpjekjeve

të bëra në këto fusha: shteti i së drejtës dhe të drejtat e njeriut, institucionet demokratike dhe reforma e administratës publike, si edhe zhvillimi ekonomik dhe konkurrueshmëria. Regresi i konsiderueshëm apo mungesa e vazhdueshme e progresit nga përfituesi IPA III në këto fusha, matur me indikatorët e përcaktuar në nenin 7(5) të Rregullores IPA III, reflektohet sipas rrethanave në modifikim të objektit dhe intensitetit të asistencës.

(3) Dhënia e asistencës IPA III kushtëzohet me plotësimin nga përfituesi IPA III të detyrimeve në kuadër të kësaj Marrëveshje dhe në kuadër të marrëveshjeve sektoriale dhe të financimit, nëse ka.

Neni 6 Roli i Koordinatorit Kombëtar IPA

(1) Përfituesi IPA III cakton një Koordinator Kombëtar IPA (KKIPA) i cili do të jetë struktura homologe e Komisionit për procesin e përgjithshëm të koordinimit të programimit, monitorimit të zbatimit, vlerësimit dhe raportimit të asistencës IPA III. KKIPA ka këto përgjegjësi:

(a) garanton lidhje të ngushtë midis përdorimit të asistencës IPA dhe procesit të përgjithshëm të anëtarësimit.

(b) garanton koordinimin e përgjithshëm të programimit në përputhje me objektivat dhe prioritetet tematike të kuadrit programues të IPA III, monitorimin e zbatimit, vlerësimin dhe raportimin e asistencës IPA, duke përfshirë koordinimin brenda administratës së përfituesit IPA III dhe me donatorë të tjerë;

(c) koordinon pjesëmarrjen e përfituesve IPA III në programet e bashkëpunimit ndërkufitar të përcaktuar në nenin 64(2), germat (a) dhe (b) të nenit 64 (2) si edhe, sipas rastit, në programet e bashkëpunimit transnacional dhe ndër-rajonal të përcaktuar në nenin 64(2), germa (c). KKIPA mund ta delegojë këtë detyrë koordinimi tek një koordinator apo strukturë bashkëpunimi territorial që ngrihet për menaxhimin e bashkëpunimit ndërkufitar, sipas rastit;

(d) përpiqet që administrata e përfituesit IPA III të marrë të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e programeve përkatëse.

(2) KKIPA duhet të jetë një përfaqësues i lartë i qeverisë apo i administratës qendrore të përfituesit IPA III, me autoritetin e duhur.

(3) Nëse Bashkimi Evropian i ka hapur negociatat e anëtarësimit me përfituesin IPA III, KKIPA caktohet në një post të lartë në strukturat kombëtare për koordinimin e negociatave të anëtarësimit.

Neni 7 Metodat e zbatimit

(1) Përfituesit IPA III i jepet asistenca sipas përcaktimeve të Rregullores Financiare me:

(a) menaxhim direkt nga departamentet e Komisionit, duke përfshirë personelin e vet në Delegacionet e BE-së dhe/ose përmes agjencive zbatuese, siç përcaktohet në nenin 62(1), germa (a) e Rregullores Financiare;

(b) menaxhim indirekt, ku Komisioni ia beson/ngarkon përfituesit IPA III detyrat e zbatimit të buxhetit, siç përcaktohet në nenin 62(1), germa (c)(i) të Rregullores Financiare;

(c) menaxhim indirekt me subjekte të tjera nga përfituesit IPA III, siç përcaktohet në nenin 62(1), germa (c)(ii) deri (viii) e Rregullores Financiare;

(d) menaxhim të përbashkët me Shtetet Anëtare, siç përcaktohet në nenin 62(1), germa (b) e Rregullores Financiare për programet e bashkëpunimit ndërkufitar dhe ato të bashkëpunimit transnacional dhe ndër-rajonal të përcaktuara në nenin 64(2), germat (a) dhe (c) të kësaj Marrëveshjeje ose masat që përfshijnë Shtete Anëtare të BE-së dhe që zbatohen në përputhje me Rregulloren Interreg.

Neni 8 Marrëveshjet e financimit

(1) Në rastet kur kërkohet nga vendimi i financimit përkatës, marrëveshjet e financimit mund të nënshkruhen bazuar në këtë marrëveshje financiare kuadër të partneritetit, siç përcaktohet në nenin 5 të Rregullores Zbatuese IPA III.

(2) Për programet që zbatohen me menaxhim indirekt nga Përfituesi IPA III, marrëveshja financiare kuadër e partneritetit, marrëveshja sektoriale, nëse ka, si dhe marrëveshja e financimit të marra së bashku duhet të respektojnë nenin 129, nenin 155 (6) dhe nenin 158 të Rregullores Financiare.

(3) Për programet e bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet përfituesve IPA III, vetëm një marrëveshje financimi mund të nënshkruhet ndërmjet Komisionit dhe të gjithë përfituesve pjesëmarrës IPA III për një program të caktuar.

(4) Rregullat për zbatimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar ndërmjet një apo disa Shteteve Anëtare dhe një apo disa përfituesve IPA III, për masa ndër-rajonale, transnacional dhe të tjera, përcaktohen në Marrëveshjen e Financimit që lidhet për një program bashkëpunimi ndërkufitar që nënshkruhet në bazë të Rregullores Interreg ndërmjet përfituesit IPA III, Komisionit dhe, sipas rastit, Shtetit Anëtar ku ngrihet Autoriteti Menaxhues i atij programi bashkëpunimi ndërkufitar.

(5) Marrëveshjet e financimit përmbajnë rregulla që i japin të drejtën Komisionit të pezullojë marrëveshjet e financimit, nëse përfituesi IPA III shkel një detyrim që lidhet me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës, si edhe në raste korrupsioni të rëndë, apo nëse përfituesi IPA III është fajtor për shkelje profesionale të rëndë që vërtetohet me çdo mjet të justifikuar.

(6) Kur nuk ka një marrëveshje financimi, zbatohen rregullat e kësaj Marrëveshjeje Financiare Kuadër të Partneritetit.

Neni 9 Marrëveshjet sektoriale

(1) Marrëveshja financiare kuadër e partneritetit mund të plotësohet me marrëveshje sektoriale ku përcaktohen dispozita specifike për menaxhimin dhe zbatimin e asistencës IPA III në fusha apo programe specifike.

(2) Marrëveshjet sektoriale mund të përcaktojnë më shumë hollësi për programet e zhvillimit rural, ku përcaktohen ndër të tjera masat që udhëheqin zbatimin e asistencës.

(3) Në rastin e marrëveshje sektoriale për një fushë apo program të caktuar, ato gjejnë zbatim në të gjitha marrëveshjet e financimit që lidhen për atë fushë apo program.

SEKSIONI II RREGULLAT E MENAXHIMIT INDIREKT NGA PËRFITUESI IPA III

TITULLI I SISTEMET E MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT

Neni 10 Ngritja e strukturave dhe autoriteteve për menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III

(1) Në rastin e menaxhimit indirekt nga përfituesi IPA III, strukturat dhe autoritetet e mëposhtme ngrihen nga përfituesi IPA III:

(a) Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA);
(b) Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA);
(c) Struktura Menaxhuese e ngritur nga ZKA dhe që konsiston nga Zyra Mbështetëse e ZKA-së dhe Organi Kontabël;
(d) Autoritetet Menaxhuese dhe Organet e Ndërmjetme;
(e) Autoriteti Auditues;

(2) Përfituesi IPA III garanton ndarje të mjaftueshme të detyrave ndërmjet dhe brenda strukturave dhe autoriteteve të përcaktuara në pikën 1.

(3) ZKA është përfaqësues i nivelit të lartë i qeverisë ose i administratës qendrore të përfituesit IPA III më autoritetin e duhur;

(4) Autoriteti Menaxhues i secilit program është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të programit;

(5) Autoriteti Menaxhues autorizon një ose disa Organe të Ndërmjetme për të kryer detyrat e menaxhimit financiar të programit ("Organet e Ndërmjetme për menaxhimin financiar").

(6) Detyrat e menaxhimit financiar janë të ndara nga Autoriteti Menaxhues. Organi i Ndërmjetëm për menaxhimin financiar merr vendime financiare brenda programit në mënyrë të pavarur.

(7) Autoriteti Menaxhues i një programi mund të autorizojë një ose disa Organe të Ndërmjetme që të kryejë detyrat e menaxhimit në fushën për të cilën janë përgjegjës në

sistemin e qeverisjes apo në administratën e përfituesit IPA III (Organet e Ndërmjetme për menaxhimin e politikave").

(8) Për programet vjetore të IPA III:

(a) Autoriteti Menaxhues ngrihet në zyrën KKIPA, me përjashtim të mundshëm të veprimeve që synojnë të përgatisin përfituesit IPA III për përthithjen e Fondeve Evropiane Strukturore dhe Investimeve.

(b) institucionet përgjegjëse për fushat që mbështeten nga programi vjetor autorizohen si Organe të Ndërmjetme për menaxhimin e politikave.

(9) Për programet IPA III për zhvillimin rural, strukturat e përcaktuara në pikën 1, germa (d) e këtij neni janë:

(a) Autoriteti Menaxhues i Zhvillimit Rural IPA (IPARD), i cili është një organ publik që vepron në nivel kombëtar, ngarkohet me përgatitjen dhe zbatimin e programeve, duke përfshirëpërzgjedhjen e masave dhe publicitetin e tyre, koordinimin, vlerësimin, monitorimin dhe raportimin e veprimit në fjalë, siç përcaktohet në Shtojcën A, klauzola 6a.

(b) Agjencia IPARD, e cila ushtron funksione të ngjashme me ato të një agjencie pagesash në Shtetet Anëtare, ngarkohet me publicitetin, përzgjedhjen e projekteve si edhe autorizimin, kontrollin dhe kontabilizimin e shumave të angazhuara dhe pagesave, si edhe me ekzekutimin e pagesave, siç përcaktohet në Shtojcën A, klauzola 6b.

Neni 11 Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave dhe autoriteteve

(1) Strukturave dhe autoriteteve të përmendura në nenin 10 iu ngarkohen funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Shtojcën A dhe ato respektojnë kuadrin e kontrollit të brendshëm të Shtojcës B.

(2) Marrëveshjet sektoriale ose të financimit mund të përcaktojnë funksione apo përgjegjësi specifike, në përputhje me qasjen bazë të zgjedhur për ngarkimin e funksioneve dhe përgjegjësive sipas Shtojcës A.

(3) Në menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III, nëse personave apo subjekteve u janë ngarkuar përgjegjësi për një aktivitet në lidhje me menaxhimin, zbatimin, kontrollin, mbikëqyrjen, monitorimin, vlerësimin, raportimin apo auditimin e veprimeve, përfituesi IPA III iu mundëson këtyre personave apo subjekteve ushtrimin e detyrave që shoqërojnë këtë përgjegjësi. Këtu përfshihen veçanërisht rastet kur nuk ka lidhje hierarkike ndërmjet këtyre personave apo subjekteve dhe organeve pjesëmarrëse në atë aktivitet. Përfituesi IPA III u jep këtyre personave apo subjekteve autoritetin që të miratojnë/vendosin ndër të tjera:

(a) marrëveshje zyrtare pune ku detajohen të drejtat dhe detyrimet e strukturave dhe autoriteteve në fjalë;

(b) një sistem të përshtatshëm për shkëmbimin e informacionit ndërmjet tyre dhe organeve në fjalë, duke përfshirë kompetencën për të kërkuar informacion dhe të drejtën e njohjes me dokumentacion dhe kontaktimit të personelit në terren, nëse është e nevojshme;
(c) standardet që duhen përmbushur dhe procedurat që duhen ndjekur.

TITULLI II DISPOZITA SPECIFIKE PËR T'I BESUAR PËRFITUESIT IPA III DETYRA TË ZBATIMIT TË BUXHETIT

Neni 12 Kushtet për t'i besuar Përfituesit IPA III detyrat e zbatimit të buxhetit

(1) Komisioni ia beson përfituesit IPA III detyrat e zbatimit të buxhetit duke lidhur një marrëveshje financimi.

(2) Gjatë menaxhimit të fondeve IPA III, përfituesi IPA III respekton parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, transparencës dhe mosdiskriminimit, si dhe garanton vizibilitetin e asistencës IPA III. Përfituesi IPA III garanton një shkallë mbrojtjeje të interesave financiare të Bashkimit Evropian të barasvlershme me atë që ofron Komisioni kur zbaton fondet IPA III direkt, duke i kushtuar vëmendjen e duhur, ndër të tjera, aspekteve të mëposhtme:

(a) natyrës së veprimit;
(b) risqeve financiare;
(c) nivelit të sigurisë që buron nga sistemet, rregullat dhe procedurat e tyre bashkë me masat që merr Komisioni për të mbikëqyrur dhe mbështetur zbatimin e detyrave që iu janë besuar.

(3) Për të mbrojtur interesat financiarë të BE-së, përfituesi IPA III kryen këto detyra:

(a) ngre dhe garanton funksionimin e një sistemi kontrolli të brendshëm bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare dhe që mundëson veçanërisht parandalimin, identifikimin, raportimin dhe korrigjimin e parregullsive dhe mashtrimin;
(b) përdor një sistem kontabël që jep të dhëna të sakta, të plota, analitike dhe të besueshme në kohën e duhur;
(c) garanton që strukturat dhe autoritetet e përcaktuara në nenin 10(1), germat (a) deri në (d) t'i nënshtrohen auditimit të jashtëm të pavarur që kryhet - në përputhje me standardet e auditimit të pranuara ndërkombëtarisht – nga Autoriteti Auditues që është funksionalisht i pavarur nga strukturat dhe autoritetet në fjalë;
(d) zbaton rregullat dhe procedurat e duhura për t'u dhënë financim palëve të treta, duke përfshirë procedura shqyrtimi transparente, mosdiskriminuese, efikase dhe efektive, rregulla për rikuperimin e fondeve të paguara më tepër si dhe rregulla për përjashtimin nga aksesi në financa;
(e) publikon informacionin e përshtatshëm për përfituesit e fondeve, në përputhje me nenin 23;

(f) garanton mbrojtjen e të dhënave personale të barasvlershme me atë që përcaktohet në Rregulloren (BE) nr. 2018/1725 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit[6] dhe në Rregulloren 2016/679 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit[7].

(4) Përfituesi IPA III njofton Komisionin menjëherë nëse u bëhen ndryshime thelbësore sistemeve, rregullave dhe procedurave të Përfituesit IPA III apo procedurave që kanë lidhje me detyrat e zbatimit të buxhetit që i janë besuar Përfituesit IPA III të fondeve të BE-së. Komisioni shqyrton marrëveshjet e financimit të lidhura me përfituesin IPA III, me qëllim që të garantojë përmbushje të vazhdueshme të kërkesave të përcaktuara në pikën 3.

Neni 13 Besimi i detyrave të zbatimit të buxhetit

(1) ZKA ka përgjegjësinë t'i dorëzojë Komisionit një kërkesë për t'i besuar përfituesit IPA III detyra të zbatimit të buxhetit për një program të caktuar.

(2) Para dorëzimit të kërkesës së përmendur në pikën 1, ZKA sigurohet për përmbushjen e kërkesave të nenit 12(3) dhe ato të Shtojcës B. ZKA mund të bazohet tek rezultatet e një vlerësimi *ex ante* të realizuar në kuadrin një besimi të tillë sipas Rregullores (BE) nr. 231/2014 së Parlamentit Evropian dhe Këshillit[8] ("Rregullorja IPA II") apo te një marrëveshjeje financimi të mëparshme.

Nëse ZKA nuk mund të bazohet tek një vlerësim i mëparshëm *ex ante*, kërkesa mbështetet nga një opinion auditi për strukturat dhe autoritetet sipas nenit 19(1), germat (a) deri (d), i hartuar nga një auditues i jashtëm dhe i pavarur nga ato struktura dhe autoritete. Opinioni i auditit bazohet në verifikime të kryera sipas standardeve të auditimit të pranuara ndërkombëtarisht.

(3) Komisioni, para se të besojë detyra zbatimi të buxhetit të asistencës IPA III, shqyrton kërkesën e përmendur në pikën 1 të këtij neni si edhe strukturat dhe autoritetet e përmendura në nenin 10 si dhe, për qëllime të vlerësimit *ex ante* sipas nenit 61(1) (c) të Rregullores Financiare, siguron prova për t'u bindur se janë përmbushur kërkesat e pikave nenit 12(3) dhe ato të Shtojcës B të kësaj Marrëveshje je. Ky shqyrtim mund të përfshijë edhe verifikime në terren nga Komisioni.

Për të besuar detyra zbatimi të buxhetit të asistencës IPA III, Komisioni mund të bazohet në një vlerësim *ex ante* të kryer për dhënien e kompetencave të menaxhimit sipas Rregullores IPA II ose një marrëveshjeje financimi të mëparshme. Me kërkesë të Komisionit, përfituesi IPA III paraqet evidenca/prova shtesë nëse ato vlerësime nuk përmbushin të gjitha kërkesat.

[6] Rregullorja (BE) 2018/1725 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 tetorit 2018 për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale nga institucionet, organet, zyrat dhe agjencitë e BE-së, si dhe për qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave, që shfuqizon Rregulloren (KE) nr. 45/2001 dhe Vendimin nr. 1247/2002, OJL 295, 21.11.2018.

[7] Rregullorja (BE) nr. 2016/679 e 27 prillit 2016 për mbrojtjen e personave fizikë lidhur me përpunimin e të dhënave personale dhe qarkullimin e lirë të këtyre të dhënave, që shfuqizon Direktivën 95/46/KE (Rregullorja për Mbrojtjen e Përgjithshme të të Dhënave) (GZ L 119, 4.5.2016).

[8] Rregullorja (BE) nr. 231/2014 Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 11 marsit 2014, që krijon Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPAII) (GZ L77, 15 mars 2014, f. 11).

Neni 14 Masat nëse Strukturat Menaxhuese, Autoritetet Menaxhuese dhe Organet e Ndërmjetme nuk respektojnë nenin 12, pikat (2) dhe (3) dhe Shtojcën B

(1) Pasi Komisioni i beson detyrat e zbatimit të buxhetit Përfituesit IPA III, ZKA monitoron përmbushjen e vazhdueshme nga të gjitha strukturat dhe autoritetet e ngritura, bazuar në nenin 10(1), germat (a) deri (d) të kërkesave të përcaktuara në nenin 12, pikat (2) dhe (3) dhe në Shtojcën B. Në rast mospërmbushjeje të këtyre kërkesave, ZKA informon pa vonesa Komisionin – dukë vënë për dijeni KKIPA-n dhe Autoritetin Auditues – si dhe merr masat mbrojtëse të përshtatshme në lidhje me pagesat e kryera dhe kontratat e nënshkruara. Çdo mospërmbushje e kërkesave duhet të pasqyrohet saktë në deklaratat e menaxhimit vjetore dhe në kërkesat për besim/ngarkim detyrash.

(2) Gjithashtu, ZKA ndërmerr hapat e nevojshëm për të garantuar ripërmbushjen e kërkesave të përcaktuara në pikën 1.

Neni 15 Pezullimi ose anulimi i pjesëve të marrëveshjes së financimit për detyrat e besuara për zbatimin e buxhetit

(1) Komisioni monitoron respektimin e nenit 8 (5), nenit 12, pikat (2) dhe (3), nenit 51(1), nenit 91 dhe të Shtojcës B dhe mund të ndërmarrë masa të përshtatshme korrigjuese, duke përfshirë pezullimin apo anulimin në çdo kohë të pjesëve të marrëveshjes së financimit, nëse kërkesat nuk përmbushen më.

(2) Nëse Komisioni pezullon apo anulon pjesë të marrëveshjes së financimit në lidhje me besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit, zbatohen këto dispozita:

(a) Komisioni mund të ndërpresë transferimin e fondeve te përfituesi IPA III;
(b) angazhimet e reja ligjore që bëjnë strukturat dhe autoritetet në fjalë pas njoftimit për pezullim apo anulim, konsiderohen të papranueshme për asistencën IPA III;
(c) pa cenuar mundësinë e korrigjimeve financiare të tjera, Komisioni mund të kryejë korrigjime financiare sipas nenit 43 për transaksionet që preken prej mosrespektimit të mëparshëm të kërkesave për besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit.

(3) Marrëveshja sektoriale apo e financimit mund të përcaktojë dispozita të mëtejshme për pezullimin apo anulimin e pjesëve që lidhen me besimin e detyrave të zbatimit të buxhetit.

SEKSIONI III RREGULLAT PËR PROGRAMIMIN

Neni 16 Programimi i asistencës

(1) Asistenca zbatohet në përputhje me nenin 9 të Rregullores IPA III dhe me Kreun III të Titullit II të Rregullores NDICI.

(2) Programet IPA III përgatiten në partneritet me përfituesin IPA III mbi bazën e kuadrit programues IPA III siç përcaktohet në nenin 7 të Rregullores IPA III, në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 5. Programet konsistojnë nga dokumente veprimi ku përshkruhen hollësitë për secilin veprim, siç përcaktohet në nenin 9(1) të Rregullores IPA III. Përfituesi IPA III i përgatit në konsultim të ngushtë me Komisionin, përveç

dokumentet e veprimit shumëvendëshe, të cilat përgatiten prej Komisionit në konsultim me përfituesit IPA III.

(3) Me përjashtim të programeve të përcaktuara në nenet 16(5), 16(7) dhe 69 ose kur Komisioni është përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të veprimit, përfituesi IPA III përgatit një përgjigje strategjike dhe dokumente veprimi sipas prioriteteve tematike dhe procesit të përcaktuar në kuadrin programues IPA III dhe me orientimet e Komisionit, duke pasur parasysh siç duhet strategjitë përkatëse ku përfshihen strategjitë evropiane makrorajonale dhe baseneve detare. Gjatë përgatitjes, KKIPA koordinohet me administratën e vet dhe garanton konsultim të ngushtë me Komisionin. KKIPA i dorëzon Komisionit përgjigjen strategjike dhe dokumentet e veprimit sipas kalendarit të programimit që dakordësohet me Komisionin.

(4) Përfituesit IPA III garanton konsultimin e duhur dhe akses të përpiktë në informacion për autoritetet publike dhe palët e interesuara përkatëse, siç janë partnerët ekonomikë, socialë dhe mjedisorë, organizatat e shoqërisë civile dhe autoritetet vendore, me qëllim që t'iu mundësohet të luajnë rol të qenësishëm gjatë hartimit, zbatimit dhe proceseve monitoruese të programeve.

(5) Asistenca IPA III mund të zbatohet përmes programeve operacionale mbi bazën e prioriteteve tematike të përcaktuara në kuadrin programues IPA III dhe të orientimeve të Komisionit. Programe të tilla miratohen prej Komisionit mbi bazën e dokumenteve të veprimit të përgatitura prej përfituesit IPA III, në konsultim të ngushtë me Komisionin.

Zbatimi merr formën e programeve shumëvjeçare me këste vjetore sipas nenit 30(3) të Rregullores NDICI.

Programet operacionale përmbajnë të gjithë informacionin e kërkuar prej udhëzimeve të Komisionit, duke përfshirë ndër të tjera:

(a) vlerësim të nevojave afatmesme dhe objektivave;
(b) përshkrim të konsultimeve me palët e interesuara;
(c) përshkrim të veprimeve strategjike të përzgjedhura;
(d) tabelë financiare me hollësi të mjaftueshme, ku totali i kontributit të BE-së çdo vit pasqyrohet në formë indikative;
(e) modalitetet e propozuara për vlerësimin dhe monitorimin;
(f) lista indikative e projekteve madhore, nëse ka;
(g) kur nevojitet, përshkrim të strukturave dhe autoriteteve të përfituesit IPA III, për menaxhimin dhe kontrollin e programit, në përputhje me nenin 10 dhe Shtojcën.

(6) Një projekt madhor i përcaktuar në nenin 16(65)(f) ka kosto totale mbi [][9] milionë EURO.

Përfituesi IPA III ia paraqet projektet madhore Komisionit për vlerësim. Financimi i projekteve madhore dakordësohet nga të dyja palët.

(7) Asistenca IPA III për zhvillimin rural (IPARD) jepet në bazë të prioriteteve përkatëse të përcaktuara në kuadrin programues IPA III, si edhe në strategjitë e zhvillimit bujqësor dhe rural të përfituesit IPA III. Zbatimi merr formën e programeve shumëvjeçare me këste

[9] Siç bihet dakord me përfituesin IPA III dhe përcaktohet në marrëveshjen sektoriale apo të financimit.

vjetore sipas nenit 30(3) të Rregullores NDICI, të cilat hartohen në nivel qendror dhe mbulojnë të gjithë periudhën e zbatimit të IPA III. Programi IPARD III përmban një grup të paracaktuar masash që specifikohen më tej në marrëveshjen sektoriale. Programi përgatitet nga Autoriteti Menaxhues IPARD sipas nenit 10(9), germa (a) e kësaj Marrëveshjeje, si dhe i dorëzohet Komisionit pas konsultimit me palët e interesuara të duhura.

(8) Asistenca IPA III për zhvillimin rural kontribuon në arritjen e objektivave më poshtë:

(a) të rrisë konkurrueshmërinë e sektorit agro-ushqimor, duke e afruar gradualisht me standardet e BE-së dhe duke përmirësuar efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e prodhimit në fermë, çka do t'i përgjigjet më mirë kërkesës së shoqërisë për produkte ushqimore të sigurta, të ushqyeshme dhe të qëndrueshme;
(b) të lehtësojë zhvillimin e biznesit, rritjen dhe punësimin në zonat rurale, të përmirësojë pozitën e fermerëve brenda zinxhirit të vlerës dhe të tërheqë fermerët e rinj drejt bujqësisë;
(c) të kontribuojë në zbutjen dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike, të nxisë menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe të kontribuojë në mbrojtjen e mjedisit;
(d) të përmirësojë zhvillimin e komunitetit dhe kapitalin social në zonat rurale dhe të ndërtojë administrata publike moderne për zhvillimin bujqësor dhe rural, duke respektuar parimet e qeverisjes së mirë.

Neni 17 Miratimi i programeve dhe ndryshimet në to

(1) Pas miratimit të programeve, në to mund të miratohen ndryshime kur çmohet e nevojshme, në përputhje me nenin 25 të Rregullores NDICI;

(2) Propozimet për ndryshime që paraqet përfituesi IPA III janë të argumentuara siç duhet dhe përmbajnë të paktën këtë informacion: tekstin e programit të ndryshuar, arsyet për ndryshimin e propozuar, efektet e pritshme të ndryshimit, si dhe implikimet financiare kur është relevante.

(3) Përfituesi IPA III propozon ndryshime në programe kurdo që është e nevojshme për të pasqyruar ndryshime e bëra në legjislacionin e BE-së, ose kur nevojiten për shkak të ndryshimeve në kushtet e zbatimit.

(4) Për përgatitjen dhe miratimin e ndryshme në programe, zbatohen dispozitat e hollësishme në dokumentet dhe udhëzimet përkatëse të përgatitura nga Komisioni.

SEKSIONI IV RREGULLAT PËR ZBATIMIN

TITULLI I RREGULLA TË PËRGJITHSHME DHE PARIMET E ZBATIMIT

Neni 18 Procedurat e prokurimit, dhënies së granteve dhe të tjera

(1) Asistenca IPA III menaxhohet sipas dispozitave të Rregullores Financiare.

(2) Të gjitha kontratat e shërbimeve, furnizimeve, punimeve, granteve dhe binjakëzimit jepen/akordohen dhe zbatohen në përputhje me kuadrin ligjor të BE-së dhe standardet e Komisionit për zbatimin e veprimeve të jashtme, të cilat janë në fuqi në momentin e shpalljes së procedurës në fjalë.

(3) Rezultatet e procedurave të tenderimit si dhe thirrjeve për fonde granti, binjakëzimi apo çmime publikohen sipas Rregullores Financiare dhe specifikimeve më të hollësishme në nenin 23 të kësaj Marrëveshjeje.

(4) Në rastin e menaxhimi indirekt nga Përfituesi IPA III, brenda një muaji nga hyrja në fuqi e marrëveshjes së financimit përkatëse, ZKA i paraqet Komisionit parashikime për prokurimet, kontraktimet dhe financiare për programin(et) që zbatohen në kuadrin e marrëveshjes së financimit ku mbulohet e gjithë periudha e zbatimit. Ky detyrim nuk gjen zbatim tek programet e zhvillimit rural.

(5) Për sa i përket prokurimit, rregullat dhe procedurat e përfituesit IPA III të cilat janë harmonizuara me Direktivën 2014/24/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit[10] mund të konsiderohen të barasvlershme me rregullat që Komisioni zbaton në përputhje me Rregulloren Financiare. Komisioni mund të pranojë që asistenca IPA III të zbatohet me këto rregulla dhe procedura, me kusht që të përcaktohen në dispozitat përkatëse të marrëveshjes së financimit.

Neni 19 Rregullat e shtetësisë dhe origjinës për procedurat e prokurimit, granteve dhe kontraktimeve të tjera

(1) Pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, granteve dhe çmimeve për programet e financuara nga IPA III është e hapur për organizatat ndërkombëtare[11] dhe rajonale dhe për të gjithë personat fizikë që janë shtetas të tyre apo personat juridikë që janë të vendosur efektivisht në vendet e mëposhtme (në vijim të referuara si "vendet përfituese"):

(a) Shtetet Anëtare, përfituesit IPA III, palët kontraktuese të Marrëveshjes për Zonën Ekonomike Evropiane dhe vendet partnere të përcaktuara në Shtojcën I të Rregullores NDICI; dhe

(b) Vendet të cilave Komisioni u jep akses të ndërsjellë në asistencën e jashtme. Aksesi i ndërsjellë mund të jepet për periudha të shkurtra të paktën njëvjeçare, kurdo që një vend akordon të drejtë pjesëmarrje me të drejta të barabarta për subjektet e BE-së dhe për vendet përfituese në kuadër të IPA III. Komisioni konsultohet me përfituesin IPA III para se të vendosë për aksesin e ndërsjellë.

(2) Të gjitha furnizimet dhe materialet e financuara nga IPA III mund ta kenë origjinën nga cilido vend.

[10] Direktiva 2014/24/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 26 shkurtit 2014 për prokurimin publik dhe që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 31 marsit 2004 për koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave për punë publike, furnizime publike dhe shërbime publike.

[11] Organizatat ndërkombëtare janë organizata ndërkombëtare të sektorit publik të ngritura me marrëveshje ndërkombëtare, agjenci të specializuara të ngritura nga organizata të tilla dhe organizata jofitimprurëse të tjera që asimilohen në organizata ndërkombëtare me vendim të Komisionit.

(3) Rregullat e këtij neni nuk zbatohen dhe nuk vendosin kufizime shtetësie për personat fizikë të punësuar ose të kontraktuar ligjërisht nga një kontraktues i pranueshëm ose, sipas rastit, nga një nënkontraktues i pranueshëm.

(4) Për programet që bashkëfinancohen nga një subjekt apo që zbatohen me menaxhim direkt ose indirekt me subjektet e referuara në nenin 62(1), germa (c)(i) deri në (viii) e Rregullores Financiare, pikën (c) (ii) deri (viii) të nenit 62 (1) të Rregullores Financiare, zbatohen edhe rregullat e pranueshmërisë të atyre subjekteve.

(5) Nëse donatorët financojnë një fond besimi të ngritur prej Komisionit ose përmes të ardhurave të alokuara së jashtmi, zbatohen rregullat e pranueshmërisë të përcaktuara në aktin e themelimit të fondit të besimit ose në marrëveshjen me donatorin në rastin e të ardhurave të alokuara së jashtmi.

(6) Në rastin e programeve të financuara nga IPA III dhe nga një instrument tjetër financiar i BE-së, subjekte të pranueshme cilësohen ato që janë të tilla në kuadrin e secilit instrument.

(7) Në rastin e programeve shumëvendëshe, të pranueshëm janë edhe personat juridikë që janë shtetas si edhe ata që janë efektivisht të vendosur në vendin e përfituesve IPA III dhe rajoneve që mbulohen nga programi.

(8) Rregullat e pranueshmërisë së këtij neni mund të kufizohen sipas shtetësisë, vendndodhjes gjeografike apo natyrës së aplikantëve, nëse këto kufizime nevojiten për shkak të natyrës specifike dhe objektivave të programit si dhe nëse janë të nevojshme për zbatimin efektiv të tij.

(9) Ofertuesit, aplikantët dhe kandidatët nga vendet e papranueshme mund të konsiderohen të pranueshëm prej Komisionit në rast se urgjenca apo mungesa e produkteve dhe shërbimeve në tregjet e vendeve përkatëse, apo në situata të tjera të justifikuara ku aplikimi i rregullave të pranueshmërisë do ta bënte realizimin e një programi të pamundur ose tejet të vështirë.

(10) Me qëllim promovimin e kapaciteteve, tregjeve dhe blerjeve vendorë, përparësi u jepet kontraktuesve vendorë dhe rajonalë kur Rregullorja Financiare parashikon dhënien e fondeve bazuar në një tender të vetëm. Në të gjitha rastet e tjera, pjesëmarrja e kontraktuesve vendorë dhe rajonalë promovohet në përputhje me dispozitat përkatëse të kësaj Rregulloreje.

Neni 20 Pjesëmarrja në programet dhe agjencitë e BE-së

(1) Asistenca mund të jepet për të mbështetur pjesëmarrjen e përfituesit IPA III në programet e BE-së dhe në agjencitë e BE-së.

(2) Pjesëmarrja e përfituesit të IPA III në programet e BE-së ndjek termat dhe kushtet specifike të përcaktuara për çdo program të veçantë të BE-së në një marrëveshje që lidhet ndërmjet Komisionit dhe përfituesit të IPA III, në përputhje me marrëveshjet që përcaktojnë parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e përfituesve të IPA III në programet e BE-së.

Neni 21 Parimet e zbatimit të mbështetjes buxhetore për Përfituesin IPA III

(1) Komisioni mund të vendosë t'i japë mbështetje buxhetore Përfituesit IPA III bazuar në nenin 236 të Rregullores Financiare dhe me Udhëzuesin për Mbështetjen Buxhetore të BE-së, me kusht që të përmbushen kriteret e pranueshmërisë të zbatueshme për qëllimet e zbatimit të asistencës IPA III. Mbështetja e tillë zbatohet me menaxhim direkt.

(2) Disbursimi i mbështetjes buxhetore kushtëzohet me arritjen e progresit të kënaqshëm në përmbushjen e objektivave të miratuar me Përfituesin IPA II dhe të parashikuar në marrëveshjen e financimit.

(3) Marrëveshja e financimit përkatëse që lidhet me përfituesin IPA III përmban:

(a) detyrimin për vendin e tretë që t'i japë Komisionit informacion të besueshëm dhe në kohë reale që i mundëson Komisionit të vlerësojë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në nenin 236(2) të Rregullores Financiare;
(b) të drejtën e Komisionit që të pezullojë marrëveshjen e financimit nëse përfituesi IPA III shkel një detyrim lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, parimet demokratike dhe shtetin e së drejtës, si edhe në rastet e korrupsionit të rëndë;
(c) dispozita të përshtatshme sipas të cilave vendi i tretë zotohet të rimbursojë plotësisht ose pjesërisht financimin e operacionit përkatës, në rast se konstatohet se pagimi i fondeve përkatëse të BE-së cenohet nga parregullsi të rënda që i atribuohen atij vendi.

Neni 22 Parimet e zbatimit për binjakëzimin

(1) Veprimet mund të zbatohen me binjakëzim kur administratat e Shtetet Anëtare të përzgjedhura pranojnë të japin ekspertizën e nevojshme për sektorin publik. Binjakëzimi mbulon rimbursimin e shpenzimeve e bëra nga Shteti(et) Anëtar(e) të përfshirë si dhe mund të financojë komandimin afatgjatë të një këshilltari para-anëtarësimi që caktohet të japë këshillim me kohë të plotë për administratën e përfituesit IPA III, që këtej e tutje referohet si "këshilltar rezident i binjakëzimit" (KRB/RTA). Përfituesi IPA III i vë në dispozicion KRB-së mjedise të mjaftueshme për zyrë.

(2) Manuali i binjakëzimit i hartuar nga Komisioni zbatohet për të gjitha binjakëzimet.

TITULLI II TRANSPARENCA DHE VIZIBILITETI

Neni 23 Informimi, publiciteti dhe transparenca

(1) Përfituesi IPA II angazhohet të rritë transparencën dhe llogaridhënien në dhënien e asistencës. Ai duhet të publikojë informacion mbi shumën e asistencës të marrë në kuadrin e IPA III.

(2) Në rastin e menaxhim indirekt, përfituesi IPA III publikon informacion për marrësit e asistencës IPA III në përputhje me rregullat dhe procedurat e zbatueshme, në masën që këto rregulla konsiderohen të barasvlershme me ato të Komisionit, pas vlerësimit të kryer prej Komisionit.

(3) Në mungesë të një vlerësimi të tillë ose kur vlerësimi konstaton se rregullat e përfituesit IPA III nuk janë të barasvlershme me ato të Komisionit, përfituesi IPA III respekton kërkesat për publikimin e informacionit mbi prokurimet dhe kontratat grant që përmbajnë marrëveshjet e financimit apo marrëveshjet sektoriale, sipas rastit.

(4) Përfituesi IPA III publikon programet IPA III, si dhe çdo rishikim ose ndryshim në to.

Neni 24 Komunikimi strategjik dhe vizibiliteti

(1) Përfituesi IPA III rrit ndërgjegjësimin publik mbi mundësitë që burojnë nga integrimi më i afërt me BE-në dhe reformat me mbështetjen e BE-së, me synimin për të garantuar përkrahjen publike për BE-në dhe aderimin në BE;

(2) Me masat e vizibilitetit dhe komunikimit, përfituesi i IPA III informon publikun për:

(a) vlerat, politikat dhe programet e BE-së dhe ndikimin e tyre në jetën e përditshme të njerëzve;
(b) procesin e aderimit në BE me reformat shoqëruese dhe përfitimet e tyre afatgjata dhe mundësitë për qytetarët dhe ekonomitë;
(c) financimet e BE-së për përfituesin IPA III dhe lidhjet e tyre me vlerat dhe objektivat e politikave të BE-së, me fokus në ndikimin e prekshëm pozitiv që projektet e financuara prej BE-së kanë tek qytetarët dhe ekonomitë.

(3) Në veçanti, përfituesi IPA III pranon origjinën e financimeve të BE-së dhe siguron vizibilitetin e duhur të këtyre financimeve përmes:

(a) përfshirjes së pohimit se fondet janë dhënë nga BE-ja në të gjitha dokumentet dhe materialet e komunikimit për zbatimin e fondeve, duke përfshirë në faqen zyrtare të internet dhe llogaritë në mediat sociale, kur ekzistojnë; dhe

(b) promovimit të veprimeve dhe rezultateve të tyre duke dhënë informacion koherent, efektiv dhe proporcional për audiencat e shumëfishta, përfshirë median.

(4) Përfituesi IPA III informon Komisionin për planifikimin dhe zbatimin e masave të vizibilitetit dhe komunikimit dhe kërkon të krijojë sinergji me masat që ndërmerr Komisioni.

(5) Komisioni dhe përfituesi IPA III bien dakord mbi një plan koherent me aktivitete vizibiliteti dhe komunikimi dhe publikojnë në mënyrë aktive informacion mbi programet dhe veprimet e asistencës IPA III në vendin përfitues IPA III. Procedurat për zbatimin e aktiviteteve të tilla përcaktohen në marrëveshjet sektoriale ose të financimit.

(6) Në rastet e menaxhimit direkt, zbatimi i aktiviteteve të përmendura në pikën 5 është përgjegjësi e Komisionit, me ndihmën e përfituesit IPA III.

(7) Në rastet e menaxhimit indirekt nga përfituesi IPA III dhe programet e bashkëpunimit ndërkufitar të përcaktuara në nenin 64(2), germa (b), zbatimi i aktiviteteve të përmendura në pikën 5 është përgjegjësi e institucioneve përkatëse të përfituesit IPA III.

(8) Aktivitetet e vizibilitetit dhe komunikimit promovojnë transparencën dhe llogaridhënien mbi përdorimin e fondeve, duke iu nënshtruar dispozitave specifike për mosdeklarimin e buxheteve indikative për prokurimin e furnizimeve dhe punimeve para nënshkrimit të kontratës, sipas rastit.

(9) Përfituesi IPA III raporton për aktivitetet e veta të vizibilitetit dhe komunikimit lidhur me asistencën IPA III pranë komitetit monitorues IPA III dhe komiteteve monitoruese sektoriale.

TITULLI III MBROJTJA E TË DHËNAVE DHE KONFIDENCIALITETI

Neni 25 Mbrojtja e të dhënave

(1) Përfituesi IPA III garanton mbrojtje të përshtatshme të të dhënave personale të barasvlershme me atë që parashikon Rregullorja (BE) 2018/1725 dhe Rregullorja (BE) 2016/679 siç referohet në nenin 12(3), germa (f). E dhënë personale nënkupton çdo të dhënë për një person fizik të identifikuar apo të identifikueshëm. Për çdo operacion që ka të bëjë me përpunimin e të dhënave personale, si p.sh. mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja apo tjetërsimi, nxjerrja, konsultimi, përdorimi, publikimi, fshirja apo shkatërrimi, respektohen rregullat dhe procedurat e përfituesit IPA III dhe shtrihet vetëm deri në masën e nevojshme për zbatimin e asistencës IPA III.

(2) Në veçanti, përfituesi IPA III merr të gjitha masat e duhura teknike dhe organizative për sigurinë, lidhur me risqet e qenësishme të operacioneve të tilla dhe me natyrën e informacionit për personat fizikë në fjalë, me qëllim që:

(a) të parandalohet aksesi i paautorizuar i çdo personi në sistemet kompjuterike që kryejnë operacione të tilla, dhe veçanërisht leximi, kopjimi, tjetërsimi apo heqja e paautorizuar e pajisjes ruajtëse; hedhjen e paautorizuar të të dhënave si dhe çdo publikim, tjetërsim apo fshirje të paautorizuar të informacionit të ruajtur;
(b) të garantohet që përdoruesit e autorizuar të një sistemi TI që kryen operacione të tilla të kenë akses vetëm në informacionin që u takon sipas të drejtave të tyre të aksesit;
(c) të ndërtohet struktura organizative e tillë që të plotësojë kërkesat e mësipërme.

Neni 26 Konfidencialiteti

(1) Pa cenuar nenin 49, përfituesi IPA III dhe Komisioni ruajnë konfidencialitetin e çdo dokumenti, informacioni apo materiali tjetër të klasifikuar si konfidencial, të cilët lidhen drejtpërdrejt me zbatimin e asistencës IPA III.

(2) Përfituesi IPA III pranon që subjekti i besuar sipas nenit 62(1), germa (c)(ii) deri në (viii) i Rregullores Financiare të cilit Komisioni i ka besuar detyra zbatimi të buxhetit, mund t'i përcjellë Komisionit dokumente që disponon, por vetëm për qëllime të monitorimit të zbatimit të detyrave të besuara. Komisioni respekton marrëveshjet e konfidencialitetit të lidhur ndërmjet përfituesit IPA III dhe atij subjekti në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

(3) Palët marrin pëlqimin me shkrim të njëra-tjetrës para publikimit të informacionit të tillë.

(4) Palët kanë detyrimin të respektojnë konfidencialitetin deri pesë vjet pas përfundimit të periudhës së zbatimit të marrëveshjes përkatëse të financimit.

TITULLI IV OFRIMI I LEHTËSIRAVE DHE TAKSIMI

Neni 27 Ofrimi i lehtësirave për zbatimin e programeve dhe ekzekutimin e kontratave

(1) Për të garantuar zbatimin efektiv të programeve të financuara tërësisht apo pjesërisht nga një tjetër instrument i BE-së, përfituesi IPA III merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar që:

(a) në rastet e procedurave të tenderimit për shërbime, furnizime apo punimeve, si edhe në thirrjet për propozime për grante dhe binjakëzime, personat fizikë dhe juridikë që kanë të drejtë të marrin pjesë në procedura konkurrimi sipas nenit 19, gëzojnë të drejtën e vendosjes dhe vendbanimit të përkohshëm kur këtë e kërkon rëndësia ose kohëzgjatja e kontratës. Kjo e drejtë fitohet vetëm pasi shpallet procedura dhe gëzohet nga personeli drejtuesi dhe teknik, duke përfshirë Këshilltarët Rezidentë të Binjakëzimit (KRB) të cilët janë të nevojshëm për të kryer studime dhe masa të tjera përgatitore për hartimin e tenderëve/aplikimeve/propozimeve. E drejta për vendosje të përkohshme e ofertuesve/kandidatëve/aplikantëve të pasuksesshëm në procedurë skadon një muaj pas shpalljes së vendimit për fituesin e kontratës;

(b) ofertuesit dhe aplikantët të dorëzojnë ofertat/aplikimet/propozimet pa hasur pengesa, si p.sh. kërkesa ligjore, administrative ose doganore shtesë që cenojnë trajtimin e barabartë ndërmjet ofertuesve apo aplikantëve, përveç kur këto kërkesa përcaktohen në vendimin përkatës të Komisionit;

(c) personeli që merr pjesë në zbatimin e programeve të financuara tërësisht apo pjesërisht nga ndonjë instrument tjetër i BE-së dhe rrethi i tyre i ngushtë familjar t'u akordohet përfitime, privilegje dhe përjashtime jo më pak të favorshme sesa ato që iu ofrohen personelit ndërkombëtar apo personelit të atashuar të = punësuar në Republikën e Shqipërisë, në kuadrin e cilësdo marrëveshjeje tjetër dypalëshe apo shumëpalëshe ose marrëveshjeve për asistencë dhe bashkëpunim teknik;

(d) personeli që merr pjesë në zbatimin e programeve të financuara tërësisht apo pjesërisht nga ndonjë instrument tjetër i BE-së dhe rrethi i tyre i ngushtë familjar të lejohen të hyjnë në Republikën e Shqipërisë, të vendosen në Republikën e Shqipërisë, të punojnë aty dhe të largohen Shqipëria, siç justifikohet nga natyra e kontratës përkatëse;

(e) të jepen të gjitha lejet e nevojshme për importimin e mallrave, veçanërisht të pajisjeve profesionale që nevojiten për ekzekutimin e kontratës përkatëse, duke respektuar ligjet ekzistuese, rregullat dhe aktet normative të përfituesit IPA III;

(f) importet e kryera në kuadrin e programeve të financuara tërësisht apo pjesërisht nga asistenca IPA III apo nga ndonjë instrument tjetër i BE-së, të përjashtohen nga të gjitha detyrimet doganore;

(g) të jepen të gjitha lejet e nevojshme për ri-eksportimin e mallrave më lart, sapo kontrata përkatëse të jetë ekzekutuar plotësisht;

(h) të jepen autorizimet për importin ose blerjen e valutës së nevojshme për zbatimin e kontratës përkatëse dhe zbatimin e akteve normative për kontrollin e kursit të këmbimit kombëtar në mënyrë jodiskriminuese për kontraktuesit, pavarësisht shtetësisë apo ku janë vendosur (kanë selinë).

(i) Riatdhesimi i fondeve të marra për kryerjen e veprimeve të financuara tërësisht ose pjesërisht nga instrumente të tjera të BE-së.

(j) transaksionet e nevojshme për realizimin e kontratave të financuara tërësisht ose pjesërisht nga instrumentet e tjera të BE-së të përjashtohen nga procedurat që kërkojnë transferimin e pagesës për mallrat dhe/ose shërbimet te kontraktuesit e tyre jashtë shtetit përmes bankave apo institucioneve financiare që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë.

(2) Përfituesi IPA III garanton bashkëpunimin e plotë të të gjitha autoriteteve përkatëse. Gjithashtu, garanton akses në ndërmarrjet shtetërore dhe institucionet qeveritare që janë të përfshira apo janë të nevojshme në zbatimin e veprimit apo në ekzekutimin e kontratës.

(3) Pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, përfituesi IPA III miraton ose ndryshon legjislacionin dhe/ose aktet normative të nevojshme për ekzekutimin e kërkesave të parashikuara në këtë nen, ndërsa i mban këto procedura të thjeshta, të arsyeshme dhe sa më pak kohëshpenzuese.

Neni 28 Rregullat për taksat, tarifat doganore dhe ato fiskale

(1) Përveç kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje sektoriale apo financimi, taksat, tarifat dhe detyrimet me efekt të barasvlershëm, nuk janë të pranueshme në kuadrin e programeve IPA III apo ndonjë instrumenti tjetër të BE-së. Ky rregull zbatohet edhe për bashkëfinancimin e dhënë nga përfituesi i IPA III, subjektet e tjera bashkëfinancuese, marrësit e asistencës IPA III apo çdo financim i dhënë nga instrumente të tjera të BE-së.

(2) Dispozita e mëposhtme gjejnë zbatim:

(a) për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi "*kontraktues i BE-së*" nënkupton çdo person fizik ose juridik që ekzekuton një kontratë të BE-së. Termi "kontraktues i BE-së" përfshin veçanërisht kontraktuesit e shërbimeve/furnizimeve/punimeve, përfituesit e grantit (duke përfshirë kontraktuesit e binjakëzimit, përfituesit e kontraktuar në kuadrin e binjakëzimit), ortakët e një konsorciumi apo sipërmarrjeje me kapital të përbashkët ose bashkëpërfituesit ose subjektet partnere në grante, nënkontraktues grantesh, nënkontraktues, organizata ndërkombëtare dhe KRB-të në kuadrin e kontratave të binjakëzimit si edhe kontraktuesit në kuadrin e Instrumentit për Asistencën Teknike dhe Shkëmbimin e Informacionit (TAIEX).

(b) termi "*kontratë e BE-së*" nënkupton çdo kontratë, kontratë granti apo marrëveshje me menaxhim direkt ose indirekt përmes të cilës një aktivitet financohet nga IPA III ose ndonjë instrument tjetër i BE-së, duke përfshirë nëngrantet apo nënkontraktimet. Termi "*kontratë e BE-së*" përfshin edhe dhënien e asistencës në kuadrin e TAIEX dhe pjesëmarrjes në programet e BE-së;

(c) të gjitha importet nga kontraktuesit e BE-së lejohen të hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa paguar tarifa doganore apo importi, taksën mbi vlerën e shtuar (TVSH), akcizë dhe taksa të tjera konsumi apo tarifa, dhe detyrime me efekt të barasvlershëm me to. Ky përjashtim zbatohet vetëm për importet ose tarifat për mallrat e furnizuar dhe/ose shërbimet apo punimet e furnizuara/kryera nga kontraktuesit e BE-së në kuadrin e një kontrate të BE-së. Republika e Shqipërisë garanton që të gjitha importet në fjalë të lihet në lira në pikën e hyrjes për t'iu dorëzuar kontraktuesve të BE-së siç e kërkojnë dispozitat e kontratës përkatëse dhe për përdorim të menjëhershëm, siç e kërkon zbatimi normal i kontratës, pavarësisht nëse ka vonesa apo mosmarrëveshje lidhur me tarifat dhe taksat doganore të lartpërmendura;

(d) kontraktuesit e BE-së përjashtohen nga TVSH-ja për çdo shërbim që japin apo mallra që furnizojnë ose punime që kryhen në kuadrin e kontratës së BE-së. Edhe mallrat e furnizuara, shërbimet e ofruara apo punimet e kryera nga një kontraktues për një kontraktues të BE-së përjashtohen nga TVSH-ja në atë masë që shërbejnë për të përmbushur objektivat dhe aktivitetet në kuadrin e kontratës së BE-së.

(e) përjashtimi i parashikuar në germën (d) fiton efektet përmes mekanizmave të mëposhtëm.

(i) përfituesi IPA III garanton ekzistencën e një mekanizmi efektiv dhe procedurave për përjashtimin *ex ante* nga TVSH-ja. Ky mekanizëm lejon kontraktuesit e BE-së dhe kontraktuesit e kontraktuesve të BE-së që të lëshojnë faturë pa TVSH.
Komisioni mund të aplikojë një korrigjim financiar nëse përfituesi IPA III nuk garanton ekzistencën e një mekanizmi efektiv dhe procedurave për përjashtimin *ex ante* nga TVSH-ja menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

(ii) Me derogim, në raste të justifikuara siç duhet kur përjashtimi *ex ante* është teknikisht dhe praktikisht i pamundur, përjashtimi nga TVSH-ja vihet në efekt përmes rimbursimit apo kompensimit.

Kur zbatohet procedura e rimbursimit, kontraktuesit e BE-së dhe kontraktuesit e kontraktuesve të BE-së marrin rimbursimin e TVSH-së direkt nga autoriteti tatimor përgjegjës sapo depozitojnë një kërkesë me shkrim pranë këtij autoriteti bashkë me dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë për rimbursimin e TVSH-së

Kur zbatohet procedura e zbritjes, kontraktuesi i BE-së dhe kontraktuesit e kontraktuesve të BE-së gëzojnë të drejtën të zbresin çdo TVSH të paguar në lidhje me mallrat e furnizuara apo shërbimet e dhëna apo punimet e ekzekutuara në kuadrin e asistencës IPA III, të cilat janë të përjashtuara nga TVSH-ja siç parashikohet në Marrëveshje, zbritje kjo që i bëhet TVSH-së së akumuluar prej tyre gjatë transaksioneve të biznesit të tyre të zakonshëm jashtë IPA III.

Autoriteti tatimor përgjegjës trajton çdo kërkesë për rimbursim taksash dhe zbritje brenda maksimumi 60 ditëve kalendarike, pa ndonjë kosto, përveç tarifave minimale administrative të arsyeshme.

(f) fitimet ose të ardhurat që burojnë nga kontratat e BE-së taksohen në Republikën e Shqipërisë sipas regjimit tatimor kombëtar/vendor. Sidoqoftë, personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë personelin e jashtëm dhe KRB-të, rezidentë ose të vendosur në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian apo në një vend tjetër të pranueshëm sipas IPA III të ndryshëm nga Përfituesi IPA III, të cilët ekzekutojnë kontrata të BE-së si edhe kontraktuesit e marrësve (pavarësisht shtetësisë apo vendbanimit të tyre përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen e shmangies së taksimit të dyfishtë apo të evazionit tatimor të lidhur nga Republika e Shqipërisë) përjashtohen nga tatim-fitimi apo tatimi mbi të ardhurat në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë tatimin në burim apo taksat e përkohshme;

(g) granti që BE-ja i jep përfituesit të grantit nuk përbën fitim apo të ardhur për atë përfitues granti. Nëse gjenerohet fitim nga një kontratë granti, Komisioni gëzon të drejtën të rikuperojë përqindjen e fitimit sipas kushteve të kontratës përkatëse. Pjesa e mbetur e fitimit mund të taksohet sipas regjimit tatimor kombëtar/vendor;

(h) shpenzimet e kontraktuesve çlirohen nga tarifat e importit, akcizat dhe taksa të tjera konsumi apo çdo taksë tjetër e ngjashme, taksa apo tarifa me efekt të barasvlershëm, për shpenzimet që bëhen në lidhje me mallrat e furnizuar dhe shërbimet e dhëna dhe punimet e kryera prej kontraktuesit të BE-së në kuadrin e kontratës së BE-së;

(i) të mirat/aktivet financiare apo materiale, duke përfshirë objektet e ndërtuara dhe/ose të drejtat e transferuara te përfituesit të veprimeve/aktiviteteve ose te përfituesit e kontratave që realizohen në kuadër të programeve IPA III apo çdo instrumenti tjetër të BE-së nuk gjenerojnë për këta përfitues "taksa trashëgimie dhe transferimi" apo taksa dhe tarifa të tjera me efekt të barasvlershëm me to;

(j) sendet personale dhe familjare për përdorim vetjak të importuara nga personat fizikë (dhe personat e rrethit të tyre të ngushtë familjar), me përjashtim të atyre të pajtuar në Shqipëri, të cilët kryejnë detyra të përcaktuara në kontrata shërbimi dhe/ose pune

dhe/ose granti dhe/ose binjakëzimi apo marrëveshje, përjashtohen nga tarifat doganore, tarifat e importit, taksat dhe tarifat e tjera që kanë efekt të barasvlershëm me to dhe/ose kritere tejet shtrënguese kolaterali; këto sende personale apo familjare ri-eksportohen ose asgjësohen në vendin përfitues në përfundim të kontratës, në përputhje me aktet normative në fuqi të [përfituesit IPA III];

(k) kontraktuesit e BE-së nuk paguajnë taksën e vulës apo regjistrimit dhe asnjë taksë tjetër me efekt të barasvlershëm në [përfituesin IPA III], kur këto taksa apo tarifa lidhen drejtpërdrejt me një kontratë të BE-së. Ky përjashtim zbatohet edhe për transaksionet (duke përfshirë delegimin e të drejtave) dhe dokumentet që lidhen me pagesa që i bëhen kontraktorit të BE-së, përfshirë kontratat e lidhura ndërmjet përfituesve të grantit (përfshirë ortakët dhe nënkontraktorët e grantit) dhe kontraktorët e tyre (përfshirë personelin e tyre dhe ekspertët që kontraktojnë) dhe kontratat e lidhura për shpenzime të rastit dhe të përkohshme përkatësisht në kuadrin e kontratave të shërbimit dhe të punimeve, kur transaksione apo pagesa të tilla lidhen drejtpërdrejt me një kontratë të BE-së;

(l) kontraktorët e BE-së përjashtohen edhe nga këto tarifa:
   i. taksa e veçantë e komunikimit;
   ii. taksat për mjetet motorike
   iii. tarifa të veçanta që aplikohen nga autoritete rajonale apo vendore ose borde të veçanta në kontekstin e ekzekutimit të kontratës jo-proporcional me koston e ekzekutimit të tyre ose që kanë efekt të barasvlershëm me taksat.

(3) Kur është e nevojshme, përfituesi IPA III miraton ose ndryshon aktet nënligjore dhe/ose miraton aktet e nevojshme për të bërë efektive dispozitat tatimore në këtë Marrëveshje menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi.

(4) Rregullat dhe procedurat e parashikuara në këtë nen zbatohen për çdo taksë apo tarifë tjetër të ngjashme ose me efekt të barasvlershëm, të cilat mund të miratohen pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, që janë ndryshime apo zëvendësime të atyre ekzistuese.

(5) Në rast konflikti të dispozitave të këtij neni dhe legjislacionit të përfituesit IPA III, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të kenë përparësi. Në rast aderimi në BE, përfituesi IPA III vazhdon të zbatojë dispozitat e nenit 27 dhe të këtij neni, përveç kur ato janë të papajtueshme me detyrimet e tij në kuadrin e *acquis* përkatës të BE-së.

SEKSIONI V RREGULLAT PËR MENAXHIMIN FINANCIAR TË ASISTENCËS IPA III

TITULLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 29 Pranueshmëria e shpenzimeve

(1) Shpenzimet nuk financohen më shumë se një herë nga IPA III. Gjithashtu, shpenzimet e financuara nga IPA III nuk përfitojnë ndonjë financim tjetër nga buxheti i BE-së.

(2) Shpenzimet e bëra nga marrësit dhe pagesat e kryera nga përfituesi IPA III nuk pranohen për financim sipas Rregullores IPA III para nënshkrimit të marrëveshjes përkatëse të financimit, kontratave dhe shtojcave, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në nenin 27(6) të Rregullores NDICI.

(3) Shpenzimet e mëposhtme nuk pranohen për financim në kuadrin e Rregullores IPA III:

(a) blerja e tokës dhe e godinave ekzistuese, përveç kur justifikohet nga natyra e programit në vendimin e financimit;

(b) shpenzime të tjera siç parashikohen në marrëveshjet sektoriale apo të financimit.

(4) Afati për pranueshmërinë e shpenzimeve përcaktohet në marrëveshjet e financimit.

Neni 30 Bashkëfinancimi i programeve IPA III

(1) Programet që zbatohen me menaxhim indirekt nga përfituesi IPA III mund të kërkojnë kontribut financiar si të përfituesit IPA, ashtu edhe të BE-së.

(2) Norma e bashkëfinancimit merr formën e bashkëfinancimit dhe përcaktohet në marrëveshjen sektoriale apo të financimit.

(3) Kur kërkohet kontribut financiar si nga përfituesi IPA III edhe nga BE-ja, kontributi i BE-së përcaktohet në marrëveshjet sektoriale apo të financimit.

TITULLI II RREGULLAT PËR MENAXHIMIN INDIREKT NGA PËRFITUESI IPA III

Neni 31 Rregullat specifike për pranueshmërinë e shpenzimeve për IPARD

(1) Për programin IPARD zbatohen dispozitat specifike më poshtë:

(a) kontributi i BE-së për projektet e investimeve, në kuadrin e programeve të zhvillimit rural, shlyhet nëse projektit i bëhet një modifikim thelbësor brenda pesë vitesh nga pagesa përfundimtare e Agjencisë IPARD;

(b) në rastin e shpenzimeve standarde për njësi, pagesat e njëhershme që nuk i tejkalojnë 100 000 EURO të kontributit publik dhe financimit me normë fikse (të sheshtë), që përcaktohen nga aplikimi i një përqindjeje ndaj një ose disa kategorish shpenzimesh të caktuara, BE-ja mbulon vetëm e përcaktuara për secilën masë dhe siç ka përcaktuar Agjencia IPARD përkatëse para shpalljes së thirrjes për aplikime.

(c) kontributet që kalojnë nga një program IPARD III në një instrument financiar që të përdoren brenda objektit të atij programi IPARD III, konsiderohen shpenzime të pranueshme.

(d) Në përcaktimin e masës së shpenzimeve publike si përqindje e shpenzimeve totale të pranueshme të investimit, nuk merret parasysh ndihma kombëtare për të lehtësuar aksesin në kreditim që jepet pa ndonjë kontribut të BE-së në kuadrin e Rregullores (BE) 2021/1529.

Neni 32 Gjurma e auditit

ZKA garanton vënien në dispozicion të të gjithë informacionit relevant që garanton gjurmë auditi mjaftueshëm të hollësishme. Ky informacion përfshin evidenca/prova të dokumentuara për autorizimin e kërkesë-pagesave, për kontabilizimin dhe pagimin e kërkesave të tilla, si edhe trajtimin e paradhënieve, garancive dhe borxheve.

Neni 33 Pagesat e kontributit të BE-së

(1) Pagesat e kontributit të BE-së bëhen brenda kufijve të fondeve në dispozicion.

(2) Pagesat mund të kryhen në formë para-financimi, pagesash të ndërmjetme dhe ekzekutim balance përfundimtare, sipas procedurave të përcaktuara në nenin 42(2). Në rastin e kontributeve si nga BE-ja edhe nga përfituesi IPA III, pagesa e kontributit të BE-së për financimin e programeve në fjalë llogaritet duke aplikuar normën e bashkëfinancimit të përcaktuar në marrëveshjen sektoriale apo të financimit ndaj shpenzimeve të pranueshme të certifikuara sipas nenit 61(5) dhe është objekt i maksimumit të kontributit të BE-së përcaktuar në marrëveshjen sektoriale apo atë të financimit.

(3) Deri më 15 janar dhe 15 korrik të çdo viti, përveç kur përcaktohet ndryshe në marrëveshjen sektoriale apo atë të financimit, ZKA i dërgon Komisionit një parashikim të kërkesë-pagesave të mundshme për vitin financiar në fjalë dhe për vitin financiar pasues, në lidhje me të gjitha programet. Komisioni mund të kërkojë përditësim të këtij parashikimi, sipas rastit.

(4) Komisioni ia bën pagesat Organit Kontabël brenda 90 ditësh pas përmbushjes së kushteve të përcaktuara në nenet 34, 35 ose 36. Komisioni mund ta ndërpresë këtë afat 90-ditor për kërkesë-pagesat, me qëllim që të kërkojë të gjithë dokumentacionin justifikues të nevojshëm për të sqaruar çdo element lidhur me pasqyrën e shpenzimeve, duke përfshirë informacion mbi raportimin e parregullsive sipas nenit 51(2) dhe Shtojcës H.

(5) Shumat e paraqitura në programet e dorëzuara prej përfituesit IPA III në pasqyrat e shpenzimeve, në kërkesë-pagesat dhe në shpenzimet e përmendura në raportet e zbatimit shprehen në Euro. Përfituesi IPA III garanton që për flukset e thesarit ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit IPA III, norma e kursit të këmbimit për konvertimin e monedhës kombëtare

në Euro të jetë norma mujore kontabël e Euros e përcaktuar nga Komisioni për muajin kur shpenzimi i paguar është regjistruar në llogaritë e Organit Kontabël ose të Organit të Ndërmjetëm për menaxhimin financiar në fjalë të specifikuar në marrëveshjen përkatëse të financimit .

(6) Komisioni ia bën pagesat përfituesit IPA III në Euro në llogarinë në Euro, me kusht që të ketë fonde buxhetore, në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenet 34, 35 ose 36 si dhe në marrëveshjet sektoriale apo të financimit. Llogaritë në Euro hapen posaçërisht për programet dhe përdoren vetëm për transaksionet që lidhen me ato programe në përputhje me dispozitat e marrëveshjeve përkatëse sektoriale apo të financimit.

(7) Përfituesi IPA III garanton që përfituesit/marrësit të marrin shumën totale të kontributit publik në kohën e duhur dhe të plotë. Nuk aplikohet asnjë tarifë që redukton këto shuma për marrësit, si dhe kontributi publik dhe aktivët e financuar në këtë mënyrë nuk i nënshtrohen asnjë konfiskimi administrativ apo gjyqësor, sekuestrimi apo zbritjeve të ngjashme.

(8) Nëse balanca e llogarisë në Euro e përcaktuar në pikën 6 është e pamjaftueshme për të mbuluar kërkesë-pagesat e dorëzuara prej përfituesve në pritje të marrjes së pagesës nga Komisioni, përfituesi IPA III përdor fondet kombëtare për të parafinancuar kontributin e BE-së. Në këto raste, fondet kombëtare trajtohen si fonde të BE-së dhe pika 6 zbatohet në momentin kur pagesa e plotë e kontributit të përfituesit IPA III (nëse ka) si dhe kontributi i BE-së i parafinancuar prej fondeve kombëtare regjistrohen në llogaritë e Organit Kontabël.

(9) Asistenca IPA III mbulon vetëm shpenzimet e bëra dhe të paguara nga Përfituesi IPA III në përputhje me rregullat e pranueshmërisë të parashikuara në klauzolat kontraktuale dhe kuadrin ligjor të ngritur nga Rregullorja Financiare, Rregullorja NDICI, Rregullorja Zbatuese IPA III dhe nenet 29, 30 dhe 31 të kësaj Marrëveshjeje dhe siç përcaktohet në marrëveshjet sektoriale dhe të financimit, sipas rastit.

(10) Shkëmbimi i informacionit, duke përfshirë dërgimin e kërkesë-pagesave sipas neneve 34, 35 dhe 36 të kësaj Marrëveshjeje, ndërmjet Komisionit dhe strukturave e autoriteteve të përmendura në nenin 10 bëhen në mënyrë elektronike, kur është e mundur, duke ndjekur procedurat që udhëzon Komisioni.

Neni 34 Parafinancimi

(1) Kushtet bazë për pagesën e parafinancimit janë si më poshtë:

(a) ZKA ia ka njoftuar Komisionit hapjen e llogarisë përkatëse në Euro;
(b) marrëveshja përkatëse e financimit ka hyrë në fuqi.

(2) Dispozitat e hollësishme për llogaritjen e pagesave të parafinancimit në programet njëvjeçare dhe shumëvjeçare përcaktohen në marrëveshjet sektoriale apo të financimit.

(3) Shuma totale e parafinancimit paguhet jo më vonë sesa data e mbylljes së programeve.

Neni 35 Pagesat e ndërmjetme

(1) Kushtet minimale për pagesën e ndërmjetme janë si më poshtë:

(a) ZKA t'i ketë dërguar Komisionit kërkesë-pagesën e shoqëruar me pasqyrën e shpenzimeve të certifikuar ku specifikohen shumat e paguara dhe shpenzimet e njohura, duke përfshirë informacion për parafinancimin, sipas rastit. Kërkesë-pagesa përmban edhe informacion relevant për zbatimin, siç përcaktohet hollësisht në marrëveshjen sektoriale apo atë të financimit;

(b) të jenë respektuar tavanet për kontributin e BE-së, siç përcaktohet në vendimin për financim;

(c) KKIPA t'i ketë dërguar Komisionit raportin vjetor të zbatimit, sipas nenit 59(1);

(d) Autoriteti Auditues t'i ketë dërguar Komisionit opinionin vjetor të auditit dhe raportin vjetor të auditimit, sipas nenit 63(1)dhe (2);

(e) marrëveshja përkatëse e financimit të jetë në fuqi;

(f) Komisionit t'i jetë vënë në dispozicion çdo informacion që ka kërkuar.

(2) Pa cenuar opinionin vjetor të auditit, nëse rezulton se nuk janë respektuar rregullat e zbatueshme apo se fondet nuk janë përdorur siç duhet, pagesat mund të pezullohen ose të ndërpriten sipas procedurës të përcaktuar në nenet 38 dhe 39.

Neni 36 Pagesa e balancës përfundimtare

(1) Kushtet bazë për pagimin e balancës përfundimtare janë si më poshtë:

(a) ZKA t'i ketë dërguar Komisionit një pasqyrë financiare të shpenzimeve të certifikuar dhe, sipas rastit, kërkesë-pagesën përfundimtare;
(b) KKIPA t'i ketë dërguar Komisionit raportin përfundimtar të zbatimit në përputhje me nenin 60;
(c) Autoriteti Auditues t'i ketë dërguar Komisionit, sipas nenit 63(4) dhe (5), një opinion mbi pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve, të shoqëruar me raportin përfundimtar të auditimit;
(d) marrëveshja e financimit përkatëse të jetë në fuqi;
(e) Komisioni ka mbyllur procedurën e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive që parashikohet në nenin 42.

Neni 37 Anulimi i fondeve të papërdorura në rastin e programeve shumëvjeçare

(1) Komisioni anulon automatikisht çdo fond buxhetor të akorduar për një program që - deri më 31 dhjetor të vitit të pestë pas vitit buxhetor kur është akorduar buxheti - nuk është përdorur për qëllimet e parafinancimit apo bërjen e pagesave të ndërmjetme nga Komisioni për përfituesin IPA III, ose për të cilin ZKA nuk ka paraqitur ndonjë deklaratë shpenzimesh të certifikuar apo nuk është bërë asnjë kërkesë-pagesë e ndërmjetme sipas nenit 35. Për qëllime të këtij neni, merren parasysh vetëm shpenzimet e pranuara që janë depozituar me një kërkesë-pagesë të ndërmjetme ose deklaratë të shpenzimeve. Një afat më i hershëm mund të specifikohet në marrëveshjen sektoriale apo të financimit.

(2) Komisioni informon ZKA-në paraprakisht kurdo që ka rrezik anulimi fondesh sipas pikës 1.

(3) Shuma e prekur nga anulimi reduktohet me shumat ekuivalente me atë pjesë të buxhetit të akorduar, për të cilat:

(a) operacionet janë pezulluar nga një procedurë ligjore apo ankim administrativ me efekt pezullues; ose
(b) nuk ka qenë e mundur të bëhet kërkesë-pagesa për shkaqe madhore që cenojnë rëndë zbatimin e plotë apo të pjesshëm të programit.

Përfituesi IPA III që ngre si pretendim forcat madhore, duhet të demonstrojë pasojat direkte të forcës madhore në zbatimin e plotë apo të pjesshëm të programit.

(4) Përfituesi IPA III i dërgon Komisionit informacion mbi përjashtimet e përcaktuar në pikën 3, germat (a) dhe (b), në raportin vjetor të përcaktuar në nenin 59(1).

Neni 38 Ndërprerja e pagesave

(1) Pavarësisht afateve për pagesat sipas nenit 33(4), Komisioni mund të ndërpresë pagesat për përfituesin IPA II plotësisht ose pjesërisht, me qëllim që të kryejë kontrolle të mëtejshme, në rastet kur:

(a) Komisioni vihet në dijeni të informacionit të besueshëm që tregon mangësi thelbësore në funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, ose shpenzimet e certifikuara nga ZKA kanë një parregullsi të rëndë e cila nuk është korrigjuar;
(b) ndërprerja është e nevojshme për të parandaluar dëmtimin e konsiderueshëm të interesave financiare të BE-së;
(c) Komisioni vihet në dijeni të informacionit i cili vë në dyshim pranueshmërinë e shpenzimeve në një kërkesë-pagesë.

(2) Komisioni mund të ndërpresë vetëm një pjesë të shpenzimeve që figurojnë në kërkesë-pagesën e cenuar nga elementët e përcaktuar në pikën 1. Komisioni informon menjëherë përfituesin IPA III për arsyen e ndërprerjes dhe i kërkon shpjegime të menjëhershme dhe të korrigjojë situatën, nëse nevojitet. Komisioni e eliminon ndërprerjen sapo të jenë marrë masat e nevojshme.

Neni 39 Pezullimi i pagesave

(1) Komisioni mund të pezullojë pagesat për përfituesin IPA III, veçanërisht kur zbulohen gabime sistemike që vënë në dyshim besueshmërinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të subjektit në fjalë, apo ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve përkatëse, ose përdorimin e aktivëve dhe produkteve për qëllimin e synuar siç specifikohet në marrëveshjen sektoriale apo të financimit.

(2) Përfituesit IPA III i jepet mundësia të paraqesë oponencën/komentet brenda një periudhe dymujore para se Komisioni të vendosë për pezullimin sipas pikës 1.

(3) Komisioni e heq pezullimin nëse përfituesi IPA III ka marrë masat e nevojshme për ndreqjen e gabimeve sistemike.

Nëse përfituesi IPA III nuk i ka marrë këto masa, Komisioni mund të vendosë të anulojë plotësisht ose pjesërisht kontributin IPA III për programin, sipas nenit 43.

Neni 40 Rikuperimi i fondeve

(1) Çdo problematikë e përcaktuar në nenet 50(7) dhe 51(5) që ndodh kurdo gjatë zbatimit të asistencës IPA III apo që rezulton nga një audit, mund të çojë në rikuperimin e fondeve nga Komisioni prej përfituesit IPA III.

(2) ZKA rikuperon kontributin e BE-së që i është paguar përfituesit IPA III prej atyre që kanë qenë në situatën e përcaktuar në nenin 51(5) apo që kanë përfituar prej saj, sipas procedurave kombëtare të përfituesit IPA III për rikuperimin e fondeve publike. Fakti që ZKA mund të mos arrijë të rikuperojë këto fonde plotësisht apo pjesërisht, nuk e pengon Komisionin që t'i rikuperojë këto fonde nga përfituesit IPA III.

Neni 41 Rregullimet financiare nga Përfituesi IPA III

ZKA kryen rregullimet financiare kur zbulohet ndonjë problematikë e përcaktuar në nenin 51(5), duke anuluar plotësisht apo pjesërisht kontributin e BE-së për programin në fjalë. ZKA mban parasysh natyrën dhe shkallën e parregullsive, si dhe humbjen financiare që i është shkaktuar kontributit të BE-së, duke garantuar parimin e proporcionalitetit.

Neni 42 Shqyrtimi dhe pranimi i procedurave të llogarisë

(1) Qëllimi i procedurës së shqyrtimit dhe pranimit të llogarive synon të garantojë që shpenzimet e kryera dhe të paguara nga përfituesi IPA III në kuadrin e menaxhimit indirekt dhe që mund t'i ngarkohen buxhetit të BE-së, të jenë në përputhje me rregullat e zbatueshme të BE-së dhe që llogaritë të jenë të plota, të sakta dhe të vërteta.

(2) Procedura e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive konsiston në sa më poshtë:

(a) analiza e deklaratës përfundimtare të shpenzimeve të dorëzuar nga ZKA;
(b) analiza e raportit përfundimtar të zbatimit të programeve njëvjeçare ose shumëvjeçare sipas nenit 60;
(c) analiza e opinionit të dërguar nga Autoriteti Auditues mbi deklaratën e shpenzimeve, mbështetur nga raporti përfundimtar i auditimit;
(d) analiza e dokumenteve përkatëse të referuara në marrëveshjen sektoriale ose të financimit dhe, sipas rastit, kontrollet në vend nga Komisioni duke mos iu nënshtruar limiteve apo kufizimeve lidhur me përmbajtjen e këtyre raporteve apo pasqyrave financiare dhe transaksionet në to, duke përfshirë kontrollet e bëra te marrësit;
(e) përcaktimi nga Komisioni i shumës së shpenzimeve që duhet t'i ngarkohen buxhetit të BE-së në vijim, sipas rastit, të një procedure oponence dhe pasi të jetë njoftuar përfituesi IPA III;
(f) llogaritja e një korrigjimi të mundshëm financiar që rezulton nga shpenzime të kryera dhe të paguara në shkelje të rregullave të përcaktuara në këtë Marrëveshje dhe, sipas rastit, në referim të marrëveshjes sektoriale apo të financimit;
(g) rikuperimi ose pagesa nga Komisioni i balancës që rezulton nga diferenca midis shpenzimeve të pranuara në buxhetin e BE dhe shumave që i janë paguar tashmë përfituesit të IPA III.

(3) Procedura e shqyrtimit dhe pranimit të llogarive të përcaktuar në pikën 2 nuk cenon mundësinë për Komisionin që të rikuperojë shpenzimet e papranueshme në një fazë të mëvonshme mbi bazën e auditeve ose inspektimeve që kryhen gjatë apo pas zbatimit të programit.

Neni 43 Korrigjimet financiare nga Komisioni

(1) Për të garantuar përdorimin e fondeve IPA III sipas rregullave të zbatueshme, Komisioni zbaton mekanizma korrigjimi financiar sipas nenit 12 të Rregullores Zbatuese IPA III dhe siç parashikohet hollësisht në marrëveshjet sektoriale apo të financimit.

(2) Korrigjimi financiar mund të lindë në rastet më poshtë:

(a) identifikimi i ndonjë problematike të përcaktuar në nenin 51(5);
(b) identifikimi i ndonjë dobësie apo mangësie në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të përfituesit IPA III;
(c) mosarritja e rezultateve dhe mospërdorimi i aktiveve dhe produkteve për qëllimin e synuar siç specifikohet në marrëveshjen sektoriale apo të financimit;
(d) ndjekja nga Komisioni e raporteve të auditimit dhe opinioneve të Autoritetit Auditues.

(3) Nëse Komisioni konstaton se shpenzimet në kuadrin e programeve që mbulon IPA III janë bërë, paguar dhe certifikuar në një mënyrë që shkel rregullat e zbatueshme, vendos se cilat shuma të përjashtohen nga financimi i BE-së.

(4) Komisioni kryen llogaritjen dhe kryerjen e korrigjimeve të tilla, si edhe rikuperimet përkatëse, duke zbatuar kriteret dhe procedurat e përcaktuara në pikat 5, 6 dhe 7 të këtij neni si dhe në nenet 42, 44 dhe 45.

(5) Korrigjimet financiare bëhen sipas rastit me kompensim ose zbritje;

(6) Komisioni zbaton korrigjimet financiare bazuar në identifikimin e shumave të paguar më tepër dhe në implikimet financiare për buxhetin. Nëse identifikimi i saktë i këtyre shumave për qëllime të korrigjimeve individuale është i pamundur, Komisioni mund të aplikojë korrigjime me normë fikse ose korrigjime bazuar në ekstrapolimin e konstatimeve.

(7) Kur vendos për shumën e korrigjimit, Komisioni mban parasysh natyrën, shkallën dhe implikimet financiare të çdo problematike të përcaktuar në pikën 2, si edhe parimin e proporcionalitetit.

Neni 44 Procedurat për korrigjimet financiare

(1) Para marrjes së një vendimi për një korrigjim financiar, duke përfshirë ato që bëhen në bazë të procedurës së shqyrtimit dhe pranimit të llogarive, Komisioni ia komunikon ZKA-së përfundimet e veta paraprake dhe i kërkon që të japë komente brenda dy muajsh.

Nëse Komisioni propozon një korrigjim financiar bazuar në ekstrapolimi e konstatimeve apo në një norme fikse sipas nenit 43(6), përfituesit IPA III i jepet mundësia të japë informacion që i mundëson Komisionit të vlerësojë shkallën e problematikës sipas nenit 43(2), përmes shqyrtimit të dokumentacionit përkatës. Në mirëkuptim me Komisionin,

përfituesi IPA III mund të kufizojë objektin e këtij shqyrtimi në një sasi apo model dokumentacioni përkatës. Përveç rasteve të justifikuara siç duhet, koha që i lejohet përfituesit IPA III nuk tejkalon dy muaj pas dy muajve të përcaktuar në nënpikën e parë. Rregulla më të hollësishme mund të përcaktohen në marrëveshjen sektoriale apo të financimit.

(2) Komisioni merr vendimin pasi mban parasysh të gjitha provat/evidencat që ia ka vënë në dispozicion përfituesi IPA III.

Neni 45 Ripërdorimi i kontributit të BE-së

(1) Fondet e anuluara prej kontributit të BE-së, në vijim të korrigjimeve financiare sipas nenit 43, derdhen në buxhetin e BE-së.

(2) Kontributi i rikuperuar sipas nenit 40 apo i anuluar sipas nenit 41, nuk mund të ripërdoret për aktivitetin(et) që kanë qenë objekt rikuperimi apo rregullimi financiar, as kur rikuperimi apo rregullimi financiar pason një parregullsi sistemike për aktivitete në vazhdim brenda të gjithë apo një pjese të programit në të cilin ka ndodhur parregullsia sistemike.

Neni 46 Shlyerja

(1) Përfituesi IPA III kryen çfarëdo shlyerje në buxhetin e përgjithshëm të BE-së para datës së përcaktuar në urdhrin e rikuperimit të hartuar sipas nenit 100 të Rregullores Financiare.

(2) Vonesat në shlyerje shkaktojnë kamatëvonesë bazuar në nenin 99 të Rregullores Financiare.

TITULLI III MBYLLJA E PROGRAMIT APO NJË PJESE TË TIJ

Neni 47 Mbyllja e programit apo një pjese të tij të zbatuar me menaxhim indirekt nga përfituesi IPA III

(1) Komisioni ia njofton me shkrim përfituesit IPA III mbylljen e programit.

(2) Komisioni nuk e mbyll një program pa kryer paraprakisht shqyrtimin dhe pranimin e llogarive sipas nenit 42.

(3) Mbyllja e programit nuk i cenon të drejtën Komisionit për të ndërmarrë korrigjime financiare në një fazë të mëvonshme.

(4) Rregulla më të hollësishme për mbylljen e programeve dhe kërkesat e raportimit mund të përcaktohen në marrëveshjen sektoriale apo të financimit.

Neni 48 Mbyllja e një pjese të programit të zbatuar në menaxhim direkt dhe atë indirekt me subjekte të tjerë nga përfituesi IPA III

(1) Programi mbyllet pasi të mbyllen të gjitha kontratat dhe grantet e financuara nga ky program.

(2) Komisioni njofton me shkrim përfituesin IPA III për mbylljen e programit.

Neni 49 Ruajtja e dokumenteve

(1) Përfituesi IPA III ruan për pesë vjet nga mbyllja e programit, të gjitha dokumentet që lidhen me procedurat e prokurimit dhe shpalljes së fituesit të granteve, kontratat, aneks-kontratat, korrespondencat relevante dhe të gjitha dokumentet përkatëse që lidhen me pagesat dhe rikuperimet.

(2) Afati i përcaktuar në pikën (1) të këtij neni ndërpritet në rast të padive gjyqësore ose me kërkesë të arsyetuar siç duhet nga Komisioni.

TITULLI IV MBIKËQYRJA, KONTROLLI, AUDITI DHE MBROJTJA E INTERESAVE FINANCIARË

Neni 50 Mbikëqyrja, kontrolli dhe auditi nga Komisioni, Zyra Evropiane kundër Mashtrimit dhe Gjykata Evropiane e Llogarive

(1) Të gjitha marrëveshjet e financimit dhe kontratat pasuese, duke përfshirë nënkontratat që përfituesit lidhin me palë të treta, janë objekt i mbikëqyrjes, kontrollit dhe auditit nga Komisioni, përfshirë Zyrën Evropiane kundër Mashtrimit (OLAF) dhe auditet e Gjykatës Evropiane të Llogarive.

Në menaxhimin indirekt nga përfituesi IPA II, kjo përfshin edhe të drejtën e Komisionit dhe të Delegacionit të BE-së në [përfituesin IPA] që të marrë masa si:

(a) verifikime *ex ante* të tenderimit dhe kontraktimit;
(b) kontrolle *ex post* të tenderimit, kontraktimit, ekzekutimit të kontratave, duke përfshirë menaxhimin e tyre financiar;
(c) mbikëqyrje për funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit.

Auditorët e jashtëm të autorizuar, agjentët ose përfaqësuesit e Komisionit, OLAF-it dhe Gjykatës Evropiane të Llogarive, kanë të drejtë të kryejnë çfarëdo verifikimi teknik dhe financiar, ose audit që e çmojnë të nevojshëm për mbikëqyrjen e zbatimit të një programi apo kontrate, përfshirë vizitat në vendet dhe ambientet ku zbatohen ose menaxhohen aktivitetet e financuara nga IPA III. Komisioni njofton paraprakisht autoritetet kombëtare për misione të tilla.

(2) Përfituesi IPA III ngre një shërbim koordinimi kundër mashtrimit[12] për të lehtësuar bashkëpunimin efektiv dhe shkëmbimin e informacionit me OLAF-in, duke përfshirë informacionin me natyrë operacionale.

Në menaxhimin indirekt, ky shërbim kundër mashtrimit i ngarkohet të koordinojë aktivitetet dhe detyrimet operacionale dhe administrative si edhe të propozojë ndryshime në legjislacionin e brendshëm të përfituesit IPA III, sipas rastit, me qëllim që të mbrohen interesat financiare të BE-së. Shërbimi ushtron këto detyra ndër të tjera:

- drejton hartimin/zbatimin e strategjive për të mbrojtur interesat financiare të BE-së;
- identifikon dobësitë e mundshme në sistemin e përfituesit IPA III për menaxhimin e fondeve të BE-së, përfshi asistencën IPA III;
- garanton kapacitete të mjaftueshme të burimeve njerëzore për të kryer këto detyra, përfshi trajnimin e personelit që merret me parandalimin e mashtrimeve financiare;
- mbështet bashkëpunimin midis administratave të përfituesit IPA III, prokurorisë dhe OLAF-it;
- ndan informacion mbi parregullsitë dhe rastet e dyshimeve për mashtrime me administratën e përfituesit IPA III dhe OLAF-in, duke përfshirë parregullsitë e identifikuara nga kontrollet dhe auditet e kryera nga Autoriteti Auditues, shërbimet e auditit të brendshëm, Struktura Menaxhuese, Autoritetet Menaxhuese dhe Organet e Ndërmjetme;

[12] Ky shërbim nuk është pjesë e strukturave të referuara në nenin 10 dhe ngritja e saj nuk është parakusht për ngarkimin e detyrave të zbatimit të buxhetit.

- garanton përmbushjen e detyrimeve sipas Rregullores (KE, Euratom) nr. 883/2013 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit[13], Rregullores së Këshillit (Euratom – KE) nr. 2988/1995[14], si dhe Rregullores së Këshillit (KE, Euratom) nr. 2185/1996[15].

(3) Përfituesi IPA III vë në dispozicion të gjithë dokumentacionin dhe informacionin e kërkuar, duke përfshirë të dhëna kompjuterike, si edhe merr të gjitha masat e duhura për të lehtësuar punën e personave të instruktuar për të realizuar audite, kontrolle në vend dhe inspektime.

(4) Përfituesi IPA III garanton edhe që agjentët apo përfaqësuesit e Komisionit, përfshirë ato të OLAF-it, të kenë të drejtën të inspektojnë të gjitha dokumentet dhe llogaritë përkatëse që i përkasin zërave të financuar në kuadrin e marrëveshjes përkatëse të financimit dhe asiston Gjykatën Evropiane të Llogarive në realizimin e auditeve me objekt përdorimin e asistencës IPA III. Kur pajisje private përdoren për qëllime pune, edhe ato pajisje mund të jenë objekt inspektimi nga OLAF. OLAF i inspekton këto pajisjeje vetëm sipas të njëjtave kushte dhe masë që u lejohet autoriteteve kombëtare të kontrollit për hetimin e pajisjeve private dhe vetëm kur OLAF ka shkaqe të arsyeshme për të dyshuar se materialet në to janë të dobishme për hetimin.

(5) Për të garantuar mbrojtjen efikase të interesave financiare të BE-së, Komisioni dhe OLAF-i mund të kryejnë të gjitha veprimet hetimore, veçanërisht kontrollet dhe inspektimet në vend sipas Rregullores nr. (BE, Euratom) 883/2013 dhe Rregullores (KE, Euratom) nr. 2185/1996. Këto kontrolle dhe inspektime përgatiten dhe kryhen në bashkëpunim të ngushtë me Përfituesin IPA III, që njoftohet në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, me qëllim që të ofrojë të gjithë ndihmesën e kërkuar. Me kërkesë të OLAF-i, përfituesi IPA III identifikon një shërbim me kompetenca procedimi penal që ndihmon në kryerjen e hetimeve sipas Rregullores nr. (BE, Euratom) 883/2013 dhe Rregullores (KE, Euratom) nr. 2185/1996.

(6) Shërbimi i përmendur në pikën (2) mund ta përmbushë këtë detyrë, nëse ka kompetenca hetimore administrative dhe penale. Nëse dëshiron OLAF, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të kryhen bashkërisht. Kur pjesëmarrësit në aktivitetet e financuara nga IPA III kundërshtojnë një kontroll apo inspektim në vend, përfituesi IPA III vepron në përputhje me ligjet dhe aktet normative të brendshme për t'iu garantuar inspektorëve të Komisionit/OLAF-it ndihmesën e nevojshme me qëllim që të kryejnë detyrën lidhur me kontrollin apo inspektimin në vend, përfshirë dhënien e informacionit mbi llogarinë bankare që i shërben OLAF-it për punën hetimore.

(7) Në rast mospërmbushjeje të detyrimeve të përcaktuara në pikat 4, 5 dhe 6 të këtij neni, Komisioni Evropian mund të rikuperojë fondet që i përkasin kontributit të BE-së që është objekt hetimi i OLAF-it, në përputhje me dispozitat e nenit 40.

(8) Komisioni/OLAF i komunikon menjëherë përfituesit IPA III çdo provë apo dyshim lidhur me mashtrimet apo parregullsitë për të cilat është vënë në dijeni nga një kontroll apo

[13] Rregullorja (BE, Euratom) nr. 883/2013 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e 11 shtatorit 2013 që i përket hetimeve që ndërmerr Zyra Evropiane e Luftës kundër Mashtrimit (OLAF) dhe që shfuqizon Rregulloren (BE) nr. 1073/1999 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dhe Rregulloren e Këshillit (Euratom) nr. 1074/1999, (GZ L248, 18 shtator 2013, f.1).

[14] Rregullorja e Këshillit (BE, Euratom) nr. 2988/1995 e 18 dhjetorit 1995 mbi mbrojtjen e interesave financiare të Komunitetit Evropian (GZ L312, 23 dhjetor 1995, f.1).

[15] Rregullorja e Këshillit (Euratom, BE) nr. 2185/96 e 11 nëntorit 1996 që i përket kontrollit në terren dhe inspektimeve të kryera nga Komisioni, me qëllim që të mbrojë interesat financiare të Komuniteteve Evropiane në luftën kundër mashtrimit dhe parregullsive të tjera, (GZ L292, 15 nëntor 1996, f. 2).

inspektim në vend. Në çdo rast, Komisioni/OLAF duhet të informojë shërbimin e lartpërmendur për rezultatin e kontrolleve dhe inspektimeve të tilla.

(9) Kontrollet dhe auditet e përshkruara më sipër janë të zbatueshme për të gjithë marrësit dhe nënkontraktuesit që kanë përfituar fonde nga asistenca IPA III, pavarësisht nëse janë përcaktuar shprehimisht në kontratë apo në marrëveshjen e grantit. Kontrolle dhe audite të tilla janë të zbatueshme edhe për dokumentet në lidhje me kontributin kombëtar, nëse ka, nga përfituesi IPA III.

(10) Në menaxhimin indirekt, Komisioni mund të kontrollojë, në çdo kohë, llogaritë dhe operacionet e Organit Kontabël, Autoriteteve Menaxhuese dhe Organeve të Ndërmjetme në formë të drejtpërdrejtë ose përmes një audituesi të jashtëm. Kjo nuk cenon përgjegjësitë e Komisionit dhe të Gjykatës Evropiane të Llogarive.

Neni 51 Mbrojtja e interesave financiare të BE-së

(1) Në përputhje me nenin 154(4), germa (a) të Rregullores Financiare, Përfituesi IPA III të cilit i janë besuar detyrat e ekzekutimit të buxhetit të asistencës IPA III parandalon, zbulon dhe korrigjon parregullsitë dhe mashtrimet gjatë kryerjes së këtyre detyrave. Për këtë qëllim, Përfituesi IPA III kryen kontrolle *ex ante* dhe *ex post*, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke përfshirë kontrollet në vend mbi baza modele transaksionesh përfaqësuese dhe/ose me bazë risku, që të garantohet se programet e financuara prej buxhetit janë kryer me efektivitet dhe janë zbatuar me korrektësi. Përfituesi IPA III rikuperon fondet e paguara më tepër dhe ngre padi gjyqësore kur është e nevojshme në lidhje me to.

(2) Në menaxhimin indirekt, përfituesi IPA III garanton hetimin dhe trajtimin efektiv të rasteve të dyshuara të parregullsive, mashtrimit, korrupsionit dhe konfliktit të interesave dhe funksionimin e një mekanizmi kontrolli dhe raportimi siç përmendet në nenin 13(7) të Rregullores IPA III. Përfituesi i IPA III i raporton pa vonesa Komisionit mashtrimet e dyshuara dhe parregullsi të tjera, të cilat kanë qenë objekt i konstatimeve të instancës së parë administrative ose gjyqësore, si edhe e informon rregullisht Komisionin për ecurinë e procedurave të tilla administrative apo ligjore. Raportimi kryhet me mjete elektronike duke përdorur sistemin e menaxhimit të parregullsive (SMP) të vënë në dispozicion nga Komisioni për këtë qëllim. Përveç dispozitave të raportimit të përcaktuara në shtojcën H të kësaj Marrëveshjeje, hollësi të mëtejshme mund të përcaktohen në marrëveshjet sektoriale apo të financimit.

(3) Për më tepër, përfituesi IPA III, në menaxhimin indirekt, merr çdo masë të përshtatshme që të parandalojë dhe të luftojë çdo praktikë korrupsioni aktiv apo pasiv në çdo fazë të procedurës së prokurimit ose procedurës së dhënies së grantit, ose gjatë zbatimit të kontratave përkatëse.

(4) Përfituesi IPA III, duke përfshirë personelin përgjegjës për programimin dhe zbatimin e detyrave të aktiviteteve të financuara nga IPA III, merr të gjitha masat paraprake të nevojshme për të shmangur çdo rrezik të konfliktit të interesave dhe informon Komisionin menjëherë për çdo konflikt të tillë interesi apo për çdo situatë që mund të shkaktojë ndonjë konflikt i tillë.

(5) Me qëllim mbrojtjen e interesave financiare të BE-së, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

(a) *Gabim* do të thotë gabim i paqëllimshëm material apo teknik nga përfituesi IPA III ose marrësi i asistencës IPA III;

(b) *Parregullsi* do të thotë çdo shkelje e një dispozite të rregullave të zbatueshme dhe kontratave që rezulton nga një veprim apo mosveprim i një operatori ekonomik ose përfituesit IPA III, i cili ka ose do të kishte efektin e cenimit të buxhetit të përgjithshëm të BE-së duke i ngarkuar buxhetit të përgjithshëm një zë financiar të pajustifikuar shpenzimesh;

(c) *Operator ekonomik* do të thotë çdo person fizik ose juridik, përfshirë një ent publik, ose grup personash të tillë që ofrohen të furnizojnë produkte, të ekzekutojnë punime, të ofrojnë shërbime ose të furnizojnë pasuri të paluajtshme;

(d) *Parregullsi sistemike* do të thotë çdo parregullsi që mund të ketë natyrë përsëritëse, me probabilitet të lartë të ndodhë në lloje të ngjashme operacionesh, që rezulton nga një mangësi serioze në funksionimin efikas të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, përfshi mosmiratimin e procedurave të përshtatshme sipas rregullave të zbatueshme;

(e) *Mashtrim* do të thotë çdo veprim apo mosveprim i paqëllimshëm që lidhet me:
- përdorimin ose paraqitjen e dokumenteve apo pasqyrave të rreme, të pasakta apo të paplota që ka për efekt përvetësimin apo mbajtjen e padrejtë të fondeve nga buxheti i përgjithshëm i BE-së apo nga buxhetet e menaxhuara nga apo për llogari të Bashkimit Evropian;
- moszbulimin e informacionit në shkelje të një detyrimi specifik me të njëjtin efekt;
- keqpërdorimin e këtyre fondeve për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë akorduar fillimisht;

(f) *Mashtrim i dyshuar* do të thotë një parregullsi që çon në fillimin e një procedimi administrativ apo gjyqësor në nivel kombëtar, me qëllim që të përcaktohet nëse ka pasur dashje, veçanërisht në lidhje me mashtrimin, siç parashikohet më lart;

(g) *Korrupsion aktiv* do të thotë veprimi me dashje i kujtdo që premton ose jep një favor të çfarëdo lloji, drejtpërdrejtë ose përmes një ndërmjetësi, një nëpunësi apo vetes ose një pale të tretë, që të veprojë apo të mos veprojë në zbatim të detyrës së vet apo në ushtrim të funksioneve të veta, duke shkelur funksionet zyrtare në mënyrë të tillë që dëmton ose mund të dëmtojë interesat financiare të BE-së;

(h) *Korrupsion pasiv* do të thotë veprimi me dashje i një nëpunësi civil, i cili, drejtpërdrejt ose përmes një ndërmjetësi, kërkon ose merr favore të çfarëdo lloji për vete apo për një pale të tretë, ose pranon premtimin për një favor të tillë, që të veprojë apo të mos veprojë në zbatim të detyrës së vet apo në ushtrim të funksioneve të veta, duke shkelur funksionet zyrtare në mënyrë të tillë që dëmton ose mund të dëmtojë interesat financiare të BE-së;

(i) *Konflikt interesi* do të thotë kur cenohet ushtrimi i paanshëm dhe objektiv i funksioneve të një aktori financiar apo personi tjetër për arsye që përfshijnë familjen, jetën emocionale, përkatësinë politike apo kombëtare, interesat ekonomike apo interesa të tjera të përbashkëta me një përfitues fondesh;

(j) *Konstatim administrativ apo gjyqësor i shkallës së parë* do të thotë një vlerësim paraprak me shkrim nga një autoritet kompetent, qoftë administrativ apo gjyqësor, që mbi bazën e fakteve specifike arrin në përfundimin se është kryer një parregullsi. Kjo nuk cenon mundësinë që ky përfundim të rishikohet ose revokohet si rezultat i fakteve që dalin nga procedura administrative apo gjyqësore.

Përkufizimet më lart në këtë nen nuk konsiderohen sikur shtojnë vepra penale të reja në Kodin Penal të përfituesit IPA III apo ndryshime në veprat penale ekzistuese.

SEKSIONI VI MONITORIMI, VLERËSIMI DHE RAPORTIMI

TITULLI I MONITORIMI

Neni 52 Komiteti Monitorues IPA

(1) Komisioni dhe përfituesi IPA III ngrenë një komitet monitorimi IPA jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes së financimit të parë. Ky komitet përmbush edhe përgjegjësitë e komitetit monitorues IPA sipas Rregullores (KE) nr. 1085/2006 [16] (Rregullorja IPA) dhe Rregullores IPA II.

(2) Komiteti Monitorues IPA shqyrton efikasitetin, cilësinë, koherencën, koordinimi n dhe përputhshmërinë e përgjithshme të zbatimit të të gjitha programeve drejt përmbushjes së objektivave të përcaktuar në marrëveshjet e financimit, në kuadrin programues të IPA III dhe në Përgjigjen Strategjike. Për këtë qëllim, ky Komitet bazohet sipas rastit në informacionin e marrë prej komiteteve monitoruese sektoriale dhe prej strukturave të tjera ekzistuese të përfituesit IPA III.

(3) Komiteti monitorues IPA mund t'i paraqesë propozime Komisionit, KKIPA-s dhe ZKA-së për të garantuar koherencë dhe koordinim më të mirë të asistencës IPA III, siç parashikohet në kuadrin programues të IPA III ose në Rregulloren IPA III, si dhe për të forcuar efikasitetin, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e përgjithshme të kësaj asistence. Gjithashtu, komiteti monitorues IPA mund t'iu rekomandojë masa korrigjuese komiteteve monitoruese sektoriale, me qëllim që të garantohet përmbushja e objektivave të IPA III dhe të forcohet efikasiteti dhe efektiviteti i asistencës IPA III. Për këtë qëllim, sipas rastit, merr parasysh përfundimet dhe rekomandimet e nxjerra nga monitorimet dhe vlerësimet e kryera si nga Komisioni ashtu edhe nga përfituesi IPA III.

(4) Komiteti monitorues IPA përbëhet nga përfaqësues të Komisionit, KKIPA-s dhe organeve e autoriteteve kombëtare përkatëse të përfituesit IPA III dhe, sipas rastit, organizatave ndërkombëtare, duke përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare dhe grupe interesi si shoqëria civile dhe organizatat e sektorit privat. Përfaqësuesit e grupeve të interesit zgjidhen sipas rregullave dhe kritereve të përcaktuara në rregulloren e brendshme të komiteti monitorues IPA dhe në dakordësi me Komisionin.

(5) Një përfaqësues i Komisionit dhe i KKIPA-s bashkëkryesojnë takimet e komitetit e komitetit monitorues IPA.

(6) Komiteti monitorues IPA miraton rregulloren e vet të brendshme në dakordësi me KKIPA-n, ZKA-në dhe Komisionin

[16] Rregullorja e Këshillit (KE) nr. 1085/2006 e 17 korrikut 2006 që krijon Instrumentin për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA), (GZ L 210, 3 korrik 2006, f. 82).

(7) Komiteti monitorues IPA mblidhet të paktën një herë në vit. Takime të posaçme mund të zhvillohen me nismën e Komisionit apo të përfituesit IPA III, veçanërisht mbi bazë tematike.

(8) Në rastet kur komitetet monitoruese sektoriale të përcaktuara në nenin 53 nuk janë ngritur, komiteti monitorues IPA përmbush funksionet e renditura në pikën 7 të këtij neni.

Neni 53 Komitetet monitoruese sektoriale

(1) Përfituesi IPA III duhet të ketë ngritur komitete monitoruese sektoriale IPA për të monitoruar programet njëvjeçare dhe shumëvjeçare të zbatuara me menaxhim indirekt nga përfituesi IPA III, të cilat financohen nga Rregullorja IPA dhe Rregullorja IPA III në një sektor apo program specifik. Komitete të tilla krijohen jo më vonë se gjashtë muaj pas hyrjes në fuqi të së parës marrëveshje financimi në këtë sektor.

(2) Në përputhje me parimin e proporcionalitetit, në rastin e programeve njëvjeçare të zbatuara me menaxhim indirekt, në marrëveshjen e financimit mund të hiqet dorë nga detyrimi për të krijuar një komitet monitorues sektorial IPA.

(3) Kur një komitet monitorues sektorial IPA është ngritur tashmë, ky komitet, përveç programeve shumëvjeçarë të zbatuara me menaxhimin indirekt, mund të monitorojë programe të tjera njëvjeçare me menaxhim direkt ose indirekt në të njëjtin sektor specifik. Kjo dispozitë nuk zbatohet për programet IPARD III.

(4) Bazuar në raportet që marrin prej Autoritetit Menaxhues përpara takimeve, komitetet monitoruese sektoriale kryejnë veçanërisht këto detyra:
   (a) shqyrtojnë efektivitetin, efektivitetin, cilësinë, koordinimin dhe përputhshmërinë e zbatimit të programeve:
   (b) shqyrtojnë progresin e bërë në arritjen e objektivave, produkteve dhe rezultateve të planifikuara, si dhe në vlerësimin e ndikimit dhe qëndrueshmërisë së asistencës IPA III, ndërsa garantojnë koherencë me dialogun e politikave, strategjitë përkatëse kombëtare dhe rajonale, si edhe aktivitetet shumëvendëshe apo rajonale në përfituesin IPA III;
   (c) shqyrtojnë raportet vjetore të zbatimit, duke përfshirë ekzekutimin financiar të programeve;
   (d) shqyrtojnë konstatimet dhe përfundimet përkatëse si edhe propozimet për masa korrigjuese që lindin prej kontrolleve në vend, monitorimet, vlerësimet dhe auditet, nëse ka;
   (e) diskutojnë mbi aspektet përkatëse të funksionimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit;
   (f) diskutojnë mbi çështjet dhe veprime problematike;
   (g) nëse nevojitet, marrin në konsideratë ose bëjnë propozime për ndryshime në programe si edhe marrin masa të tjera korrigjuese për të garantuar përmbushjen e objektivave dhe forcimin e efikasitetit, efektivitetit, ndikimit dhe qëndrueshmërisë së asistencës IPA III;
   (h) shqyrtojnë masat për informimin, publicitetin, transparencën dhe komunikimin që merren sipas neneve 23 dhe 24.

Dispozita të tjera specifike mund të përcaktohen në marrëveshjet sektoriale apo të financimit.

(5) Në fund të mbledhjeve, komitetet monitoruese sektoriale hartojnë përfundimet operacionale dhe rekomandimet. Këto përfundime janë objekt ndjekjeje të mjaftueshme

dhe shqyrtimi në mbledhjet pasardhëse të komitetit, si dhe përbëjnë bazën e raportimit pranë komitetit monitorues IPA për progresin e bërë sipas nenit 52(2).

(6) Secili komitet monitorues sektorial miraton vetë rregulloren e brendshme, e cila hartohet në konsultim me Autoritetet Menaxhuese dhe Organet e Ndërmjetme, KKIPA-n dhe Komisionin.

(7) Komiteti monitorues sektorial përbëhet nga përfaqësues të organeve dhe autoriteteve kombëtare të përfituesit IPA III, grupet e tjera të interesit siç janë partnerët ekonomikë, socialë dhe mjedisorë, si edhe organizatat ndërkombëtare, sipas rastit, duke përfshirë institucionet financiare ndërkombëtare dhe shoqërinë civile. Komisioni merr pjesë në mbledhjet e komiteteve. Përfaqësuesit e grupeve të interesit përzgjidhen mbi bazën e rregullave dhe kritereve të përcaktuara në rregulloren e brendshme. Takimet e komitetit monitorues IPA kryesohen nga një përfaqësues i lartë i përfituesit IPA III. Në varësi të fushës apo programit, takimet e komitetit mund të bashkëkryesohen me Komisionin.

(8) Komitetet monitoruese sektoriale mblidhen të paktën dy herë çdo 12 muaj. Mund të zhvillohen edhe takime të posaçme.

TITULLI II VLERËSIMI

Neni 54 Vlerësimi i asistencës IPA III

(1) Asistenca IPA III i nënshtrohet vlerësimeve sipas nenit 13 të Rregullores IPA III, nenit 34 të Rregullores Financiare, si dhe Kreut V të Titullit II të Rregullores NDICI. Vlerësimi synon të përmirësojnë relevancën, koherencën, cilësinë, efikasitetin, efektivitetin, ndikimin, vlerën e shtuar të BE-së, qëndrueshmërinë e asistencës IPA III, si dhe sinergjinë me dialogun e politikave përkatëse.

(2) Objektivat e vlerësimit janë si vijon:

(a) vlerësimi i kushteve për zbatimin e asistencës, performancës së saj aktuale dhe të parashikuar, si edhe përputhshmërisë së asistencës me objektivat e politikave të përcaktuara me qëllim arritjen e ndikimeve dhe objektivave afatgjatë;

(b) vlerësimi i arritjes së rezultateve të dakordësuara (rezultatet, produktet, ndikimet), me qëllim arritjen e ndikimeve dhe objektivave globalë afatgjatë;

(c) vlerësimi i procesit të programimit dhe i sistemit të monitorimit dhe, sipas rastit, i modaliteteve të zbatimit;

(d) promovimi i llogaridhënies së asistencës tek institucionet e BE-së dhe publiku, në lidhje me shfrytëzimin efektiv të parasë dhe përdorimit të fondeve;

(e) nxjerrja e mësimeve që synojnë përmirësimin e cilësisë dhe hartimit të politikave, strategjive dhe ndërhyrjeve të ardhshme. Si rrjedhojë, vlerësimet duhet të kryhen në kohë dhe konstatimet e tyre duhet të mbahen parasysh si në ciklin e radhës të programimit dhe zbatimit, ashtu edhe në vendimin për akordimin e burimeve.

(3) Vlerësimet mund të kryhen në nivel projekti dhe programi, si edhe në nivel strategjik.

Vlerësimet strategjike bëhen për instrumente (përfshirë mbështetjen buxhetore), tema, përfitues IPA ose rajone.

(4) Mund të kryhen edhe vlerësime *ex ante*. Këto vlerësime synojnë të optimizojnë akordimin e burimeve buxhetore për programet si edhe të përmirësojnë cilësinë e programimit. Ato identifikojnë dhe vlerësojnë pabarazitë, boshllëqet dhe potencialin për zhvillim, objektivat që duhen arritur, rezultatet e pritshme, synimet e kuantifikuara, koherencën (nëse nevojitet) të strategjisë së propozuar dhe cilësinë e procedurave për zbatimin, monitorimin, vlerësimin dhe menaxhimin financiar.

(5) Vlerësimet retrospektive dhe *ex post* vlerësojnë relevancën, efikasitetin, efektivitetin, koherencën, ndikimin, qëndrueshmërinë dhe vlerën e shtuar të BE-së në asistencën IPA III, me qëllim arritjen e objektivave të përcaktuar në dokumentet e programimit.

(6) Ndikimet afatgjata dhe qëndrueshmëria e asistencës IPA III vlerësohen sipas rregullave dhe procedurave të zbatueshme, si edhe sipas legjislacionit përkatës të BE-së.

(7) Rekomandimet dhe përfundimet e vlerësimeve mbahen parasysh nga komiteti monitorues IPA dhe nga komitetet monitoruese sektoriale.

(8) Komisioni përgatit metoda vlerësimi, duke përfshirë standardet e cilësisë[17] dhe indikatorë të matshëm. Përfituesit IPA II ndjekin këto metoda gjatë kryerjes së vlerësimeve.

[17] Në përputhje me kriteret e vlerësimit dhe teknikat e metodat e vlerësimit të qëndrueshëm të përcaktuara në Rregulloren e Përmirësimit dhe OECD/DAC.

Neni 55 Vlerësimet e Komisionit

(1) Kur Komisioni ndërmerr vlerësime të asistencës IPA III, përfituesi IPA III lehtëson aksesin në të dhënat dhe informacionin përkatës të nevojshëm për kryerjen e vlerësimeve, përfshirë lehtësimin e intervistave me grupet e interesit.

Neni 56 Vlerësimet e Përfituesit IPA III në menaxhimin indirekt

(1) Përfituesi IPA III që zbaton fonde IPA III me menaxhim indirekt, mban përgjegjësi për kryerjen e vlerësimeve të programeve që menaxhon, sipas nenit 54.

(2) Përfituesi IPA III, në konsultim me Komisionin, harton një plan vlerësimi ku paraqet aktivitetet vlerësuese që do të kryhen në faza të ndryshme të zbatimit.

TITULLI III RAPORTIMI

Neni 57 Përkufizime shtesë për raportimin

(1) "Periudhë 12-mujore" do të thotë periudha nga 1 korriku i vitit financiar paraardhës deri më 30 qershor të vitit financiar aktual, përveç kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje sektoriale apo financimi.

(2) "Kosto/Shpenzime të Pranuara" do të thotë shpenzimet e kryera (nga marrësi) që janë pranuar (nga Organi Ndërmjetës për menaxhimin financiar) dhe paguhen (nga Organi Ndërmjetës për menaxhimin financiar).

Neni 58 Gjuha dhe formati

(1) Të gjitha raportet, pasqyrat financiare, deklaratat dhe llogaritë që lidhen me përgatitjen apo zbatimin e asistencës IPA III i dorëzohen Komisionit në gjuhën angleze.

(2) ZKA, me mbështetjen e Organit Kontabël, ngre një sistem kontabiliteti akrual ku regjistrohen dhe ruhen në format elektronik të dhëna kontabël të sakta, të plota dhe të besueshme për secilin program/veprim/operacion IPA III që përfituesi IPA III zbaton me menaxhim indirekt. ZKA e përdor si bazë për të përpiluar kërkesë-pagesa, llogari, raporte financiare dhe pasqyra financiare.

(3) Përfituesi IPA III ngre një sistem informatik menaxhimi ku regjistron dhe ruan në format elektronik të dhënat për secilin program/veprim/operacion IPA III, të nevojshme për planifikimin, zbatimin, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, verifikimet dhe auditet e asistencës IPA III.

(4) Përfituesi IPA III përcakton specifikimet teknike të sistemit që përmendet në pikat (2) dhe (3), me qëllim që të maksimizojë automatizimin e raportimit dhe shkëmbimit të të dhënave në format elektronik.

(5) Komisioni mund të krijojë sistemet e veta informatike dhe t'i kërkojë përfituesit IPA III që të ndërmarrë rol aktiv në zhvillimin dhe përdorimin e tyre.

Neni 59 Kërkesat bazë për raportimin nga KKIPA

(1) Deri më 15 shkurt të çdo viti, KKIPA i dorëzon Komisionit një raport vjetor mbi zbatimin e asistencës financiare të dhënë përmes Rregullores IPA, Rregullores IPA II dhe Rregullores IPA III në vitin financiar pararendës.

(2) Raporti ndjek modelin e vënë në dispozicion nga Komisioni dhe përfshin në veçanti këtë informacion:

a. programimi i asistencës, progresi i bërë me zbatimin, problemet e hasura dhe masat korrigjuese të ndërmarra, ndjekja e monitorimit dhe vlerësimit;
b. komunikimi dhe vizibiliteti, si edhe puna e koordinimit të donatorëve;
c. progresi i bërë në arritjen e objektivave të parashtruar në dokumentet strategjikë dhe programet, i matur me indikatorët përkatës;
d. komandimet për periudhën në vazhdim.

Kur mbulon programe të zbatuara nga përfituesi IPA III me menaxhim indirekt, raporti bazohet në informacionin e dhënë nga Autoritetet Menaxhuese dhe Organet e Ndërmjetme, si edhe trajton progresin e bërë në zbatimin e detyrave të besuara, duke përfshirë ndonjë problem të hasur dhe masat korrigjuese të ndërmarra.

(3) Kërkesa raportimi shtesë nga KKIPA mund të përcaktohen në marrëveshjet sektoriale apo të financimi, duke përfshirë kërkesat e raportimit për programet operacionale të përcaktuara në nenin 16(5) dh programet e përcaktuara në nenin 16(7).

Neni 60 Kërkesa raportimi nga KKIPA në menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III

Jo më vonë se 16 muaj nga përfundimi i zbatimit të secilit program, KKIPA i dorëzon Komisionit raportin përfundimtar për zbatimin e atij programi, i cili mbulon të gjithë periudhën e zbatimit, duke përfshirë veçanërisht informacionin për rezultatet e pritshme dhe aktuale si dhe të dhëna financiare lidhur me zbatimin e aktiviteteve.

Neni 61 Kërkesat e raportimit për ZKA-në në menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III

(1) Deri më 15 janar të çdo viti, ZKA i dorëzon Komisionit dhe Autoritetit Auditues një ekstrakt të të dhënave në format elektronik që mban në sistemin kontabël më 31 dhjetor të vitit financiar pararendës. Ekstrakti shoqërohet me një raport vjetor kontabël me të dhënat në periudhën e duhur, duke përdorur modelin *ad hoc* që Komisioni ia vë në dispozicion.

(2) Deri më 15 shkurt të çdo viti, ZKA i dorëzon Komisionit – duke vënë për dijeni KKIPA-n dhe Autoritetin Auditues – informacionin e mëposhtëm për vitin financiar pararendës:

(a) pasqyra apo raporte financiare vjetore me bazë akruale të hartuara sipas formatit të raporteve apo pasqyrave financiare bashkëlidhur marrëveshjes së financimit, ku tregohen qartë shpenzimet e pranuara dhe pagesat e kryera;

(b) një raport për sistemin e menaxhimit dhe kontrollit, duke përfshirë:

(i) përmbledhjen e raporteve të verifikimit dhe kontrolleve të kryera nga Struktura Menaxhuese;
(ii) analizën e natyrës, shkakut, përmasave dhe ndikimit të gabimeve financiare;
(iii) përmbledhjen e ndryshimeve thelbësore në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit, rregullat apo procedurat e përfituesit IPA III, ku analizohet ndikimii tyre në menaxhimin e fondeve të BE-së;
(iv) vetëvlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit, ku respektohen kërkesat e nenit 12(3) dhe Shtojcës B, duke identifikuar dobësitë dhe masat korrigjuese të ndërmarra apo të planifikuara;

(c) situatën e planeve të veprimit dhe ndjekjen e raporteve të auditit të hartuara nga Autoriteti Auditues, shërbimet e auditit të brendshëm dhe Komisioni;

(d) deklaratën vjetore të menaxhimit për secilin program, të përpiluar sipas Shtojcës C; nëse konfirmimet që kërkon Shtojca C mungojnë, ZKA nxjerr deklaratën vjetore të menaxhimit me rezervë, duke informuar Komisionin për arsyet dhe pasojat e mundshme, si edhe masat e ndërmarra apo të planifikuara për korrigjimin e situatës dhe për mbrojtjen e interesave financiare të Bashkimit Evropian.

(3) Deri më 31 korrik të çdo viti, përveç kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje sektoriale apo marrëveshje financimi, ZKA u dërgon Komisionit dhe Autoritetit Auditues raportet apo pasqyrat financiare me bazë akruale për periudhën 12-mujore që ka përfunduar më 30 qershor të të njëjtit vit. Ato përpilohen në përputhje me formatin e raporteve dhe pasqyrave financiare bashkëlidhur marrëveshjes së financimit, ku tregohen qartë shpenzimet e pranuara dhe pagesat e kryera.

(4) Jo më vonë se 16 muaj nga përfundimi i zbatimit të secilit program, ZKA i dërgon Komisionit pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve të programit duke përdorur modelin që Komisioni ia vë në dispozicion. Sipas rastit, pasqyra shoqërohet me kërkesë-pagesën përfundimtare.

(5) Të gjitha raportet financiare, pasqyrat financiare dhe llogaritë e përcaktuara në këtë nen, certifikohen nga ZKA. Certifikimi nënkupton konfirmimin e plotësisë, saktësisë dhe vërtetësisë së raporteve financiare, pasqyrave financiare dhe llogarive.

(6) Në marrëveshjet sektoriale apo të financimit mund të parashikohen kërkesa raportimi shtesë për ZKA-në.

Neni 62 Kërkesat e raportimit për Autoritetet Menaxhuese në menaxhimin indirekt nga përfituesi IPA III

(1) Autoritetet Menaxhuese dhe Organet e Ndërmjetme u japin të gjithë informacionin e nevojshëm KKIPA-s, ZKA-së dhe Autoritetit Auditues, me qëllim mbështetjen e punës së tyre dhe përgatitjen e raporteve.

(2) Në fillim të çdo viti, Autoritetet Menaxhuese dhe Organet e Ndërmjetme i vënë në dispozicion ZKA-së raporte apo pasqyra financiare vjetore me bazë akruale për vitin financiar pararendës lidhur me programet nën përgjegjësinë e tyre.

(3) Në fillim të çdo viti, Autoritetet Menaxhuese vënë në dispozicion të ZKA-së deklarata menaxhimi vjetor për vitin financiar pararendës lidhur me programet nën përgjegjësinë e tyre. Këto deklarata menaxhimi vjetor pasqyrojnë të gjitha aspektet thelbësore të përcaktuara në Shtojcën C.

(4) Objekti i saktë i raporteve, pasqyrave financiare dhe deklaratave që përmenden në pikat (2) dhe (3) të këtij neni, modelet e tyre, metodat e përgatitjes, dokumentet mbështetëse dhe afati përcaktohen nga ZKA dhe parashikohen në marrëveshjet e punës të lidhura ndërmjet ZKA-së dhe secilit Autoritet Menaxhues.

(5) KKIPA dhe Komisioni mund t'u kërkojnë Autoriteteve Menaxhuese të hartojnë raporte të posaçme (*ad hoc),* tematike ose periodike mbi zbatimin e programeve nën përgjegjësinë e tyre. Raportet mund t'i paraqiten për shqyrtim komitetit monitorues sektorial përgjegjës.

(6) Në marrëveshjet sektoriale apo të financimit mund të parashikohen kërkesa raportimi shtesë për Autoritetet Menaxhuese dhe Organet e Ndërmjetme.

Neni 63 Kërkesat e raportimit për Autoritetin Auditues në menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III

(1) Deri më 15 shkurt të çdo viti, përveç kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje sektoriale apo marrëveshje financimi, Autoriteti Auditues i dorëzon Komisionit dhe qeverisë së Përfituesit IPA III - duke vënë në dijeni KKIPA dhe ZKA - një opinion auditi vjetor sipas modelit të paraqitur në Shtojcën E.

(2) Deri më 15 shkurt të çdo viti, përveç kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje sektoriale apo marrëveshje financimi, Autoriteti Auditues i dorëzon Komisionit një raport auditi vjetor sipas modelit të paraqitur në Shtojcën D, i cili mbështet opinionin e auditit vjetor të përmendur në pikën (1).

(3) Në raste përjashtimore dhe me kërkesë të argumentuar nga një Autoritet Auditues, Komisioni mundet që afatin 15 shkurt të përcaktuar në pikat (1) dhe (2) ta shtyjë deri më 1 mars, përveç kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje sektoriale apo marrëveshje financimi.

(4) Brenda tre muajve nga dorëzimi i pasqyrës përfundimtare të shpenzimeve nga ZKA, Autoriteti Auditues i dërgon Komisionit një opinion auditi për pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve, sipas modelit të paraqitur në Shtojcën F.

(5) Opinioni i auditit për pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve shoqërohet me raportin përfundimtar të auditimit sipas modelit të paraqitur prej Komisionit.

(6) Autoriteti Auditues i paraqet Komisionit raporte të auditit të sistemeve menjëherë pasi përfundon procedura e oponencës me të audituarit përkatës.

(7) Në marrëveshjet sektoriale apo të financimit mund të përfshihen kërkesa specifike shtesë lidhur me raportet dhe opinionet e Autoritetit Auditues.

SEKSIONI VII DISPOZITAT PËR PROGRAMET E BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR

TITULLLI I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 64 Format e bashkëpunimit ndërkufitar

(1) Asistenca në këtë Seksion synon të promovojë marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, të nxisë integrimin në BE dhe të promovojë zhvillimin socio-ekonomik përmes nismave të përbashkëta vendore dhe rajonale.

(2) Bashkëpunimi ndërkufitar jep asistencë për sa më poshtë:

(a) bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet një ose më shumë Shteteve Anëtare dhe një ose më shumë përfituesve IPA III;

(b) bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet dy ose më shumë përfituesve IPA III;

(c) pjesëmarrjen e përfituesve IPA III në programet e bashkëpunimit ndër-rajonal dhe transnacional të ERDF-së (Fondi Evropian për Zhvillim Rajonal).

(3) Ky Seksion zbatohet për bashkëpunimin ndërkufitar të përcaktuar në pikën (2), germa (b). Rregullat programimit të zbatueshme për programet e përcaktuar në pikën (2), germat (a) dhe (c) parashikohen në marrëveshjet e financimit që lidhen në zbatim të nenit 5 të Rregullores Interreg.

Neni 65 Përkufizime shtesë për bashkëpunimin ndërkufitar

(1) Për qëllime të këtij Seksioni zbatohen këto përkufizime:

(a) "operacion" do të thotë një projekt, kontratë, veprim ose grup projektesh të përzgjedhura nga Autoriteti Kontraktues i programit në fjalë, ose nën përgjegjësinë e tij, që kontribuon në arritjen e objektivave të një prioriteti tematik apo prioriteteve tematike të cilave u përket;

(b) "aplikant" do të thotë një person fizik apo subjekt me apo pa personalitet juridik i cili ka dorëzuar një aplikim në një procedurë për dhënie granti;

(c) "përfitues" do të thotë një subjekt publik ose privat, përgjegjës për fillimin dhe zbatimin e operacioneve në kuadrin e një programi bashkëpunimi ndërkufitar;

(d) "përfitues IPA kryesor" do të thotë përfituesi IPA III që është caktuar si udhëheqës dhe në të cilin është vendosur autoriteti kontraktues për programin ndërkufitar.

(e) "struktura të bashkëpunimit ndërkufitar (SBNK)" do të thotë institucionet e përfshira në përgatitjen dhe menaxhimin e një programi BNK në secilin prej përfituesve pjesëmarrës IPA III. Përgjegjësitë e secilës strukturës BNK përcaktohen në varësi të llojit të menaxhimit.

Neni 66 Bashkëfinancimi

(1) Norma e bashkëfinancimit të BE-së për çdo prioritet tematik nuk tejkalon 85% të shpenzimeve të pranueshme të çdo programi bashkëpunimi ndërkufitar. Për asistencën teknike, norma e bashkëfinancimit të BE-së është 100%.

TITULLI II RREGULLAT PËR PROGRAMIMIN

Neni 67 Prioritetet tematike dhe përqendrimi i bashkëpunimit ndërkufitar IPA III

(1) Prioritetet tematike të përcaktuara në Shtojcën III të Rregullores IPA III grupohen në grupe) tematikë në Kuadrin e Programimit IPA III, me qëllim që të jepet asistencë më e fokusuar. Përfituesi IPA III përzgjedh maksimumi dy grupe tematikë për secilin program bashkëpunimi ndërkufitar, përveç grupit tematik "përmirësimi i kapaciteteve të autoriteteve rajonale dhe vendore në trajtimin e sfidave vendore".

(2) Për programet e bashkëpunimit ndërkufitar akordohet një buxhet specifik i dedikuar për asistencën teknike, siç përcaktohet në nenin 73.

Neni 68 Shtrirja gjeografike

Përfituesit pjesëmarrës IPA III dhe Komisioni bien dakord për listën e rajoneve përfituese që t'i përfshijnë në programin e bashkëpunimit ndërkufitar përkatës.

Neni 69 Përgatitja, vlerësimi, miratimi dhe ndryshimet në programet e bashkëpunimit ndërkufitar

(1) Programet e bashkëpunimit ndërkufitar hartohen sipas programit model të dhënë prej Komisionit dhe përgatiten bashkërisht nga përfituesit pjesëmarrës IPA III.

(2) Për çdo prioritet tematik të përzgjedhur, përfituesit pjesëmarrës IPA III bien dakord për objektivat specifikë, rezultatet e pritshme, synimet, indikatorët dhe llojet e aktiviteteve që do të mbështeten, si edhe identifikojnë grupet kryesore të synuara dhe llojet e aplikantëve.

(3) Përfituesi kryesor IPA III i dorëzon elektronikisht programin e bashkëpunimit ndërkufitar Komisionit për miratim.

(4) Komisioni vlerëson konsistencën e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar ndaj kuadrit programues IPA III dhe kontributin e tyre efektiv në prioritetet tematike të përzgjedhura dhe të përcaktuara në Shtojcën III të Rregullores IPA III.

(5) Komisioni bën komente brenda tre muajve nga data e dorëzimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar. Përfituesit pjesëmarrës IPA III i vënë në dispozicion Komisionit të gjithë informacionin shtesë të nevojshëm dhe, sipas rastit, rishikojnë programin e bashkëpunimit ndërkufitar të propozuar.

(6) Para miratimit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar, Komisioni sigurohet që të gjitha komentet e tij janë pasqyruar në nivel të mjaftueshëm.

(7) Programeve të bashkëpunimit ndërkufitar mund t'u bëhen ndryshime me nismën e përfituesve pjesëmarrës IPA III ose të Komisionit, me pëlqimin e përfituesve pjesëmarrës IPA III.

(8) Kërkesat për ndryshime në programet e bashkëpunimit ndërkufitar që paraqiten prej përfituesve pjesëmarrës IPA III duhet të argumentohen siç duhet dhe të përcaktojnë veçanërisht ndikimin e pritshëm të ndryshimeve në programin e bashkëpunimit ndërkufitar në lidhje me arritjen e objektivave. Këto kërkesa shoqërohen me programin e rishikuar. Për ndryshimet në programet e bashkëpunimit ndërkufitar zbatohen pikat (3) deri në (6).

(9) Miratimi i Komisionit nuk kërkohet për korrigjime të natyrës tërësisht materiale apo editoriale që nuk prekin zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar. Përfituesit pjesëmarrës IPA III informojnë pa vonesa Komisionin për këto korrigjime pasi të jenë kryer.

Ndryshimet mund të kërkohen në një apo disa prej rasteve të mëposhtme:

(a) në vijim të një shqyrtimi të kuadrit programues IPA III që rezulton në ndryshime të strategjive të cilat ndikojnë ndjeshëm në programet e bashkëpunimit ndërkufitar, duke përfshirë ndryshime në vendndodhjen e autoritetit kontraktues apo në planin financiar;

(b) në vijim të ndryshimeve të mëdha socio-ekonomike në zonën e programit;

(c) për të pasqyruar ndryshime të mëdha në BE, përfituesin IPA III apo prioritetet rajonale;

(d) në vijim të rezultateve të vlerësimeve të përcaktuara në nenin 55.

Neni 70 Marrëveshjet dypalëshe ndërmjet përfituesve IPA III për menaxhimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar të zbatuara me menaxhim indirekt

(1) Në menaxhimin indirekt, përfituesit pjesëmarrës IPA III lidhin - për të gjithë kohëzgjatjen e programit të bashkëpunimit ndërkufitar - një marrëveshje dypalëshe ku parashikohen përgjegjësitë përkatëse për zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar. Marrëveshjet dypalëshe përmbajnë:

(a) përshkrimin e strukturave kryesore zbatuese dhe rolet e përgjegjësitë e tyre;

(b) përshkrimin e modaliteteve menaxhuese, financiare, të kontrollit dhe auditit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar;

(c) procedurat kryesore të zbatimit, përfshirë procesin për përzgjedhjen e operacioneve dhe monitorimin në nivel operacioni si dhe të programit të bashkëpunimit ndërkufitar në përgjithësi;

(d) dispozitat për të garantuar ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve të përfituesve, si edhe për të garantuar kryerjen e verifikimeve të përcaktuara në Klauzolën 8(1)(b) dhe (c) të Shtojcës A;

(e) masa korrigjuese në rastin e vështirësive në zbatim;

(f) dispozita për të garantuar menaxhimin e qëndrueshëm financiar të fondeve të akorduara

për programin e bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë rikuperimin e shumave të paguara më tepër;

(g) procedura për përjashtimin nga taksat që parashikon neni 28;

(h) hollësi për menaxhimin financiar të programit, përfshirë pagesat ndërmjet përfituesve IPA III, mbajtjen e të dhënave kontabël, detyrimet e raportimit dhe parregullsitë.

TITULLI III OPERACIONET

Neni 71 Përzgjedhja e operacioneve

(1) Operacionet e përzgjedhura në kuadrin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar duhet të gjenerojnë ndikime dhe përfitime të qarta ndërkufitare.

(2) Operacionet në kuadrin e bashkëpunimit ndërkufitar përzgjidhen nga autoriteti kontraktues përmes thirrjeve për propozime që mbulojnë të gjithë zonën përfituese.

(3) Përfituesit pjesëmarrës IPA III mund të identifikojnë edhe operacione jashtë thirrjes për propozime. Në këtë rast, operacionet përmenden specifikisht në programin e bashkëpunimit ndërkufitar të përcaktuar në nenin 69.

(4) Operacionet e përzgjedhura për bashkëpunimin ndërkufitar përfshijnë përfitues nga të paktën dy përfitues pjesëmarrës IPA III. Përfituesit bashkëpunojnë në përpilimin dhe zbatimin e operacioneve. Gjithashtu, ato bashkëpunojnë me personel apo me financimin e operacioneve, ose me të dyja.

(5) Një operacion mund të zbatohet vetëm në një përfitues pjesëmarrës IPA III, me kusht që të identifikohen ndikimet dhe përfitimet ndërkufitare.

Neni 72 Përfituesit

(1) Përfituesit duhet të jenë të vendosur në një nga përfituesit pjesëmarrës IPA III të programit.

(2) Përfituesit caktojnë një prej tyre si përfitues kryesor. Përfituesi kryesor garanton zbatimin e të gjithë operacionit, monitoron që operacioni të zbatohet sipas kushteve të parashikuara në kontratë dhe përcakton modalitetet me përfituesit e tjerë për të garantuar menaxhimin e shëndoshë financiar të fondeve të akorduara për operacionin, përfshirë modalitetet/marrëveshjet për rikuperimin e shumave të paguara më tepër.

Neni 73 Asistenca teknike

(1) Secili program bashkëpunimi ndërkufitar ka të akorduar një buxhet specifik për mbështetjen me asistencë teknike, e cila kufizohet në 10% të kontributit të BE-së për programin e bashkëpunimit ndërkufitar.

(2) Mbështetja me asistencë teknike mund të përfshijë ndër të tjera:

(a) përgatitjen, menaxhimin, monitorimin, vlerësimin, informimin, komunikimin,

formimin e rrjeteve, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, aktivitetet e kontrollit dhe auditit lidhur me zbatimin e programit;

(b) aktivitete për forcimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e programit;

(c) aktivitete për zvogëlimin e barrës administrative për përfituesit, përfshirë sistemet e shkëmbimit të të dhënave elektronike, si edhe aktivitete për të forcuar kapacitetet dhe shkëmbimin e praktikave të mira ndërmjet autoriteteve në përfituesit pjesëmarrës IPA III dhe të përfituesve në menaxhimin e asistencës IPA III.

(d) financimin e Sekretariatit të Përbashkët Teknik.

(3) Mbështetja me asistencë teknike mund të jepet edhe për periudha programimi pararendëse apo pasuese.

(4) Me derogim nga neni 29(2), shpenzimet e asistencës teknike që mbështet përgatitjen e një programi bashkëpunimi ndërkufitar dhe ngritjen e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit mund të jenë të pranueshme për financim para datës së nënshkrimit të marrëveshjes së financimit përkatëse, kontratave dhe shtojcave në rastet e parashikuara në nenin 27(6) të Rregullores NDICI.

TITULLI IV ZBATIMI

Neni 74 Modalitetet e Zbatimit

Programet e bashkëpunimit ndërkufitar zbatohen me menaxhim direkt ose me menaxhim indirekt me përfituesin kryesor IPA III.

TITULLLI V STRUKTURAT DHE AUTORITETET E PROGRAMIT DHE PËRGJEGJËSITË E TYRE

Neni 75 Strukturat dhe autoritetet për menaxhimin e BNK-së

(1) Strukturat e mëposhtme të parashikuara në nenin 10 përfshihen në menaxhimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar në përfituesit IPA III:

(a) KKIPA-t e vendeve pjesëmarrëse në programet e bashkëpunimit ndërkufitar dhe, sipas rastit, koordinatorët e bashkëpunimit territorial, që janë bashkërisht përgjegjës për të garantuar që objektivat e përcaktuar në programet e bashkëpunimit ndërkufitar të jenë në përputhje me objektivat e kuadrit programues IPA III;

(b) ZKA dhe Struktura Menaxhuese e përfituesit kryesor IPA III pjesëmarrës, kur programi ndërkufitar zbatohet me menaxhim indirekt;

(c) strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar në të gjithë përfituesit pjesëmarrës IPA III që duhet të bashkëpunojnë ngushtë në programimin dhe zbatimin e programit të bashkëpunimit kufitar përkatës. Në rastin e menaxhimit indirekt, struktura e

bashkëpunimit ndërkufitar në përfituesin kryesor IPA III kryen detyrat e Autoritetit Menaxhues. Autoriteti Menaxhues cakton Organet e Ndërmjetme.

(d) Autoriteti Auditues siç përcakton neni 10(1), germa (e) kur programi ndërkufitar zbatohet me menaxhim indirekt me përfituesin IPA III.

(2) Përfituesit pjesëmarrës IPA III ngrenë për çdo program bashkëpunimi ndërkufitar një Komitet të Përbashkët Monitorues (KPM) i cili përmbush edhe rolin e komitetit monitorues sektorial të parashikuar në nenin 53.

(3) Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT) ngrihet për të ndihmuar Komisionin, autoritetet dhe strukturat menaxhuese të programit, si dhe KPM-në. I njëjti SPT mund të ndihmojë në përgatitjen dhe zbatimin e më shumë se një programi bashkëpunimi ndërkufitar.

Neni 76 Strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar dhe Autoriteti Menaxhues IPA

(1) Strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar ngrihen brenda administratës së secilit përfitues pjesëmarrës IPA III që të hartojnë, të zbatojnë dhe të menaxhojnë programet e bashkëpunimit ndërkufitar. E njëjta strukturë bashkëpunimi ndërkufitar mund të përdoret për më shumë se një program bashkëpunimi ndërkufitar.

(2) Në menaxhimin indirekt, struktura e bashkëpunimit ndërkufitar e përfituesit kryesor IPA III kryen detyrat e Autoritetit Menaxhues.

(3) Strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar të përfituesve pjesëmarrës IPA III bashkëpunojnë ngushtë në kryerjen e detyrave me interes të ndërsjellë. Ato bashkërisht realizojë funksionet dhe marrin përsipër përgjegjësitë si më poshtë:

(a) përgatisin programet e bashkëpunimit ndërkufitar sipas nenit 69, ose rishikime të tyre;

(b) përgatisin një marrëveshje dypalëshe sipas nenit 70 në rastin e menaxhimit indirekt dhe garantojnë zbatimin e saj;

(c) bashkëpunojnë për të garantuar realizimin e detyrave të përcaktuara në pikat (4) dhe (5) të këtij neni;

(d) garantojnë pjesëmarrjen në mbledhjet e KPM-së dhe në mbledhje të tjera dypalëshe;

(e) emërojnë përfaqësuesin(t) e tyre në KPM;

(f) ngrenë Sekretariatin e Përbashkët Teknik (SPT) dhe garantojnë plotësimin e tij me personel të mjaftueshëm;

(g) përgatisin dhe zbatojnë vendimet strategjike të KPM-së;

(h) mbështetin punën e KPM-së dhe i japin informacionin e kërkuar për të kryer detyrat e veta, sidomos të dhëna mbi progresin e programit operacional në arritjen e objektivave specifikë dhe synimeve për çdo prioritet tematik siç janë përcaktuar në programin e bashkëpunimit ndërkufitar;

(i) ngrenë një sistem për mbledhjen e informacionit të besueshëm mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

(j) hartojnë raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit, siç përcakton neni 80;

(k) përgatisin dhe zbatojnë një plan koherent për komunikimin dhe vizibilitetin;

(l) hartojnë një plan pune vjetor për SPT-në që miratohet nga KPM-ja.

(4) Nëse programi i bashkëpunimit ndërkufitar zbatohet me menaxhim indirekt nga përfituesi IPA III, Autoriteti Menaxhues kryen detyrat më poshtë, përveç atyre të përcaktuara në Klauzolën 6 të Shtojcës A:

(a) emëron anëtarët me të drejtë vote në komisionin e vlerësimit dhe garanton që komisioni i vlerësimit të ketë edhe një anëtar me të drejtë vote nga përfituesi jokryesor IPA III, ndërsa organi i ndërmjetëm për menaxhimin financiar sipas autoritetit që ka, emëron kryetarin dhe sekretarin e komisionit;

(b) përgatit dokumentacionin teknik të nevojshëm për shpalljen e thirrjeve, në bashkëpunim të ngushtë me përfituesin tjetër pjesëmarrës IPA III;

(c) kryen ndjekjen operacionale, monitoron aspektet teknike të operacioneve dhe konfirmon se operacionet janë realizuar në bashkëpunim të ngushtë me përfituesin tjetër pjesëmarrës IPA III.

(5) Nëse programi i bashkëpunimit ndërkufitar zbatohet me menaxhim indirekt nga përfituesi kryesor IPA III dhe strukturat dhe autoritetet e evidentuara në nenin 10(1), germat (a) deri në (d) nuk mund të realizojnë verifikimet e menaxhimit në mbarë zonën e programit, përfituesit pjesëmarrës IPA III bien dakord se si të realizohet ky funksion i verifikimeve të menaxhimit. Modalitetet për kryerjen e verifikimeve të tilla përcaktohen në marrëveshjen dypalëshe të parashikuar në nenin 70.

Neni 77 Autoriteti Auditues

(1) Nëse programi i bashkëpunimit ndërkufitar zbatohet me menaxhim indirekt nga përfituesi IPA III, Autoriteti Auditues për programin e bashkëpunimit ndërkufitar është ai nga vendi i përfituesit kryesor IPA III.

(2) Kur Autoriteti Auditues i parashikuar në pikën (1) nuk ka autorizimin për të kryer drejtpërdrejt funksionet në mbarë territorin që mbulon programi i bashkëpunimit ndërkufitar, ndihmohet nga një grup audituesish që përbëhet nga një përfaqësues prej secilit përfitues pjesëmarrës IPA III në programin e bashkëpunimit ndërkufitar. Grupi i auditorëve kryesohet nga Autoriteti Auditues i vendit kryesor. Modalitetet specifike për kryerjen e funksioneve të tilla përcaktohen në marrëveshjen dypalëshe të parashikuar në nenin 70.

Neni 78 Komiteti i Përbashkët Monitorues (KPM)

(1) Përfituesit pjesëmarrës IPA III ngrenë një KPM jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e marrëveshjes së financimit;

(2) Secili përfitues pjesëmarrës IPA III emëron përfaqësuesit e vet në KPM;

(3) KPM-ja përbëhet nga përfaqësues të KKIPA-ve dhe koordinatorët e bashkëpunimit territorial, sipas rastit, si dhe përfaqësues të përfituesve pjesëmarrës IPA III (autoritete kombëtare, rajonale dhe vendore), përfshirë strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar dhe, sipas rastit, grupe të tjera interesi si organizatat e shoqërisë civile. Komisioni merr pjesë në punimet e KPM-së me rol këshillimor.

(4) KPM-në e kryeson përfituesi jokryesor IPA III.

(5) KPM-ja mblidhet të paktën dy herë në vit. Takime të posaçme mund të mblidhen me nismën e përfituesit pjesëmarrës IPA III apo të Komisionit.

(6) KPM-ja miraton vetë rregulloren e brendshme e cila hartohet në konsultim me strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar, KKIPA-t dhe Komisionin.

(7) Secili përfitues pjesëmarrës IPA III ka të drejta vote të barabarta, pavarësisht numrit të përfaqësuesve që ka emëruar.

(8) Detyrat e KPM-së janë si më poshtë:

(a) ka përgjegjësinë të identifikojë prioritetet tematike, objektivat specifikë, përfituesit e synuar dhe fokusin specifik të secilës thirrje për propozime që miratohen nga Komisionit;

(b) shqyrton dhe jep opinion këshillues për listën e operacioneve të përzgjedhura përmes thirrjeve për propozime para vendimit për shpalljen e fituesit të grantit. Autoriteti kontraktues miraton vendimin përfundimtar për shpalljen e fituesve të granteve;

(c) shqyrton progresin e bërë në arritjen e objektivave specifikë, rezultateve të pritshme dhe synimeve për çdo prioritetet tematik që janë përcaktuar në programin e bashkëpunimit ndërkufitar, mbi bazën e informacionit që merr nga strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar të përfituesve pjesëmarrës IPA III. Progresi monitorohet kundrejt indikatorëve të përcaktuar në programin e bashkëpunimit ndërkufitar;

(d) shqyrton konstatimet dhe përfundimet përkatëse si dhe propozimet për masa korrigjuese apo ndjekëse që burojnë nga kontrollet në vend, monitorimi dhe vlerësimet, nëse ka;

(e) miraton çdo propozim për rishikim të programit të bashkëpunimit ndërkufitar. Kur është e nevojshme, mund të bëjë propozime për ndryshime në programin e bashkëpunimit ndërkufitar siç parashikon neni 69(7), për të garantuar arritjen e objektivave të programit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe për të forcuar efikasitetin, efektivitetin, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e asistencës IPA III. Edhe KPM-ja mund të japë rekomandime sesi të përmirësohet zbatimi i programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

(f) shqyrton dhe miraton planin e komunikimit dhe vizibilitetit për programin e bashkëpunimit ndërkufitar;

(g) shqyrton dhe miraton planin e vlerësimit, siç përcaktohet në nenin 56(2);

(h) shqyrton dhe miraton raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit, siç përcaktohet në nenin 80;

(i) shqyrton dhe miraton planin vjetor të punës të Sekretariatit të Përbashkët Teknik.

(9) KPM-ja i raporton Komitetit Monitorues IPA të përfituesit kryesor IPA III.

Neni 79 Sekretariati i Përbashkët Teknik (SPT)

(1) Për çdo program bashkëpunimi ndërkufitar ngrihet një SPT për të ndihmuar Komisionin, strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar, Autoritetin Menaxhues dhe KPM-në, sipas rastit. SPT-ja do ta ketë vendndodhjen në vendin e përfituesit kryesor IPA III. SPT-ja mund të ketë një zyrë antenë në vendin e përfituesit tjetër pjesëmarrës IPA III. SPT-ja dhe zyra antenë duhet ta kenë vendndodhjen në zonën përfituese, përveç kur miratohet ndryshe nga Komisioni.

(2) Funksionimi i SPT-së financohet nga buxheti i asistencës teknike.

(3) Personeli i SPT-së përbëhet nga anëtarë të të dy përfituesve IPA III që marrin pjesë në programin e bashkëpunimit ndërkufitar.

(4) SPT-ja menaxhohet nga struktura e bashkëpunimit ndërkufitar e përfituesit kryesor IPA III.

(5) Strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar përgatitin çdo vit një plan pune për SPT-në, i cili i dërgohet KPM-së për shqyrtim dhe miratim.

(6) SPT-ja nuk merr pjesë dhe as kontribuon në verifikimet e menaxhimit apo në komisionin e vlerësimit.

(7) SPT-ja mund të jetë përgjegjëse për detyrat si më poshtë:

(a) organizon mbledhjet e KPM-së, përfshirë mbajtjen dhe shpërndarjen e procesverbalit të mbledhjeve;

(b) ndihmon aplikantët potencialë në gjetjen e partnerëve dhe hartimin e projekteve, duke organizuar ditë informuese dhe tryeza të rrumbullakëta; zhvillon dhe mban rrjetin e grupeve të interesit;

(c) ndihmon përfituesit dhe partnerët me zbatimin e projekteve;

(d) përgatit, kryen dhe raporton për aktivitetet monitoruese të operacioneve të bashkëpunimit ndërkufitar;

(e) ngre një sistem për mbledhjen e informacionit të besueshëm mbi zbatimin e programit të bashkëpunimit ndërkufitar;

(f) jep kontribut në raportet vjetore dhe përfundimtare mbi zbatimin e programit ndërkufitar;

(g) planifikon dhe zbaton fushata informimi dhe aktivitete të tjera lidhur me sensibilizimin publik mbi programin e bashkëpunimit ndërkufitar, përfshirë publikimin e materialeve reklamuese rreth programit ndërkufitar dhe mirëmbajtjen e faqes së internetit të programit të bashkëpunimit ndërkufitar.

TITULLI VI RAPORTIMI

Neni 80 Raportet vjetore dhe përfundimtare të zbatimit

(1) Për qëllime të kërkesës së raportimit të përcaktuar në Titullin III, strukturat e bashkëpunimit ndërkufitar hartojnë një raport vjetor zbatimi dhe një raport përfundimtar zbatimi për secilin program bashkëpunimi ndërkufitar. Raporti përfundimtar i zbatimit mund të përfshijë raportin vjetor të fundit. Raporti ndjek modelin bashkëlidhur në marrëveshjen e financimit.

(2) Pas shqyrtimit dhe miratimit nga KPM-ja, raportet i dërgohen KKIPA-s dhe ZKA-së, sipas rastit, të përfituesit IPA III. KKIPA i përfituesit kryesor IPA III ia dorëzon raportet KKIPA-s të përfituesve të tjerë pjesëmarrës IPA III dhe Komisionit sipas kërkesave të raportimit të përcaktuara në Titullin III.

SEKSIONI VIII DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 81 Komunikimi

Shkëmbimi i informacionit dhe dokumenteve ndërmjet Komisionit dhe Përfituesit IPA III në lidhje me programimin, programet dhe ndryshimet në to, si edhe i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e programeve bëhet sa të jetë i mundur me mjete elektronike. Modalitetet për shkëmbimin e të dhënave dakordësohen ndërmjet Komisionit dhe përfituesit IPA III dhe përcaktohen në marrëveshjen sektoriale apo atë të financimit.

Neni 82 Konsultimi

(1) Çdo problematikë që lind në lidhje me zbatimin apo interpretimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me bisedime ndërmjet Palëve dhe rezulton, kur është e nevojshme, në ndryshime të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Në rast mospërmbushjeje të një detyrimi të përcaktuar në këtë Marrëveshje dhe për të cilën nuk merren masa korrigjuese në kohën e duhur, Komisioni mund ta pezullojë këtë Marrëveshje në zbatim të nenit 90.

(3) Përfituesi IPA III mund të heqë dorë nga zbatimi i plotë apo i pjesshëm i asistencës së IPA III. Për këtë qëllim, përfituesi IPA III njofton Komisionin të paktën 6 muaj paraprakisht. Palët përcaktojnë hollësitë e kësaj dorëheqjeje me anë të shkëmbimit të letrave, ose me anë të miratimit të ndryshimeve në marrëveshjen e financimit, sipas rastit.

Neni 83 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, arbitrazhi

(1) Kjo Marrëveshje rregullohet nga e drejta e BE-së.

(2) Nëse një mosmarrëveshje që lind nga interpretimi, zbatimi apo vlefshmëria e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të zgjidhet me bisedime, ajo zgjidhet në arbitrazh sipas Rregullave të vitit 2012 për Gjykatën e Përhershme të Arbitrazhit, duke iu nënshtruar rregullave të mëposhtme:

(a) Përbërja e Trupës

Për pretendime me vlerë 500 000 EURO e lart: trupa përbëhet nga tre arbitra. Secila palë cakton një arbitër brenda 40 ditë kalendarike pas dërgimit të njoftimit të arbitrazhit. Dy arbitrat e caktuar nga palët caktojnë secili një arbitër të tretë që të veprojë si arbitër kryesues.

Për pretendime me vlerë nën 500 000 EURO: trupa përbëhet nga një arbitër, përveç kur palët bien dakord ndryshe.

Nëse trupa nuk krijohet brenda 80 ditësh kalendarike pas dërgimit të njoftimit të arbitrazhit, secila palë mund t'i kërkojë Sekretariatit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit apo një autoriteti tjetër të paanshëm të pranuar nga të dyja palët që të caktojë arbitrin(at) e nevojshëm.

(b) Selia

Selia e trupës së arbitrazhit është Hagë, Holandë.

(c) Gjuha

Gjuha e punimeve është anglishtja ose një gjuhë tjetër zyrtare e BE-së e pranuar bashkërisht nga palët. Nëse palët bien dakord, provat mund të depozitohen edhe në gjuhë të tjera.

(d) Procedura

Masat e ndërmjetme, ndërhyrjet e palëve të treta dhe *amicus curiae* përjashtohen.

Nëse trupës i kërkohet nga njëra palë që të trajtojë informacion ose materiale në mënyrë konfidenciale, vendimi merret në formën e një urdhri të arsyetuar dhe pasi dëgjohet pala tjetër (10 ditë kalendarike për të depozituar parashtrimet). Trupa analizon arsyet e kërkesës, natyrën e informacionit dhe të drejtën për mbrojtje gjyqësore efektive. Trupa,në veçanti, mund:

- ta kushtëzojë publikimin e informacionit/materialit me marrjen e masave specifike; ose
- të vendosë kundër publikimit të informacionit, por të urdhërojë prodhimin e versionit jokonfidencial apo përmbledhje të informacionit apo materialit që përmban të dhëna të mjaftueshme që i mundësojnë palës tjetër të shprehë qëndrimet e veta në mënyrë thelbësore.

Nëse trupës i kërkohet ta shqyrtojë çështjen në dhomë këshillimi, vendimi merret pasi dëgjohet pala tjetër (10 ditë kalendarike për të depozituar parashtrimet). Trupa mban parasysh arsyet e kërkesës dhe kundërshtimet e palës tjetër (nëse ka).

Nëse trupës i kërkohet të interpretojë apo të zbatojë të drejtën e Bashkimit Evropian, i ndërpret punimet dhe i kërkon Kryetarit të Gjykatës së Lartë të Parisit (Président du Tribunal de grande instance de Paris, 'juge d'appui'), në përputhje me nenet 1460 dhe 1505 të Kodit të Procedurës Civile të Francës që të kërkojë një vendim paraprak nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian në përputhje me nenin 267 të Traktatit të Themelimit të BE-së. Punimet e tribunalit të arbitrazhit rifillojnë sapo merret vendimi i *juge d'appui*. Vendimi i Gjykatës së Drejtësisë dhe i *juge d'appui* janë detyruese për trupën.

Vendimi i arbitrazhit është i formës së prerë dhe detyrues për palët të cilat e zbatojnë atë pa vonesa.

Secila palë mund të kërkojë që vendimi të shqyrtohet nga Gjykata e Apelit e Hagës (Gerechtshof Den Haag) mbi bazën e legjislacionit të brendshëm në fuqi. Në këtë rast, vendimi nuk konsiderohet i formës së prerë deri në përfundim të kësaj procedure. Vendimi i gjykatës shqyrtuese është detyrues për trupën.

(e) Shpenzimet

Shpenzimet e arbitrazhit konsistojnë në:
- tarifat dhe shpenzimet e arsyeshme të arbitrave
- shpenzimet e arsyeshme të ekspertëve dhe dëshmitarëve të miratuar nga trupa; dhe
- tarifat dhe shpenzimet e Sekretariatit të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit për punimet e arbitrazhit (p.sh. kateringu, puna administrative, sallat, përkthimi).

Tarifat e arbitrave nuk tejkalojnë:

- 30 000 EURO për arbitrat nëse vlera e kontestuar është nën 1 000 000 EURO
- 9% të vlerës së kontestuar nëse vlera është mbi 1 000 000 EURO. Në çdo rast, tarifat e arbitrave nuk tejkalojnë 300 000 EURO.

Shpenzimet e arbitrazhit përballohen nga palët në mënyrë të barabartë, përveç kur bihet dakord ndryshe.

Palët përballojnë vetë shpenzimet e tyre të përfaqësimit ligjor dhe shpenzimet e tjera që kryejnë në lidhje me arbitrazhin.

(f) Privilegjet dhe imunitetet

Marrëveshja për ta paraqitur mosmarrëveshjen në arbitrazh në zbatim të Rregullave të Arbitrazhit të vitit 2012 të Gjykatës së Përhershme të Arbitrazhit, nuk përbën dhe as nuk interpretohet si heqje dorë nga privilegjet apo imunitetet që gëzon secila palë.

Neni 84 Mosmarrëveshjet me palët e treta

(1) Pa cenuar juridiksionin e gjykatës të përcaktuar në një kontratë të financuar nga IPA III si gjykata përgjegjëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura ndërmjet palëve të kontratës, BE-ja gëzon në territorin e Republikës së Shqipërisë imunitet nga paditë, përfshirë arbitrazhin përveç parashikimeve në nenin 83 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe nga procedimet ligjore për çfarëdo mosmarrëveshje ndërmjet Komisionit Evropian dhe/ose Përfituesit IPA III dhe një pale të tretë, ose ndërmjet palëve të treta, që lidhet drejtpërdrejt

ose tërthorazi me dhënien e asistencës IPA III për Përfituesin IPA III në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, përveç rasteve kur BE-ja heq dorë shprehimisht nga ky imunitet.

(2) Në çdo procedim gjyqësor apo procedurë administrative para një gjykate, tribunali apo instance administrative në Republikën e Shqipërisë, përfituesi IPA III e evokon këtë imunitet si dhe mban një qëndrim që brendëson plotësisht interesat e BE-së. Kur është e nevojshme, Përfituesi IPA III dhe Komisioni angazhohen në konsultime paraprake në lidhje me qëndrimin që do të mbahet.

Neni 85 Njoftimet

(1) Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje bëhet me shkrim dhe në gjuhën angleze. Çdo komunikim nënshkruhet dhe dorëzohet si dokument origjinal ose si dokument origjinal i skanuar.

(2) Çdo komunikim në lidhje me këtë Marrëveshje dërgohet në adresat e mëposhtme:

Për Komisionin:

European Commission
Directorate-General for Neighbourhood and Enlargement Negotiations
Rue de la Loi 15
B-1049 Brussels, Belgium
E-mail: NEAR-D@ec.europa.eu

Për Përfituesin IPA III:
Koordinatori Kombëtar IPA
Z. Ilir Beqaj
Kryeministria
Bulevardi "Dëshmoret e Kombit"
Tirana, Albania
E-mail: beqaj.ilir@gmail.com

Neni 86 Shtojcat

Shtojcat e kësaj Marrëveshjeje janë pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 87 Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën kur Pala e fundit informon Palën tjetr me shkrim për miratimin e Marrëveshjes në përputhje me legjislacionin apo procedurën e vet.

Neni 88 Zbatueshmëria e marrëveshjes kuadër për IPA II

Marrëveshjet kuadër të nënshkruara ndërmjet Komisionit dhe Republikës së Shqipërisë mbeten në fuqi për asistencën e miratuar në kuadrin e instrumenteve të mëparshëm të para-anëtarësimit, derisa kjo asistencë të përfundojë sipas kushteve të marrëveshjeve përkatëse të financimit.

Neni 89 Ndryshimet

Kjo Marrëveshje rishikohet pas vlerësimit afatmesëm të Instrumentit të Asistencës së Para-anëtarësimit.

Çdo ndryshim i dakordësuar nga Palët bëhet me shkrim dhe është pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje. Çdo ndryshim i tillë hyn në fuqi sipas procedurës së përcaktuar në nenin 87. Komisioni mund të bëjë ndryshime apo të përditësojë Shtojcat në mënyrë të njëanshme, përveç Shtojcës A.

Neni 90 Pezullimi nga Komisioni dhe zgjidhja e Marrëveshjes

(1) Kjo Marrëveshje zbatohet për një afat të pacaktuar përveç nëse pezullohet nga Komisioni ose zgjidhjet nga njëra Palë duke njoftuar me shkrim Palën tjetër. Pezullimi nga Komisioni merr fuqi të menjëhershme përveç kur njoftohet ndryshe. Zgjidhja merr fuqi 3 muaj nga data e njoftimit me shkrim.

(2) Sapo kjo Marrëveshje pezullohet nga Komisioni ose zgjidhet prej cilësdo palë, çdo asistencë që është në proces zbatimi pezullohet nga Komisioni ose ndërpritet, përveç rastit të të drejtave të fituara në kuadrin e kontratave specifike të financuara nga IPA.

Neni 91 Masat kufizuese të BE-së

(1) Përkufizime:

(a) "Masat Kufizuese të BE-së" nënkuptojnë masat kufizuese/shtrënguese të miratuara në zbatim të Traktatit të Bashkimit Evropian (TBE) ose në zbatim të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE).
(b) "Person i Kufizuar" nënkupton çdo subjekt, individ apo grup individësh i klasifikuar nga BE-ja si subjekt i Masave Kufizuese të BE-së[18].

(2) Në të gjitha marrëdhëniet e tyre, Palët pranojnë që në zbatim të së drejtës së BE-së, asnjë fond apo burim ekonomik i BE-së nuk i vihet në dispozicion drejtpërdrejt apo tërthorazi apo në përfitim të Personave të Kufizuar.

(3) Përfituesi IPA III garanton se asnjë transaksion nga fondet e BE-së nuk shkon në dobi të subjekteve që janë në listën e sanksioneve të BE-së, qoftë drejtpërdrejt apo tërthorazi. Përfituesi IPA III zotohet ta përmbushë këtë detyrim:

(a) duke verifikuar listën e sanksioneve të BE-së para se të nënshkruajë apo të kryejë pagesa në kuadrin e marrëveshjeve përkatëse për cilindo Kontraktues, Përfitues Granti apo Marrësi Përfundimtar me të cilin Përfituesi IPA III ka ose pritet të ketë marrëdhënie kontraktuese të drejtpërdrejta (marrës i drejtpërdrejtë), me qëllim që të konstatojë nëse ky marrës është Person i Kufizuar.

[18] www.sanctionsmap.eu. Masa e sanksioneve është një instrument TI për identifikimin e regjimeve të sanksioneve. Sanksionet burojnë nga aktet ligjore të publikuara në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZ). Në rast mospërputhjeje ndërmjet akteve ligjore dhe përditësimeve në faqen e internetit, versioni në Gazetën Zyrtare do të ketë përparësi.

(b) përmes verifikimit apo mjeteve të tjera (që mund të jenë verifikime *ex post)* me bazë risku, me qëllim që asnjë subjekt që është Person i Kufizuar të mos marrë financime të BE-së tërthorazi.

(4) Në rast se Përfituesi IPA III konstaton se ndonjë marrës (i drejtpërdrejtë apo i tërthortë) i financimeve të BE-së është Person i Kufizuar, Përfituesi IPA III njofton menjëherë Komisionin.

(5) Pa cenuar detyrimin e përcaktuar në pikën 3 më lart, nëse Komisioni vlerëson se përdorimi i asistencës financiare të BE-së në kuadrin e IPA III rezulton apo ka rezultuar në shkelje të masave kufizuese të BE-së, shumat korresponduese nuk janë të pranueshme për asistencën financiare të BE-së në kuadrin e IPA III. Kjo nuk cenon asnjë të drejtë që Komisioni ka për pezullimin apo anulimin e veprimit të prekur nga kjo shkelje, për rikuperimin e financimeve të BE-së që ka kontribuuar Komisioni apo të pezullojë ose të anulojë marrëveshjen financiare kuadër të partneritetit.

(6) Përcaktimi i masave korrigjuese bëhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit. Masat korrigjuese zbatohen vetëm për financimet e BE-së që janë vënë në dispozicion apo në përfitim të një marrësi gjatë periudhës që ka qenë Person i Kufizuar.

(7) Kjo klauzolë nuk cenon përjashtimet që parashikohen në Masat Kufizuese të BE-së.

Kjo Marrëveshje hartohet në dy kopje në gjuhën angleze.

Nënshkruar për dhe në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në Tiranë, më datë ...

nga _____

Z. Ilir BEQAJ
Koordinator Kombëtar IPA

Nënshkruar për dhe në emër të Komisionit, në Bruksel, në datën ...

nga _____

Znj. Michela Matuella
Drejtore e Komanduar

SHTOJCA A

**Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave dhe autoriteteve
që ngrihen në zbatim të nenit 10
në menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III**

Klauzola 1 Dispozita të përgjithshme

(1) Funksionet dhe përgjegjësitë e strukturave dhe autoriteteve të ngritura në zbatim të nenit 10 në menaxhimin indirekt nga Përfituesi IPA III, të cilat përcaktohen në këtë Shtojcë, burojnë prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje.

(2) Hollësitë sesi këto funksione dhe përgjegjësi ushtrohen në praktikë mund të përcaktohen më tej në:

(a) marrëveshje sektoriale të lidhura në zbatim të nenit 9;

(b) marrëveshje financimi të lidhura në zbatim të nenit 8;

(c) marrëveshjet dypalëshe ndërmjet përfituesve IPA III për menaxhimin e programeve të bashkëpunimit ndërkufitar që zbatohen me menaxhim indirekt, të lidhura në zbatim të nenit 70;

(d) marrëveshje formale pune që përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e strukturave dhe autoriteteve, të lidhura në zbatim të nenit 11(3), germa (a);

(e) sistemin e kontrollit të brendshëm që ngrihet në zbatim të nenit 12(3), germa (a);

(f) çfarëdo marrëdhënie tjetër që përfshin këto struktura dhe autoritete, e cila është relevante për zbatimin e asistencës IPA III me menaxhim indirekt nga përfituesi IPA III.

(3) Burimet e renditura në pikën 2 mund të përmbajnë funksione dhe përgjegjësi shtesë të strukturave dhe autoriteteve të ngritura në zbatim të nenit 10.

Klauzola 2 Të gjitha strukturat dhe autoritetet

Strukturat dhe autoritetet e ngritura në Përfituesin IPA III në zbatim të nenit 10(1), germat (a) deri në (d), ushtrojnë brenda autoriteteve dhe kompetencave të tyre përkatëse funksionet dhe përgjegjësitë më poshtë:

(1) zbatojnë dhe promovojnë parimet e asistencës financiare të BE-së në kuadrin e IPA III, në përputhje me nenin 5(2);

(2) garantojnë ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve nën përgjegjësinë e tyre;

(3) respektojnë parimet e menaxhimit të qëndrueshëm financiar, transparencës dhe mosdiskriminimit, në përputhje me nenin 12(2);

(4) garantojnë nivel mbrojtjeje të interesave financiare të Bashkimit Evropian të barasvlershme me atë që sigurohet kur Komisioni zbaton drejtpërdrejt fondet IPA III, në përputhje me nenin 12(2) dhe (3);

(5) respektojnë kuadrin e kontrollit të brendshëm, në përputhje me Shtojcën B;

(6) mbikëqyrin strukturat vartëse;

(7) garantojnë dhe respektojnë ndarjen e mjaftueshme të detyrave;

(8) miratojnë masa efektive dhe proporcionale për të luftuar parregullsitë, mashtrimin, korrupsionin dhe konfliktin e interesit, në përputhje me nenin 51;

(9) garantojnë që agjentët apo përfaqësuesit e Komisionit, përfshirë OLAF-in (Zyra e BE-së kundër Mashtrimit), të mund të inspektojnë të gjithë dokumentacionin dhe llogaritë përkatëse që u përkasin zërave të financuar prej IPA III, në përputhje me nenin 50(4);

(10) ndihmojnë Gjykatën Evropiane të Llogarive në realizimin e auditeve lidhur me përdorimin e asistencës IPA III, në përputhje me nenin 50(4);

(11) garantojnë mbrojtjen e të dhënave personale të barasvlershme me atë që përcaktohet në Rregulloret (BE) 2018/1725 dhe (BE) nr. 2016/679, në përputhje me nenin 12(3), germa (f) dhe nenin 25;

(12) garantojnë publicitetin, transparencën, komunikimin strategjik dhe vizibilitetin e asistencës IPA III, në përputhje me nenin 12(2) dhe nenet 23 dhe 24;

(13) ndihmojnë autoritetet përgjegjëse të përfituesit IPA III për vënien në dispozicion të lehtësirave për zbatimin e veprimeve dhe kontratave, si edhe për zbatimin e rregullave për taksat/tatimet, detyrimet doganore dhe tarifa të tjera fiskale, në përputhje me nenet 27 dhe 28;

(14) marrin pjesë në komitetet monitoruese dhe u vënë në dispozicion të gjithë informacionin e nevojshëm për të mbështetur punën e tyre, në përputhje me nenet 52, 53 dhe 78;

(15) mbështesin vlerësimet dhe lehtësojnë aksesin në të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për vlerësimet që kryhen, në përputhje me nenet 55 dhe 56;

(16) ruajnë dokumentacion dhe informacion për të garantuar kronologji/gjurmë auditi me hollësi të mjaftueshme, në përputhje me nenet 32 dhe 49;

(17) marrin të gjitha masat e nevojshme për të lehtësuar zbatimin e asistencës IPA III, në përputhje me nenin 6(1), germa (d).

Klauzola 3 Koordinatori Kombëtar IPA (KKIPA)

(1) KKIPA ka rol koordinimi të përgjithshëm të asistencës IPA III në vendin e përfituesit IPA III, në përputhje me nenin 6.

(2) KKIPA ka përgjegjësinë e përgjithshme për programimin e asistencës nga përfituesi IPA

III. Në këtë kontekst, KKIPA kryen këto detyra:

(a) garanton lidhje të ngushtë ndërmjet përdorimit të asistencës IPA dhe procesit të përgjithshëm të anëtarësimit, në përputhje me nenin 6(1), germa (a);

(b) koordinon përgatitjen e përgjigjes strategjike dhe dorëzimin e saj Komisionit, në përputhje me nenin 16(3);

(c) koordinon përgatitjen e dokumenteve të veprimit, në përputhje me nenin 16(3);

(d) koordinon përgatitjen e dokumenteve të programimit të programeve operacionale në përputhje me nenin 16(5) dhe të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar, në përputhje me nenin 69;

(e) koordinon përgatitjen e ndryshimeve në programe, në përputhje me nenet 17 dhe 69, përveç programeve IPARD III për të cilat Autoriteti Menaxhues IPARD ia propozon ndryshimet Komisionit duke vënë për dijeni KKIPA-n;

(f) i dorëzon Komisionit projektet madhore për vlerësim, në përputhje me nenin 16(6);

(g) garanton që autoritetet publike dhe grupet e interesit siç janë partnerët ekonomikë, socialë dhe mjedisorë, organizatat e shoqërisë civile dhe autoritet vendore, të konsultohen siç duhet dhe të kenë akses në kohë reale në informacionin përkatës lidhur me asistencën IPA III, në përputhje me nenin 16(4).

(3) KKIPA është përgjegjës për detyrat e menaxhimit dhe kontrollit si më poshtë:

(a) ngritjen, funksionimin dhe pjesëmarrjen e grupeve të interesit në komitetet monitoruese, në përputhje me nenet 52, 53 dhe 78;

(b) vlerësimet dhe aksesin në të dhënat e përfituesi IPA III, në përputhje me nenet 55 dhe 56.

(4) KKIPA respekton kërkesat e raportimit të përcaktuara në nenet 59 dhe 60.

Klauzola 4 Zyrtari Kombëtar Autorizues (ZKA)

(1) ZKA ka përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin financiar të asistencës IPA III në vendin përfitues IPA III dhe për ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve.

(2) ZKA ka përgjegjësinë e përgjithshme për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të IPA III në vendin përfitues IPA III. Për këtë qëllim, ZKA kryen këto detyra:

(a) përgatit dhe i dorëzon Komisionit një kërkesë për t'i besuar/ngarkuar përfituesit IPA III detyrat e zbatimit të buxhetit për një program të caktuar, në përputhje me nenin 13(1) dhe 13(2);

(b) njofton Komisionin pa vonesa për ndonjë ndryshim thelbësor në sistemet, rregullat apo procedurat që lidhen me detyrat e zbatimit të buxhetit që i janë besuar përfituesit IPA

III, në përputhje me nenin 12(4);

(c) monitoron përmbushjen në vijimësi nga ana e strukturave dhe autoriteteve të kërkesave të neneve 12(2) dhe 12(3) dhe të Shtojcës B;

(d) informon Komisionin, duke vënë për dijeni KKIPA-n dhe Autoritetin Auditues, për çdo mospërmbushje të këtyre kërkesave, si edhe merr masa të përshtatshme mbrojtëse lidhur me pagesat e bëra apo kontratat e nënshkruara, në përputhje me nenin 14(1);

(e) merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar përmbushjen e rinovuar të kërkesave të neneve 12(3) dhe 12(4) dhe Shtojcës B;

(f) merr parasysh rezultatet e të gjitha verifikimeve dhe auditeve të jashtme lidhur me sistemin e menaxhimit dhe kontrollit IPA III, përfshirë ato të kryera nga Autoriteti Auditues, Komisioni apo Gjykata Evropiane e Llogarive, si edhe koordinon përgatitjen dhe zbatimin e planeve përkatëse të veprimit, me qëllim përmirësimin e përputhshmërisë dhe efektivitetit të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit IPA III;

(g) garanton hetim dhe trajtim efektiv të rasteve të dyshuara për parregullsi, mashtrim, korrupsion dhe konflikt interesi, si edhe funksionimin e një mekanizmi kontrolli dhe raportimi për to, në përputhje me nenin 51(2), (3) dhe (4);

(h) i jep mundësinë shërbimit të koordinimit kundër mashtrimit të përcaktuar në nenin 50(2) që të raportojë drejtpërdrejt parregullsitë dhe mashtrimin e dyshuar dhe mban dialog të rregullt për raportimin e parregullsive pranë atij shërbimi, me qëllim që të shmanget mosraportimi apo raportimi i dyfishtë i rasteve.

(3) Në fushën e menaxhimit financiar, ZKA kryen këto detyra:

(a) ngre një sistem kontabël akrual për regjistrimin dhe ruajtjen në format elektronik të të dhënave kontabël të sakta, të plota dhe të besueshme për secilin program/veprim/operacion IPA III që zbatohet me menaxhim indirekt nga përfituesi IPA III, në përputhje me nenin 58(2);

(b) organizon dhe menaxhon sistemin e llogarive në Euro;

(c) i dërgon Komisionit një parashikim të kërkesë-pagesave të mundshme, në përputhje me nenin 33(3);

(d) i dërgon Komisionit kërkesë-pagesat dhe merr pagesat nga Komisioni, në përputhje me nenet 33, 34, 35 dhe 36;

(e) garanton ekzistencën, korrektësinë dhe disponueshmërinë e elementëve të bashkëfinancimit;

(f) fondet që merr nga Komisioni dhe bashkëfinancimi publik ua përcjell Organeve të Ndërmjetme për menaxhim financiar për transferim të mëtejshëm tek marrësit e asistencës IPA III;

(g) garanton ekzistencën dhe disponueshmërinë e burimeve të mjaftueshme për të

përballuar mungesat e mundshme për shkak të transferimit me vonesë të fondeve nga Komisioni ose urdhrave të rikuperimit që nxjerr Komisioni, në përputhje me nenin 33(8);

(h) kryen operacionet e konvertimit të valutës, sipas rastit;

(i) bën rregullime financiare, në përputhje me nenin 41;

(j) jep komente dhe informacion në procedurat për korrigjime financiare, në përputhje me nenin 44;

(k) bën parashtrime lidhur me qëllimin e Komisionit për ndërprerjen apo pezullimin e pagesave në përputhje me nenet 38 dhe 39, si edhe ndërmerr masa korrigjuese sipas nevojës;

(l) kthen fondet tek buxheti i BE-së në zbatim të urdhrave të rikuperimit të nxjerra prej Komisionit, në përputhje me nenet 40 dhe 46.

(4) ZKA respekton kërkesat e raportimit të përcaktuara në nenin 61.

Klauzola 5 Struktura Menaxhuese (SM), Zyra Mbështetëse e ZKA-së (ZMZKA) dhe Organi Kontabël (OK)

(1) Struktura Menaxhuese përbëhet nga Zyra Mbështetëse e ZKA-së si dhe nga Organi Kontabël.

(2) Organi Kontabël e ka vendndodhjen në ministrinë e përfituesit IPA III me kompetenca buxheti qendror dhe vepron si subjekt qendror i thesarit.

(3) Zyra Mbështetëse e ZKA-së e mbështet ZKA-në në realizimin e detyrave të përcaktuara Klauzolën 4(2).

(4) Organi Kontabël mbështet ZKA-në në realizimin e detyrave të përcaktuara në Klauzolën 4(3) dhe nenin 61(5).

(5) Zyra Mbështetëse e ZKA-së dhe Organi Kontabël bashkëpunojnë me qëllim që të garantojnë përputhshmërinë, integritetin, efektivitetin dhe efikasitetin e menaxhimit, si edhe të sistemit të kontrollit dhe menaxhimit financiar të ngritur për zbatimin e asistencës IPA III në vendin e përfituesit IPA III.

Klauzola 6 Autoriteti Menaxhues (AM)

(1) Autoriteti Menaxhues i secilit program është përgjegjës për menaxhimin e përgjithshëm të programit.

(2) Autoriteti Menaxhues autorizon një ose disa Organe të Ndërmjetme që të kryejnë detyrat e menaxhimit financiar të programit (Organe të Ndërmjetme për menaxhimin financiar).

(3) Autoriteti Menaxhues ndan detyrat e menaxhimit financiar. Organi i Ndërmjetëm për menaxhimin financiar merr vendime financiare në mënyrë autonome në kuadrin e programit.

(4) Autoriteti Menaxhues mbikëqyr punën e Organeve të Ndërmjetme për menaxhimin financiar, duke respektuar siç duhet autonominë e tyre në marrjen e vendimeve financiare në kuadrin e programit.

(5) Autoriteti Menaxhues i programit mund të autorizojë një ose disa Organe të Ndërmjetme që të kryejnë detyrat e menaxhimit në fushën e politikave për të cilën janë përgjegjëse në sistemin e qeverisë apo administratës së përfituesit IPA III (Organet e Ndërmjetme për menaxhimin e politikave).

(6) Autoriteti Menaxhues mbikëqyr punën e Organeve të Ndërmjetme për menaxhimin e politikave.

(7) Për të menaxhuar programet me efektivitet, Autoriteti Menaxhues mund të kryejë detyrat e përcaktuara në Klauzolat 2, 3(2), 3(3), 4(2) dhe 7(2) në nivel programi, sipas rastit.

(8) Autoriteti Menaxhues respekton kërkesat e raportimit të përcaktuara në nenin 62.

Klauzola 6a Autoriteti Menaxhues për Zhvillimin Rural IPA (IPARD)

(1) Autoriteti Menaxhues IPARD është përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e programit IPARD III që detajohet më tej në marrëveshjen sektoriale.

(2) Autoriteti Menaxhues IPARD kryen funksionet e veta, me qëllim zbatimin efektiv të programit IPARD III.

(3) Në përputhje me nenin 10(1), germa (d) është përgjegjës edhe për:

(a) hartimin e programit IPARD III dhe ndryshimeve në të, përfshirë ato që kërkohen nga Komisioni;

(b) kontrollueshmërinë dhe verifikueshmërinë e masave që përcaktohen në programin IPARD III në bashkëpunim me Agjencinë IPARD;

(c) përzgjedhjen e masave nën secilën thirrje për propozime në kuadrin e programit IPARD III si edhe periudhën e tyre, kushtet e pranueshmërisë dhe alokimin financiar për secilën masë dhe thirrje. Vendimet merren në mirëkuptim me Agjencinë IPARD III;

(d) ekzistencën e bazës ligjore të brendshme të përshtatshme për zbatimin e IPARD III dhe përditësimin e saj sipas nevojës;

(e) ndihmon komitetin monitorues sektorial në punën e tij, sipas nenit 53, kryesisht duke vënë në dispozicion dokumentet e nevojshme për monitorimin e cilësisë së zbatimit të programit IPARD III.

(4) Autoriteti Menaxhues IPARD ngre një sistem raportimi dhe informacioni për të mbledhur informacion financiar dhe statistikor mbi ecurinë e programit IPARD III, si edhe mbi bazën e informacionit që i jep Agjencia IPARD, si edhe përcjell këto të dhëna te komiteti monitorues IPARD III në përputhje me modalitetet e dakordësuara ndërmjet Këshillit të

Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit, duke përdorur kur është e mundur sisteme kompjuterike që mundësojnë shkëmbimin e të dhënave me Komisionin dhe që janë të lidhura me sistemin e raportimit dhe informacionit që ngrihet nga ZKA.

Sistemi i raportimit dhe informacionit duhet të kontribuojë në përgatitjen e raporteve vjetore dhe përfundimtare të zbatimit, në përputhje me nenin 59.

(5) Autoriteti Menaxhues IPARD i propozon Komisionit ndryshime në programin IPARD III, duke vënë për dijeni KKIPA-n, pas konsultimit me Agjencinë IPARD dhe pas pëlqimit të komitetit monitorues IPARD III. Autoriteti Menaxhues IPARD ka përgjegjësinë që të garantojë informimin e autoriteteve përkatëse për nevojën e ndryshimeve administrative të përshtatshme kur këto ndryshime kërkohen në zbatim të një vendimi të Komisionit për ndryshimin e programit IPARD III.

(6) Çdo vit, Autoriteti Menaxhues IPARD harton një plan veprimi për operacionet e synuara në kuadrin e masës 'Asistenca teknike', të cilit ia paraqet komitetit monitorues IPARD III për pëlqim.

(7) Autoriteti Menaxhues IPARD harton një plan vlerësimi sipas nenit 56, të cilin ia paraqet komitetit monitorues sektorial sipas nenit 53 jo më vonë se një vit pas miratimit të programit IPARD III nga Komisioni. Autoriteti Menaxhues IPARD raporton tek komiteti monitorues IPARD III dhe te Komisioni mbi ecurinë e zbatimit të këtij plani.

(8) Autoriteti Menaxhues IPARD harton një plan koherent me aktivitete vizibiliteti dhe komunikimi sipas nenit 24 si dhe konsultohet dhe informon Komisionin, pasi merr këshilla nga komiteti monitorues sektorial. Plani paraqet, në veçanti, nismat e ndërmarra dhe ato të planifikuara, me qëllim informimin e publikut të gjerë mbi rolin që luan BE-ja në programin IPARD III dhe rezultatet e tij.

(9) Kur një pjesë e detyrave të veta ia delegon një organi tjetër, Autoriteti Menaxhues IPARD mban përgjegjësinë e plotë për menaxhimin dhe zbatimin e atyre detyrave në përputhje me parimin e menaxhimit të qëndrueshëm financiar.

Klauzola 6b Agjencia e Zhvillimit Rural IPA (IPARD)

(1) Agjencisë IPARD i ngarkohen funksione dhe përgjegjësi që detajohen më tej në marrëveshjen sektoriale.

(2) Në përputhje me nenin 10(1), është përgjegjëse edhe për:

(a) dhënien e konfirmimit Autoritetit Menaxhues për kontrollueshmërinë dhe verifikueshmërinë e masave në programin IPARD III;

(b) përgatitjen e thirrjeve për propozime dhe publikimin e kritereve dhe kushteve të pranueshmërisë me miratimin paraprak të Autoritetit Menaxhues lidhur me çështjet e ngritura në Klauzolat 6a(3)(c) dhe 8(2)(c);

(c) përzgjedhjen e projekteve që do të zbatohen;

(d) përcaktimin me shkrim të detyrimeve kontraktuese ndërmjet Agjencisë IPARD dhe marrësve, përfshirë informacionin për sanksione të mundshme në rast mospërmbushjeje të atyre detyrimeve dhe, sipas rastit, dhënien e miratimit për fillimin e punës. Agjencia IPARD mund të vazhdojë të kontraktojë apo të marrë zotime në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje për një masë specifike deri në datën kur Republika e Shqipërisë fillon të kontraktojë apo të marrë zotime për këtë masë në kuadrin e çdo programi IPARD III pasues;

(e) masa ndjekëse për të garantuar progresin e projekteve që zbatohen;

(f) raportimin e progresit të masave që zbatohen ndaj indikatorëve;

(g) informimin e marrësit për kontributin e BE-së në projekt;

(h) raportimin e parregullsive në nivel kombëtar;

(i) garanton që ZKA, Struktura Menaxhuese dhe Autoriteti Menaxhues IPARD të marrin të gjithë informacionin e nevojshëm për kryerjen e detyrave të tyre;

(j) respektimin e detyrimeve në lidhje me publicitetin sipas nenit 23.

(3) Për investime në projekte infrastrukturore të llojit që normalisht pritet të gjenerojë të ardhura neto të konsiderueshme, Agjencia IPARD vlerëson, para se të lidhë marrëveshje kontraktuese me marrësin potencial, nëse projekti është i këtij lloji. Kur konstatohet se është projekt i tillë, Agjencia IPARD garanton që ndihma publike nga të gjitha burimet të mos tejkalojë 50% të shpenzimeve totale të projektit që konsiderohen të pranueshme për bashkëfinancimin e BE-së.

(4) Agjencia IPARD garanton që për çdo projekt në kuadrin e programit IPARD III, akumulimi i ndihmës publike që jepet nga të gjitha burimet të mos tejkalojë tavanet maksimale për shpenzimet publike.

Klauzola 7 Organi i Ndërmjetëm për menaxhimin e politikave (ONMP)

(1) Kur autorizohet, Organi i Ndërmjetëm për menaxhimin e politikave mbështet Autoritetin Menaxhues në të gjitha çështjet për të cilat është përgjegjës në sistemin e qeverisjes apo administratës së përfituesit IPA III.

(2) Kur autorizohet, Organi i Ndërmjetëm për menaxhimin e politikave ofron ekspertizë teknike për programimin, zbatimin, menaxhimin dhe kontrollin e programit. Në këtë kontekst, Organi i Ndërmjetëm për menaxhimin e politikave kryen këto detyra:

(a) propozon operacione për financim si edhe draft-dokumente programimi;

(b) përgatit dokumentacionin teknik të nevojshëm për shpalljen e thirrjeve për tender dhe thirrjeve për propozime, si edhe ndihmon në përgatitjen e përgjigjeve ndaj kërkesave për sqarime;

(c) cakton anëtarë me të drejtë vote në komitetet vlerësuese;

(d) ngre një grup ekspertësh ose mbështet Autoritetin Menaxhues në ngritjen e një grupi të tillë që të vlerësojë rezultatet e veprimeve dhe të kontratave në proces zbatimi;

(e) monitoron aspektet teknike të veprimeve dhe kontratave;

(f) konfirmon që shërbimet e kontraktuara janë dhënë, furnizimet janë dorëzuar dhe instaluar, punimet janë finalizuar dhe veprimet janë realizuar;

(g) kryen çdo detyrë tjetër ose mbështet çdo kërkesë tjetër që varet nga ekspertiza teknike e Organit të Ndërmjetëm për menaxhimin e politikave.

Klauzola 8 Organi i Ndërmjetëm për menaxhimin financiar (ONMF)

(1) Në bashkëpunim me strukturat dhe autoritetet e tjera, Organi i Ndërmjetëm për menaxhimin financiar kryen këto detyra:

(a) garanton që aktivitetet të propozohen për financim në përputhje me procedurat dhe kriteret e zbatueshme për programin, veprimin, thirrjen për tender dhe thirrjen për propozime;

(b) kryen monitorime për secilën kontratë, përfshirë aspektet administrative, financiare, teknike dhe fizike të zbatimit të kontratës;

(c) verifikon që pagesat që iu bëhen përfituesve përputhen me legjislacioni e BE-së dhe të përfituesit IPA III, me kërkesat e programet dhe me kushtet e kontratës;

(2) Organi i Ndërmjetëm për menaxhimin financiar kryen në mënyrë autonome këto detyra:

(a) menaxhon procedurat e prokurimit, procedurat e shpalljes së fituesit të grantit dhe procedura të tjera kontraktimi, në përputhje me nenet 18, 19 dhe 22;

(b) garanton që aktivitetet të përzgjidhen për financim në përputhje me procedurat dhe kriteret e zbatueshme për programin, veprimin, thirrjen për tender dhe thirrjen për propozime;

(c) lidh kontrata dhe aneks-kontrata;

(d) autorizon pagesat e asistencës IPA III në favor të marrësve/përfituesve;

(e) autorizon rikuperimin e fondeve prej përfituesve të asistencës IPA III.

Klauzola 9 Autoriteti Auditues (AA)

(1) Përfituesi IPA III vë në dispozicion Autoritetin Auditues, i cili është një organ publik funksionalisht i pavarur nga strukturat dhe autoritetet e përcaktuara në nenin 10(1), germat (a) deri në (d). Autoriteti Auditues gëzon autonominë e nevojshme financiare.

(2) Kryetari i Autoritetit Auditues zotëron kompetenca, njohuri dhe përvojë të mjaftueshme në fushën e auditimit për të kryer detyrat e kërkuara.

(3) Autoriteti Auditues i kryen auditet në përputhje me standardet e auditit të pranuara ndërkombëtarisht. Auditimet përfshijnë auditin e sistemeve, auditin e operacioneve dhe auditin e llogarive.

(4) Deri në fund të nëntorit të çdo viti, Autoriteti Auditues i dorëzon Komisionit, duke i dërguar një kopje edhe ZKA-së, një strategji auditi bazuar në vlerësim risku sipas modelit të paraqitur në Shtojcën G. Strategjia e auditit mbulon tre vitet financiare pasuese dhe përditësohet çdo vit. Kërkesa specifike shtesë për strategjinë e auditit mund të përcaktohen në marrëveshjet sektoriale apo ato të financimit.

(5) Komisioni mund të japë orientime të mëtejshme mbi metodologjinë e auditimit dhe raporteve e opinioneve të auditit.

(6) Autoriteti Auditues respekton kërkesat e raportimit të përcaktuara në nenin 63.

SHTOJCA B

KUADRI I KONTROLLIT TË BRENDSHËM

Komponentët, parimet dhe karakteristikat e kuadrit të kontrollit të brendshëm në menaxhimin indirekt nga vendet përfituese

I. MJEDISI I KONTROLLIT

Mjedisi i kontrollit është tërësia e standardeve të sjelljes, proceseve dhe strukturave që përbëjnë bazën e realizimit të kontrolleve të brendshme në mbarë organizatën[19]. Drejtuesit e lartë[20] mbajnë tonusin lart për rëndësinë e kontrollit të brendshëm, përfshirë standardet e sjelljes të pritshme.

1. Organizata tregon përkushtim ndaj integritetit dhe vlerave etike.

Karakteristikat:

1.1. *Tonusi lart.* Të gjitha nivelet drejtuese respektojnë integritetin dhe vlerat etike në udhëzimet, veprimet dhe sjelljen e tyre.

1.2. *Standardet e sjelljes.* Integriteti dhe vlerat etike janë të parashikuara në standardet e sjelljes dhe kuptohen nga të gjitha nivelet e organizatës, si edhe nga ofruesit e shërbimeve që kontraktohen dhe përfituesit.

1.3. *Respektimi i standardeve.* Ekzistojnë procese për të vlerësuar nëse individët dhe njësitë po respektojnë standardet e sjelljes dhe për të trajtuar pa vonesa rastet e devijimeve.

2. Drejtuesit e lartë ushtrojnë mbikëqyrje mbi zhvillimin dhe performancën e kontrollit të brendshëm.

Karakteristikat:

2.1. *Drejtuesit e lartë mbikëqyrin praktikat e qeverisjes, menaxhimit të riskut dhe kontrollit të brendshëm, si dhe marrin përgjegjësinë e përgjithshme për menaxhimin në nivelet më poshtë.* Kjo bëhet e mundur përmes modaliteteve të punës dhe kanaleve të komunikimit që janë të përshtatshme.

2.2. *Secili drejtues mbikëqyr sistemet e kontrollit të brendshëm brenda njësisë së vet.* Secili drejtues mbikëqyr zhvillimin dhe performancën e kontrollit të brendshëm. Në kryerjen e kësaj detyre, ata mbështeten nga koordinatorët e kontrollit të brendshëm.

2.3. *Secili drejtues i lartë nënshkruan një deklaratë të sigurisë* për alokimin e duhur dhe

[19] Në këtë Shtojcë, "organizatë" nënkupton të gjithë sistemin e ngritur në një vend përfitues për menaxhimin dhe kontrollin e IPA III.
[20] Në këtë Shtojcë, "drejtues të lartë" nënkupton Zyrtarin Kombëtar Autorizues dhe titullarët e Autoritetit Menaxhues.

përdorimin e burimeve vetëm për qëllimet e synuara dhe në përputhje me parimet e menaxhimit të qëndrushëm financiar, si edhe për ekzistencën e procedurave të mjaftueshme të kontrollit.

2.4. *Koordinatorët e kontrollit të brendshëm luajnë rol kyç, sepse koordinojnë përgatitjen e deklaratave të sigurisë.*

3. Drejtuesit përcaktojnë struktura, linja raportimi dhe autoritete e përgjegjësi të përshtatshme për realizimin e objektivave.

Karakteristikat:

3.1. *Strukturat Menaxhuese janë të plota.* Krijimi dhe zbatimi i strukturave menaxhuese dhe mbikëqyrëse mbulon të gjitha politikat, programet dhe aktivitetet. Ato mbulojnë të gjitha llojet e shpenzimeve, mekanizmat e zbatimit dhe njësitë e ngarkuara me ekzekutimin e buxhetit në mbështetje të realizimit të objektivave të politikave, operacionalë dhe kontrollit.

3.2. *Autoritetet dhe përgjegjësitë.* Drejtuesit e lartë, sipas rastit, delegojnë autoritetin dhe përdorin proceset dhe teknologjinë e përshtatshme për të caktuar përgjegjësi dhe për të ndarë detyrat sipas nevojës në nivele të ndryshme të organizatës.

3.3. *Linjat e raportimit.* Drejtuesit e lartë hartojnë dhe vlerësojnë linja raportimi brenda njësive për të mundësuar ushtrimin e autoritetit, përmbushjen e përgjegjësive dhe fluksin e informacionit.

4. Organizata tregon përkushtim për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur individët kompetentë në harmoni me objektivat.

Karakteristikat:

4.1. *Kuadri i kompetencave.* Njësitë përcaktojnë kompetencat e nevojshme për të mbështetur arritjen e objektivave dhe i vlerësojnë periodikisht në mbarë organizatën, duke marrë masa për të korrigjuar mangësitë sipas nevojës.

4.2. *Zhvillimi profesional.* Njësitë ofrojnë trajnimin dhe këshillimin e nevojshëm për të tërhequr, zhvilluar dhe mbajtur numër të mjaftueshëm personeli kompetent.

4.3. *Lëvizshmëria.* Njësitë planifikojnë lëvizshmërinë e personelit për të gjetur ekuilibrin e duhur midis vijimësisë dhe rinovimit.

4.4. *Planifikimi i zëvendësimeve dhe modalitetet e kontingjencës* për aktivitetet operacionale dhe transaksionet financiare janë miratuar për të garantuar vijimësinë e operacioneve.

5. Organizata u kërkon llogari individëve për përgjegjësitë e tyre të kontrollit të brendshëm në realizimin e objektivave.

Karakteristikat:

5.1. *Forcimi i llogaridhënies.* Organizata përcakton role dhe përgjegjësi të qarta dhe u kërkon

llogari individëve për performancën e përgjegjësive të kontrollit të brendshëm në mbarë organizatën dhe për zbatimin e masave korrigjuese sipas nevojës.

5.2. *Vlerësimi i personelit.* Efikasiteti, aftësitë dhe sjellja e personit në shërbim vlerësohen çdo vit ndaj standardeve të sjelljes së pritshme dhe objektivave të përcaktuar. Rastet e performancës së pamjaftueshme trajtohen siç duhet.

5.3. *Ngritja në detyrë e personelit.* Ngritja në detyrë vendoset pasi analizohen meritat karahasimore të personelit në fjalë, duke pasur parasysh sidomos raportet e vlerësimit.

II. VLERËSIMI I RISKUT

Vlerësimi i riskut është proces dinamik dhe përsëritës për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve që mund të cenojnë arritjen e objektivave, si edhe për të përcaktuar sesi duhet të menaxhohen këto risqe.

6. Organizata specifikon objektivat me qartësi të mjaftueshme për të mundësuar identifikimin dhe vlerësimin e risqeve ndaj objektivave.

Karakteristikat:

6.1. *Misioni.* Njësitë kanë deklarata misioni të përditësuara dhe të harmonizuara në të gjitha nivelet hierarkike, deri në nivelin e detyrave dhe objektivave që u caktohen secilit pjesëtar të personelit. Deklaratat e misionit janë të harmonizuara me përgjegjësitë dhe objektivat e politikave të njësive.

6.2. *Objektivat janë të përcaktuar në çdo nivel.* Objektivat e njësive janë të përcaktuara qartë dhe përditësohen sipas nevojës (p.sh. ndryshimet thelbësore në prioritete, aktivitete dhe/ose organigramë). Ato filtrohen vazhdimisht deri në nivelet e poshtme të organizatës dhe komunikohen e kuptohen nga drejtuesit dhe personeli.

6.3. Objektivat përcaktohen për aktivitetet më të rëndësishme. Objektivat[21] dhe indikatorët[22] mbulojnë aktivitetet më të rëndësishme të njësisë që kontribuojnë në realizimin e prioriteteve si edhe në menaxhimin operacional.

6.4. *Objektivat përbëjnë bazën për akordimin e burimeve.* Drejtuesit iu referohen objektivave të vënë si bazë për akordimin e burimeve, sipas nevojës, për të arritur synimet e politikave, operacionale dhe performancës financiare.

6.5. *Objektivat e raportimit financiar.* Objektivat e raportimit financiar janë në përputhje me parimet e kontabilitetit që kërkohen prej Komisionit.

6.6. *Objektivat e raportimit jofinanciar.* Raportimi jofinanciar u jep drejtuesve informacionin e saktë dhe të plotë që nevojiten për menaxhimin e organizatës në të gjitha nivelet.

[21] Objektivat duhet të jenë SMART (specifikë, të matshëm, të arritshëm, realistë)
[22] Objektivat duhet të jenë RACER (relevantë, të pranuar, të besueshëm, të lehtë për t'u monitoruar dhe të qëndrueshëm).

6.7. *Toleranca ndaj riskut dhe materialiteti.* Kur vendosin objektivat, drejtuesit përcaktojnë nivelet e pranueshme të devijimit kundrejt arritjes së tyre (toleranca ndaj riskut) si edhe nivelin e përshtatshëm të materialitetit për qëllime raportimi, duke mbajtur parasysh kosto-efektivitetin.

6.8. *Monitorimi.* Vendosja e objektivave dhe indikatorëve të performancës mundëson matjen e progresit drejt arritjes së tyre.

7. Organizata identifikon risqet ndaj arritjes së objektivave dhe analizon risqet si bazë për të përcaktuar sesi duhet të menaxhohet risku.

Karakteristikat:

7.1. *Identifikimi i riskut.* Secila njësi identifikon dhe vlerëson risqet në nivele të ndryshme organizative, duke analizuar faktorët e brendshëm dhe të jashtëm. Drejtuesit dhe personeli përfshihen në proces në nivele të përshtatshme.

7.2. *Vlerësimi i riskut.* Njësia vlerëson peshën e risqeve të identifikuara dhe përcakton përgjigjen ndaj risqeve të mëdha dhe sesi duhet të menaxhohet secili risk, si edhe vendos nëse të pranojë, të shmangë, të reduktojë apo të ndajë riskun. Intensiteti i kontrolleve zbutëse të riskut është proporcional me peshën e riskut.

7.3. *Identifikimi dhe vlerësimi i riskut integrohen në planifikimin vjetor* dhe monitorohen periodikisht.

8. Organizata vlerëson mundësinë e mashtrimit në vlerësimin e risqeve ndaj arritjes së objektivave.

Karakteristikat:

8.1. *Risku i mashtrimit.* Procedurat e identifikimit dhe vlerësimit të riskut (shihni parimin 7) mbajnë parasysh stimujt e mundshëm, presionet, mundësitë dhe qëndrimet që mund të rezultojnë në çdo lloj mashtrimi, kryesisht raportim mashtrues, humbje të aktiveve, publikim të informacionit sensitiv dhe korrupsion.

8.2. *Strategjia kundër mashtrimit.* Organizata si e tërë dhe secila njësi miratojnë dhe zbatojnë masa për të luftuar mashtrimin dhe aktivitetet e paligjshme që cenojnë interesat financiare të BE-së. Këtë e bëjnë duke zhvilluar një strategji të qëndrueshme kundër mashtrimit për të përmirësuar parandalimin, zbulimin dhe kushtet për hetimin e mashtrimit, si edhe për të miratuar masa kompensimi dhe parandalimi me penalitete proporcionale dhe shkurajuese.

9. Organizata identifikon dhe vlerëson ndryshimet që mund të kenë ndikim të qenësishëm në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Karakteristikat:

9.1. *Vlerësimi i ndryshimeve.* Procesi i identifikimit të riskut merr parasysh ndryshimet në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm, në politikat dhe prioritetet operacionale, si edhe në qëndrimin e drejtuesve ndaj sistemit të kontrollit të brendshëm.

III. AKTIVITETET E KONTROLLIT

Aktivitetet e kontrollit garantojnë zbutjen e risqeve që lidhen me arritjen e objektivave të politikave, operacionale dhe kontrollit të brendshëm. Ato realizohen në të gjitha nivelet e organizatës, në faza të ndryshme të proceseve të punës, si edhe në mbarë mjedisin teknologjik. Aktivitetet e kontrollit mund të jenë parandaluese ose zbuluese, si dhe të përfshijnë një gamë aktivitetesh manuale dhe të automatizuara si edhe ndarjen e detyrave.

10. Organizata përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli që kontribuojnë në zbutjen në niveleve të pranueshme të risqeve ndaj arritjes së objektivave.

Karakteristikat:

10.1. *Aktivitetet e kontrollit kryhen për të zbutur risqet e identifikuara.* Ato përshtaten sipas risqeve specifike të secilës njësi dhe intensiteti i tyre është proporcional me risqet korresponduese.

10.2. *Aktivitetet e kontrollit pasqyrohen në një strategji kontrolli.* Strategjia e kontrollit përmban një sërë kontrollesh, përfshirë modalitetet e mbikëqyrjes dhe, sipas rastit, duhet të përmbajë një balancim të metodave për zbutjen e risqeve, duke pasur në vëmendje kontrollet manuale dhe të automatizuara, si edhe kontrollet parandaluese dhe zbuluese.

10.3. *Ndarja e detyrave.* Kur miratohen masat e kontrollit, drejtuesit analizojnë nëse detyrat janë ndarë siç duhet midis personelit për të reduktuar risqet e gabimeve dhe veprimeve të papërshtatshme apo mashtruese.

10.4. *Planet e vazhdimësisë së punës* bazuar në një analizë ndikimi të punës janë të miratuara, të përditësuara dhe përdoren prej personelit të trajnuar për të garantuar vazhdimësinë e punës së organizatës sa më gjatë në rast problemesh madhore. Sipas nevojës, planet e vazhdimësisë së punës duhet të përmbajnë plane rikuperimi ndaj fatkeqësive natyrore (plane që duhet të jenë të koordinuara dhe të miratuara) lidhur me infrastrukturën mbështetëse të ndjeshme ndaj kohës (p.sh. sistemet e teknologjisë së informacionit).

11. Organizata përzgjedh dhe zhvillon kontrolle të përgjithshme të teknologjisë për të mbështetur arritjen e objektivave.

Karakteristikat:

11.1. *Kontrolli i teknologjisë.* Për të garantuar që teknologjia e përdorur në proceset e punës – përfshirë kontrollet e automatizuara – është e besueshme si dhe duke pasur parasysh të gjitha proceset e korporatës, njësitë përzgjedhin dhe zhvillojnë aktivitete kontrolli mbi blerjen, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e teknologjisë dhe infrastrukturës përkatëse.

11.2. *Siguria e sistemeve TI.* Njësitë zbatojnë kontrolle të përshtatshme për të garantuar sigurinë e sistemeve TI për të cilat janë pronarë të sistemit. Këtë e bëjnë në përputhje me parimet e qeverisjes të sigurisë TI, sidomos në kuadrin e mbrojtjes së të dhënave, sekretit profesional, disponueshmërisë, konfidencialitetit dhe integritetit.

12. Organizata integron kontrollin në rregulloret (politikat) e organizatës që përcaktojnë pritshmëritë dhe në procedura që vënë politikat në zbatim.

Karakteristikat:

12.1. *Procedurat e përshtatshme të kontrollit garantojnë arritjen e objektivave.* Procedurat e kontrollit ia caktojnë përgjegjësinë për aktivitetet e kontrollit njësisë apo individit përgjegjës për riskun në fjalë. Punonjësit e ngarkuar me këtë detyrë kryejnë aktivitetet e kontrollit në kohën dhe me zellin e duhur, duke ndërmarrë masa korrigjuese kur nevojitet. Drejtuesit rivlerësojnë periodikisht procedurat e kontrollit për të garantuar që të mbeten relevante.

12.2. *Raportimi i përjashtimeve* është një mjet menaxhimi që përdoret për të nxjerrë përfundime mbi efektivitetet e kontrollit të brendshëm dhe/ose ndryshimet që i duhen bërë sistemit të kontrollit të brendshëm. Ekziston një sistem që garanton se të gjitha rastet e cenimit të kontrolleve apo devijimit prej proceseve dhe procedurave dokumentohen në raporte të përjashtimeve. Të gjitha rastet duhet të argumentohen dhe të miratohen para se të merren masa, ndërsa kjo procedurë duhet të jetë e centralizuar.

12.3. *Vlerësimi i ndikimit dhe vlerësimi i programeve të shpenzimeve,* legjislacionit dhe aktiviteteve të tjera joshpenzuese kryhen në përputhje me kërkesat ligjore dhe praktikat e mira, me qëllim që të vlerësohet ecuria e ndërhyrjeve të BE-së dhe të analizohen alternativat dhe ndikimet e nismave të reja.

IV. INFORMIMI DHE KOMUNIKIMI

Informimi i shërben organizatës që të realizojë kontrollin e brendshëm dhe të mbështetë arritjen e objektivave. Komunikimi është i brendshëm dhe i jashtëm. Komunikimi i jashtëm i jep informacion publikut dhe grupeve të interesit mbi objektivat dhe punën e organizatës. Komunikimi i brendshëm i jep informacionin e nevojshëm personelit për të arritur objektivat dhe për të kryer kontrollet e përditshme.

13. Organizata merr ose gjeneron dhe përdor informacion cilësor dhe relevant për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Karakteristikat:

13.1. *Administrimi i informacionit dhe dokumentacionit.* Njësitë identifikojnë informacionin që nevojitet për të mbështetur funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe për të arritur objektivat. Sistemet e informacionit përpunojnë të dhëna përkatëse që merren nga burime të brendshme dhe të jashtme, me qëllim që të marrin informacionin cilësor të kërkuar dhe të pritshëm, në përputhje me rregullat e zbatueshme për sigurinë, administrimin e dokumentacionit dhe mbrojtjen e të dhënave. Ky informacion gjenerohet në kohën e duhur dhe është i besueshëm, aktual, i saktë, i plotë, i aksesueshëm, i mbrojtur, i verifikueshëm, i sistemuar në arkiv dhe i ruajtur. Informacioni i shpërndahet organizatës në përputhje me udhëzimet e zbatueshme.

14. Organizata komunikon së brendshmi informacionin, përfshirë objektivat dhe përgjegjësitë për kontrollin e brendshëm, të cilat janë të nevojshme për të mbështetur funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Karakteristikat:

14.1. *Komunikimi i brendshëm.* Njësitë komunikojnë së brendshmi mbi objektivat, sfidat, masat e marra dhe rezultatet e arritura prej tyre, përfshirë ndër të tjera objektivat dhe përgjegjësitë e kontrollit të brendshëm.

14.2. *Linja të ndara komunikimi,* siç janë numrat telefonikë falas për sinjalizimet, janë të ngritura në nivel organizativ për të mundësuar fluksin e raportimit kur kanalet normale rezultojnë joefektive.

15. Organizata komunikon me palët e jashtme mbi çështje që prekin funksionimin e kontrollit të brendshëm.

Karakteristikat:

15.1. *Komunikimi i jashtëm.* Të gjitha njësitë sigurohen që komunikimi i tyre i jashtëm të jetë i qëndrueshëm dhe relevant për audiencën e synuar. Organizata përcakton përgjegjësi të qarta për të sjellë komunikimin e njësive në përputhje me prioritetet dhe narrativën e organizatës.

15.2. *Komunikimi mbi kontrollin e brendshëm.* Organizata komunikon me palët e jashtme mbi funksionimin e komponentëve të kontrollit të brendshëm. Informacioni relevant dhe i përpiktë përcillet duke pasur parasysh momentin, audiencën, natyrën e informacionit, si edhe kërkesat ligjore e rregullatore dhe interesat e organizatës.

V. AKTIVITETET E MONITORIMIT

Vlerësimet e vazhdueshme dhe specifike përdoren për të konstatuar nëse secili nga pesë komponentët e kontrollit të brendshëm është i pranishëm dhe funksional. Vlerësimet e vazhdueshme që kryhen në proceset e punës në nivele të ndryshme të organizatës, japin informacion në kohë reale mbi ndonjë mangësi. Konstatimet vlerësohen dhe mangësitë komunikohen dhe korrigjohen në kohën e duhur, ku problematikat madhore raportohen siç duhet.

16. Organizata përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme dhe/ose specifike për të konstatuar nëse komponentët e kontrollit të brendshëm janë të pranishëm dhe funksionalë.

Karakteristikat:

16.1. *Vlerësimet e vazhdueshme dhe specifike.* Njësitë monitorojnë vazhdimisht performancën e sistemit të kontrollit të brendshëm me mjete që mundësojnë identifikimin e mangësive, regjistrimin dhe vlerësimin e rezultateve të kontrollit, devijimet e kontrollit dhe përjashtimet. Vlerësimet e vazhdueshme janë të integruara në proceset e punës dhe përshtaten sipas ndryshimit të kushteve. Gjithashtu, njësitë kryejnë vlerësime specifike sipas nevojës, duke pasur parasysh ndryshimet në mjedisin e kontrollit.

16.2. *Njohuri dhe informacione të mjaftueshme.* Personeli që kryen vlerësimet e vazhdueshme dhe specifike zotëron njohuri dhe informacion të mjaftueshëm për realizimin e kësaj

detyre, sidomos për objektin dhe plotësinë e rezultateve të kontrollit, devijimeve të kontrollit dhe përjashtimeve.

16.3. *Vlerësimet me bazë risku dhe periodike.* Njësitë e ndryshojnë objektivin dhe shpeshtësinë e vlerësimeve specifike në varësi të risqeve të identifikuara. Vlerësimet specifike kryhen periodikisht për të marrë informacion objektiv.

17. Organizata vlerëson dhe komunikon mangësitë e kontrollit të brendshëm në kohën e duhur tek palët që kanë përgjegjësinë për marrjen e masave korrigjuese, duke përfshirë drejtuesit e lartë.

Karakteristikat:

17.1. *Mangësitë.* Me mbështetjen e koordinatorëve të kontrollit të brendshëm, drejtuesit analizojnë rezultatet e vlerësimeve sesi funksionon sistemi i kontrollit të brendshëm në njësitë e tyre. Mangësitë u komunikohen drejtuesve dhe njësive përgjegjëse për marrjen e masave korrigjuese.

Termi "mangësi të kontrollit të brendshëm" nënkupton mangësi të një apo disa komponentëve dhe parimeve përkatëse që reduktojnë mundësitë që njësia të arrijë objektivat. Mangësi madhore në sistemin e kontrollit të brendshëm konsiderohet kur drejtuesit përcaktojnë se një komponent dhe një apo disa parime nuk janë të pranishme ose funksionale apo kur komponentët nuk funksionojnë së bashku. Kur ekziston një mangësi madhore, drejtuesi nuk mund të dalë në përfundimin se sistemi i kontrollit të brendshëm është efektiv. Për të klasifikuar rëndësinë e mangësive, drejtuesit duhet të gjykojnë bazuar në kriteret përkatëse të përcaktuara në rregullore, rregulla apo standarde të jashtme.

17.2. *Masat korrigjuese.* Masat korrigjuese merren në kohën e duhur nga punonjësit e ngarkuar me proceset në fjalë, nën mbikëqyrjen e titullarëve të tyre. Me mbështetjen e koordinatorit të kontrollit të brendshëm, secili drejtues monitoron dhe merr përgjegjësinë për zbatimin në kohë të masave korrigjuese.

SHTOJCA C

Model për Deklaratën e Menaxhimit

Unë, i nënshkruari (*emri, mbiemri, titulli zyrtar ose funksioni*), Zyrtar Kombëtar Autorizues *(i përfituesit IPA III)* për programin (*emri i programit*),

bazuar në zbatimin e (*emri i programit*) gjatë vitit financiar që mbaroi më 31 dhjetor (*viti*), (përveç kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje sektoriale apo financimi), bazuar në gjykimin tim dhe të gjithë informacionit që më është vënë në dispozicion, përfshirë rezultatet e verifikimeve të menaxhimit si edhe nga auditet për shpenzimet e pasqyruara në llogaritë vjetore, raportet vjetore përfundimtare dhe pasqyrat e vitit financiar (*viti*),

dhe duke marrë parasysh detyrimet e mia në kuadrin e Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit ndërmjet Komisionit Evropian dhe [Përfituesit IPA III] mbi Modalitetet për Zbatimin e Asistencës Financiare të BE-së nga [Përfituesi IPA III] në kuadrin e Instrumentit për Asistencën e Para-anëtarësimit (IPA III) datë [data],

deklaroj se:

- të dhënat në llogaritë vjetore, raportet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare janë paraqitur siç duhet, të plota dhe të sakta,

- shpenzimet e pasqyruara në llogaritë vjetore, në raportet financiare vjetore dhe në pasqyrat financiare janë në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm dhe janë përdorur për qëllimin e synuar,

- sistemi i menaxhimit dhe kontrollit i ngritur për programin jep garancitë e nevojshme në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve përkatëse.

Konfirmoj se parregullsitë e identifikuara në raportet e auditit dhe kontrollit për vitin financiar janë trajtuar siç duhet në llogaritë vjetore, raportet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare.

Gjithashtu, konfirmoj se shpenzimet që janë në proces vlerësimi për ligjshmërinë dhe rregullsinë janë përjashtuar nga llogaritë vjetore, raportet financiare vjetore dhe pasqyrat financiare në pritje të përfundimit të vlerësimit, për përfshirje të mundshme në kërkesë-pagesën në vitin financiar pasardhës.

Mangësitë në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të raportuar në ato raporte janë ndjekur në nivel të mjaftueshëm ose ndjekja është në vazhdim lidhur me masat korrigjuese e kërkuara më poshtë:

Janë ndjekur në nivel të mjaftueshëm mangësitë në sistemin e menaxhimit dhe kontrollit të raportuara në këto raporte ose janë në ndjekje për sa i përket masave korrigjuese të nevojshme si më poshtë:
…… (Tregoni cilat masat korrigjuese janë në proces në datën e nënshkrimit të deklaratës).

Gjithashtu, konfirmoj se janë miratuar masa efektive dhe proporcionale kundër mashtrimit dhe se ato mbajnë parasysh risqet e identifikuara në këtë drejtim.

Përfundimisht, konfirmoj se nuk jam në dijeni të ndonjë problematike të fshehtë reputacioni lidhur me zbatimin e programit.

[Seksioni i rezervave përfshihet kur gjykohet e nevojshme.]

(Vendi dhe data e lëshimit)

Nënshkrimi
(Emri, mbiemri, titulli zyrtar ose funksioni)

SHTOJCA D

Model për Raportin Vjetor të Auditimit[1]

drejtuar

- Komisionit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme
- Qeverisë së (Përfituesit IPA III)
- për dijeni Koordinatorit Kombëtar IPA (KKIPA) të (Përfituesit IPA III) dhe
- për dijeni Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA) të (Përfituesit IPA III)

1. HYRJE

1.1. Identifikimi i Autoritetit Auditues dhe organeve të tjera që janë përfshirë në përgatitjen e raportit.
1.2. Periudha e referuar (d.m.th. viti financiar dhe periudha 12-mujore nga 1 korriku (*viti*) deri më 30 qershor (*viti*), përveç kur parashikohet ndryshe në marrëveshje sektoriale apo financimi) dhe objekti i auditeve (bashkë me shpenzimet e pranuara që i janë deklaruar Komisionit për periudhën në fjalë).
1.3. Identifikimi i programit/veprimit(eve)/sektorit(ëve) që mbulon raporti dhe i Autoritetit Menaxhues dhe Organeve të Ndërmjetme të tij/tyre.
1.4. Përshkrimi i hapave të ndërmarrë për përgatitjen e raportit dhe përpilimin e opinionit të auditit.

2. NDRYSHIME THELBËSORE NË SISTEMET E MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT

2.1. Hollësi për ndryshimet madhore në sistemet e menaxhimit dhe kontrollit dhe konfirmimin e përputhshmërisë së tyre me nenin 8 të Rregullores Zbatuese (BE) nr. 2021/2236 të Komisionit, bazuar në auditimin e kryer nga Autoriteti Auditues.
2.2. Duhet të përcaktohen datat nga të cilat hyjnë në fuqi këto ndryshime, datat e njoftimit të ndryshimeve tek Autoriteti Auditues, si edhe ndikimi i këtyre ndryshimeve tek auditimi.

3. NDRYSHIMET NË STRATEGJINË E AUDITIT

3.1. Hollësitë e çdo ndryshimi që i është bërë Strategjisë së Auditit dhe shpjegimeve përkatëse. Në veçanti, tregoni ndonjë ndryshim në metodën e kampionimit të përdorur për auditin e operacioneve (shihni Seksionin 5).
3.2. Autoriteti Auditues bën dallimin ndërmjet ndryshimeve të bëra në fazë të vonë që nuk ndikojnë në punën e bërë gjatë periudhës së referuar, si dhe ndryshimeve të kryera gjatë periudhës së referuar, të cilat ndikojnë tek auditimi dhe rezultatet e audit.

Pasqyrohen vetëm ndryshimet krahasuar me versionin e mëparshëm të strategjisë së auditit.

[1] Në zbatim të nenit 63, pika (2) e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit.

4. AUDITET E SISTEMEVE

4.1. Identifikimi i autoriteteve/organeve që kanë kryer audite sistemesh, përfshirë vetë Autoritetin Auditues.

4.2. Tabelë përmbledhëse e auditeve të kryera, ku tregohen autoritetet/organet e audituara, vlerësimi i kërkesave kyçe për çdo autoritet/organ, çështjet e mbuluara[2] dhe një krahasim me planin e auditit. Përmbledhja përfshin programin (referencën/titullin), autoritetin/organin që ka kryer auditin e sistemit, datën e auditit, objektin e auditit, përfshirë kufizimet në objekt, si dhe autoritetet/organet e audituara. Në këtë seksion raportohen edhe auditet tematike horizontale.

Periudha e auditit	1. Programi (referenca /titulli)	2. Organi Auditues [3]	3. Organ(et)e audituara	4. Data e auditit[4]	5. Objekti i auditit[5]	6. Konstatimet kryesore dhe përfundimet	7. Problemet me natyrë sistemike dhe masat e marra	8. Ndikimi financiar i vlerësuar (nëse ka)	9. Ndjekja (mbyllur ose jo)

4.3. Përshkrimi i bazës për auditet e kryera, përfshirë referencën për strategjinë e auditit të zbatueshme dhe sidomos metodologjinë e vlerësimit të riskut dhe rezultatet që çuan në hartimin e planit të auditit për audit sistemi. Nëse vlerësimi i riskut është përditësuar, kjo duhet të përshkruhet në seksionin 3 lart, duke evidentuar ndryshimet në strategjinë e auditit.

4.4. Përshkrimi i konstatimeve kryesore dhe përfundimeve që kanë nxjerrë auditet e sistemeve, përfshirë auditet në fusha tematike specifike.

4.5. Evidentim nëse ndonjë problem i konstatuar cilësohet se ka natyrë sistemike, hollësi të masa të ndërmarra, përfshirë kuantifikimin e shpenzimeve të parregullta dhe ndonjë korrigjim financiar që është bërë.

4.6. Informacion mbi ndjekjen e rekomandimeve nga auditet e sistemeve të viteve të mëparshme.

4.7. Përshkrimi (sipas rastit) i mangësive specifike që lidhen me menaxhimin e instrumenteve financiare, të zbuluara gjatë auditeve të sistemeve dhe përshkrimi i ndjekjes që raporton përfituesi IPA III për korrigjimin e këtyre mangësive.

4.8. Niveli i sigurisë të përftuar pas auditeve të sistemeve (i ulët/i mesëm/i lartë) dhe argumentimi.

---

[2] Çështjet duhet të korrespondojnë me ato në strategjinë e auditit (por jo ekskluzivisht), p.sh. cilësia e verifikimeve të menaxhimit, përfshirë në lidhje me respektimin e rregullave të prokurimit publik, rregullat e ndihmës shtetërore, kërkesat mjedisore, mundësitë e barabarta, zbatimi i instrumenteve financiare, efektiviteti i sistemeve TI, raportimi i tërheqjeve dhe rikuperimeve, zbatimi i vlerësimit të riskut të mashtrimit; besueshmëria e të dhënave që lidhen me indikatorët dhe parametrat si dhe ecuria e programit në arritjen e objektivave.

[3] Organet që kanë kryer auditet e sistemeve, përfshirë vetë Autoritetin Auditues.

[4] Data e auditimit në terren.

[5] Autoritetet e audituara, temat horizontale të audituara, kufizimet e objektit...

5. AUDITET E OPERACIONEVE

5.1. Identifikimi i autoriteteve/organeve që kanë kryer audite të operacioneve, përfshirë Autoritetin Auditues.

5.2. Përshkrimi i metodologjisë së kampionimit të përdorur, si edhe informacion nëse metodologjia është në përputhje me strategjinë e auditit.

5.3. Sqarim i parametrave të kampionimit dhe informacion për procedurat e kampionimit statistikor ose jostatistikor, llogaritjet që çuan në përzgjedhjen e modelit (në një format që sqaron hapat bazë të ndërmarrë, në përputhje me metodën specifike të kampionimit që është përdorur) dhe shpjegime për gjykimin profesional të zbatuar.
Informacioni duhet të përfshijë nivelin e materialitetit, nivelin e konfidencës, njësitë e kampionimit, marzhin e pritshëm të gabimit, intervalin e kampionimit, devijimin standard, vlerën e popullatës, përmasën e popullatës, përmasën e kampionit/modelit dhe informacion mbi shtresëzimin.

5.4. Rakordimi midis shpenzimeve të pranuara që i janë deklaruar Komisionit për periudhën 12-mujore dhe popullatës nga e cila është nxjerrë kampioni rastësor. Zërat rakordues përfshijnë zëra negativë ku janë kryer korrigjime/rregullime financiare, si edhe diferencat ndërmjet shumave të deklaruara në Euro dhe shumave në monedhën e përfituesit IPA III, sipas rastit.

5.5. Kur ka zëra negativë, konfirmimi se janë trajtuar si popullatë më vete. Analiza e rezultateve kryesore të auditeve në këto njësi, me fokus në verifikimin nëse shumat i korrespondojnë vendimeve për të zbatuar korrigjime/rregullime financiare (të ndërmarrë nga përfituesi IPA III ose nga Komisioni) si dhe për rakordim me shumat nëpër llogari të cilat janë tërhequr dhe rikuperuar / do të rikuperohen.

5.6. Kur përdoret metodë kampionimi jostatistikor, specifikohen arsyet pse është përdorur kjo metodë, përqindja e njësive të kampionuara/shpenzimeve të pranuara që kanë analizuar auditet, hapat e ndërmarrë për të garantuar se kampioni është rastësor, duke mbajtur parasysh se kampioni duhet të jetë përfaqësues. Gjithashtu, përshkruhen hapat e ndërmarrë për të garantuar përmasë të mjaftueshme të kampionit që i mundëson autoritetit auditues nxjerrjen e një opinioni auditi të vlefshëm. Në rastet e metodës së kampionimit jostatistikor, llogaritet edhe marzhi total (i projektuar) i gabimit.

5.7. Tabela përmbledhëse (shihni Seksionin 9) e zbërthyer sipas programit sipas rastit, ku tregohen shpenzimet e pranuara dhe pagesat e kryera që i janë deklaruar Komisionit, shpenzimet e pranuara që janë audituar dhe gabimet e identifikuara.
Informacioni për kampionin rastësor duhet të dallohet prej informacionit për kampionët e tjerë, sipas rastit (p.sh. kampionët komplementarë me bazë risku).

5.8. Analiza e konstatimeve kryesore të auditeve të operacioneve, ku përshkruhet:
   a) numri i njësive kampion të audituar, sasia përkatëse;
   b) sasia dhe lloji i gabimit sipas çdo njësie kampion[6];
   c) gabimet totale[7];
   d) natyra e gabimeve të konstatuara[8];
   e) shkaqet kryesore, masat korrigjuese të propozuara, përfshirë ato që synojnë përmirësimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit, si edhe ndikimin në opinionin e auditit.

[6] Rastësor, sistemik, anormal.
[7] "Gabimet totale" nënkupton shumën e gabimeve rastësore të parashikuara dhe, sipas rastit, gabimet sistemike dhe gabimet anormale të pakorrigjuara.
[8] Për shembull: pranueshmëria, prokurimi publik, ndihma shtetërore.

5.9. Përshkrimi i marzhit total të gabimit[9] dhe marzhit të gabimit rezidual[10]. Specifikimi i tavanit të marzhit të gabimit (sipas rastit).
Përshkrimi i marzheve totale dhe reziduale të gabimit për çdo shtresë [11] që u korrespondojnë mangësive, sasisë së parregullsive dhe ndikimit tek opinioni i auditit.
Llogaritjet për marzhin total dhe rezidual të gabimit, në një format që sqaron hapat bazë të ndërmarrë, në përputhje me metodën specifike të kampionimit që është përdorur.

5.10. Krahasimi i marzhit total të gabimit dhe marzhit të gabimit rezidual me nivelin e materialitetit 2%, me qëllim që të konstatohet nëse popullata është e keqdeklaruar materialisht apo jo, si edhe ndikimi në opinionin e auditit.

5.11. Hollësi të çdo korrigjimi financiar që lidhet me periudhën 12-mujore të zbatuar nga Autoriteti Menaxhues/struktura menaxhuese para dorëzimit tek Komisioni të raporteve financiare vjetore apo të pasqyrave/llogarive vjetore, si pasojë e auditeve të operacioneve, përfshirë normën fikse ose korrigjimet e ekstrapoluara.

5.12. Hollësi nëse ndonjë problem i konstatuar cilësohet se ka natyrë sistemike, si dhe masat e ndërmarra, përfshirë kuantifikimin e shpenzimeve/shpenzimeve të parregullta dhe ndonjë korrigjim financiar të bërë.

5.13. Informacion për auditet e operacioneve në vazhdimësi të kryera në vitet e mëparshme, sidomos ato për mangësitë e mëdha me natyrë sistemike. Rishikim i marzheve të gabimit rezidual të raportuara, si rezultat i të gjitha masave korrigjuese që janë ndërmarrë pas auditeve.

5.14. Informacion mbi rezultatet e auditit të kampionit të komplimentarietit (p.sh. me bazë risku), nëse ka.

5.15. Përshkrimi (sipas rastit) i mangësive specifike apo parregullsive që lidhen me instrumentet financiare. Sipas rastit, përshkruhet marzhi i gabimit të kampionit për instrumentet financiare të audituara.

5.16. Përfundimet e nxjerra prej rezultateve të auditeve në lidhje me efektivitetin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit.

6. AUDITET E RAPORTEVE FINANCIARE VJETORE OSE TË PASQYRAVE FINANCIARE/ LLOGARIVE VJETORE

6.1. Identifikimi i autoriteteve/organeve që kanë kryer audite të raporteve financiare vjetore apo të pasqyrave financiare/llogarive vjetore.

6.2. Përshkrimi i metodës së auditit të përdorur për të verifikuar që raportet financiare vjetore apo pasqyrat financiare/llogaritë vjetore janë të plota, të sakta dhe të vërteta. Këtu përfshihet një referencë për punën audituese të bërë në kontekstin e auditeve të sistemeve, auditeve të operacioneve dhe verifikimeve shtesë që iu janë bërë raporteve financiare vjetore apo pasqyrave financiare/llogarive vjetore.

6.3. Përfundimet e nxjerra nga auditet në lidhje me plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e raporteve financiare vjetore dhe pasqyrave financiare/llogarive vjetore, duke përfshirë përshkrimin për korrigjimet financiare të bëra dhe të pasqyruara në raportet financiare vjetore apo pasqyrat financiare/llogaritë vjetore si ndjekje e këtyre përfundimeve.

6.4. Përshkrimi nëse janë identifikuar probleme që cilësohen me natyrë sistemike, si edhe për masat e ndërmarra.

---

[9] "Marzhi i gabimeve totale" nënkupton totalin e gabimeve pjesëtuar me popullatën.

[10] "Marzhi i gabimeve reziduale" nënkupton totalin e gabimeve minus korrigjimet financiare të zbatuara nga Përfituesi IPA III (referuar në seksionin 5.11) pjesëtuar me popullatën.

[11] Marzhet e gabimit për shtresë specifikohen kur përdoret shtresëzim, që mbulon nënpopullatat me karakteristika të ngjashme, zërat me vlera të larta, programet / (në rastin e grupimit të programeve)/ etj.

7. INFORMACION SHTESË

7.1. Vlerësimi i Autoritetit Auditues për rastet e dyshuara të mashtrimit në kontekstin e auditeve të tyre (dhe rastet e raportuara nga organe të tjera kombëtare apo të BE-së si edhe që lidhen me operacionet e audituara nga autoriteti auditues), bashkë me masat e ndërmarra. Informacion për numrin e rasteve, rëndësinë e tyre dhe vlerat/shumat e prekura, nëse dihen.

7.2. Rastet e ndodhura pas përfundimit të periudhës 12-mujore dhe para se t'i dërgohet Komisionit raporti vjetor i auditimit, të cilat mbahen parasysh gjatë vlerësimit të nivelit të sigurisë dhe opinionit që nxjerr autoriteti auditues.

7.3. Çdo informacion tjetër që autoriteti auditues e cilëson relevant dhe të rëndësishëm për t'ia komunikuar Komisionit, veçanërisht për të arsyetuar opinionin e auditit.

8. NIVELI I PËRGJITHSHËM I SIGURISË

8.1. Shpjegim mbi nivelin e përgjithshëm të sigurisë për funksionimin e duhur të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit, si edhe shpjegim sesi ky nivel është arritur nga kombinimi i rezultateve të auditeve të sistemeve dhe të auditeve të operacioneve. Sipas rastit, Autoriteti Auditues mban parasysh edhe rezultatet e auditimeve të kryera nga organe të tjera kombëtare apo të BE-së.

8.2. Vlerësimi i masave zbutëse që nuk lidhen me korrigjime/rregullime financiare që janë zbatuar, korrigjimet/rregullimet financiare që janë zbatuar dhe vlerësimi i nevojës për masa korrigjuese shtesë, si nga pikëpamja e përmirësimit të sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, edhe e ndikimit në buxhetin e BE-së.

9. TABELA PËR KOSTOT E DEKLARUARA TË PRANUARA, PAGESAT E KRYERA DHE AUDITET E OPERACIONEVE

	A	B	C		D	E	F	G	H	I	J	K	L	M
Programi (referenca /titulli)	Pagesat e bëra që i janë deklaruar Komisionit për periudhën 12-mujore	Shpenzimet e pranuara që i janë deklaruar Komisionit për periudhën 12-mujore[1]	Shpenzimet e pranuara në periudhën 12-mujore të audituar për kampionin rastësor		Numri total i njësive në popullatë	Numri i njësive kampion për kampionin rastësor	Shuma e shpenzimeve të parregullta të pranuara në kampionin rastësor	Marzhi total i gabimit[2]	Korrigjimet e zbatuara si rezultat i marzhit total të gabimit	Marzhi total i gabimit rezidual	Kosto të tjera të pranuara që janë audituar[3]	Shuma e shpenzimeve të parregullta të pranuara në shpenzime të tjera të pranuara që janë audituar	Kostot totale të pranuara që i janë deklaruar Komisionit si kumulative	Kostot totale të pranuara që janë audituar në mënyrë kumulative
			Shuma[4]	%[5]				%		%				

[1] Kolona B duhet t'i referohet popullatës nga e cila është nxjerrë kampioni rastësor, d.m.th. shuma totale e shpenzimeve të pranuara që i janë deklaruar Komisionit për periudhën 12-mujore nga 1 korriku (*viti)* deri 30 qershor (*viti*), përveç kur parashikohet ndryshe në një marrëveshje sektoriale apo financimi. Sipas rastit, shpjegimet duhet të bëhen në Seksionin 5.4.

[2] Marzhi total i gabimit llogaritet para se të bëhen korrigjimet financiare në lidhje me kampionin e audituar apo popullatën nga e cila është nxjerrë kampioni rastësor. Nëse kampioni rastësor mbulon më shumë se një program, marzhi total i gabimit (të llogaritur), të paraqitur në kolonën G, i referohet të gjithë popullatës. Nëse përdoret shtresëzim, më shumë informacion për secilën shtresë jepet në seksionin 5.9.

[3] Kolona J duhet t'i referohet shpenzimeve të pranuara dhe të audituara në kontekstin e kampionit komplementar.

[4] Shumica e shpenzimeve të pranuara që janë audituar (në rastin e nënkampionimit, vetëm shuma e shpenzimeve të pranuara dhe tashmë të audituara pasqyrohet në këtë kolonë).

[5] Përqindja e shpenzimeve të pranuara dhe të audituara në lidhje me popullatën.

SHTOJCA E

Modeli për Opinionin e Auditit Vjetor[1]

drejtuar

- Komisionit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme
- Qeverisë së (Përfituesit IPA III)
- për dijeni Koordinatorit Kombëtar IPA (KKIPA) të (Përfituesit IPA III) dhe
- për dijeni Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA) të (Përfituesit IPA III)

HYRJE

Unë, i nënshkruari, Kryetar i Autoritetit Auditues të *(Përfituesit IPA III)*, i pavarur në kuptimin e Klauzolës 9(1) të Shtojcës A të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit, kam audituar:

(i) plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e raporteve financiare vjetore apo të pasqyrave financiare dhe llogarive vjetore në to për vitin financiar (*viti*),

(ii) ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve që ZKA ia ka deklaruar Komisionit për periudhën 12-mujore nga 1 korriku (*viti)* deri më 30 qershor (*viti),* përveç kur parashikohet ndryshe në një Marrëveshje Sektoriale ose Marrëveshje Financimi,

(iii) funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, si dhe verifikova deklaratën e menaxhimit me referencë vitin financiar (*viti*),

në lidhje me programin …….. [referenca/titulli i programit/] (në vijim "programi"), me qëllim nxjerrjen e një opinioni auditi në përputhje me nenin 63 (1) të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit.

PËRGJEGJËSITË E ZYRTARIT KOMBËTAR AUTORIZUES

ZKA, sipas Klauzolës 4(2) të Shtojcës A të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit, është përgjegjës për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit IPA III në vendin përfitues IPA III.

Gjithashtu, me mbështetjen e Organit Kontabël, ZKA ka përgjegjësinë që të konfirmojë plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e raporteve financiare apo pasqyrave financiare dhe llogarive në to që i dorëzohen Komisionit sipas nenit 61(5) të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit.

Për më tepër, në përputhje me Klauzolën 4(1) të Shtojcës A të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit, ZKA ka përgjegjësinë e përgjithshme për ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve.

[1] Në zbatim të nenit 63 (1) 58(4) të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit.

PËRGJEGJËSITË E AUTORITETIT AUDITUES

Siç parashikohet në nenin 63(1) të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit, përgjegjësia ime është të shpreh një opinion të pavarur mbi plotësinë, saktësinë dhe vërtetësinë e raporteve financiare vjetore apo pasqyrave financiare vjetore dhe llogarive vjetore të pasqyruara në to, nëse shpenzimet që i janë deklaruar Komisionit janë të ligjshme dhe të rregullta, si edhe nëse sistemet e ngritura të menaxhimit dhe kontrollit funksionojnë siç duhet.

Gjithashtu, përgjegjësia ime është të përfshij në opinion një deklaratë nëse auditimi vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit.

Auditet për programin janë realizuar në përputhje me strategjinë e auditit dhe respektojnë standardet e auditit të pranuara ndërkombëtarisht. Këto standarde kërkojnë që autoriteti auditues të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin, me qëllim që të përftojë siguri të arsyeshme për qëllime të opinionit të auditit.

Auditi përfshin procedura për marrjen e evidencave të mjaftueshme dhe të përshtatshme në mbështetje të opinionit të paraqitur më poshtë. Procedurat e realizuara varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e riskut të mosrespektimit material, qoftë për shkaqe mashtrimi apo gabimi. Gjykoj se procedurat e realizuara të auditit janë të përshtatshme për rrethanat.

Besoj se evidencat e mbledhura të auditit janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të shërbyer si bazë për opinionin tim [në rast se nuk ka kufizime të objektit], përveç atyre të përmendura në seksionin "Kufizimet e objektit".

Përmbledhja e konstatimeve kryesore të auditit në lidhje me programin, raportohet në raportit e auditit vjetor bashkëlidhur, në përputhje me nenin 63(2) të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit.

KUFIZIME TË OBJEKTIT

Ose
Nuk ka pasur kufizime në objektin e auditimit.

Ose
Objekti i auditimit u kufizua nga faktorët e mëposhtëm:

(a) ...
(b) ...
(c) ...

[Tregoni kufizimet në objektin e auditit, për shembull, mungesën e dokumentacionit mbështetës, çështjet nën procedim gjyqësor dhe llogaritni nën seksionin "Opinion i Kualifikuar" më poshtë shumat e shpenzimeve dhe kontributin e BE-së të prekur dhe ndikimin e kufizimeve në objektin e auditit në opinionin e auditit. Shpjegime të mëtejshme në këtë drejtim pasqyrohen në raportin e auditit vjetor, sipas rastit.]

OPINIONI

Ose
(Opinion i pakualifikuar)

Në opinionin tim, bazuar në auditimin e kryer:

– raportet financiare vjetore apo pasqyrat financiare/llogaritë vjetore japin një pasqyrim të vërtetë dhe të drejtë;

– shpenzimet që i janë deklaruar Komisionit janë të ligjshme dhe të rregullta;

– sistemet e ngritura të menaxhimit dhe kontrollit funksionojnë siç duhet.

Auditimi i kryer nuk vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit.

Ose
(*Opinion i kualifikuar*)

Në opinionin tim, bazuar në auditimin e kryer:

– raportet financiare vjetore apo pasqyrat financiare/llogaritë vjetore japin një pasqyrim të vërtetë dhe të drejtë [kur kualifikimi i referohet raporteve financiare vjetore apo pasqyrave financiare/llogarive vjetore, shtohet teksti në vijim], përveç aspekteve më poshtë:……...

Ndikimi i kualifikimit është i kufizuar [ose i konsiderueshëm] dhe korrespondon me ..... [shuma në EURO dhe %] të shpenzimeve totale të pasqyruara në raportet financiare vjetore apo pasqyrat financiare/llogaritë vjetore. Kontributi i BE-së i prekur është ..... [shuma në EURO].

– shpenzimet që i janë deklaruar Komisionit janë të ligjshme dhe të rregullta [kur kualifikimi i referohet ligjshmërisë dhe rregullsisë, shtohet teksti në vijim], përveç aspekteve të mëposhtme:
……..

Ndikimi i kualifikimit është i kufizuar [ose i konsiderueshëm] dhe korrespondon me ..... [shuma në EURO dhe %] të shpenzimeve totale të deklaruara. Kontributi i BE-së i prekur është ..... [shuma në EURO].

– sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të ngritura funksionojnë siç duhet [kur kualifikimi u referohet sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit, shtohet teksti në vijim], përveç aspekteve të mëposhtme:[2]
……...

Ndikimi i kualifikimit është i kufizuar [ose i konsiderueshëm] dhe korrespondon me ..... [shuma në EURO dhe %] të shpenzimeve totale të deklaruara. Kontributi i BE-së i prekur është ..... [shuma në EURO].

[2] Nëse preken sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, në opinion evidentohet organi ose organet dhe aspekti(et) e sistemeve që nuk përmbushin kriteret dhe/ose nuk kanë funksionuar siç duhet, përveç kur ky informacion është pasqyruar qartë në raportin e auditimit vjetor dhe paragrafi i opinionit referon qartë seksionin(et) e raportit ku pasqyrohet ky informacion.

Auditimi i kryesor nuk/vë në dyshim [fshini sipas rastit] pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit.

[Nëse auditimi i kryesor vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit, autoriteti auditues paraqet në këtë paragraf aspektet që çuan në këtë përfundim.]

Ose
(*Opinion negativ*)

Në opinionin tim, bazuar në auditimin e kryer:

– raportet financiare vjetore apo pasqyrat financiare/llogaritë vjetore [nuk] japin [fshini sipas rastit] një pasqyrim të vërtetë dhe të drejtë; dhe/ose

– shpenzimet që i janë deklaruar Komisionit janë/nuk janë [fshini sipas rastit] të ligjshme dhe të rregullta; dhe/ose

– sistemet e menaxhimit dhe kontrollit të ngritura funksionojnë/nuk funksionojnë [fshini sipas rastit] siç duhet.

Ky opinion negativ bazohet në aspektet e mëposhtme:

– në lidhje me problematikat materiale në raportet financiare vjetore ose pasqyrat financiare/llogaritë vjetore:
……..

dhe/ose [fshini sipas rastit]

– në lidhje me problematikat materiale në ligjshmërinë dhe rregullsinë e shpenzimeve të deklaruara Komisionit:
……..……..

dhe/ose [fshini sipas rastit]

– në lidhje me problematikat materiale në funksionimin e sistemeve të menaxhimit dhe kontrollit[3]:
……..

Auditimi i kryer vë në dyshim pohimet e bëra në deklaratën e menaxhimit për aspektet e mëposhtme:
…….....……..

[Autoriteti auditues mund të evidentojë edhe çështje për vëmendje që nuk prekin opinionin e

[3] Nëse preken sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, në opinion evidentohet organi ose organet dhe aspekti(et) e sistemeve që nuk përmbushin kriteret dhe/ose nuk kanë funksionuar siç duhet, përveç kur ky informacion është pasqyruar qartë në raportin e auditimit vjetor dhe paragrafi i opinionit referon qartë seksionin(et) e raportit ku pasqyrohet ky informacion.

vet, siç përcaktohet nga standardet e auditimit të pranuara ndërkombëtarisht. Në raste përjashtimore[4] parashikohet heqje dorë nga përgjegjësia e opinionit.]

Data:

_____

Nënshkrimi:

_____

[4] Këto raste përjashtimore duhet të kenë lidhje me faktorë të jashtëm të paparashikueshëm që janë jashtë tagrave të autoritetit auditues.

SHTOJCA F

Modeli për Opinionin e Auditit për pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve[1]

drejtuar

- Komisionit Evropian, Drejtorisë së Përgjithshme
- Qeverisë së (Përfituesit IPA III)
- për dijeni Koordinatorit Kombëtar IPA (KKIPA) të (Përfituesit IPA III) dhe
- për dijeni Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA) të (Përfituesit IPA III)

HYRJE

Unë, i nënshkruari Kryetar i Autoritetit Auditues të *(Përfituesit IPA III)*, i pavarur funksionalisht në kuptimin e Klauzolës 9(1) të Shtojcës A të Marrëveshjes Kuadër Financiare të Partneritetit (FFPA), kam audituar pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve për programin (referenca/titulli) e cila është hartuar nën përgjegjësinë e Zyrtarit Kombëtar Autorizues (ZKA) në përputhje me nenin 61(4) të FFPA, me qëllim përgatitjen e një opinioni auditi në përputhje me nenin 63(4) të FFPA-së.

Auditi është kryer në përputhje me standardet e auditit të pranuara ndërkombëtarisht ..... [citoni standardet e ndjekura].

Besoj se auditimi i kryer ofron bazë të arsyeshme për opinionin tim.

OBJEKTI I AUDITIT

Auditi i programit është kryer në përputhje me Strategjinë e Auditimit dhe raportohet në raportin përfundimtar të auditimit sipas nenit 63(5) të FFPA-së.

Ose
Nuk ka pasur kufizime në objektin e auditimit.

Ose
Objekti i auditimit u kufizua nga faktorët e mëposhtëm:

(a).....
(b).....
(c) etj.

[Tregoni kufizimet në objektin e auditit, për shembull, mungesën e ndonjë dokumentacioni mbështetës, çështjet nën procedim gjyqësor dhe llogaritni nën seksionin Opinion i Kualifikuar më poshtë shumat e shpenzimeve dhe kontributin e BE-së të prekur dhe ndikimin e kufizimeve në objektin e auditit në opinionin e auditit. Shpjegime të mëtejshme në këtë drejtim jepen në

[1] Në zbatim të nenit 63(4) të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneriteti.

raportin përfundimtar të auditimit, sipas rastit].

OPINIONI

Ose
(Opinion i pakualifikuar)

Në opinionin tim, bazuar në auditimin e kryer:

– shpenzimet e pasqyruara në pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve dhe në kërkesë-pagesën përfundimtare janë të ligjshme dhe të rregullta;

– kërkesë-pagesa përfundimtare është e vlefshme;

– të dhënat financiare të pasqyruara janë të sakta.

Ose
(*Opinion i kualifikuar*)

Në opinionin tim, bazuar në auditimin e kryer:

– shpenzimet e pasqyruara në pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve dhe në kërkesë-pagesën përfundimtare janë të ligjshme dhe të rregullta;

– kërkesë-pagesa përfundimtare është e vlefshme;

– të dhënat financiare të pasqyruara janë të sakta.

me përjashtim të aspekteve të mëposhtme: .....[2]

Ndikimi i kualifikimit është i kufizuar [ose i konsiderueshëm] dhe korrespondon me [shuma në EURO dhe %] të shpenzimeve totale të pasqyruara në pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve dhe në kërkesë-pagesën përfundimtare. Kontributi Komunitar i prekur është.... [shuma në EURO].

Ose
(Opinion negativ)

Në opinionin tim, bazuar në auditimin e kryer:

– shpenzimet e pasqyruara në pasqyrën përfundimtare të shpenzimeve dhe në kërkesë-pagesën përfundimtare nuk janë të ligjshme dhe të rregullta; dhe/ose

[2] Nëse preken sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, në opinion evidentohet organi ose organet dhe aspekti(et) e sistemeve që nuk përmbushin kriteret dhe/ose nuk kanë funksionuar siç duhet, përveç kur ky informacion është pasqyruar qartë në raportin e auditimit vjetor dhe paragrafi i opinionit referon qartë seksionin(et) e raportit ku pasqyrohet ky informacion.

– kërkesë-pagesa përfundimtare nuk është e vlefshme; dhe/ose

– të dhënat financiare të pasqyruara nuk janë të sakta.

Ky opinion negativ bazohet në aspektet e mëposhtme.....[3]

[Autoriteti auditues mund të evidentojë edhe çështje për vëmendje që nuk prekin opinionin e vet, siç përcaktohet nga standardet e auditimit të pranuara ndërkombëtarisht. Në raste përjashtimore[4] parashikohet heqje dorë nga përgjegjësia e opinionit.]

Data:

Nënshkrimi:

[3] Nëse preken sistemet e menaxhimit dhe kontrollit, në opinion evidentohet organi ose organet dhe aspekti(et) e sistemeve që nuk përmbushin kriteret dhe/ose nuk kanë funksionuar siç duhet, përveç kur ky informacion është pasqyruar qartë në raportin e auditimit vjetor dhe paragrafi i opinionit referon qartë seksionin(et) e raportit ku pasqyrohet ky informacion.

[4] Këto raste përjashtimore duhet të kenë lidhje me faktorë të jashtëm të paparashikueshëm që janë jashtë tagrave të autoritetit auditues.

SHTOJCA G

Modeli për Strategjinë e Auditit[1]

1. HYRJE

1.1. Identifikimi i programit(eve)[2] (referenca/titulli) dhe periudha që mbulon strategjia e auditit.

1.2. Identifikimi i Autoritetit Auditues përgjegjës për hartimin, monitorimin dhe përditësimin e strategjisë së auditit dhe të ndonjë organi tjetër që ka kontribuuar në këtë dokument.

1.3. Referim për statusin e Autoritetit Auditues dhe organit ku e ka vendndodhjen.

1.4. Referim i deklaratës së misionit, ligjit të auditit apo legjislacionit të brendshëm (sipas rastit), duke përshkruar funksionet dhe përgjegjësitë e Autoritetit Auditues dhe të organeve të tjera që kryejnë audite nën përgjegjësinë e tij.

1.5. Konfirmimi i Autoritetit Auditues se organet që kryejnë audite kanë pavarësinë funksionale dhe organizative që duhet.

2. VLERËSIMI I RISKUT

2.1. Shpjegimi i metodës së vlerësimit të riskut që është ndjekur, përfshirë:

- përshkrim të faktorëve të riskut që janë marrë parasysh, përfshirë ato për fushat tematike të Seksionit 3.2.2;
- pikëzimin e risqeve;
- masën në të cilën janë marrë parasysh rezultatet e auditeve të mëparshme të organeve dhe sistemeve.

2.2. Procedurat e brendshme për përditësimin e vlerësimit të riskut.

2.3. Identifikimi i kontrolleve në tre nivele:

- niveli i parë i kontrolleve të ushtruara nga strukturat administrative IPA;
- niveli i dytë i kontrolleve të ushtruara, nga njëra anë, përmes sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe, nga ana tjetër, përmes funksionit të auditit të brendshëm;
- monitorimi i nivelit të lartë, të ushtruar përmes funksionit sigurues të ZKA-së.

3. METODOLOGJIA

3.1. Përshkrimi

3.1.1. Referimi i standardeve të auditit të pranuara ndërkombëtarisht të cilat autoriteti auditues do t'i zbatojë në auditimet që kryen.

[1] Në zbatim të Klauzolës 9 (4) të Shtojcës A të Marrëveshjes Financiare Kuadër të Partneritetit.

[2] Tregoni programet që mbulohen me sistem kontrolli dhe menaxhimi të përbashkët, në rastin kur përgatitet vetëm një strategji auditi për disa programe.

3.1.2. Informacion sesi autoriteti auditues do të marrë siguri lidhur me programin(et) (përshkrim i blloqeve kryesore – llojet e auditeve dhe objekti i tyre).

3.1.3. Përcaktimi i procedurave ekzistuese për hartimin e raportit të auditimit vjetor dhe opinionit të auditit që i dorëzohet Komisionit në përputhje me nenin 63(1) dhe (2) të FFPA-së.

3.1.4. Referim i manualeve apo procedurave të auditit, si dhe një përshkrim i shkurtër i hapave kryesorë të auditimit, si p.sh.:

- planifikimi i auditeve;
- kryerja e auditeve dhe mbledhja e evidencave;
- vlerësimi i evidencave dhe arritja tek përfundimet, përfshirë klasifikimin dhe trajtimin e gabimeve të konstatuara;
- raportimi (përfshirë procedurën e oponencës me subjektin e audituar);
- proceset e ndjekjes;
- modalitetet e kontrollit të cilësisë për punën e autoritetit auditues.

3.2. Auditet e sistemeve:

3.2.1 Identifikimi i organeve/strukturave që do të auditohen, si edhe elementët kyç të kontrollit në kontekstin e auditeve të sistemeve.

Sipas rastit, referohet organi auditues tek i cili Autoriteti Auditues bazohet për kryerjen e këtyre auditeve.

3.2.2 Përshkrimi i ndonjë auditi sistemesh që synon fusha tematike specifike apo organe specifike, si p.sh.:

- cilësia e përzgjedhjes së projekteve dhe verifikimeve të menaxhimit në nivelin e autoritetit menaxhues apo organit të ndërmjetëm;
- cilësia dhe sasia e verifikimeve të menaxhimit administrativ dhe në vend, në raport me legjislacionin e zbatueshëm siç janë rregullat e prokurimit publik, rregullat e ndihmës shtetërore, mundësitë e barabarta dhe kërkesat mjedisore;
- ngritja dhe zbatimi i instrumenteve financiare në nivelin e instrumenteve financiare zbatuese të organeve (sipas rastit);
- funksionimi dhe siguria e sistemeve elektronike, si dhe lidhja e tyre me sistemin(et) TI të Komisionit;
- besueshmëria e të dhënave që lidhen me indikatorët, parametrat dhe ecurinë e programeve në arritjen e objektivave të përcaktuar nga autoriteti auditues;
- raportimi i tërheqjeve dhe rikuperimeve;
- zbatimi i masave anti-korrupsion që janë efektive dhe proporcionale dhe që burojnë nga një vlerësim i riskut të mashtrimit.

3.3 Auditet e operacioneve:

3.3.1 Përshkrimi i shkurtër (duke iu referuar dokumentit të brendshëm që specifikon) metodologjinë e kampionimit të përdorur.

3.3.2 Sipas rastit, përshkrim i metodikës së kampionimit jostatistikor që i mundëson Autoritetit Auditues nxjerrjen e një opinioni auditi të vlefshëm.

3.3.3 Përshkrimi i procedurave të tjera specifike ekzistuese për auditet e operacioneve, kryesisht lidhur me klasifikimin dhe trajtimin e gabimeve të konstatuara, përfshirë dyshimet për mashtrim (referuar manualeve dhe procedurave të auditit që trajtojnë këtë problematikë).

3.3.4 Aspekte specifike lidhur me auditet e instrumenteve financiare, nëse ka.

3.4 Auditet e raporteve financiare vjetore apo pasqyrave financiare/llogarive vjetore:

Përshkrimi i metodikës së auditit për auditimin e raporteve financiare vjetore apo pasqyrave financiare/llogarive vjetore.

3.5 Verifikimi i deklaratës së menaxhimit

Përshkrimi i procedurave të auditit të zbatuara gjatë verifikimit të pohimeve të deklaratës së menaxhimit, për qëllime të opinionit të auditit.

4. AUDITIMI I PLANIFIKUAR

4.1 Përshkrimi dhe arsyetimi i prioriteteve dhe objektivave të auditit për vitin financiar pasardhës dhe për dy vitet financiare pasardhëse, bashkë me shpjegimin e lidhjes midis rezultateve të vlerësimit të riskut dhe auditimit të planifikuar.

4.2 Kalendar indikativ i auditeve të sistemeve, përfshirë auditet që synojnë fusha tematike specifike si edhe ndjekja e konstatimeve të auditit të mëparshëm në lidhje me vitin financiar pasardhës dhe me dy vitet financiare pasardhëse si vijon:

Autoritetet/ organet apo fushat tematike specifike që do të auditohen	Programi (referenca/ titulli)	Rezultati i vlerësimit të riskut	Objektivi dhe objekti i Auditit 20xx	Objektivi dhe objekti i Auditit 20xx	Objektivi dhe objekti i Auditit 20xx

5. BURIMET

5.1 Organigrama e autoritetit auditues.

5.2 Përshkrimi i burimeve të planifikuara që do të akordohen për vitin pasardhës dhe dy vitet financiare pasardhëse (përfshirë informacion për kontraktim të jashtëm dhe objektin e tij, nëse ka).

5.3 Përshkrimi i kualifikimeve dhe përvojës që duhet të ketë personeli që kryen auditet, si edhe kriteret e trajnimit.

SHTOJCA H

Raportimi i parregullsive dhe mashtrimit lidhur me Instrumentin për Asistencën Para-anëtarësimit (IPA III)

Klauzola 1 Përkufizime

Për qëllime të raportimit të mashtrimeve të dyshuara dhe parregullsive të tjera, zbatohen përkufizimet e përcaktuara në nenin 51, për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së.

Klauzola 2 Raportimi i parregullsive

(1) Përfituesi IPA III i raporton menjëherë Komisionit çdo mashtrim të dyshuar dhe parregullsi të tjera, përfshirë mashtrimin, që kanë qenë objekt i konstatimit administrativ apo gjyqësor paraprak, si dhe e mban Komisionin të informuar mbi ecurinë e proceseve administrative dhe ligjore duke përdorur, kur kërkohet, Sistemin e dedikuar të Menaxhimit të Parregullsive (SMP).

Në atë raport, Përfituesi IPA III jep në çdo rast hollësi për sa më poshtë:

(a) emërtimin dhe numrin e programit/veprimit në fjalë;

(b) identitetin e personit fizik dhe juridik të përfshirë apo të ndonjë subjekti tjetër pjesëmarrës, si edhe rolin e tyre;

(c) identifikimin e rajonit apo zonës ku është kryer operacioni, duke përdorur informacionin e përshtatshëm, si për shembull nivelin NUTS[3];

(d) dispozitën (at) që janë shkelur;

(e) datën dhe burimin e informacionit fillestar që çoi në dyshimin se është kryer parregullsi;

(f) praktikat e ndjekura në kryerjen e parregullsisë;

(g) sipas rastit, nëse praktika lë shkas për të dyshuar për mashtrim;

(h) mënyrën si është zbuluar parregullsia;

(i) sipas rastit, përfituesin IPA III dhe Shtetet Anëtare dhe/ose vendet e treta të përfshira;

(j) periudhën apo momentin kur është kryer parregullsia;

(k) datën kur është bërë konstatimi administrativ apo gjyqësor paraprak i parregullsisë;

(l) shumën totale të shpenzimeve të pranueshme, të ndarë sipas kontributit të BE-së, kontributit të përfituesit IPA III dhe kontributi privat;

[48] Nomenklatura e Njësive Territoriale për Statistikat.

(m) shpenzimet e prekura nga parregullsia, të ndara sipas kontributit të BE-së dhe kontributit të përfituesit IPA III;

(n) shumën që do të paguhej më tepër nëse nuk do të ishte identifikuar parregullsia, të ndarë sipas kontributit të BE-së dhe kontributit të përfituesit IPA III;

(o) natyrën e shpenzimeve të parregullta;

(p) pezullimin e pagesave, sipas rastit, dhe mundësinë e rikuperimit;

(q) sipas rastit, arsyet për ndonjë heqje dorë nga procedurat e rikuperimit;

(r) sipas rastit, numrin e plotë të rastit të OLAF-it.

(2) Kur përfituesi IPA III i raporton Komisionit, informon edhe Shtetet Anëtare apo përfituesit e tjerë IPA III përkatës lidhur me çdo parregullsi të zbuluar apo që dyshohet të ketë ndodhur, kur ekziston frika se parregullsia mund të ketë pasoja jashtë territorit të përfituesit IPA III.

(3) Kur një pjesë e informacionit të përcaktuar në pikën 1, dhe veçanërisht kur informacioni për praktikat e ndjekura në kryerjen e parregullsisë dhe mënyrën sesi është zbuluar mungon ose duhet të korrigjohet, përfituesi IPA III i paraqet pa vonesa Komisionit informacionin e munguar apo të saktë.

(4) Nëse dispozitat ligjore të vendit përfitues IPA III parashikojnë sekretin e hetimit, komunikimi i informacionit është objekt i autorizimit nga gjykata apo tribunali përkatës.

Klauzola 3 Informacioni për penalitetet

i. Në vijim të raportit të përgatitur në zbatim të Klauzolës 2, përfituesi IPA III i vë në dispozicion Komisionit pa vonesa hollësi mbi fillimin, përfundimin apo heqjen dorë nga ndonjë procedurë për vendosjen e penaliteteve administrative apo penale lidhur me parregullsitë e raportuara, si edhe mbi rezultatin e procedurave të tilla.

Në lidhje me parregullsitë për të cilat janë vendosur penalitete, përfituesi IPA III sqaron edhe sa vijon:

(a) nëse penalitetet janë të natyrës administrative apo penale;
(b) nëse penalitetet rezultojnë nga shkelja e legjislacionit të BE-së apo të përfituesit IPA III;
(c) dispozitat ku parashikohen penalitetet;
(d) nëse është vërtetuar mashtrimi;

ii. Me kërkesë me shkrim të Komisionit, përfituesi IPA III jep informacion shtesë në lidhje me një parregullsi specifike apo grup parregullsish.

Klauzola 4 Raportimi elektronik përmes Sistemit të Menaxhimit të Parregullsive (SMP)

Informacioni i parashikuar në Klauzolat 2 dhe 3 dërgohet në gjuhën angleze në rrugë elektronike, duke përdorur Sistemin e Menaxhimit të Parregullsive (SMP) të ngritur prej Komisionit për këtë qëllim.

Klauzola 5 Përdorimi i informacionit

Komisioni mund të përdorë për analiza risku çdo informacion me natyrë të përgjithshme apo operacionale që i është komunikuar prej Përfituesit IPA III sipas këtyre dispozitave, dhe në bazë të informacionit të marrë, mund të përgatitë raporte dhe të krijojë sisteme që shërbejnë për të identifikuar risqet më efektivisht.

Klauzola 6 Përdorimi i Euros

Për raportimin e parregullsive përdoret monedha Euro. Përfituesi IPA III konverton në Euro shumat e shpenzimeve të kryera në monedhën vendase. Këto shuma konvertohen në Euro me kursin e këmbimit valutor të Komisionit në muajin kur shpenzimi është kontabilizuar në llogaritë e Organit Kontabël, Organeve të Ndërmjetme për menaxhimin financiar dhe Agjencinë IPARD të programeve në fjalë. Komisioni e publikon kursin e këmbimit elektronikisht çdo muaj.

Kur shumat lidhen me shpenzime të kontabilizuara në llogaritë e autoritetit të Përfituesit IPA III gjatë një periudhe më shumë se njëmujore, mund të përdoret kursi i këmbimit për muajin kur shpenzimi është kontabilizuar herën e fundit. Nëse shpenzimi nuk është regjistruar në kontabilitetin e autoritetit përfitues IPA III, përdoret kursi i këmbimit valutor kontabël më i fundit publikuar elektronikisht prej Komisionit.

Klauzola 7 Mbrojtja e të dhënave personale

(1) Përfituesit IPA III dhe Komisioni marrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar publikimin e paautorizuar apo aksesin e paautorizuar në informacionin e përcaktuar në Klauzolat 2 dhe 3.

(2) Informacioni i përcaktuar në Klauzolat 2 dhe 3 nuk mund t'u dërgohet personave të tjerë përveç atyre të Përfituesit IPA III apo brenda institucioneve/ agjencive /zyrave dhe organeve të BE-së, detyrat e të cilëve kërkojnë që ata të kenë akses në këtë informacion, me përjashtim të rasteve kur Përfituesi IPA III që ofron këtë informacion, pranon shprehimisht që t'u vihet në dispozicion.

(3) Çdo e dhënë personale që përfshihet në informacionin e përcaktuar në Klauzolat 2 dhe 3 përpunohet vetëm për qëllime të specifikuara në ato dispozita.

DEKRET
Nr. 13853, datë 26.9.2022

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 65/2022, "Për ratifikimin e marrëveshjes financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të asistencës financiare të BE-së për Republikën e Shqipërisë, në kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA III)".

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

VENDIM
Nr. 606, datë 14.9.2022

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR PËR AKTIVITETET JASHTË ORARIT MËSIMOR DHE PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2022, MIRATUAR PËR MINISTRINË E ARSIMIT DHE SPORTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; të nenit 14, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar; të shkronjës "b", të pikës 3, të nenit 54, të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; dhe të pikës 2, të nenit 53, të ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik", me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit Kombëtar për Aktivitetet jashtë Orarit Mësimor, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Programi Kombëtar për Aktivitetet jashtë Orarit Mësimor (JOM) për orët e zhvilluara në "Art, zeje e sport" të realizohet në 200 (dyqind) institucione arsimore pilot të arsimit parauniversitar, shkolla të arsimit bazë dhe arsimit të mesëm të lartë.

3. Plani i veprimit, kriteret për përzgjedhjen e institucioneve arsimore, të mësuesve e trajnerëve për programe specifike të Programit Kombëtar për Aktivitetet jashtë Orarit Mësimor miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

4. Ministrisë përgjegjëse për arsimim, në buxhetin e miratuar për vitin 2022, nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave i shtohet fondi prej 276 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë) lekësh për mbulimin e shpenzimeve të këtij programi kombëtar.

5. Pagesa për një orë mësimore për zbatimin e Programit Kombëtar për Aktivitetet jashtë Orarit Mësimor për mësuesit dhe trajnerët e programeve specifike është 500 (pesëqind) lekë.

6. Procedurat e prokurimit për blerjen e bazës materiale didaktike dhe infrastruktura mbështetëse, sipas kurrikulave të hartuara për secilën tematikë të Programit Kombëtar për Aktivitetet jashtë Orarit Mësimor realizohen nga Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Ministria e Kulturës, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Brendshme, ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKS 1
PROGRAMI KOMBËTAR PËR AKTIVITETET JASHTË ORARIT MËSIMOR

1. Vështrim i përgjithshëm
1.1 Qëllimi dhe vizioni
1.2 Objektivat
1.3 Grupi i synuar dhe mbulimi i tij
1.4 Struktura
2. Qeverisja, menaxhimi dhe bashkërendimi
2.1 Qeverisja
2.2 Qeverisja
2.3 Qeverisja në nivel shkolle
3. Financimi dhe qëndrueshmëria
3.1 Mekanizmat e financimit/fondeve
3.2 Mekanizma kontabiliteti
3.3 Kontrolli vendor (në shkollë) i financimit
3.4 Buxheti
4. Burimet njerëzore
4.1 Stafi i shkollës
4.2 Zbatuesit e tjerë të Programit
5. Përvoja e pjesëmarrësve
5.1 Zbulimi dhe vlerësimi
5.2 Regjistrimi dhe pjesëmarrja
5.3 Pjesëmarrja
5.4 Zgjerimi dhe pika kulmore
5.5 Vlerësime të përgjithshme
6. Praktikat e mësimdhënies dhe të nxënët
6.1 Kurrikula dhe të nxënët e bazuar te standardet
6.2 Praktika mësimore

6.3 Matja e rritjes
6.4 Nismat tematike
7. Lokalizimi dhe novatorizmi
7.1 Zgjedhja e nismave
7.2 Përshtatja dhe zgjerimi i nismave
7.3 Novatorizmi dhe zhvillimi i nismave të reja
8. Mundësimi i cilësisë së programit
8.1 Përgjegjësitë
8.2 Monitorimi rutinë, vlerësimi dhe raportimi
8.3 Vlerësimi dhe të nxënët

1. Vështrim i përgjithshëm

1.1 Qëllimi dhe vizioni

Programet Jashtë Orarit Mësimor (JOM)[1] njihen gjerësisht si ndërhyrje të vyera që iu ofrojnë fëmijëve dhe të rinjve kohë mësimore shtesë, mundësi për zgjerim horizontesh, si dhe përvoja të shumëllojshme të të nxënët. Rrjedhimisht, programet JOM lidhen me një sërë dobish, duke përfshirë rezultate më të larta mësimore, frekuentim më të lartë të shkollës, reduktim të braktisjes së hershme të shkollës, si dhe gjasa më të ulëta për përdorim alkooli ose droge.

Programet JOM janë komponent integral i kuadrit të Shkollës si Qendër Komunitare, i cili është përshtatur dhe zbatohet në Shqipëri që prej vitit 2014. Ky Program ndërmerr hapa për të forcuar nismën "Shkolla si Qendër Komunitare", përmes realizimit mbarëkombëtar dhe gjithëpërfshirës së nismave JOM.

1.2 Objektivat

Programi do të kontribuojë në katër fusha rezultatesh të ndërlidhura dhe përforcuese:

- rritja e orientimit prosocial/komunitar te fëmijët dhe adoleshentët, duke i shndërruar shkollat në qendra të jetës në komunitet;
- përmirësimi i të nxënit te nxënësit, duke ofruar mundësi joformale të të nxënit në bashkërendim dhe si shtojcë e kurikulës formale;
- përmirësimi i gatishmërisë dhe ndërgjegjësimit rreth karrierës;
- mbështetja e shëndetit fizik dhe psikosocial të nxënësve.

1.3 Grupi i synuar dhe mbulimi i tij

Programi do të synojë fëmijë dhe të rinj nga klasa e parë deri në klasën e dymbëdhjetë. Në fazën e parë, e cila do të zhvillohet në semestrin e dytë të vitit shkollor 2022–2023, Programi do të zbatohet në 200 shkolla. Zbatimi mbarëkombëtar parashikohet të ndodhë në vjeshtën e vitit 2023.

1.4 Struktura

Programi do të realizohet në formën e kurseve me zgjedhje JOM [2], duke synuar fillimisht pesë fusha tematike: artet e bukura dhe tradicionale, muzikën, shkencën dhe teknologjinë, sportet dhe mirëqenien[3], si dhe bujqësinë dhe mjedisin. Këto kurse ofrojnë mundësi të nxëni dhe zhvillimi, që bazohen dhe shkojnë përtej kurrikulës formale, me përvoja konkrete kuptimplota, me në qendër nxënësin. Këto mundësi e kanë fillesën në metoda mësimdhënieje të bazuara në hulumtime dhe projekte, si dhe teknika që mundësohen nga formati i JOM -it, përkatësisht:

- mundësi për përdorimin e metodave jotradicionale të mësimdhënies dhe të të nxënit;
- përvojë me në qendër nxënësin, që nënvizon fleksibilitetin, pavarësinë dhe aftësitë drejtuese të nxënësit, si dhe lidhjen midis nxënësve;
- mundësi për të mobilizuar burimet e komunitetit, duke përfshirë ato financiare dhe njerëzore.

Kurset janë të veçanta për çdo cikël: nxënësit e ciklit fillor do të përbëjnë një grup, logjikë e cila do të zbatohet edhe për ciklin e mesëm të ulët dhe atë të mesëm të lartë. Krahas kësaj, kurset do të ofrohen edhe sipas nivelit të aftësive: kurset e nivelit të parë do të jenë të disponueshme për të gjithë nxënësit e interesuar nga të gjitha ciklet, ndërsa kurset e nivelit të dytë do t'iu mundësohen nxënësve nga cikli i mesëm i ulët dhe ai i mesëm të lartë, që arrijnë rezultate të shkëlqyera.

[1] Shënim i përkthyesit: Jashtë Orarit Mësimor (JOM) gjendet në anglisht si *OST – Out of School Time.*

[2] Për efekt të këtij dokumenti, kurseve JOM do t'u referohemi si *nisma tematike*, për t'i dalluar nga kurset e zhvilluara gjatë orarit të zakonshëm mësimor.

[3] Programi plotëson përpjekjet e MAS-it dhe të KOKSH-it për të mundësuar programe sportive për fëmijët dhe adoleshentët. Për më shumë informacion, ju lutem shihni seksionin 6.4.

		Nismat tematike			
Grupmosha	**Niveli**	**Artet e bukura dhe muzika**	**Teknologji**	**Mjedisi dhe Agrikultura**	**Sporte dhe Mirëqenia**
Cikli Fillor	**I Parë**	●	●	●	Basketball and Volleyball
	I Dytë	**Programe të nivelit te dytë do të realizohen nga pjesëmarrësit e ciklit fillor**			
Cikli i Mesëm	**I Parë**	●	●	●	**Fuqizimi dhe vetëmbrojtja**
	I Dytë	●	●	●	○
Cikli i Mesëm i lartë	**I Parë**	●	●	●	**Fuqizimi dhe vetëmbrojtja**
	I Dytë	●	●	●	○

Figura 1-1. Nismat tematike sipas grup-moshës dhe nivelit

Kurset JOM-ja të nivelit të parë do të zhvillohen në mjediset e shkollës dhe do të ndiqen nga nxënësit e shkollës përkatëse, si dhe do të realizohen nga mësuesit e po asaj shkolle. Kurset e nivelit të parë do të ofrohen rregullisht (dy herë në javë) gjatë gjithë vitit shkollor.

Kurset JOM të nivelit të dytë kanë disa dallime nga kurset e nivelit të parë. Kurset e nivelit të dytë do të zhvillohen në një shkollë të qarkut, e cila përzgjidhet sipas kritereve të aksesueshmërisë dhe përshtatshmërisë, si dhe do të ofrohen nga ekspertë të veçantë të fushës që nuk janë staf i shkollës zakonisht. Këto kurse do të mundësohen gjatë fundjavave. Nxënësit që ndjekin kursin e nivelit të dytë në një fushë të caktuar tematike do të kenë mundësinë të ndjekin edhe kursin e nivelit të parë në po të njëjtën fushë. Njësoj si me nivelin e parë, pjesëmarrja është me zgjedhje për ata nxënës që janë pranuar në nivelin e dytë.

2. Qeverisja, menaxhimi dhe bashkë-rendimi

2.1 Qeverisja qendrore

Qeverisja qendrore nënkupton bashkësinë e aktorëve që mbikëqyrin dhe drejtojnë Programin, si dhe veprimtaritë dhe financat e tij. Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe ministri i Arsimit dhe Sportit ndajnë përgjegjësinë për këtë program. Përgjegjës kryesor për arkitekturën e Programit është ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët, ndërsa përgjegjës kryesor për zbatimin e tij është ministri i Arsimit dhe Sportit. Me mbështetjen e organit qeverisës të parashikuar në pikën 2.2.1, është kompetencë e MSHRF-së dhe MAS-it që të garantojnë zhvillimin dhe operacionalizimin e planeve strategjike të Programit, të sigurojnë zhvillimin dhe zbatimin cilësor të kurikulave të tij, të përgatitin buxhetin dhe financimin e sigurt të tij, si dhe të çojnë përpara mjediset rregullatore dhe statutore. Ministrat përgjegjës për Bujqësinë, Kulturën, Turizmin dhe Mjedisin janë të ngarkuar me dhënien e kontributit për ideimin dhe zhvillimin e nismave tematike në mbështetje të programit, si dhe me identifikimin dhe mobilizimin e aseteve sektoriale për të ndihmuar realizimin e këtyre nismave.

Krahas kësaj, një organ qeverisës (Bordi) do të jetë përgjegjës për drejtimin e programit kombëtar, burimet dhe strukturat e tij mundësuese. Natyra e mirëfilltë e bordit do të përcaktohet nga mekanizmi i kontabilitetit. Nëse, sikundër propozohet në seksionin 3.2, për menaxhimin e fondeve joqeveritare (nga donatorë) ngrihet një korporatë jofitimprurëse, Bordi i Programit do të jetë homolog me Bordin e Korporatës; korporata do të shërbejë si një superstrukturë që do të mundësojë bashkëpunimin strategjik dhe ndarjen e kostove midis qeverisë dhe donatorëve.

Bordi përbëhet nga përfaqësues të qeverisë, donatorë dypalësh dhe shumëpalësh, aktorë të sektorit privat dhe të komunitetit, prindër dhe nxënës. Bordi nuk kompensohet. Sipas gjykimit të bordit, përfaqësuesit e stafit të shkollës, komunitetit, prindërve dhe nxënësve mund të marrin shpërblime të arsyeshme financiare, që janë të mjaftueshme për të garantuar kosto zero gjatë ofrimit të shërbimit. Bordi përbëhet nga palët e mëposhtme:

- (1) kryetar i përhershëm: ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- (1) nënkryetar i përhershëm: përfaqësues i UNICEF-it[4];
- (1) anëtar i përhershëm: ministri i Arsimit dhe Sportit;
- (1) anëtar që përfaqëson ministritë e linjës: i përzgjedhur me mandat të rinovueshëm dyvjeçar;
- (3) anëtarë që përfaqësojnë sektorin privat, me mandate të rinovueshme dyvjeçare: të përzgjedhur nga aktorë që janë zotuar se do të ofrojnë mbështetje financiare për programin[5];
- (2) anëtarë që përfaqësojnë institucionet shumëpalëshe dhe dypalëshe, me mandate të rinovueshme dyvjeçare, të përzgjedhur nga aktorë që janë zotuar se do të ofrojnë mbështetje financiare për programin;
- (1) anëtar që përfaqëson organizatat me bazë komunitare, me mandat të parinovueshëm dyvjeçar: i përzgjedhur nga organizata që kanë historik zbatimi dhe kanë shfaqur angazhim ndaj sektorit të arsimit ose sektorëve të lidhur me të;
- (1) përfaqësues i prindërve: i përzgjedhur me mandat të parinovueshëm dyvjeçar nga komitetet e prindërve;
- (1) përfaqësues i nxënësve: i përzgjedhur me mandat të parinovueshëm dyvjeçar nga këshillat e nxënësve. Përfaqësuesi i nxënësve nuk lejohet të jetë nënkryetar.
- Një sekretar, i cili zgjidhet dhe është anëtar i bordit dhe ka një mandat të rinovueshëm dyvjeçar.

Komitetet përbëhen nga anëtarët e bordit. Ngrihen nga bordi dhe ngarkohen me përgjegjësi dhe autoritete të caktuara për të ndërmarrë detyrime dhe për të marrë vendime për llogari të bordit, shpeshherë në fusha ku kërkohen përpjekje të përqendruara dhe ekspertizë teknike specifike. Objekti i autoritetit vendimmarrës të komiteteve përcaktohet nga bordi pas ngritjes së tyre; zakonisht, komitetet japin rekomandime, të cilat ia përcjellin bordit për diskutim dhe miratim. Komitetet janë një mekanizëm për të ndarë përgjegjësitë me efektivitet dhe për të garantuar efikasitetin dhe funksionimin e përgjithshëm të bordit. *Komitetet e Përhershme* janë ato komitete që janë integrale për veprimtarinë e bordit dhe kanë natyrë të përhershme. Ato përfshijnë:

- *Komitetin Ekzekutiv*, që është i ngarkuar me raportimin e përgjithshëm dhe funksionet që lidhen me Komitetin e Qeverisjes. Komiteti Ekzekutiv u jep udhëzime dhe orientime të drejtpërdrejta personave të ngarkuar me menaxhimin e programit, si dhe mbikëqyr gjendjen dhe veprimtarinë e vetë Bordit. Komitetit Ekzekutiv mund t'i jepet autoritet domethënës vendimmarrës dhe tagër për të zhvilluar mbledhje më shpesh se sa bordi kryesor – dhe ndonjëherë edhe në vend të tij.
- *Komiteti i Financës dhe Fondeve*, që është i ngarkuar me gjendjen e përgjithshme financiare, performancën dhe qëndrueshmërinë e programit. Ky Komitet mund të ngarkohet me buxhetimin dhe zhvillimin e ndarjes së kostove, si dhe mund të japë udhëzime dhe orientime specifike, në lidhje me flukset e financimit. Së fundi, ky Komitet mund të jetë përgjegjës për hartimin e strategjive për mbledhjen e fondeve.
- *Komiteti i Programeve*, që është i ngarkuar me strategjinë e programit, novatorizmin dhe cilësinë. Ky komitet është përgjegjës për aspektet programore (mësimdhënien dhe të nxënët, si dhe përvojën e nxënësve) të Programit. Ky Komitet mbikëqyr zhvillimin e kurrikulës, ndryshimet dhe shtesat në të ardhmen, si dhe zbatimin e Programit nga mësuesit dhe aktorët e tjerë.

Komitetet e posaçme formohen sipas gjykimit të bordit.

Krahas kësaj, bordi mund të zgjedhë të formojë grupe pune për ekzekutimin e detyrave specifike me afate të ngjeshura, që bordi dhe/ose komitetet i konsiderojnë të nevojshme apo të dëshirueshme. Anëtarët e bordit mund të caktojnë persona te këto grupe pune. Në raste të caktuara, kur pjesëmarrja në grupet e punës tejkalon detyrat dhe përgjegjësitë tipike të anëtarit, dhe nëse parashikohet me ligj,

[4] Një tjetër alternativë do të ishte që përfaqësuesi i UNICEF-it të ishte sekretar i nënkryetarit të zgjedhur nga bordi.

[5] Kompromisi strategjik në këtë rast është nxitja e mbështetjes financiare, duke ngushtuar rrethin e aktorëve të pranueshëm. Kriteret duhet të rishikohen herë pas here.

bordi mund ta shohë të arsyeshme që t'i kompensojë këta persona.

Skenarët kur mund të jetë e nevojshme ngritja e grupit të punës përfshijnë:

- Komiteti i Programit mund të zgjedhë të formojë një Grup Pune për Vlerësimin e Programit, ku ministri i Arsimit dhe Sportit mund të caktojë anëtarë të stafit të tij/saj;
- Komiteti Ekzekutiv mund të zgjedhë të formojë një grup pune për diversitetin dhe gjithëpërfshirjen dhe të caktojë një ekspert nga një organizatë me bazë komunitare.
- Bordi mund të zgjedhë të formojë një Komitet të Posaçëm për fushatën kryesore dhe ky i fundit mund të zgjedhë të formojë një grup pune për hartimin e strategjisë së fushatës dhe një përfaqësues i sektorit privat mund të zgjedhë të caktojë një anëtar të ekipit të marketingut në këtë grup.

Për ta ndihmuar bordin në ekzekutimin e detyrave të tij, mund të krijohen dy organe të tjera:

- Këshilli i Donatorëve, që përbëhet nga përfaqësues të ftuar të subjekteve që ofrojnë mbështetje financiare për programin kombëtar dhe/ose mbështetje domethënëse financiare për programet vendore (rajonale ose në shkollë/terren). Këshilli ofron komente dhe rekomandime strategjike për programin në përgjithësi.
- Grupi i Referencës, që përbëhet nga përfaqësues të nxënësve dhe prindërve nga çdo qark. Grupi i Referencës shërben si bord vlerësues i konsideratave programore dhe eksperimentale.



Figura 2-1. Bordi, Komitetet e Përhershme dhe Strukturat Mbështetëse Ndihmëse

Majtas

Bordi i Drejtuesve

Organi drejtues i Programit, që ofron drejtim strategjik, mbikëqyrje dhe përgjegjshmëri.

Ekzekutivi

Zhvillon strategjinë dhe politikat e përgjithshme të Programit dhe drejton zbatimin e planit të aprovuar nga bordi, është përgjegjës dhe për funksionimin e rregullt të bordit.

Financimi dhe Financa

Përgatit buxhetin e Programit, vlerëson performancën financiare, planifikon marrëveshjet për ndarjen e kostove, siguron administrim dhe kontabilitet financiar dhe mbikëqyr zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të mobilizimit të burimeve.

Programi

Mbikëqyr aspektet mësimdhënëse dhe mësimnxënëse të Programit përfshirë kurikulën, praktikën e udhëheqjes, vlerësimin, përvojën e pjesëmarrësve, novatorizmin dhe monitorimin, vlerësimin dhe të nxënin.

Djathtas

Grupi iReferencës

Prindër, nxënës dhe zbatues. Shërben si bord burimi dhe matjeje, sidomos lidhur me çështjet programatike.

Këshilli i Donatorëve

Donatorët e Programit. I ofron Bordit udhëzime dhe mbështetje, sidomos për çështjet lidhur me gjetjen e fondeve. Informohet shkurtimisht rregullisht për përparimin e projektit.

Menaxhimi dhe bashkërendimi

Duke qenë se Programi është një zgjerim i mëtejshëm dhe funksionon në kuadër të nismës "Shkolla si Qendër Komunitare (SHQK)", menaxhimi në nivelin qendror do të realizohet nëpërmjet shumë strukturave, mekanizmave dhe roleve ekzistuese, që janë ngritur nga MAS-i për këtë qëllim (ose qëllim tjetër). Në realizimin e detyrave dhe përgjegjësive në lidhje me Programin, stafi do të japë llogari pranë MAS-it dhe MSHRF-së dhe do ta ushtrojë veprimtarinë e tij nën drejtimin strategjik të bordit.

Aktualisht nuk janë identifikuar ende burime njerëzore për veprimtaritë mbështetëse të programit kombëtar, si: menaxhimi i granteve. Janë të nevojshme përpjekje dhe mbështetje nga të gjitha institucionet, në kuadër të zbatimit të programit kombëtar. Alternativat përfshijnë: këto detyra mund t'i caktohen një *locum tenens* (zëvendës) nga ministria ose punonjësi të agjencisë; pranë MAS-it mund të krijohen role të dedikuara, të përhershme dhe mund të sigurohen burime stafi; një pjesë e këtyre përgjegjësive mund t'i alokohet stafit të punësuar nga korporata që bashkëpunon me stafin e ministrive në grupin e punës; ose një kombinim i alternativave të mësipërme.

2.2 Qeverisja

Rajonale

Në nivelin rajonal nuk parashikohet asnjë organ qeverisës.

Menaxhimi dhe bashkërendimi

Koordinatori ekzistues i SHQK-së do të ndërmarrë funksionet e koordinatorit rajonal për Programin. Çdo qark do të ketë një koordinator, që punon në drejtorinë rajonale dhe është përgjegjës për koordinimin, komunikimin, mbështetjen e programit, sigurimin e cilësisë së programit dhe raportimin. Pavarësisht se punon në drejtorinë rajonale, koordinatori raporton edhe për MAS-in dhe MSHRF-në. Ky rol ka të bëjë me kontributin individual dhe nuk e menaxhon drejtpërdrejt stafin që zbaton programin në shkollë/terren. Koordinatorët rajonalë do të shërbejnë si burim dhe do të këshillojnë drejtuesit e shkollës/terrenit për të gjitha aspektet e Programit, do të parashikojnë dhe trajtojnë sfidat e përbashkëta në terren, do të identifikojnë dhe do të ofrojnë mundësi për përmirësim dhe novatorizëm të vazhdueshëm, do të ndihmojnë për monitorimin rutinë të performancës në shkollë/terren, si dhe do t'i raportojnë rregullisht rreth performancës menaxhimit në nivelin qendror dhe bordit. Krahas kësaj, koordinatorët rajonalë do të drejtojnë vlerësimin dhe përzgjedhjen e stafit joshkollor për zbatimin e nismave të nivelit të dytë.

2.3 Qeverisja në nivel shkolle

Rajonale

Qeverisja në shkollë/terren nënkupton aktorët që mbikëqyrin dhe ofrojnë mbështetje strategjike për zbatimin e Programit në nivel vendor. Ky organ mbështet dhe këshillon menaxhimin në shkollë/terren për zbatimin e Programit në shkollë/terren, sipas pikëpamjes së tij. Anëtarët:

- këshillojnë drejtuesit e shkollës/terrenit rreth përshtatjes dhe lokalizimit të Programit: nismave, veprimtarive dhe financimit të tij;
- identifikojnë dhe mobilizojnë asetet komunitare financiare dhe jofinanciare për zbatimin e suksesshëm të nismave;
- kontribuojnë për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimin e programit dhe i mbikëqyrin;
- mbikëqyrin zbatimin e politikave dhe procedurave, në lidhje me mjedisin në shkollë, mbrojtjen, shëndetin dhe mirëqenien e pjesëmarrësve, lidhjen me shërbimet sociale dhe sjelljen e nxënësve.

Qasja e parapëlqyer për qeverisjen në shkollë kërkon që përgjegjësitë e mësipërme të ndërmerren nga shoqatat prindër – mësues (sikundër parashikohet në ligjin "Për arsimin parauniversitar"). Me qëllim bashkërendimin dhe përforcimin e përpjekjeve të MAS-it në këtë hapësirë, veprimet e programit duhet të synojnë së pari funksionalizimin e shoqatave, me mbështetjen e koordinatorit të shkollës. Duke vërejtur se disa procese të parashikuara në nismën SHQK dhe në këtë Program diktojnë mekanizmin e qeverisjes vendore, krijimi i një mekanizmi qeverisjeje që është specifik për Programin mund të konsiderohet plan kontingjent. Qeverisja në shkollë/terren mund të marrë formën e Bordit Vendor[6] me përfaqësuesit e mëposhtëm:

- (1) nënkryetar i përhershëm: mësuesi bashkërendues;

[6] Edhe në këtë rast, përshtatshmëria e kësaj strukture varet nga prania ose mungesa e qeverisjes apo mekanizmave bashkërendues ekzistues. Nëse, për shembull, shkolla ka një këshill aktiv prindërish, kjo strukturë mund të përthithet nga organi ekzistues.

- (1) përfaqësues i përhershëm, drejtori i shkollës nuk lejohet të ketë rolin e kryetarit;
- (1) përfaqësues i propozuar nga shkolla, i cili është i angazhuar në program dhe ka mandat të rinovueshëm dyvjeçar;
- (3) përfaqësues të propozuar nga Këshilli i Prindërve, me mandat të rinovueshëm dyvjeçar;
- (3) përfaqësues të propozuar nga këshilli i nxënësve, me mandat të rinovueshëm dyvjeçar; përfaqësuesi i nxënësve nuk lejohet të jetë kryetar;
- (3) përfaqësues të sektorit privat dhe aktorë komunitarë, që japin mbështetje financiare dhe jofinanciare për Programin, të përzgjedhur me mandat të rinovueshëm dyvjeçar;
- një kryetar, i cili zgjidhet dhe është anëtar i bordit, dhe ka një mandat të rinovueshëm dyvjeçar;
- një sekretar, i cili zgjidhet dhe është anëtar i Bordit, dhe ka një mandat të rinovueshëm dyvjeçar.

Anëtarësia në Bordin Vendor është me zgjedhje dhe anëtarët nuk marrin shpërblim. Bordet Vendore duhet të mblidhen jo më pak se sa një herë në tre muaj. Përfaqësimi i diversitetit, për sa i përket gjinisë, etnisë dhe aftësisë, duhet të merret parasysh kur formohet Bordi.

Menaxhimi dhe bashkërendimi

Menaxhimi i programit në nivelin e shkollës/terrenit është detyrë e drejtorit ose nëndrejtorit të shkollës.

Krahas kësaj, në çdo shkollë pjesëmarrëse ndodhet një koordinator. Koordinatori i shkollës vjen nga stafi i shkollës zbatuese dhe kompensohet sipas orëve të parashikuara që përfshihen në ofrimin e nismave tematike. Koordinatori i shkollës do të shërbejë si burim për mësuesit, do të lehtësojë hartimin e planeve të Programit në nivelin e shkollës, do të ndihmojë për bashkërendimin e të gjithë programit, do të ofrojë mbështetje logjistike dhe operacionale për nismat tematike, do të komunikojë me prindërit, nxënësit dhe aktorët komunitarë, do të kontribuojë për mobilizimin e burimeve të komunitetit, si dhe do të bashkëpunojë me drejtorin e shkollës dhe koordinatorin vendor për kryerjen e monitorimeve rutinë.

3. Financimi dhe qëndrueshmëria

3.1 Mekanizmat e financimit/fondeve

Mekanizmat e financimit/fondeve në këtë dokument nënkuptojnë burimet e të ardhurave ose burime të tjera të disponueshme financimi për Programin, krahas strategjive për gjenerimin, mobilizimin dhe sigurimin e burimeve financiare.

Në fillim, Programi do të mbështetet nga fondet publike. Në planin afatmesëm dhe për të mundësuar kalimin e Programit në shkallë kombëtare dëshirohet një kombinim burimesh, duke përfshirë burime publike (taksa, të ardhura të tjera publike ose transferta të tjera ndërqeveritare) dhe jopublike (kontribute vullnetare nga sektori privat, donatorë dypalësh dhe shumëpalësh, si dhe donatorë të tjerë).

Ndonëse shumica e buxhetit të Programit do të duhet të vijë nga të ardhurat e qeverisë, strategjia e financimit do të përqendrohet te të ardhurat jotatimore, si burim domethënës fondesh. Programi do të shfrytëzojë kontributin e donatorëve dypalësh, shumëpalësh dhe të tjerëve në fillesat e tij dhe më vonë do të zhvillohen dhe do të zbatohen strategji të qëndrueshme financimi. Këto strategji përfshijnë:

- Ndër taktikat më të efektshme janë partneritetet me korporatat, duke përfshirë grantet, sponsorizimet dhe qasjet novatore, si: mbledhja e fondeve në pikat e shitjes dhe modele të tjera për aktivizimin e klientëve. Fokusi i programit te fëmijët, të rinjtë dhe arsimi, krahas fushës së gjerë tematike dhe objektit kombëtar, i siguron Programit më shumë gjasa për të përfituar mbështetje nga korporatat kombëtare me CSR (përgjegjësi sociale e korporatës) të sofistikuar dhe strategji marketingu, si dhe nga korporatat shumëkombëshe me prani domethënëse në Shqipëri. Identiteti i konsoliduar i markës luan rol integral për mundësimin e këtyre taktikave.
- Sikundër është përmendur më sipër, donatorët dypalësh dhe shumëpalësh janë një burim i çmuar financimi në fazat fillestare të zhvillimit dhe zbatimit të Programit. Donatorët mund ta konsiderojnë Programin veçanërisht premtues, si në drejtim të inovacionit, ashtu edhe në drejtim të eksperimentimit me nisma të reja të të nxënit. Krahas kësaj, mund ta shohin si mbështetje kyçe që nismat e ardhshme të arrijnë shkallë kombëtare. Megjithatë, ka pak gjasa që fondet nga institucionet dypalëshe dhe shumëpalëshe t'i mundësojnë Programit vazhdimësi afatgjatë.
- Mbledhja e fondeve në pikën e shitjes (angl. POS) mund të jetë taktikë e përshtatshme për të mbledhur të ardhura nga qeveria. Një model i zakonshëm që ka qenë i suksesshëm në skenarë dhe kontekste të krahasueshme ka qenë mundësia që përdoruesve të shërbimeve publike t'u ofrohet

mundësia të dhurojnë kur paguajnë tarifën e një shërbimi të caktuar publik.

3.2 Mekanizma kontabiliteti

Mekanizëm kontabiliteti në këtë dokument nënkupton mënyrën se si merren dhe disbursohen të ardhura ose fonde për Programin ose përmes transfertave ndërqeveritare (p.sh. fonde të Ministrisë së Arsimit për pagat e stafit të angazhuar me zbatimin e Programit), granteve për shkollat dhe/ose qeverisjen vendore ose pagesave direkte për ofruesit e shërbimeve, krahas politikave dhe procedurave që lidhen me këto transferta, grante dhe pagesa.

Duke qenë se preferohet një kombinim burimesh publike (taksa, prime, të ardhura publike, ose transferta të tjera ndërqeveritare) dhe jopublike (kontribute vullnetare nga sektori privat, donatorë dypalësh dhe shumëpalësh, si dhe donatorë të tjerë), fondi ose fondet duhet të jenë në gjendje të regjistrojnë dhe të kalojnë fonde nga këto burime. Krahas kësaj, kontrolli i disbursimit të fondeve preferohet shumë nga sektori privat dhe donatorë të tjerë, sikurse dhe elasticiteti financues.

Identifikimi i një mekanizmi të përshtatshëm financimi dhe kontabiliteti është në zhvillim e sipër[7] dhe deri tani janë evidentuar tri modele:

- Mbështetja e drejtpërdrejtë buxhetore. Përfshin transfertat direkte të fondeve nga donatorët pranë degës kombëtare të thesarit dhe menaxhimin pasues të këtyre fondeve nga ministritë e linjës, d.m.th. pas marrjes fillestare, fondet kombinohen dhe nuk bëhet dallim midis fondeve që vijnë nga donatorët, fondeve që mblidhen dhe fondeve që alokohen nga qeveria. Ky model është aplikuar në kontekstin e instrumentit të BE-së për asistencë paraanëtarësimit. Duhet vërejtur se fondet transferohen dhe menaxhohen në këtë modalitet sipas një kuadri të gjerë dhe kompleks asistence, zbatimit të synuar të strategjive sektoriale, janë voluminoze dhe vijnë nga një donator i vetëm.

- Fondi i veçantë ose nga donatorë. Këtu përfshihet transferimi i fondeve nga donatorët te dega kombëtare e thesarit; ndryshe nga mbështetja buxhetore direkte, një organ qeverisës me kontroll dhe autoritet shpenzimi mund të përbëhet nga administratorë qeveritarë dhe joqeveritarë dhe vetë fondi mund të ketë status ekstrabuxhetor. Njësoj si me mbështetjen buxhetore direkte, fondet e donatorëve janë përdorur më parë me një donator të vetëm, të madh, institucional që e ushtron veprimtarinë e tij në një kuadër të gjerë asistence.

- Hibrid. Një organizatë ose korporatë jofitimprurëse, e caktuar me akt ligjor ose vendim të Këshillit të Ministrave, do të shërbente si mbledhës i fondeve të donatorëve dhe mjet për t'u dhënë kontroll dhe autoritet mbi kontributet e tyre donatorëve, që, së bashku me përfaqësuesit e qeverisë dhe të tjerë, do të formojnë bordin. Alokimet qeveritare për programin do të menaxhohen në buxhet nga ministritë e linjës, që do të bashkëpunojnë me donatorët për të zhvilluar një buxhet të përgjithshëm dhe strategji për ndarjen e kostove. Donatorët do të kalojnë fonde për korporatën, që do të disbursojë fonde nën drejtimin e bordit.

3.3 Kontrolli vendor (në shkollë) i financimit

Një tematikë e përsëritur gjatë zbulimit është mungesa e një mekanizmi përmes të cilit shkollat mund të marrin dhe të menaxhojnë fondet me përgjegjshmëri. Në këtë rast mekanizmi përfshin një llogari bankare, regjimin e procedurave dhe kontrolleve të përshtatshme financiare, si dhe burimet njerëzore për të kryer menaxhimin financiar. Mbetet tejet e dëshirueshme zhvillimi i disa metodave për t'iu dhënë shkollave grante: për donatorët që procesin aktual e konsiderojnë të mundimshëm dhe për Programin, për të cilin centralizimi i të gjitha procedurave të prokurimit dhe menaxhimi i grantit përbëjnë një barrë të madhe operacionale. Në fazën e parë të pilotimit në 200 (dyqind) institucione arsimore të arsimit parauniversitar, është parashikuar që procedurat e prokurimit për blerje materiale didaktike dhe infrastrukturës së nevojshme, të realizohen në mënyrë të përqendruar, ndërsa menaxhimi burimeve financiare të realizohet nga zyrat arsimore vendore të arsimit parauniversitar.

3.4 Buxheti

Shihni shtojcën për kostot indikative të burimeve njerëzore.

Kostot jopersonale, duke përfshirë inputet dhe kostot dytësore, të bazuara në kurikulat përkatëse.

4. Burimet njerëzore

4.1 Stafi i shkollës

Nismat e nivelit të parë do të zbatohen nga mësuesit e shkollave përkatëse, nën udhëheqjen e

[7] Ekspertët e angazhuar në projekt po i shqyrtojnë dhe po i vlerësojnë hollësisht këto alternativa.

drejtorit të shkollës. Mësuesit do të jenë përgjegjës për hartimin e planeve mësimore (bazuar në materialet kurikulare të programit), si dhe për mësimdhënien. Mësuesit pjesëmarrës do të shpërblehen për punën shtesë sipas tarifave të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

4.2 Zbatuesit e tjerë të Programit

Në nivelin e dytë, Programi do të zbatohet nga ekspertë, trajnerë në fushën përkatëse tematike. Këtu mund të përfshijnë individë që kanë dalë në pension, profesionistë vendorë dhe (në rastin e temës së mjedisit dhe bujqësisë) pedagogë dhe studentë universiteti.

Identifikimi, mobilizimi dhe përzgjedhja

Ndonëse një program me shumë vlerë, përfshirja e zbatuesve të tjerë në Program shkakton edhe disa sfida operacionale. Sfida e parë është identifikimi i kontribuesve të mundshëm dhe garantimi i pjesëmarrjes së tyre. Drejtorët e shkollave dhe strukturat e qeverisjes vendore (në kuadër të pjesëmarrjes së tyre në nismën SHQK) do të ndërmarrin hartëzimin e burimeve komunitare, duke përfshirë zbatuesit e tjerë të Programit. Ushtrimi i hartëzimit të aseteve duhet të shqyrtohet sërish me mbështetjen e koordinatorit të caktuar, që do të bashkërendojë zbatuesit e mundshëm. Ky koordinator i përcjell koordinatorit rajonal një listë me personat e interesuar, i cili më pas vlerëson dhe përzgjedh zbatuesit e tjerë. Stafi joshkollor mund të zgjedhë të përdorë kohën dhe përpjekjet e tij ose mund të përdoren nxitje, duke përfshirë mirënjohjen, aksesin preferencial në objekte, kreditet e kursit (në rastin e studentëve të universitetit), dhe/ose kompensimin e parashikuar nga ligji dhe politikat vendore. Rekomandohet që kontribuesit të kompensohen për angazhimin e tyre afatgjatë dhe të vazhdueshëm, që kërkohet nga stafi zbatues.

Vendimi dhe përgatitja

Asnjë ose pak zbatues të tjerë që s'janë mësues do t'u nënshtrohen rishikimeve dhe shqyrtimeve të kërkuara për mësuesit ose do të përfshihen në trajnim dhe praktikë formale pedagogjike. Përpara angazhimit me nxënësit, zbatuesit e tjerë duhet të kalojnë një kontroll paraprak (sipas mekanizmave dhe kritereve të njëjta si stafi i shkollës), si dhe duhet të nënshkruajnë Kodin e Sjelljes, duke përfshirë politikën e mbrojtjes. Së fundi, disa orientime për Programin, trajnime bazë për mësimdhënie dhe mësimnxënie, si dhe udhëzime elementare rreth menaxhimit të klasave formojnë përmbajtjen e një përvoje fillestare që u duhet transmetuar të gjithë zbatuesve jo mësues. Duke marrë parasysh ndikimin dhe përvojën e trajnimeve pedagogjike dhe trajnimeve rreth sigurisë, ASCAP-i mund të jetë organi që do të mbikëqyrë zhvillimin dhe zbatimin e përvojave përgatitore (ose së brendshmi, ose nëpërmjet bashkëpunimit me një palë të tretë dhe akreditimit të moduleve të trajnimit). Përvoja mund të përftohet nëpërmjet tri modeleve ose kombinimit të tri variablave:

- Fizikisht ose në distancë
- *En masse*, në grupe të vogla (në nivel rajonal ose në ndarje sipas fushave tematike), ose individualisht;
- Në një aktivitet (trajnim treditor), në seanca të ndryshme, ose në mënyrë asinkrone.

Mbështetja për zbatuesit e tjerë jo mësues

Zbatuesit e tjerë jo mësues mund të kenë nevojë për mbështetje shtesë, sidomos për aksesimin dhe përdorimin e strukturave dhe rrjeteve shkollore, ndaj përkrahja dhe roli lidhës i koordinatorëve vendorë do t'u jepet edhe zbatuesve të tjerë jo mësues.

5. Përvoja e pjesëmarrësve

Përvoja e Pjesëmarrësve në këtë dokument nënkupton tërësinë e ndërveprimit të nxënësve me Programin. Në kontekstin e ideimit të shërbimit, shërbimi është rezultat i ndërthurjes së njerëzve, infrastrukturës, komunikimit dhe komponentëve materialë për të krijuar vlerë për palë të ndryshme interesi. Përvoja e këtij shërbimi është përkthim i teorisë në praktikë, pasi krijon vlera dhe krijon dhe ruan marrëdhënien midis konsumatorit dhe ofruesit të shërbimit. Rrjedhimisht, përvoja e pjesëmarrësve është një kusht thelbësor për të garantuar arritjen e suksesshme të rezultateve të synuara të Programit. Koordinatori i shkollës është përgjegjësi kryesor për sigurimin e përvojës së nxënësve dhe garantimin e zbatimit të taktikave të përshkruara në këtë dokument.

Krahas marrëdhënies së përgjithshme midis nxënësve dhe Programit, Përvoja e Pjesëmarrësve përfshin rrugëtimin e nxënësve drejt disa objektivave të ndërlidhur. Procesi i drejtimit të Programit për të arritur një objektiv të caktuar quhet rrugëtim. Rrugëtimet përfshijnë zbulimin, shqyrtimin dhe vendimin për t'iu bashkuar Programit; regjistrimin dhe integrimin në Program; pjesëmarrjen në nismat e Programit (përvoja të të

nxënit); dhe përfundimin dhe/ose rritjen e angazhimit me Programin.

Ky seksion përfshin një vështrim të përgjithshëm të çdo rrugëtimi, parimet që qeverisin ofrimin e shërbimeve të Programit përkundrejt rrugëtimit dhe, kur është e përshtatshme, strategji, qasje, procedura dhe veprime të tjera specifike që do të ndërmerren nga Programi për të mundësuar rrugëtimin e pjesëmarrësve.

5.1 Zbulimi dhe vlerësimi

Duke qenë se pjesëmarrja e nxënësve është me zgjedhje, për aq kohë sa nxënësit (së bashku me prindërit ose kujdestarët e tyre) zgjedhin se në cilat nisma do të përfshihen ose nëse angazhohen në Program, procesit nëpërmjet të cilit nxënësit dhe prindërit mësojnë dhe vendosin t'i bashkohen Programit duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Vlerësimet përfshijnë:

- Qëllimi i përgjithshëm i Programit duhet të jetë tërheqës për nxënësit (dhe prindërit). Jo vetëm estetika, por edhe vlerat, zëri dhe deklarata e vlerave të markës duhet të jenë domethënëse për nxënësit. Nënvizimi i mundësisë për t'u lidhur me nxënës të tjerë, për të ndjekur pasione e tyre, për të qenë drejtues më të mirë dhe për t'u angazhuar në të nxënë nëpërmjet problemeve, projekteve, dhe/ose orientimeve është i rëndësishëm për të krijuar afrimitet ndërmjet nxënësve. Krahas kësaj është jetike që të qartësohen mënyrat se si dallojnë nga shkolla nismat JOM, pasi shumë të rinj kanë merak se mos Programi do t'u duket si orë mësimore shtesë.

- Pjesëmarrësit e ardhshëm do të kërkojnë informacione nga bashkëmoshatarët e tyre ndaj, strategjitë që japin prova sociale dhe u mundësojnë nxënësve që të ndajnë histori suksesi, do të jenë pjesë integrale e përpjekjeve për mobilizim.

- Përveç dobive akademike dhe zhvillimore për fëmijët, prindërit do të duan të kuptojnë konkretisht natyrën e angazhimit të fëmijës së tyre, nevojën për kohë nga agjenda e tyre dhe kostot ose implikime të tjera financiare. Prindërit dhe kujdestarët mund të kenë edhe pyetje dhe shqetësime të tjera në varësi të gjinisë dhe identitetit të fëmijës së tyre; materialet duhet t'i parashikojnë dhe drejtuesit e shkollës duhet të jenë të përgatitur për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve.

5.2 Regjistrimi dhe pjesëmarrja

Regjistrimi është momenti kur nxënësit konfirmojnë vendimin e tyre për të marrë pjesë në program. Ka një tension të natyrshëm midis dëshirës për t'u siguruar që regjistrimi është tërheqës dhe i lehtë për nxënësit (për të maksimizuar pjesëmarrjen) dhe rolit të nevojshëm të prindërve ose kujdestarëve te vendimi i një nxënësi për të marrë pjesë në nismat JOM (duke pasur parasysh ndryshimin në rutina familjare, që lindin nga orare të reja, nevoja për transport etj.).

Në nivelin taktik rekomandohet një qasje me dy hapa. Së pari, zhvillohet një aktivitet regjistrimi në shkollë, ku nxënësit regjistrojnë interesat e tyre. Ky aktivitet duhet të jetë festiv dhe argëtues dhe duhet të tregojë se cilat janë veprimtaritë, përvojat dhe produktet unike të punës me nismat JOM. Bazuar në konsideratat e theksuara në pikat 5.1 dhe 5.4, ky aktivitet është një mundësi që pjesëmarrësit e pranishëm të ushtrojnë aftësitë e tyre drejtuese dhe krijuese, duke rekrutuar dhe duke mobilizuar pjesëmarrës të rinj. Përpara aktiviteti të regjistrimit, prindërit dhe kujdestarët duhet të informohen rreth Programit, nismave tematike dhe pjesëmarrjes së fëmijëve të tyre.

Pasi nxënësit të kenë shprehur interesin e tyre, të regjistruarit e rinj duhet të kenë pëlqimin e shprehur të prindërve për t'iu bashkuar një programi të caktuar. Komunikimi i pëlqimit thekson politikat dhe procedurat e JOM-it, orarin, si dhe jep mundësi për mbështetjen dhe përfshirjen e prindërve. Në manualin SHQK ofrohet një formular pëlqimi.

Pasi të merret pëlqimi i prindërve, nxënësit mund të konsiderohen të pranueshëm për të marrë pjesë në program. Rekomandohet që aktiviteti i regjistrimit të zhvillohet dy herë, çdo vit; njëherë në fillim të semestrit të parë dhe njëherë tjetër në fillim të semestrit të dytë. Ka disa arsye për këtë: nga pikëpamja operacionale, aktivitetet e regjistrimit dhe konfirmimit janë më efikase se sa alternativa; nga pikëpamja e mësimdhënies dhe e të nxënit, ulen gjasat që nxënësit të bashkohen në një moment të dytë gjatë kapitujve të veçantë ose veprimtarive afatgjata. Krahas kësaj, nga pikëpamja e marketingut të programit, prezantimi i mundësive "të kufizuara" për t'iu bashkuar Programit mund t'i nxisë nxënësit që t'i konsiderojnë regjistrimin dhe Programin edhe më tërheqës.

5.3 Pjesëmarrja

Pjesëmarrja në këtë rast nënkupton përdorimin e shërbimeve, duke asistuar dhe duke marrë pjesë në përvojën e të nxënit. Shumë nga përvojat e të

nxënit përvijohen në dokumentacionin e kurikulës (shihni shtojcën); një përmbledhje e këtyre përvojave ofrohet në seksionin 6.3 dhe një vështrim i përgjithshëm i tyre shqyrtohet në seksionet 6.1 dhe 6.2.

Disa konsiderata specifike procedurale, në lidhje me pjesëmarrjen e nxënësve:

- Sikundër vërehet në seksionin 5.1, një ndër shqetësimet më të mëdha të nxënësve është se Programi do t'u duket si orë mësimore shtesë. Përveç përdorimit të metodave të mësimdhënies jotradicionale, duhet të përdoren taktika për dallimin e nismës JOM nga dita formale e shkollës. Këtu mund të përfshihen pyetjet informuese, riorganizimi i bankave në klasë, muzika në sfond ose ndryshime në mjedis dhe rituale të tjera, që përforcojnë dallimin midis shkollës dhe JOM-it. Nxënësit duhet të kenë autonomi për të përcaktuar se si është arritur ky objektiv; taktikat e rrahjes së mendimeve në fillim të semestrit janë një strategji e përshtatshme.

- Për sa më sipër, nxënësit duhet të mbështeten që të ndërthurin pjesëmarrjen në nismat JOM në procesin e formimit të identitetit pozitiv. Bashkëkrijimi i deklaratës së misionit dhe/ose i vlerave: emrit, logos, sloganit ose këngës së klubit; krijimi dhe mirëmbajtja (në përputhje me politikat e shkollës) i një profili në mediat sociale janë të gjitha taktika që u japin pjesëmarrësve ndjesinë e përkatësisë në Program.

- Procedurat duhet të pasqyrojnë ndryshimin e përvojës së Programit për gjini të ndryshme. Pjesëmarrja mund të ndikohet nga normat rreth vajzave, si drejtuese, roleve gjinore tradicionale në fusha ose veprimtari të caktuara tematike (p.sh. në shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë, muzikë dhe kërcim, ose veprimtari të lidhura me kujdesin ndaj të tjerëve), pronësisë së vajzave mbi asetet sociale, shëndetësore, njohëse dhe ekonomike, si dhe rreth autonomisë trupore. Mund të hidhen hapa të thjeshtë për të trajtuar dhe për të përqafuar dallimet, si: përshtatshmëria e mjediseve sportive, inkurajimi dhe lehtësimi aktiv i vajzave në role drejtuese, ose biseda me anëtarët e komuniteteve, karrierat e të cilëve sfidojnë normat diskriminuese (p.sh. koduese gra ose burra të përfshirë në prodhime kulturore); pjesa më e rëndësishme në këtë rast mund të jetë ruajtja e një pozicioni që merr parasysh lentën gjinore gjatë procesit të planifikimit dhe të zbatimit.

- Duhet mbajtur listëprezenca. Ky është një element i monitorimit rutinë dhe kontribuon për mbrojtjen e nxënësve. Nëse nxënësit ndjekin procesin mësimor formal, por mungojnë në programit pas orarit mësimor, mungesa e tyre duhet të shënohet.

5.4 Zgjerimi dhe pika kulmore

Pjesëmarrja në nismat e nivelit të dytë është mjeti thelbësor për pasurimin e përvojave të të nxënit. Dy herë në vit, mësuesit e nivelit të parë caktojnë nxënës që tregojnë arritje të jashtëzakonshme në nivelin e dytë të programit. Nismat e nivelit të dytë ofrojnë udhëzime të specializuara dhe përvoja të të nxënit më sfiduese, që mundësohen nga individë me ekspertizë unike dhe/ose përvojë në fushën përkatëse.

Një mundësi tjetër për pasurim paraqitet nga nxënësit që shprehin vazhdimisht dëshirën për të zgjeruar rrjetet e tyre personale dhe për të pasur mundësi drejtimi. Më e rëndësishmja është që metaanaliza e komenteve të nxënësve lë të kuptohet se shumë nxënës i barazojnë "mundësitë për drejtim" me njohje dhe privilegje dhe mundësi të veçanta për të ndjekur aktivitete dhe veprimtari të ndryshme. Nxënësit nuk kanë folur shpesh për mundësitë e drejtimit për sa u përket përgjegjësive shtesë për të udhëzuar, ndikuar, drejtuar ose mbështetur të tjerët. Nismat JOM ofrojnë mundësi drejtimi për nxënësit që sfidojnë dhe zgjerojnë modelin mendor mbizotërues të drejtimit. Për këtë qëllim, grupet JOM duhet të kenë struktura dhe mekanizma drejtimi të përshtatshme për moshën e nxënësve.

Për grupet e ciklit fillor dhe të mesëm të ulët, mund të kenë formën e pozicioneve javore të drejtimit me rotacion, ku nxënësit do të merrnin përgjegjësi për detyra, si: apeli dhe/ose përgatitja e materialeve. Në kuadër të ofrimit të mësimit, nxënësve drejtues mund t'u kërkohet të lehtësojnë grupe të vogla lidhur me përzgjedhjen e temave për një projekt. Për grupet e ciklit të mesëm të lartë, nxënësit mund të kenë zgjedhur role drejtimi (që bashkërendohen me të drejtat aktuale të fëmijëve dhe strategjitë për arsimin) në një nismë, duke ndihmuar me veprimtari dhe duke luajtur edhe një rol të kufizuar në vendimmarrjen financiare. Nxënësit drejtues do të luajnë një rol të fuqishëm për rekrutimin dhe mobilizimin e anëtarëve të rinj. Në nivelin mësimor, nxënësit drejtues mund të veprojnë me autonomi të konsiderueshme për të

kërkuar, përgatitur mundësi dhe të lehtësojnë votimin e një pjesë teatrale për t'u studiuar dhe vënë në skenë ose mund të zgjedhin të strukturojnë dhe të zhvillojnë një konkurs kodimi.

Mundësitë për drejtim janë vektorë të rëndësishëm për përforcimin e vlerave të drejtësisë dhe gjithëpërfshirjes në klasë, për të investuar te vajzat dhe pjesëmarrësit, që nuk vijnë nga shumica, si dhe për të mbështetur zhvillimin e normave pozitive dhe prosociale. Duhet siguruar që përfshirja e plotë nuk frenohet nga ofrimi i mundësive të barabarta që vajzat dhe komunitetet që nuk vijnë nga shumica të ndërmarrin pozicione drejtuese, si dhe faktorëve strukturorë, si: përgjegjësitë për kujdesin, pritshmëritë e ndryshme ndaj prindërve dhe kujdestarëve, ose sjelljet diskriminuese nga bashkëmoshatarët ose stafi.

Së fundi, është e rëndësishme që progresi i pjesëmarrësve gjatë kursit të Programit të njihet dhe të vërehet. Teksa "diplomohen" nga grupet e ciklit fillor në ato të ciklit të mesëm të ulët, një mënyrë për të njohur pjesëmarrjen dhe kontributin e tyre, qoftë në një aktivitet ose ceremoni, një çmim ose një deklaratë publike është e përshtatshme për të mbështetur vetëbesimin dhe formimin e identitetit pozitiv të nxënësve. E njëjta gjë vlen për pjesëmarrësit që diplomohen nga cikli i mesëm i lartë, me një konsideratë shtesë praktike: pjesëmarrja në veprimtari jashtëkurkikulare ndihmon në procesin e aplikimit për në universitet. Një certifikatë ose kredenciale të tjera formale, që vërtetojnë pjesëmarrjen janë aset për nxënësit që dëshirojnë të ndjekin studimet universitare.

5.5 Vlerësime të përgjithshme

Barazia gjinore

Programi prezanton disa çështje që lidhen me drejtësinë gjinore, përcaktuesit strukturorë dhe mundësinë për qasjen shndërruese programore. Këtu përfshihen:

- Modelet ekzistuese të diskriminimit gjinor dhe mosmarrjes në konsideratë të gjinisë në shkolla, si: sisteme, institucione dhe ofruese shërbimesh;

- Kapaciteti i sistemit arsimor për të kryer analiza gjinore dhe për të evidentuar barrierat, si dhe për të projektuar dhe për të zbatuar masa proaktive, parandaluese dhe zbutëse;

- Përgjigjshmëria e identiteteve ndër seksionale të institucioneve dhe privimeve të mbivendosura;

Gjendja ideale e qasjeve shndërruese dhe të përgjigjshme gjinore dhe ndërthurja e tyre e suksesshme në të gjitha elementet e sistemit arsimor formal dhe joformal, nga përvojat legjislative tek ato institucionale, deri te përvojat ndërpersonale dhe individuale të nxënësve. MAS-i ka bërë përpjekje të konsiderueshme për integrimin gjinor dhe Programi do të përfitojë nga ky proaktivitet. Konsiderata specifike integrohen gjatë këtij dokumenti. Disa konsiderata të përgjithshme përfshijnë:

- A ka përfaqësim të drejtë në Program të stafit, menaxhimit dhe qeverisjes?

- Në nivelin strategjik, a përzgjidhen nismat dhe veprimtaritë e tyre me përgjigjshmëri gjinore? A pasqyrojnë një shumëllojshmëri interesash, stilesh të të nxënit dhe qasjesh? A merret gjinia parasysh nga këto veprimtari? P.sh. a kanë vajzat mundësinë të luajnë basketboll me djemtë ose vetëm me njëra-tjetrën nëse duan? A kanë djemtë mundësinë që të marrin pjesë në veprimtari kërcimi? A mbështeten fëmijët që vetidentifikohen me gjini jobinare për kapërcimin e dinamikave gjinore sipas rastit?

- A përdoret lentja gjinore në buxhetim dhe (në nivelin e zbatimit) në shpërndarje burimesh? P.sh. nëse djemtë e përdorin më shpesh fushën e futbollit dhe për rinovimin e saj bëhet një investim më i madh në dëm të funksionalizimit të objekteve të tjera që përdoren nga të gjitha gjinitë.

- Për të mundësuar pikat e mësipërme, a kategorizohen të dhënat sipas seksit dhe gjinisë?

Peizazhi i ofrimit të shërbimeve

Peizazhi i ofrimit të shërbimeve është mjedisi ku ofrohen shërbimet, duke përfshirë të gjitha aspektet e ambientit fizik. Në nivelin e parë, Programi do të zbatohet në shkolla. Kjo do të thotë që mjedisi duhet të jetë i përshtatshëm për ofrimin e shërbimeve për fëmijët. Thënë këtë, duke marrë parasysh ndryshimet në kërkesat për burime, qasje mësimore, si dhe oraret e programit, ekzistojnë konsiderata të tjera për funksionalizimin e shkollave në kontekstin e Programit. Këto përfshijnë:

- Identifikimin e hapësirave të përshtatshme në godinën ose përreth shkollës për zbatimin e veprimtarive. A ka hapësirë të mjaftueshme për të përballuar numrin e kërkuar të nxënësve që do të marrin pjesë në një nismë, si dhe për të zhvilluar disa nisma njëkohësisht, pa ndërprerje? A mund të riorganizohen hapësirat për të zhvilluar veprimtari në formate ndryshe nga veprimtaritë e zakonshme në shkollë (prova kërcimi, prova teatrale, punë

laboratorike në grup etj.)? A mund të ruhet ky riorganizim për disa seanca (p.sh., nëse nxënësit përgatitin skenën për një performancë, a duhet të zhbëjnë punën në fund të çdo seance)?

- Çfarë pajisjesh ose mjetesh shtesë duhet të prokurohen për zbatimin e nismave (p.sh. kompjutera, instrumente, mjete kopshtarie dhe artistike etj.)? Si do të mirëmbahen pajisjet? Ku do të ruhen pajisjet?

- A është mjedisi fizik i shkollës, duke përfshirë energjinë elektrike, sistemin e ngrohjes, ndriçimin, sistemin hidraulik dhe depozitimin e mbetjeve, i disponueshëm dhe i mjaftueshëm për kohëzgjatjen e zbatimit të Programit?

- A ofron shkolla lidhje me internet? A janë të disponueshme pajisjet e lidhura me internet për nxënësit e angazhuar në Program edhe pas orarit zyrtar?

- Si mund të duhet të përshtaten shërbimet e kujdestarisë dhe sigurisë për të akomoduar përdorimin shtesë të shkollës?

- Si edhe ku do të ruhen produktet e punës së nxënësve nga njëra seancë në tjetrën (p.sh. punimet në proces, paketa robotike në ndërtim etj.)?

- Si dhe ku do të shfaqet dhe të njihet puna e nxënësve?

Mbrojtja

Në kontekstin e Programit, mbrojtja nënkupton ato veprime, politika, procedura dhe praktika për parandalimin dhe përgjigjen ndaj abuzimit dhe dëmtimit të shëndetit, mirëqenies sociale emocionale dhe zhvillimit të pjesëmarrësve. Protokollet e konsoliduara të mbrojtjes kanë rëndësi të veçantë, sepse pjesëmarrësit do të njihen me stafin shkollor dhe joshkollor dhe me pjesëmarrës të tjerë jashtë mjedisit tradicional të shkollës gjatë pjesëmarrjes së tyre në program.

Si një shtojcë e sistemit arsimor formal, programi përqafon të gjitha politikat, procedurat dhe praktikat ekzistuese. Masat shtesë përfshijnë:

- përfshirjen e protokolleve të mbrojtjes në procedurën e përzgjedhjes së zbatuesve të tjerë;

- përfshirjen e ndërgjegjësimit dhe trajnimit rreth mbrojtjes së fëmijëve gjatë përgatitjes dhe rekrutimit të zbatuesve të tjerë;

- komunikimin e qartë të politikave dhe procedurave të mbrojtjes, duke përfshirë mekanizmat e ankesave për stafin zbatues, prindërit dhe pjesëmarrësit;

- shkollat ndërmarrin hapa për të garantuar sigurinë dhe mirëqenien e pjesëmarrësve, teksa ecin përpara ose përmbyllin rrugëtimin e tyre në nisma. Këtu përfshihen procedura të qarta për nxënësit në fund të orarit mësimor dhe në fillim të nismave, si dhe procedura dhe masa të qarta për largimin e sigurt të nxënësve. Në këto masa duhet të pasqyrohet mundësia e dallimit të shqetësimeve për sigurinë në gjini të ndryshme, që kanë pjesëmarrësit, prindërit dhe kujdestarët.

Fëmijët me aftësi të kufizuara

Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë të drejtën e një arsimi cilësor dhe gjithëpërfshirës dhe angazhimi i tyre i barabartë në program është shprehje e kësaj të drejte. Veprimtaritë jashtëkurrikulare janë një komponent i zakontë dhe i dëshirueshëm i Programeve të Individualizuara Arsimore. Përpjekjet për arsim gjithëpërfshirës që ndërmerren në kontekstin e programeve të rregullta akademike duhet të aplikohen edhe për pjesëmarrjen në Program. Njësoj si me programin formal akademik, këtu përfshihet llogaridhënia e drejtorëve të shkollave dhe drejtorisë arsimore rajonale për të vlerësuar gjithëpërfshirjen, për të monitoruar ecurinë e fëmijëve, si dhe për të bashkërenduar dhe për të ofruar mbështetje. Më tej:

- Për ideimin dhe zhvillimin e nismave tematike për të garantuar akses dhe cilësi të barabartë duhet të merret në konsideratë gjithëpërfshirja.

- Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë mbështetjes së zbatuesve të tjerë për të respektuar të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Këtu përfshihet sensibilizimi dhe aftësimi si pjesë e procesit të rekrutimit, por njihet edhe fakti që mbështetja e fëmijëve me aftësi të kufizuara kërkon përpjekje për zhvillimin profesional të vazhdueshëm dhe të specializuar të mësuesve; rrjedhimisht, zbatuesit e tjerë që s'janë pjesë e personelit mund të kenë nevojë për udhëzime dhe ndihmë shtesë për aksesimin dhe përdorimin e mekanizmave mbështetës.

- Bashkëpunimi i ngushtë i zbatuesve me prindërit dhe/ose kujdestarët, mësuesit dhe staf tjetër akademik është çelësi i suksesit.

Lidhja me shërbimet sociale

Një parim i kuadrit të Shkollës si Qendër Komunitare është mbështetja e integruar e nxënësve dhe e familjeve, me anë të bashkërendimit të shërbimeve sociale nëpërmjet

strukturës së shkollës si qendër komunitare. Ky parim është njohja e nevojës dhe mundësia për të ndjekur një qasje të plotë me fëmijën për krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi nxitës për arritjet dhe mirëqenien e nxënësve. Teksa Programi përqendrohet te pasurimi akademik, përpjekjet në të ardhmen duhet të shqyrtojnë mënyrat për të thelluar integrimin e shërbimeve mjekësore, të shëndetit mendor, tutorimit etj.

Sjelljet sfiduese dhe menaxhimi i klasës

Për nxënësit, iniciativat e JOM-it zënë një vend të kufizuar – ata kanë të përbashkët dhe lidhje me një pjesë të madhe të strukturës së sistemit formal shkollor, por dallohen nga objektivat, modalitetet, pritshmëritë dhe marrëdhëniet që ndryshojnë nga dita shkollore tipike. Standardet dhe parimet rreth sjelljes ndërpersonale të nxënësve – sjellja e tyre kundrejt nxënësve të tjerë dhe stafit – praktikisht nuk ndryshojnë. Ka qysh tani disa burime në dispozicion për të mbështetur drejtuesit mësimorë, përfshirë dhe manualin e mbështetur nga UNICEF-i "Ndërhyrje për sjellje pozitive në shkollë". Çështja është se si manifestohen këto standarde dhe parime brenda një mjedisi të karakterizuar nga metoda mësimore që përqendrohen tek aktiviteti dhe autonomia studentore, mungesa e mekanizmave të zakonshëm të marrjes së komenteve (si notat) dhe te pjesëmarrja vullnetare. Hapat praktikë dhe parimet për sjelljen e nxënësve dhe menaxhimin e klasës në kontekstin e iniciativave JOM përfshijnë:

- Një artikulim të qartë i pritshmërive dhe i pasojave. Nxënësit duhet të ndërgjegjësohen për këto standarde sjelljeje, që vazhdojnë nga dita formale shkollore deri tek mjedisi i JOM-it

- Përfshirja e nxënësve te hartimi i normave të grupit dhe gjetja e sanksioneve, sipas moshës së përshtatshme. Nxënësit ndiejnë përkatësi dhe fuqizim më të madh, kur janë pjesë e përcaktimit të pritshmërive dhe të pasojave, dhe kësisoj ka më të ngjarë që t'i zbatojnë këto norma. Të ndihmohen nxënësit që të rrisin standardet formale të sjelljes, duke zhvilluar normat e tyre të qarta e koncize.

- Drejtuesi mësimor ka përgjegjësinë më të madhe për menaxhimin e klasës dhe sjelljen e nxënësve. Kjo shfaqet në formën e pritshmërive të qarta e të qëndrueshme, komunikimit të shpeshtë (përfshirë dhe komente pozitive), udhëzimeve të hollësishme dhe modelimit të sjelljeve të dëshirueshme, kultivimit të marrëdhënieve të besueshme, pozitive dhe të barabarta me pjesëmarrësit dhe prindërit dhe kujdestarët e tyre.

- Dokumentimi i incidenteve të sjelljes sfiduese është thelbësor për të gjitha palët.

- Programi parashikon udhëtime jashtë zonës. Komunikimi i qartë për pritshmëritë dhe politikat dhe procedurat e duhura gjatë udhëtimit dhe në pikëmbërritjen e udhëtimit janë jetësore për sigurinë dhe mirëqenien e pjesëmarrësve.

- Mjedisi e ndikon shumë sjelljen e nxënësve. Hapësirat e përcaktuara dhe organizuara që i lejojnë nxënësit, në grupe të vogla, të punojnë më vete pa hutuar apo ndërprerë njeri-tjetrin është thelbësor. Duhet të vendosen procedurat dhe rutina për marrjen, përdorimin dhe kthimin e materialeve dhe pajisjeve (ose të përshtatet nga politikat aktuale të shkollës), sikurse dhe rutina lidhur me pastrimin dhe largimin.

- Komunikimi me prindërit është thelbësor. Politikat për ta kaluar trajtimin e sjelljeve sfiduese te prindërit duhet të vendosen me koordinatorin dhe drejtorin e shkollës. Komunikimi me prindërit, megjithatë, duhet të përqendrohet shpesh te përvojat pozitive dhe arritjet e nxënësve.

6. Praktikat e mësimdhënies dhe të nxënët

6.1 Kurikula dhe të nxënët e bazuar te standardet

Programi JOM është një mënyrë për të pasuruar të nxënën në shkollë. Rrjedhimisht, përvojat e të nxënit nëpërmjet Programit bazohen kryesisht mbi standardet e përmbajtjes dhe aftësive që numërohen në kurikulën zyrtare kombëtare. Për këtë qëllim, në kuadër të një grupi pune, ekspertët e sektorit të zgjedhur nga ministritë e linjës do të bashkëpunojnë me ASCAP-in (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar) për të identifikuar synimet dhe që standardet dytësore të trajtohen/pasurohen nëpërmjet programit.

Megjithatë, Programi siguron edhe një mekanizëm për zgjerimin e të nxënit. Nxënësve mund t'u jepet mundësia t'i tejkalojnë standardet e përmbajtjes; ekspertët e angazhuar në hartimin e nismave tematike mund të identifikojnë objektiva të të nxënit përtej atyre të renditura në kurikulën formale. Kjo është një dinamikë e lakmueshme. Për të siguruar cilësinë e programit, objektivat kurikularë/të pasurimit janë ende të specifikuara në dokumentacionin kurrikular të Programit (aneksi) dhe subjekt i shqyrtimit të MASR-së.

6.2 Praktika mësimore

Ndërmjet shumë përfitimeve nga Programi është dhe elasticiteti që sigurohet nga formati JOM dhe nga mobilizimi i aseteve komunitare për arritjen e përvojave mësimore unike, të kontekstualizuara dhe domethënëse. Ndërkohë që leksioni është një metodë mësimdhënieje e vlefshme, Programi do të përqendrohet te qasjet pedagogjike aktive, afatgjata, përjetuese dhe të bazuara të të nxënit; efektivisht, jo "shkruaj me shkumës e fol". Këto qasje përfshijnë:

- Të nxënët e bazuar te problemi: nxënësve u jepet një sfidë e hapur, shpesh e ideuar mbi kontekste të botës reale dhe ndihmohen që të gjejnë një zgjidhje. Nxënësit që zhvillojnë mjete softueri për të gjetur numrin e duhur të vullnetarëve për pastrimin e vendhedhjeve të paligjshme të mbeturinave janë një shembull i të nxënit të bazuar te problemi.
- Të nxënët e bazuar te kërkimi: i afërm me të nxënën e bazuar te problemi; të nxënët i bazuar te kërkimi mund t'u japë pjesëmarrësve një pyetje për t'iu përgjigjur (më shumë se një problem për të zgjidhur); një mundësi tjetër është që nxënësit të zhvillojnë pyetjet e tyre. Nxënësit që kërkojnë dhe kryejnë vëzhgime horizontale dhe eksperimente për të hetuar se si shtimi i ndotjes rrit ndikimin te rritja e bimëve janë një prej shembujve të të nxënit të bazuar te kërkimi.
- Të nxënët e bazuar te projekti: nxënësve u jepet një produkt përfundimtar specifik dhe ndihmohen me mjetet për ta zhvilluar produktin. Krijimi dhe shfaqja e një pjese muzikore është shembull i të nxënit të bazuar te projekti.

Për të ndihmuar mësuesit me zhvillimin e planeve të tyre, dokumentacioni kurikular i Programit përfshin një sërë aktivitetesh treguese të të nxënit, të orientuara sipas standardeve dhe të zhvilluar nga ekspertët e sektorit. Më tej, përbërësit digjitalë të programit mund të sigurojnë mundësinë e ndarjes së planeve të leksioneve me mësues të tjerë nëpërmjet librarisë ose funksioneve të arkivit.

6.3 Matja e rritjes

Programi nuk përdor matjen tradicionale të dijes së nxënësve, si testet përmbledhëse me shkrim; thënë thjesht, notat dhe vlerësimi përmbledhës nuk përfshihen në program. Megjithatë, disa matje të performancës së nxënësve vlejnë si themele të udhëheqjes dhe mbështetjes së zhvillimit të nxënësve nëpërmjet vërejtjeve dhe komenteve formuese, dhe për qëllimet e vlerësimit të efektshmërisë së zbatimit dhe identifikimit. Qasjet e përshtatshme mund të përfshijnë:

- vlerësimin e bazuar te rubrikat, ku kriteret vlerësuese përbëhen nga përshkrime me fjalë të sjelljeve të vëzhgueshme, që lidhen me nivele të ndryshme të dijes;
- vëzhgime të rregullta të dokumentuara;
- vetëvlerësime të rregullta nga nxënësit;
- një kombinim të sa më sipër; ose
- matje e Bazuar te Kurikula (MBK) MBK-ja *(Curriculum Based Measurement - CBM)* është një teknikë për matjen e rezultateve të të nxënit të nxënësve (ndryshe nga qëllimet specifike të zotërimit të mësimit) nëpërmjet testimit rutinë të performancës së nxënësit përkundrejt një detyre standarde vlerësuese – si të luajturit e një pjese muzikore, për shembull. Ndërkohë që MBK-ja ka potencial të konsiderueshëm si një qasje për matjen e përparimit të pjesëmarrësit dhe për mësimin e efektshmërisë në mjedise, si të Programit, ajo është një teknikë e specializuar gjerësisht e panjohur dhe e papërdorur nga mësuesit në ditët e sotme. Mundësia e zbatimit të MBK-së, nëse do të përdoret, duhet të bëhet në harmoni me përpjekjet në gjithë sistemin arsimor për zhvillimin profesional të lidhur me matje më të gjera.

6.4 Nismat tematike

Nismat tematike mund të mendohen si fusha përmbajtjeje ose shtigje kurikulare dhe janë njësia bazë e Programit JOM. Kurikula dhe dokumentacioni kurikular i lidhur me secilën janë ende duke u zhvilluar.

Kulturë

Edukimi kulturor përfshin artet e bukura, dekorative dhe të aplikuara, muzikën, teatrin, kinematografinë, folklorin dhe zejet tradicionale. Në vitin pilot, Programi do të përqendrohet përkatësisht tek artet e bukura dhe muzika.

Shkenca dhe teknologjia

Fusha tematike e shkencës dhe teknologjisë përqendrohet kryekëput tek inxhinieria dhe programimi i softuerëve.

Mjedisi dhe agrikultura

Fusha tematike e mjedisit dhe agrikulturës përfshin edukimin dhe sensibilizimin mjedisor dhe për qëndrueshmërinë, si dhe edukimin për agrikulturën, sistemet ushqimore, agronominë dhe agroekologjinë.

Sporte dhe mirëqenia

Fusha tematike e sportit përqendrohet te basketbolli dhe volejbolli për pjesëmarrësit e arsimit fillor. Pjesëmarrësit nga arsimi i mesëm dhe i lartë do të mund të fuqizohen nëpërmjet programeve të vetëmbrojtjes, që kombinojnë artet marciale Aikido me parandalimin e dhunës, vetëpërmbajtjen emocionale dhe aftësitë e komunikimit.

7. Lokalizimi dhe novacioni

Programet me më shumë se një vendndodhje, sidomos ato që shtrihen në disa qytete dhe rajone, duhet të jenë elastike dhe të kujdesen për dallimet mjedisore dhe kontekstuale nga siti në sit. Kombinimi i burimeve të pranishme, praktikave institucionale, ofertave konkurruese, përshtatshmërisë dhe traditës, ndryshon sipas rrethanave. Programi përdor disa strategji për të mundësuar lokalizimin (në fakt, lokalizimi dhe përshtatja janë strategji të mirëfillta për të mundësuar novacionin e këtij programi).

7.1 Zgjedhja e nismave

Nëpërmjet procesit të përcaktuar në manualin e SHQK-së (Shkolla si Qendër Komunitare), shkollat kanë evidentuar të dhëna lidhur me udhëheqësit dhe stafin shkollor, prindër, nxënës dhe anëtarë të komunitetit; së bashku, kontribuesit do të rendisin dhe hartëzojnë burimet e shkollës dhe komunitetit që mund të mobilizohen për të mbështetur përpjekjet e shkollës. Në rastin e Programit, dokumentacioni kurikular për çdo nismë nënvizon aktivitetet dhe inputet treguese që nevojiten për t'i siguruar ato përvoja. Kjo siguron disa struktura shtesë për ushtrimin e hartëzimit të aseteve: udhëheqja e nivelit shkollor (ose organi qeverisës i përcaktuar në 2.2, ose një kombinim *ad-hoc* i drejtorit të shkollës, koordinatorit të shkollës, personelit të programit, shoqatës së prindërve dhe këshillit të nxënësve) mund të vlerësojë disponueshmërinë e inputeve të nevojshme të nismës dhe të përcaktojë:

- nëse të zhvillojë një nismë të caktuar;
- si të sigurojë inputet e nevojshme për një nismë, përfshirë dy strategjitë për mobilizimin e inputeve të pranishme në nivel lokal (p.sh., pajisjet) që mungojnë nëpërmjet mekanizmave të tjera;
- si të përshtatë një nismë të caktuar, duke pasur parasysh burimet e pranishme.

7.2 Përshtatja dhe zgjerimi i nismave

Dokumentimi kurikular për çdo nismë përvijon se cilat përmbajtje dhe standarde kompetencash nga kurikula formale do të pasurohen nëpërmjet Programit; dokumentacioni, gjithashtu, identifikon aktivitetet e këshilluara të të nxënit për mësimin e atyre standardeve. Qëllimi është të sigurohet një kornizë e lehtë dhe elastike për shkollat dhe zbatuesit; kjo kornizë ofron udhëzimet e duhura për zbatimin cilësor, por, gjithashtu, lejon dhe mundëson vendime të përgjegjshme kontekstualisht se cilat aktivitete dhe qasje duhet të përdoren dhe si të përdoren më mirë. Si udhëheqës mësimorë, zbatuesit janë përgjegjës për të përshtatur nismat me kontekstet e shkollës dhe të komunitetit të tyre gjatë zhvillimit të planeve të tyre. Ata mbështeten për këtë veprim nga drejtori dhe koordinatori i shkollës.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në rastin e nismave të nivelit të dytë, ku ka vlerë përvoja dhe ekspertiza unike e zbatuesve jomësues. Zbatuesit e nivelit të dytë mund të identifikojnë objektiva shtesë të të nxënit kurikular, që shtrihen dhe ndërtohen mbi standardet e identifikuara në dokumentacionin kurikular.

7.3 Novacioni dhe zhvillimi i nismave të reja

Përhapja e përshtatjeve në nivel shkolle krijon kushte të favorshme për novatorizmin; praktikisht, çdo shkollë është një eksperiment për atë se cili kombinim burimesh dhe praktikash jep rezultatet më të mira për pjesëmarrësit. Për këtë qëllim, monitorimi strikt, vlerësimi horizontal dhe menaxhimi i dijes dhe ndarja e praktikave janë thelbësore për krijimin e një "programi që mëson" – një kusht thelbësor për risinë e programit.

Sikurse u vu re në 8.1, njësia e mësuesve dhe planet e leksioneve duhet të regjistrohen në mënyrë të ngjashme me atë që përdoret në programin shkollor formal. Si grumbullues i rezultateve të monitorimit rutinë, koordinatori rajonal ndodhet në pozicionin për të identifikuar shkolla dhe zbatues të veçantë me performancë të jashtëzakonshme; bashkë me planet e mësuesve, duhet të jetë i mundur identifikimi i praktikave më të mira. Sikurse u vu re në 6.2, përdorimi i mjeteve të menaxhimit të dijes digjitale që mundësojnë funksionimin e librarisë/arkivit të dokumentacionit do të mundësonte mjetet për mirëmbajtjen dhe ofrimin e aksesit te dokumentacioni bazë kurikular, por, gjithashtu, do të bënte të mundur identifikimin, theksimin dhe përhapjen e praktikave

premtuese (pra, të një librarie me plane mësimore dhe aktivitete me cilësi të lartë).

Me maturimin e Programit, vetë këto struktura ofrojnë dhe një platformë për krijimin e nismave krejt të reja në fushat tematike të patrajtuara. Duke mundësuar qasje te modelet kurikulare, Programi mbështet zhvillimin e nismave që trajtojnë nevojat e paplotësuara dhe mundësitë e munguara. Në fakt, një model (si nisma UPSHIFT e UNICEF-it) që fuqizon dhe lehtëson disenjimin e nismave të reja nga vetë nxënësit, do të ishte një ndërhyrje e fuqishme; për më tepër, kjo shkon shumë dhe kontribuon për qëllimet e përgjithshme të Programit.

Duke pranuar natyrën e tyre eksperimentuese, ato nisma të reja të konceptuara në nivel shkolle (në fillim) mbështeten kryesisht te burimet që mund të livrohen lokalisht. Megjithatë, një mekanizëm që u mundëson shkollave të sigurojnë fonde për nisma eksperimentale është plotësisht i realizueshëm. Kjo do të përfshinte, me shumë mundësi, pak me tepër se zhvillimin dhe zbatimin e një procesi për propozimin e nismave të reja nga shkollat, që qeverisja e nivelit qendror (me gjasë komisioni i programit) të vlerësojë dhe të zgjedhë nisma premtuese dhe grante për shkollat, dhe që koordinatorët rajonalë dhe lokalë t'i shtrijnë përpjekjet e tyre monitoruese edhe te nismat eksperimentale. Për shkak të elasticitetit të madh (për sa u përket procedurave të nëngranteve) korporatat jofitimprurëse të parashikuara nga mekanizmi hibrid kontabiliteti, përshkruar në 3.2, janë një mjet ideal për t'i drejtuar investimet te nismat e reja. Ç'është më e rëndësishmja, ky element varet nga ekzistenca e një mekanizmi për shkollat që ato të marrin dhe të menaxhojnë financime.

8. Mundësimi i cilësisë së Programit

8.1 Përgjegjësitë

Cilësia e Programit është pasqyrë e inputeve të përshtatshme, mjediseve (përfshirë mjedisin fizik, psikosocial dhe ato elemente të ofrimit të shërbimit mjedisor), përmbajtjeve, proceseve transformuese dhe rezultateve.

Në nivelin më të lartë, përgjegjësia për cilësinë e programit bie bashkërisht mbi MRF-në dhe MAS-in, si aktorët përgjegjës për disenjimin dhe zbatimin e Programit me ndihmën e strukturave qeverisëse të parashikuara në paragrafin 2.2. Praktikisht, cilësia e programit arrihet nëpërmjet përpjekjeve të përbashkëta të gjithë rrjetit të aktorëve të përfshirë në disenjimin dhe zbatimin e Programit dhe çdo aktor ka një rol për sigurimin e cilësisë. Aktori përgjegjës për zhvillimin e metodologjisë dhe mekanizmave (d.m.th., instrumenteve, mjeteve dhe sistemeve) për monitorimin rutinë, raportimin dhe vlerësimin, nuk është identifikuar ende. Zbatuesit dhe koordinatorët e shkollës (nën drejtimin e drejtuesve të shkollës dhe me mbështetjen e koordinatorëve rajonalë) janë përgjegjës për të mbledhur të dhëna në nivel shkolle që do të kontribuojnë për përpjekjet e monitorimit rutinë. Monitorimi rutinë, vlerësimi dhe raportimi janë përgjegjësitë kryesore të koordinatorëve rajonalë, të cilët ua raportojnë gjetjet e tyre MRF-së dhe MAS-it. Aktori apo aktorët specifikë përgjegjës për raportimin dhe vlerësimin në nivel qendror (si dhe për kryerjen e auditit të përgjithshëm të programit) nuk janë identifikuar ende, ndonëse Drejtoria e Përgjithshme për Arsimin Parauniversitar ose ASCAP-i do të ishin më të natyrshmit për këtë rol.

8.2 Monitorimi rutinë, vlerësimi dhe raportimi

Monitorimi rutinë këtu do të thotë mbledhja e zakonshme dhe analiza e informacionit për të kualifikuar zbatimin dhe performancën e programit për qëllimet e menaxhimit. Një vlerësim është një matës i performancës programatike dhe operacionale kundrejt objektivave. Raportimi është analiza dhe grumbullimi sistematik i gjetjeve bashkë me sintetizimin e tyre në një narrativë që përshkruan pikat e forta dhe sukseset, dobësitë dhe dështimet, mundësitë, rreziqet dhe mësimet e nxjerra.

Do të duhet të përpunohen metodologjitë dhe të zhvillohen mekanizma për të ndërmarrë monitorimin, vlerësimin dhe raportimin në kontekstin e Programit, por kuadri i ofruar nga SHQK-ja është një pikënisje e mirë. Disa vlerësime të tjera:

- Duke qenë se Programi nuk mishëron vlerësimin tradicional përmbledhës, zhvillimi i matëseve alternativë të përparimit të nxënësve kundrejt objektivave të të nxënit është thelbësor. Do të gjeni më shumë për këtë në paragrafin 6.3.
- Duke pasur parasysh sidomos natyrën zgjedhore të Programit, kënaqësia e nxënësve dhe e prindërve/e kujdestarëve janë matës të rëndësishëm të suksesit. Kështillohet me këmbëngulje testimi i rregullt dhe sistematik.

- Në përgjithësi, komentet e nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve janë burim i rëndësishëm informacioni cilësor lidhur me performancën e programit dhe duhet të kërkohen dhe të dokumentohen.

- Klasifikimi i të dhënave, sipas seksit dhe gjinisë bashkë me adoptimin e hollësishëm të lentës gjinore në analiza dhe raportim është jetësor për të siguruar Programim përfshirës, të barabartë dhe transformues.

8.3 Vlerësimi dhe të nxënët

Duke pasur parasysh natyrën eksperimentale të Programit dhe trajektoren e tij ambicioze pilote në llojin e vet, duhet theksuar rëndësia e një vlerësimi të programit. Një vlerësim zhvillimor ose formues në përfundim të vitit të parë do të jetë integral për ndërtimin e teorisë së ndryshimit të programit, duke identifikuar mundësitë dhe pengesat dhe duke nxjerrë hipoteza rreth elementeve fikse dhe elastike për përgatitjen e shkallës së vlerësimit; ia vlen të merren hapa për t'u përgatitur për një vlerësim të atillë edhe në këtë fazë të hershme.

Dy metodologji vlerësimi janë veçanërisht të përshtatshme duke pasur parasysh modalitetin kompleks operacional të Programit, radhën e ndërhyrjeve që përfshin dhe rezultatet shumëdimensionale, që synon:

- *Outcome Harvesting (vjelja e rezultatit)* është një qasje pjesëmarrëse dhe shumë praktike që identifikon dhe interpreton ndikimin e programit aty ku marrëdhëniet kazuale janë të paqarta ose indirekte dhe mund të priten rezultate të paparashikueshme. Në dallim nga përcaktimi i rezultateve specifike *ex ante* dhe përparimit të matshëm drejt atyre objektivave, vjelja e rezultatit është elastike ndaj përkufizimeve të mjegullta të rezultateve dhe niset nga provat e mbledhura të ndryshimit për të identifikuar mekanizmat e ndryshimit.

- *Most Significant Change* (ndryshimi më domethënës) ka disa ngjashmëri me vjeljen e rezultateve dhe është shumë i vlefshëm kur përdoret si plotësues i tij ose i metodologjive të tjera të vlerësimit. Ndryshimi më domethënës përdor historitë e ndikimit dhe ofron njohuri për ndryshimet më të rëndësishme nga këndvështrimi i palëve të interesit, duke vënë në pah kështu vlerat e palëve të interesit dhe përkufizimin e suksesit. Kjo qasje është e vlefshme në kontekstin e Programit, duke pasur parasysh motivimet, qëllimet dhe matësit e suksesit të ndryshëm e të paeksploruar të aktorëve të ndryshëm – qeverisë, personelit të shkollës, prindërve, anëtarëve të komunitetit dhe pjesëmarrësve – të cilët lidhen me Programin dhe vlerat e propozuara prej tij në mënyra shumë të ndryshme.

VENDIM
Nr. 625, datë 28.9.2022

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 165, DATË 2.3.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR GRUPIMIN E NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, DHE CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË FUNKSIONARËVE TË ZGJEDHUR E TË EMËRUAR, TË NËPUNËSVE CIVILË E TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË TË NJËSIVE TË VETËQEVERISJES VENDORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, shkronja "c", 4, pika 2, shkronja "d", e 5, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", dhe të neneve 46, 54, 65, 71 e 77, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 165, datë 2.3.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fjalinë e dytë, të pikës 6, pas fjalëve "... së çdo punonjësi ..." shtohen "... apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, ...".

b) Në pikën 18, fjalët "...deri në 39 000 lekë në muaj ..." zëvendësohen me "... deri në 41 700 lekë në muaj ...".

c) Në pikën 19, fjalët "... nga 30 000–39 000 lekë në muaj ..." zëvendësohen me "... nga 34 000–41 700 lekë në muaj ...".

ç) Në kolonën e dytë, të lidhjes nr. 9, pas emërtimit "Master i arteve" shtohet emërtimi

"Master profesional të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë, me 120 kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 vite akademike".

d) Lidhjet nr. 1 deri në nr. 8 zëvendësohen me lidhjet me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

2. Efektet, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e lira si pasojë e vakancave në strukturat e institucioneve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2022.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës

						PAGA MUJORE (LEK)
KLASA	**KATEGORIA**	**Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori**	**PAGA INDIVIDUALE**			**SHTESA PËR POZICION**
	1		*2*	*3*	*4*	*5*
			Paga e grupit	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa për kualifikim**	**Shtesa për pozicion**
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 73.500 deri 138.700
II	II-a	Drejtor i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 70.500 deri 126.300
	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 62.000 deri 107.000
III	III-a	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 34.200 deri 86.500
	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 31.000 deri 74.800
	III-b	Specialist inspektor	1 ose 2	2%	0	Nga 28.900 deri 65.200
IV	IV-a	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 26.700 deri 52.000
	IV-b	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 24.600 deri 40.600

Lidhja nr. 2

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me 200.001–400.000 banorë dhe me mbi 400.000 banorë

						PAGA MUJORE (LEK)
KLASA	**KATEGORIA**	**Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori**	**PAGA INDIVIDUALE**			**SHTESA PËR POZICION**
	1		*2*	*3*	*4*	*5*
			Paga e grupit	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa për kualifikim**	**Shtesa për pozicion**
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 73.500 Deri 123.000
II	II-a	Drejtor i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 70.500 deri 105.000

	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 62.000 deri 85.000
III	III-a	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 34.200 deri 74.700
	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 31.000 deri 68.700
	III-b	Specialist Inspektor	1 ose 2	2%	0	Nga 28.900 deri 65.200
IV	IV-a	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 26.700 deri 52.000
	IV-b	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 24.600 deri 40.600

Lidhja nr. 3

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me 100.001–200.000 banorë

						PAGA MUJORE (LEK)
KLASA	**KATEGORIA**	**Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori**	**PAGA INDIVIDUALE**			**SHTESA PËR POZICION**
	1		*2*	*3*	*4*	*5*
			Paga e grupit	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa për kualifikim**	**Shtesa për pozicion**
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 62.000 deri 105.000
II	II-a	Drejtor i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 34.200 deri 85.000
	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 31.000 deri 74.700
III	III-a	Përgjegjës sektori Kryeinspektor	1	2%	0	Nga 29.800 deri 72.500
	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 28.900 deri 68.700
	III-b	Specialist Inspektor	1 ose 2	2%	0	Nga 28.900 deri 65.200
IV	IV-a	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 26.700 deri 52.000
	IV-b	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 24.600 deri 40.600

Lidhja nr. 4

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me 50.001–100.000 banorë

						PAGA MUJORE (LEK)
KLASA	**KATEGORIA**	**Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori**	**PAGA INDIVIDUALE**			**SHTESA PËR POZICION**
	1		*2*	*3*	*4*	*5*
			Paga e grupit	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa për Kualifikim**	**Shtesa për pozicion**

I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 34.200 deri 85.000
II	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 28.900 deri 68.700
	III-a/1	Përgjegjës sektori Kryeinspektor	1	2%	0	Nga 28.900 deri 65.200
	III-b	Përgjegjës sektori Specialist Inspektor	1 ose 2	2%	0	Nga 26.700 deri 52.000
IV	IV-a	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 24.600 deri 40.600
	IV-b	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 24.000 deri 31.500

Lidhja nr. 5

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me 20.001–50.000 banorë

						PAGA MUJORE (LEK)
KLASA	**KATEGORIA**	**Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori**	**PAGA INDIVIDUALE**			**SHTESA PËR POZICION**
	1		*2*	*3*	*4*	*5*
			Paga e grupit	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa për Kualifikim**	**Shtesa për pozicion**
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 31.000 deri 74.700
II	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 28.900 deri 65.200
III	III-a/1	Përgjegjës sektori Kryeinspektor	1	2%	0	Nga 26.700 deri 52.000
	III-b	Përgjegjës sektori	1 ose 2	2%	0	Nga 26.700 deri 45.800
IV	IV-a	Specialist Inspektor	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 24.600 deri 38.400
	IV-b	Specialist	1 ose 2 ose 3	2%	0	Nga 24.600 deri 31.500

Lidhja nr. 6

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në bashkitë me deri në 20.000 banorë

						PAGA MUJORE (LEK)
KLASA	**KATEGORIA**	**Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori**	**PAGA INDIVIDUALE**			**SHTESA PËR POZICION**
	1		*2*	*3*	*4*	*5*
			Paga e grupit	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa për kualifikim**	**Shtesa për pozicion**
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 28.900 deri 65.200
II	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 26.700 deri 52.000

III	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 26.700 deri 45.800
	III-b	Përgjegjës sektori	1 ose 2	2%	0	Nga 24.100 deri 38.400
IV	IV-a	Specialist Inspektor	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 24.000 deri 34.200
	IV-b	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 24.000 deri 29.000

Lidhja nr. 7

Nivelet e pagave për nëpunësit civilë në Këshillin e Qarkut

						PAGA MUJORE (LEK)
KLASA	**KATEGORIA**	**Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori**	**PAGA INDIVIDUALE**			**SHTESA PËR POZICION**
	1		*2*	*3*	*4*	*5*
			Paga e grupit	**Shtesa për vjetërsi**	**Shtesa për kualifikim**	**Shtesa për pozicion**
I	I-b	Sekretar i Përgjithshëm	1	2%	0	Nga 62.000 deri 105.000
II	II-b	Drejtor drejtorie	1	2%	0	Nga 34.200 deri 85.000
III	III-a/1	Përgjegjës sektori	1	2%	0	Nga 31.000 deri 74.700
	III-b	Përgjegjës sektori Specialist Inspektor	1 ose 2	2%	0	Nga 28.900 deri 65.200
IV	IV-a	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 26.700 deri 52.000
	IV-b	Specialist	1 ose 2, ose 3	2%	0	Nga 24.600 deri 40.600

Lidhja nr. 8

Struktura dhe kufijtë e pagave për punonjësit e policisë bashkiake pranë bashkive

Emërtesa/pozicioni	**Paga (lek/muaj)**	
	Nga	**Deri**
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	84.500	104.000
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 200001 deri në 400000 banorë dhe me mbi 400.000 banorë	69.500	84.700
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 100001 deri në 200.000 banorë	67.400	82.400
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 50001 deri në 100.000 banorë	65.200	81.800
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 20001 deri në 50.000 banorë	54.600	65.200
Kryeinspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri në 20.000 banorë	53.000	61.300
Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	65.200	81.800
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 200001 deri në 400000 banorë dhe me mbi 400.000 banorë	53.000	61.300
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 100001 deri në 200.000 banorë	51.400	59.500
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 50001 deri në 100.000 banorë	48.100	59.500
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me 20001 deri në 50.000 banorë	42.800	51.000
Inspektor i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri në 20.000 banorë	40.600	49.200
Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	53.500	63.000

Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me 200001 deri në 400000 banorë dhe me mbi 400.000 banorë	47.000	54.900
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me 100001 deri në 200.000 banorë	44.400	52.700
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, 50001 deri në 100.000 banorë	42.800	51.000
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore, me 20001 deri në 50.000 banorë	40.600	49.200
Punonjës i Policisë Bashkiake në njësitë e vetëqeverisjes vendore me deri 20000 banorë	38.500	47.500

VENDIM
Nr. 627, datë 28.9.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 234, DATË 20.4.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS DHE PUNONJËSVE TË TJERË TË SPECIALITETEVE TË NDRYSHME NË DISA INSTITUCIONE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 234, datë 20.4.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja I zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja II zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2022, përballohen nga fondet e lira si pasojë e vakancave në strukturat e institucioneve, si dhe nga fondet e miratuara me aktin normativ nr. 12, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 115/2021, 'Për buxhetin e vitit 2022', të ndryshuar", në kuadër të paketës së rezistencës sociale ndaj pasojave të krizës.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2022.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja I

Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij vendimi

Nr. rendor	Klasa e pagës	Paga bazë mujore për klasë
1	I	34.000
2	II	35.000
3	III	35.800
4	IV	36.500
5	V	37.700
6	VI	38.800
7	VII	41.000
8	VIII	41.800
9	IX	43.000

Lidhja II

Nivelet e pagës bazë për klasë të punonjësve të institucioneve të përmendura në shkronjën "b", të pikës 1, të këtij vendimi

Nr. rendor	Klasa e pagës	Paga bazë mujore për klasë
1	I	34.000
2	II	35.000
3	III	35.800

4	IV	36.500
5	V	36.900
6	VI	37.500
7	VII	38.100
8	VIII	38.800
9	IX	39.500
10	X	40.200
11	XI	40.700
12	XII	41.000
13	XIII	42.000

URDHËR
Nr. 385, datë 8.9.2022

PËR ZBATIMIN E REKOMANDIMIT ICCAT, "PËR NDRYSHIMIN E REKOMANDIMIT 19-04 PËR NDRYSHIMIN E REKOMANDIMIT 18-02, PËR HARTIMIN E NJË PLANI MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR TONIN NË ATLANTIKUN LINDOR DHE DETIN MESDHE" [REC. ICCAT 21-08]

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës; të nenit 25, pika 4, të ligjit nr. 64, datë 31.5.2012, "Për peshkimin", të ndryshuar; të nenit 8, pikave 1 dhe 2, të Konventës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT), të miratuar me ligjin nr. 9822, datë 29.10.2007, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT)",

URDHËROJ:

1. Zbatimin e rekomandimit ICCAT "Për ndryshimin e rekomandimit 19-04, për ndryshimin e rekomandimit 18-02 për hartimin e një plani menaxhimi shumëvjeçar për tonin në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe" [rec. ICCAT 21–08], që i bashkëngjitet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Sektori i Politikave të Peshkimit dhe Akuakulturës, në Drejtorinë e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e pikave 1–10, 12–29, 32–33, 36–50, 52–54, 56–73, 76, 80–91, 93–109, 113–118, 120, 122–123, 125–129, 131–139, 140–141, 143–146, 151–158, 160–166, 168–192, 198–217, 236 si dhe shtojcat 1, 2, 5, dhe 8–13.

3. Ngarkohet Inspektorati i Peshkimit në Drejtorinë e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës për zbatimin e pikave 147, 159, 191, 218–22, 225–231, si dhe shtojcat 6 dhe 7.

4. Operatori i anijeve së peshkimit apo i fermës zbatojnë detyrimet që rrjedhin nga pikat 74, 75, 77, 79, 92, 110–112, 119, 121, 124, 130, 133, 146–150, 167, 168, 192–194, 195–198, 215–217, si dhe shtojcat 2, 3, 4, 8, 9, 11, 112.

5. Pikat e tjera të rekomandimit 21-08 të papërmendura në pikat 2–4 të këtij urdhri, janë detyruese për institucionet e mësipërme, në zbatim të shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të Konventës Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT), të miratuar me ligjin nr. 9822, datë 29.10.2007, "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare për Ruajtjen e Peshkut Ton të Atlantikut (ICCAT), në rast se Shqipëria do të zhvillojë aktivitetet e rregulluara sipas këtyre pikave.

6. Peshkimi i tonit do të kryhet vetëm me mjetet lundruese që përdorin formën e peshkimit me koshilok (me rrethim) sipas përcaktimeve të vendimit nr. 719, datë 12.10.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit tregtar dhe disa rregullime të mënyrës së funksionimit të regjistrit të anijeve të peshkimit", të ndryshuar.

7. Urdhri nr. 334, datë 25.8.2020, "Për zbatimin e rekomandimit të ICCAT-it për ndryshimin e rekomandimit 18-02, për hartimin e një plani menaxhimi shumëvjeçar për tonin në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe" [rec. ICCAT 19-04].

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca

REKOMANDIMI I ICCAT-it
PËR NDRYSHIMIN E REKOMANDIMIT 19-04, PËR NDRYSHIMIN E REKOMANDIMIT 18-02, PËR HARTIMIN E NJË PLANI MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR TONIN[8] NË ATLANTIKUN LINDOR DHE DETIN MESDHE

Duke pranuar se Komiteti i Përhershëm për Kërkimin dhe Statistikat (SCRS) rekomandoi në këshillimin e tij të vitit 2020 që Totali i Zënieve të Lejuara *(Total Allowable Catch*) të mbahet në 36,000 t për vitin 2022 dhe kjo shifër të rishikohet në vitin 2022 bazuar në përditësimet e treguesit të abondancës;

Duke vërejtur se SCRS-ja konfirmoi në këshillën e saj të vitit 2021 se ekzaminimi i treguesve të përditësuar të abondancës së stokut lindor dhe parashikimet e vlerësimit të vitit 2017 nuk dhanë asnjë provë për të ndryshuar këshillën aktuale të TAC-ve prej 36,000 t për vitin 2022.

Duke pranuar këshillën e SCRS-së për të konsideruar kalimin nga plani aktual i rimëkëmbjes në një plan menaxhimi dhe se statusi aktual i stokut nuk ka nevojë për masa emergjente të paraqitura në kuadrin e planit të rimëkëmbjes për tonin në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe (rekomandimi 17-07 nga ICCAT-i që ndryshon rekomandimin 14-04);

Duke marrë parasysh që SCRS-ja po kryen një vlerësim të strategjisë së menaxhimit (MSE), për të krijuar një procedurë menaxhimi (MP), e cila përfshin rregullat e kontrollit të zënieve (HCR), dhe komisioni pritet të vendosë për MP-në në takimin e tij vjetor të 2022, për të krijuar TAC-të për 2023-shin e më pas;

Duke pranuar më tej ndikimet e planit të rimëkëmbjes së tonit në flotën e peshkimit artizanal në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, sidomos në lidhje me reduktimin e kapacitetit të peshkimit;

Duke marrë parasysh kapacitetin e stokut për t'iu përgjigjur rekrutimit të ulët në disa vite të njëpasnjëshme, kjo do të jetë e rëndësishme për të siguruar që kapaciteti i peshkimit të mbetet brenda kufijve të qëndrueshëm dhe se kontrolli i kapacitetit mbetet efektiv;

Duke marrë në konsideratë rëndësinë e ruajtjes së qëllimit dhe integritetit të masave të kontrollit dhe përforcimin e gjurmueshmërisë së zënieve, veçanërisht në lidhje me transportin e peshqve të gjallë dhe aktiviteteve në fermat e rritjes;

Duke marrë parasysh që Grupi i Punës i ICCAT-it për kontrollin dhe masat e gjurmueshmërisë së tonit, i datës 2–4 mars 2020, identifikoi dispozita të ndryshme në rekomandimin 19-04 që do të përfitonin nga qartësimi, kombinimi, racionalizimi ose përmirësimi dhe përforcimi dhe se rekomandimet e Grupit të Punës u miratuan nga Paneli 2 i ICCAT-it në mars 2020;

Duke marrë parasysh, gjithashtu, se Grupi Punës ka identifikuar dispozita edhe në rekomandime të tjera, duke përfshirë rec. 06-07, 18-13 dhe 20-07, lidhur me aktivitetin e tonit, i cili do të përfitonte nga përfshirja e tyre në këtë rekomandim.

KOMISIONI NDËRKOMBËTAR PËR KONSERVIMIN E TONIT TË ATLANTIKUT (ICCAT) REKOMANDON QË:

PJESA I
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME DHE OBJEKTIVAT

1. Palët kontraktuese dhe palët bashkëpunuese jokontraktuese, subjektet ose entitetet e peshkimit referuar më poshtë si CPCs-të, anijet e të cilave kanë peshkuar në mënyrë aktive tonin (*Thunnus thynnus*) në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe do të zbatojnë një plan menaxhimi për tonin në atë zonë gjeografike duke filluar në vitin 2019, me qëllim të ruajtjes së biomasës rreth B 0.1, arritur nga peshkimi në ose më pak se F 0.1, të cilin SCRS-ja e konsideron si numër të arsyeshëm për F_{MSY}-në.

Ky objektiv do të rishikohet dhe modifikohet, nëse është e nevojshme, kur vlerësimi i Strategjisë së Menaxhimit (MSE) tregon progres të dukshëm, kur objektivat alternative të menaxhimit mund të merren parasysh dhe pikët e referencës, rregullat e Kontrollit të Zënieve (HCR) dhe/ose procedurat e menaxhimit mund të adoptohen.

2. Kur vlerësimi i stokut nga SCRS-ja tregon se statusi dhe zhvillimi i tij (në terma të biomasës dhe/ose mortalitetit nga peshkimi) devijon nga objektivi, do të aplikohen klauzolat e masave të

[8] Kudo në këtë rekomandim, fjala "ton" i referohet vetëm species *Thunnus thunnus*, *Bluefin tuna*.

sigurisë dhe rishikimit siç përcaktohen në dispozitat përfundimtare të këtij plani.

Përkufizimet

3. Për qëllimet e këtij rekomandimi:

a) "Anije peshkimi" është çdo anije e përdorur për qëllimin e shfrytëzimit për qëllime komerciale të resurseve të tonit, duke përfshirë anijet peshkuese, anijet përpunuese të peshkut, anijet mbështetëse, anijet rimorkiuese, anijet që aktivizohen në proceset e transbordimit dhe anijet e transportit të pajisura për transportimin e prodhimeve të tonit dhe anijet ndihmëse, përjashtuar anijet kontejner;

b) "Anije peshkuese" është një anije e përdorur me synim zënien për arsye tregtie të resurseve të tonit;

c) "Anije përpunuese" është një anije, në bordin e së cilës, para se prodhimi të paketohet, mund të ndodhë një ose disa nga aktivitetet e mëposhtme: filetimi apo prerja në feta, ngrirja dhe/ose përpunimi;

d) "Anije ndihmëse" është çdo anije që përdoret për transportimin e individëve jo të gjallë të tonit (jo të përpunuar) nga koshat e transportit/rritjes, nga një koshilok apo kurth në një port të përcaktuar/ose në një anije përpunimi;

e) "Anije rimorkimi/tërheqëse" nënkupton çdo anije që përdoret për tërheqjen e koshave;

f) "Anije mbështetëse" nënkupton çdo anije tjetër të autorizuar për të operuar në peshkimin e tonit të kuq për të kryer detyra mbështetëse, e cila nuk bën pjesë në asnjë nga kategoritë e tjera të përmendura në paragrafin "a" më sipër. Anijet mbështetëse nuk mund të mbajnë në bord ose të transportojnë ton;

g) "Peshkimi në mënyrë aktive" do të thotë, për çdo anije peshkuese, që faktikisht synon të peshkojë tonin gjatë një sezoni të caktuar peshkimi;

h) "Operacion i përbashkët i peshkimit" (referuar në tekst si "JFO") nënkupton çdo operacion midis dy ose më shumë anijeve me koshilok, ku zënia e një anijeje me koshilok i atribuohet një ose më shumë anijeve të tjera me koshilok, në përputhje me çelësin e shpërndarjes. JFO-ja mund të përfshijë ose jo të gjithë anijet me koshilok që përbëjnë JFO-në në pjesëmarrjen aktive në kapjen e tonit;

i) "Operacion transferimi" nënkupton:

- çdo transferim i individëve të gjallë të tonit nga rrjeta e anijes peshkuese në koshin transportues;
- çdo transferim i tonit të gjallë nga një kurth në koshin transportues pavarësisht nga prania e një anijeje tërheqëse;
- çdo transferim i individëve të gjallë të tonit nga një kosh transportues në një kosh tjetër transportues;
- çdo transferim i koshave me ton nga një anije tërheqëse në një tjetër anije tërheqëse;
- çdo transferim i tonit të gjallë midis koshave të ndryshëm në të njëjtën fermë (transferimi brenda fermës);
- çdo transferim i tonit të gjallë nga një kosh ferme në një kosh transporti;

j) "Transferim ndërmjet fermave" nënkupton zhvendosjen e tonit të gjallë nga një fermë në një fermë tjetër, e përbërë nga dy faza, një transferim nga koshi i fermës dhuruese në një kosh transporti dhe vendosjen në kosh nga koshi i transportit në koshin e fermës marrëse;

k) "Transferimi i parë" do të thotë transferimi i peshkut ton të gjallë nga një koshilok ose një kurth në një kosh transporti;

l) "Transferim i mëtejshëm" nënkupton çdo operacion transferimi që kryhet pas transferimit të parë dhe përpara mbylljes në kosh në fermën e destinacionit, si p.sh. ndarja ose bashkimi i përmbajtjes së dy koshave të transportit, por që nuk përfshin transferime vullnetare ose kontrolluese;

m) "Operator donator" do të thotë kapiteni i anijes së zënies ose të anijes tërheqëse ose përfaqësuesi i saj, ose përfaqësuesi i një ferme ose një kurthi, nga e cila buron një operacion transferimi;

n) "CPC-ja e operatorit dhurues" është pala kontraktuese që ushtron juridiksionin e saj mbi operatorin dhurues;

o) "Transferim vullnetar" nënkupton përsëritjen e çdo transferimi që zbatohet vullnetarisht nga operatori donator, me qëllim plotësimin e kërkesave të aneksit 8;

p) "Transferim kontrolli" nënkupton përsëritjen e çdo transferimi që zbatohet me kërkesë të autoriteteve të kontrollit;

q) "Kosh kontrolli" është një përsëritje e operacionit të vendosjes në kosha që zbatohet me kërkesë të autoriteteve të kontrollit, me qëllim verifikimin e numrit dhe/ose peshës mesatare të peshqve që futen në kosh;

r) "Kurth" do të thotë pajisje fikse e ankoruar në fund, që zakonisht përmban një rrjetë udhëzuese që e çon tonin në një strehë ose një seri rrethimesh ku ruhet para zënies ose kultivimit;

s) "Vendosja në kosha" nënkupton zhvendosjen e tonit të gjallë nga koshi i transportit ose kurthi në koshat e kultivimit ose të majmërisë;

t) "Majmëri" ose "Kultivim" nënkupton futjen në kosh të tonit në ferma dhe ushqyerjen e mëpasshme me synim majmen dhe rritjen e biomasës totale të tyre;

u) "Fermë" nënkupton një zonë detare të përcaktuar qartë nga koordinatat gjeografike, e përdorur për majmërinë ose kultivimin e tonit të kapur nga anijet me koshilok dhe/ose kurthe. Një fermë mund të ketë disa vendndodhje koshash për kultivim, të gjitha të përcaktuara nga koordinatat gjeografike (me një përcaktim të qartë të gjatësisë dhe gjerësisë gjeografike për secilën nga pikat e poligonit);

v) "Vjelje" (*harvest*) nënkupton vrasjen e tonit në ferma ose kurthe;

w) "Transportim" nënkupton shkarkimin e të gjithë ose ndonjë prej peshqve në bordin e një anijeje peshkimi në një anije tjetër peshkimi. Megjithatë, shkarkimi i tonit të ngordhur nga anija me koshilok, kurthi ose anija tërheqëse në një anije ndihmëse nuk do të konsiderohet si transportim;

x) "Peshkim sportiv" do të thotë peshkim jotregtar, anëtarët e të cilit aderojnë në një organizatë sportive kombëtare ose janë të pajisur me licencë sportive kombëtare;

y) "Peshkim rekreativ" do të thotë peshkim jokomercial, anëtarët e të cilit nuk aderojnë në një organizatë sportive kombëtare ose nuk janë të pajisur me licencë sportive kombëtare;

z) "Kamerë stereoskopike" nënkupton një aparat fotografik me dy ose më shumë lente, me një sensor të veçantë imazhi ose kornizë filmi për secilën lente, që mundëson marrjen e imazheve tredimensionale, për qëllimin e matjes së gjatësisë së peshkut dhe për të ndihmuar në përcaktimin e numrit dhe peshës së tonit;

aa) "kamerë kontrolli" nënkupton një kamerë stereoskopike dhe/ose videokamerë konvencionale për qëllimet e kontrolleve të parashikuara në këtë rekomandim;

bb) "BCD ose BCD elektronike (eBCD)" do të thotë një dokument i zënies së tonit;

cc) "Gjatësia e anijes" do të thotë gjatësia e përgjithshme e saj;

dd) "anije e peshkimit artizanal" është një anije me të paktën tre nga pesë karakteristikat e mëposhtme: a) gjatësia e përgjithshme <12 m; b) anija peshkon ekskluzivisht brenda ujërave territoriale të saj; c) udhëtimet e peshkimit kanë një kohëzgjatje prej më pak se 24 orë; d) numri maksimal i ekuipazhit është përcaktuar në katër persona; ose e) anija peshkon duke përdorur teknika të cilat janë selektive dhe kanë një ndikim të reduktuar në mjedis;

ee) "CPC-ja e fermës" nënkupton shtetin kontraktues nën juridiksionin e së cilës ndodhet ferma e tonit;

ff) "CPC flamur" nënkupton shtetin kontraktues flamurin e të cilit anija e peshkimit mban;

gg) "CPC-ja e kurthit" nënkupton shtetin kontraktues nën juridiksionin e të cilit ndodhet kurthi;

hh) "Input i kapacitetit të fermës" nënkupton sasinë maksimale të tonit që një fermë lejohet të vendosë në kosha gjatë një sezoni peshkimi.

PJESA II
MASAT MENAXHUESE

TAC (zëniet totale të lejuara) kuotat dhe kushtet e lidhura me ndarjen e kuotave për CPCs-të

4. Çdo CPC duhet të marrë masat e nevojshme për të siguruar që sforco e peshkimit, nga anijet e peshkimit dhe kurthet e tij, janë në përputhje me mundësitë e peshkimit të tonit në dispozicion të këtij CPC-je në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, duke përfshirë vendosjen e kuotave individuale për anijet e peshkimit me gjatësi mbi 24 m, përfshirë në listën e përmendur në paragrafin 48, pika "a" të këtij rekomandimi.

5. Totali i zënieve të lejuara (TAC), duke përfshirë edhe peshqit e ngordhur hedhurinë, për vitin 2022, do të vendoset në 36,000 t, në përputhje me këshillën e SCRS-së. TAC-të për vitin 2023 dhe më pas do të vendosen në mbledhjen vjetore të komisionit 2022, në përputhje me një procedurë menaxhimi (MP) ose bazuar në këshillat e reja të SCRS-së në 2022-shin nëse MP-ja nuk është ende i disponueshëm.

Sasia 36,000 t do të ndahet në vitin 2022 në përputhje me skemën e mëposhtme:

CPC-ja	Kuota 2022 (t)
Shqipëria	170
Algjeria	1,655
Kina	102
Egjipt	330
Bashkim Evropian	19,460
Islanda*	180
Japoni	2,819
Kore	200
Libi	2,255
Marok	3,284
Norvegji	300
Siri	80
Tunizi	2655
Turqi	2305
Kina Taipei	90
Total	35,885
Rezerva të paalokuara	115
Total	**36.000**

** Pavarësisht nga dispozita e kësaj pjese, Islanda mund të arrijë përtej 180 t në vitin 2022 me 25% ndërsa është zënia totale për 2020, 2021 dhe 2022, së bashku do të jetë më shumë se 540 t (180 t + 180 t + 180 t).*

Kjo tabelë nuk do të interpretohet që të ketë ndryshuar çelësat e shpërndarjes të paraqitura në rekomandimin 14-04. Hapat e tjera do të bëhen në të ardhmen nga komisioni.

Bashkimi Evropian është i autorizuar të transferojë 48.40 t nga kuota e tij në vitin 2022 në Mbretërinë e Bashkuar.

Mauritania mund të peshkojë deri në 5 t për kërkime çdo vit, në qoftë se ata respektojnë rregullat e raportimit të zënieve të përcaktuara në këtë rekomandim. Zëniet do të zbriten nga rezervat e pashpërndara.

Senegali mund të peshkojë deri në 5 t për kërkime çdo vit, në qoftë se ata respektojnë rregullat e raportimit të zënieve të përcaktuara në këtë rekomandim. Zëniet do të zbriten nga rezervat e pashpërndara.

Në varësi të disponueshmërisë, Kina Taipei mund të transferojë deri në 50 t të kuotave të saj Koresë në 2022-shin.

6. CPC-ja flamur mund t'i kërkojë një anijeje peshkimi të kthehet menjëherë në një port të përcaktuar prej tij, kur kuota individuale konsiderohet e peshkuar/mbaruar.

7. Nuk lejohet mbartja e kuotave të papërdorura. Një CPC mund të kërkojë të transferojë një maksimum prej 5% të kuotës së vitit 2021 në vitin 2022. CPC-ja do të përfshijë këtë kërkesë në planin e tij të kapacitetit të peshkimit që miratohet nga komisioni.

8. Nuk lejohet asnjë operacion i dhënies së të drejtës (*chartering*) për peshkimin e tonit të kuq.

9. Pavarësisht nga dispozita e rekomandimit 01-12, të gjitha CPC-të e përmendura në mënyrë specifike në tabelën në paragrafin 5, mund të transferojnë një pjesë të kuotës së tyre në një CPC tjetër, me kusht që të dy CPC-të bien dakord dhe t'i japin njoftim paraprak sekretariatit të ICCAT-it, në lidhje me sasinë që do të transferohet. Sekretariati do t'u a shpërndajë këtë njoftim të gjitha CPC-ve.

10. Nëse zëniet e një CPC-je në ndonjë vit tejkalojnë sasitë e përcaktuara, CPC-ja duhet të pakësojnë atë sasi në vitin pasardhës, në përputhje me dispozitat në paragrafët 2 dhe 3, të rekomandimit ICCAT 96-14.

11. Në linje me udhërrëfyesin e MSE-së, SCRS-ja do të vazhdojë punën për MSE-në, testimin e procedurave të menaxhimit, duke përfshirë edhe rregullat e kontrollit të vjeljeve (HCRs), të cilat duhet të mbështesin objektivat e menaxhimit që do të miratohen nga komisioni. Bazuar në të dhënat dhe këshillat e SCRS-së dhe një procesi dialogu mes shkencëtarëve dhe menaxherëve, komisioni do të zgjedhë në vitin 2022 një procedurë menaxhimi për rezervat e tonit në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe, duke përfshirë veprime menaxhuese të miratuara më parë që do të ndërmerren sipas kushteve të ndryshme të rezervave të tonit për ofrimin e këshillave të TAC-ve duke filluar nga viti 2023.

Dorëzimi i planeve vjetore të peshkimit, planet e inspektimit dhe menaxhimit të kapaciteteve të peshkimit dhe të fermave, planet e menaxhimit të fermave të rritjes

12. Deri në 15 shkurt të çdo viti, çdo CPC që ka kuotë të tonit do të paraqesë në sekretariatin e ICCAT-it:

a) Një plan vjetor të peshkimit për anijet e peshkimit dhe kurthe të peshkimit të tonit në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe të hartuar në përputhje me paragrafët 14-15;

b) Një plan vjetor i menaxhimit të kapacitetit të peshkimit që siguron që kapaciteti i peshkimit të autorizuar i CPC-ve është në përpjesëtim me kuotën e alokuar, të hartuar duke përfshirë informacionin e paraqitur në paragrafët 16–21;

c) Një plan monitorimi, kontrolli dhe inspektimi, me qëllim që të sigurojë përputhjen me dispozitat e këtij rekomandimi. Ky plan do të caktojë gjithashtu autoritetin kompetent të kontrollit të CPC-ve dhe listën e pikave të kontaktit të emëruara si përgjegjëse për zbatimin e këtij plani monitorimi, kontrolli dhe inspektimi;

d) Një plan vjetor të menaxhimit për fermat e rritjes, që është në përputhje me kërkesat e parashtruara në paragrafët 22–25, duke përfshirë inputin maksimal të autorizuara për fermë, kapacitetin maksimal për fermë dhe sasinë totale të peshkut për fermë të mbartur nga një vit më parë, në përputhje me paragrafin 199–205;

13. Për vitin 2022, para 31 marsit të 2022-shit dhe në përputhje me paragrafin 235 të këtij rekomandimi, komisioni do të thërrasë një mbledhje ndërseksionale të panelit 2, për të analizuar dhe miratuar planet e përmendura në paragrafin 12. Ky detyrim mund të rishikohet pas vitit 2022 për të lejuar miratimin e planeve me rrugë elektronike. Nëse komisioni gjen një gabim serioz në planet e paraqitura dhe nuk mund të miratojë këto plane, komisioni vendos për pezullimin automatik të peshkimit të tonit në atë vit nga ajo CPC. Mosdorëzimi i planit të përmendur më sipër automatikisht do të çojë në pezullimin e peshkimit të tonit në atë vit.

Planet vjetore të peshkimit

14. Plani vjetor i peshkimit do të identifikojë, ndër të tjera, kuotat e ndara për secilin grup të formave të peshkimit, kur është e aplikueshme, metodën e përdorur për të alokuar dhe menaxhuar kuotat, si dhe masat që sigurojnë respektimin për kuotat individuale, hapjen e sezonit të peshkimit për secilën formë peshkimi, si dhe rregullat e bashkëzënieve (*by catch*).

15. Çdo modifikim i më pasmë i planit vjetor të peshkimit do t'i transmetohet Sekretariatit Ekzekutiv të ICCAT-it së paku një ditë pune para ushtrimit të veprimtarisë që korrespondon me atë ndryshim. Pavarësisht nga kjo dispozitë, transferimet e kuotave ndërmjet formave të ndryshme të peshkimit dhe transferimet në mes të kuotave të zënieve dhe kuotave të bashkëzënieve (*by catch*) nga i njëjti CPC do të lejohen, me kusht që informacioni mbi transferimet të transmetohet te Sekretariati i ICCAT-it, përpara hyrjes në fuqi.

Masat e menaxhimit të kapacitetit të peshkimit

Kapaciteti i peshkimit

Rregullimi i kapacitetit të peshkimit

16. Çdo CPC do të përshtatë kapacitetin e tij të peshkimit për të siguruar se është në përpjesëtim me kuotën e ndarë për atë, duke përdorur normat përkatëse të zënies vjetore sipas segmentit të flotës dhe formës së peshkimit të propozuara nga SCRS-ja dhe të miratuar nga komisioni në 2009-n. Këto parametra duhet të rishikohen nga SCRS-ja jo më vonë se 2022-shi dhe çdo herë që një vlerësim i rezervës për tonin kryhet, do përfshijë normat specifike të zënies për llojet e formave të peshkimit dhe zonat e peshkimit.

17. Plani vjetor i menaxhimit të kapacitetit të peshkimit, siç përmendet në paragrafin 12 "b", do të rregullojë numrin e anijeve të peshkimit për të demonstruar se kapaciteti i peshkimit është në përpjesëtim me mundësitë e peshkimit të ndara për anijet e peshkimit për të njëjtën periudhë të kuotës. Sa i përket anijeve të peshkimit të vogël bregdetar, kërkesa minimale e kuotës prej 5 t (norma e zënies e përcaktuar nga SCRS-ja në vitin 2009) nuk do të jenë më të zbatueshme dhe kuotat e këtij sektori mund të aplikohen në mënyrë alternative tek ato anije si më poshtë:

a) Nëse një CPC ka anije të peshkimit të vogël bregdetar të autorizuar për peshkimin e tonit, ai do të alokojë një kuotë specifike për këto anije dhe do ta pasqyrojë këtë në planet e tij të peshkimit dhe të inspektimit për zbatimin e të cilave do të merren masa shtesë për të bërë të mundur monitorimin e drejtpërdrejtë të konsumimit (zënies) të kuotës nga ky segment i flotës;

b) Për anijet nga arkipelagët e Azorës, Ishujt Kanarie dhe Madeira, mund të krijohet një kuotë sektoriale për anijet me karrem. Kuota për këtë segment dhe kushtet shtesë për të monitoruar atë duhet të përcaktohen qartë në planin e peshkimit, dorëzuar në bazë të paragrafit 12 më lartë.

18. Rregullimi i kapacitetit të peshkimit për anijet me rrethim me koshilok do të kufizohet në

një ndryshim maksimal prej 20% në krahasim me kapacitetin bazë të peshkimit të vitit 2018. CPC-të mund të rrumbullakosin numrin e anijeve të peshkimit kur llogaritet kjo përqindje.

19. Për 2022-shin, CPC-të mund të autorizojnë një numër të kurtheve të tyre të angazhuara në peshkimin e tonit në Atlantikun lindor dhe në Detin Mesdhe, i cili lejon shfrytëzimin e plotë të mundësive të peshkimit.

20. Kërkesat për rregullime dhe për numrin e kurtheve të përcaktuara në paragrafët 17, 18 dhe 19 nuk do të zbatohen:

a) nëse CPC-të e vendeve në zhvillim mund të tregojnë se ata kanë nevojë të zhvillojnë kapacitetin e tyre të peshkimit në mënyrë që të përdorin tërësisht kuotën e tyre, duke përdorur normat përkatëse të zënies vjetore sipas segmentit të flotës dhe formës së peshkimit të propozuar nga SCRS-ja dhe nëse rregullimet e tilla përfshihen në planin vjetor të peshkimit në përputhje me paragrafin 12;

b) në Atlantikun Verilindor, ndaj atyre CPC-ve që peshkojnë kryesisht në zonat e tyre ekonomike (Zonën Ekonomike Norvegjeze dhe Zonën Ekonomike Islandeze).

21. Çdo llogaritje për të vendosur rregullime të kapacitetit të peshkimit do të bëhet në përputhje me metodologjinë e miratuar në takimin vjetor të 2009-s dhe me kushtet e përcaktuara në paragrafët 17 dhe 19, me përjashtim të rasteve kur CPC-të në fjalë peshkojnë kryesisht në Zonat Ekonomike Ekskluzive të Norvegjisë ose Islandës.

Kapaciteti i kultivimit

22. Çdo CPC që kultivon, do të krijojë një plan vjetor të menaxhimit të kultivimit. Ky plan duhet të tregojë se kapaciteti i përgjithshëm i inputeve dhe kapaciteti i përgjithshëm kultivues është në përpjesëtim me shumën e vlerësuar të tonit të disponueshëm për kultivim, duke përfshirë informacionin e përmendur në paragrafët 23 dhe 25. Komisioni do të sigurojë që kapaciteti total kultivues në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe është në përpjesëtim me sasinë totale të tonit të disponueshëm për kultivim në zonë.

23. Çdo CPC do të kufizojë kapacitetin e saj të kultivimit të tonit në kapacitetin total kultivues të fermave të cilat janë regjistruar në listën ICCAT ose janë autorizuar dhe deklaruar në ICCAT në vitin 2018.

24. Ata CPC të vendeve në zhvillim pa ferma kultivimi ose me më pak se tre ferma dhe që synojnë të krijojnë ferma të reja të kultivimit të tonit, kanë të drejtë të krijojnë ferma të tilla me një kapacitet maksimal kultivues deri në 1800 ton për CPC-të. Për këtë qëllim, ata do t'i komunikojnë ICCAT-it, duke i përfshirë ato në planin e tyre të kultivimit sipas paragrafit 12 të këtij rekomandimi. Kjo pikë duhet të rishikohet në 2022-shin.

25. Çdo CPC duhet të krijojë një maksimum hyrjesh vjetore për tonin e kuq të egër të kapur dhe futur në fermat e tij në nivel të të dhënave të regjistruara në ICCAT nga ferma e tij në 2005-n, 2006-n, 2007-n apo 2008-n. Nëse një CPC ka nevojë të rrisë kultivimin për tonin e peshkuar, kjo rritje duhet të jetë në përpjesëtim me kuotën e peshkimit të alokuar për atë CPC duke përfshirë edhe importet e tonit.

26. Sekretariati i ICCAT-it do të përpilojë statistika mbi sasinë vjetore të tonit në kosha (inputin e peshkut të egër të kapur), vjeljen dhe eksportin, sipas fermës së CPC-ve, duke përdorur të dhënat në sistemin eBCD. eBCD-TWG do të marrë në konsideratë zhvillimin e një funksionaliteti të tillë të nxjerrjes së të dhënave dhe derisa një funksion i tillë të bëhet i disponueshëm, çdo CPC me ferma duhet t'i raportojë këto statistika Sekretariatit të ICCAT-it. Këto statistika do të vihen në dispozicion në faqen e internetit të ICCAT-it, duke iu nënshtruar kërkesave të konfidencialitetit.

Normat e rritjes

27. SCRS-ja, në bazë të një protokolli të standardizuar që do të krijohet nga SCRS-ja për monitorimin e peshqve individualisht të njohur (të markuar), do të ndërmarrë mostra për të identifikuar normat e rritjes, duke përfshirë peshën dhe madhësinë e rritjes gjatë periudhës së majmërisë. Bazuar në rezultatin e provave dhe informacioneve të tjera shkencore në dispozicion, SCRS-ja do të shqyrtojë dhe përditësojë tabelën e rritjes të publikuar në vitin 2009 dhe normat e rritjes që përdoren për kultivimin e peshkut të referuar në paragrafin 34.c dhe do të paraqesë këto rezultate në mbledhjen vjetore të komisionit më 2022-shin.

SCRS-ja duhet të ftojë shkencëtarë të pavarur të cilët kanë ekspertizën e duhur për të shqyrtuar analizën për përditësimin e tabelës së rritjes. SCRS-ja do të marrë në konsideratë gjithashtu dallimin në mes të zonës gjeografike (duke përfshirë Atlantikun dhe Mesdheun) në përditësimin e tabelës. CPC-të

që kanë ferma do të sigurojnë që shkencëtarët e ngarkuar nga SCRS-ja për mostrat, mund të kenë qasje dhe, siç kërkohet nga protokolli, ndihmë për të kryer ato. CPC-të që kanë ferma do të përpiqen të sigurojnë që normat e rritjes që rrjedhin nga eBCD-të janë koherente me normat e rritjes të publikuara nga SCRS-ja. Nëse vërehen mospërputhje të mëdha midis tabelave të SCRS-së dhe niveleve të rritjes të vërejtura, ky informacion duhet t'i dërgohet SCRS-së për analizë.

PJESA III
MASAT TEKNIKE

Hapja e sezonit të peshkimit

28. Peshkimi me rrethim i tonit do të lejohet në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe gjatë periudhës nga 26 maj deri më 1 korrik.

Përjashtimisht, në Mesdheun Lindor (zonat e peshkimit të FAO-s 37.3.1 Egjeu; 37.3.2 Levant), sezoni hapet nga 15 maji nëse CPC-të e kërkojnë në planin e tij të peshkimit.

Përjashtimisht, në Detin Adriatik (zona e peshkimit FAO 37.2.1) sezoni mund të hapet nga 26 maji deri më 15 korrik, për peshqit e kultivuar në Detin Adriatik.

Përjashtimisht, sezoni peshkimit me rrethim në Zonën Ekonomike Norvegjeze dhe në Zonën Ekonomike Islandeze do të jetë nga 15 qershori në 15 nëntor.

Përjashtimisht, sezoni i peshkimit me rrethim në Atlantikun Lindor dhe zonat e peshkimit të Detit Mesdhe, të kufizuara me ujërat nën sovranitetin ose juridiksionin e Mbretërisë së Marokut mund të jenë të hapura nga 1 maji deri më 15 qershor nëse një CPC e kërkon atë në planin e tij të peshkimit.

29. Nëse kushtet e këqija të motit pengojnë operacionet e peshkimit, CPC-të mund të vendosin që sezonet e peshkimit të referuara në paragrafin 28 të shtyhen me një numër të barabartë të ditëve të peshkimit të humbura, por jo me shumë se 10 ditë.

30. Anijet, me linjë grepash pelagjikë, më të mëdha se 24 metra, do të lejohen të peshkojnë tonin e kuq në Atlantikun Lindor dhe në Mesdhe nga 1 janari deri në 31 maj, me përjashtim të zonës së kufizuar në perëndim prej 10 °W dhe në veri të 42 °N, si dhe në Zonën Ekonomike Norvegjeze, ku ky lloj peshkimi (me linjë grepash pelagjikë) do të lejohet gjatë periudhës 1 gusht deri në 31 janar.

31. CPC-të do të vendosin hapjen e sezonit të peshkimit për flotën e tyre, përveç peshkimit me rrethim dhe anijeve të referuara në paragrafin 30 dhe do ta përfshijnë këtë informacion në planin e tyre të peshkimit të përcaktuar në paragrafin 14 për t'u analizuar dhe për t'u miratuar nga Paneli 2 ndërsezonal.

32. Jo më vonë se viti 2020, komisioni do të vendosë se në çfarë mase sezonet e peshkimit për forma të ndryshme të peshkimit dhe/ose zonave të peshkimit mund të zgjerohen dhe/ose modifikohen në bazë të këshillave të SCRS-së pa ndikuar negativisht në zhvillimin e rezervës peshkore dhe duke siguruar që rezerva të menaxhohet në mënyrë të qëndrueshme.

Madhësia minimale

33. Madhësia minimale për tonin e zënë në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe do të jetë 30 kg ose me gjatësi 115 cm deri në degëzimin e bishtit. Prandaj, CPC-të do të marrin masat e nevojshme për ndalimin e peshkimit, mbajtjen në bord, transbordimin, transferimin, zbarkimin, transportimin, magazinimin, shitjen, reklamimin apo ofrimin për shitje të tonit që peshkon më pak se 30 kg ose me gjatësi më të vogël se 115 cm në bifurkacion.

34. Përjashtimisht nga paragrafi 33, për peshqit me peshë deri në 8 kg ose me gjatësi deri 75 cm aplikohen situatat e mëposhtme (shiko shtojcën 1):

a) Toni i kapur në Atlantikun Lindor nga barkat me grepa lundrues dhe anijet tërheqëse;

b) Toni i kapur në Detin Mesdhe nga peshkimi artizanal bregdetar për peshk të freskët me linja grepash, grepa lundruese dhe grepa dore;

c) Toni i kapur në Detin Adriatik për qëllime kultivimi.

Pavarësisht nga sa më sipër, për tonin e zënë në Detin Adriatik nga anijet me flamur kroat për qëllim kultivimi, CPC-të përkatëse mund të përcaktojnë një nivel tolerance për individë toni me një peshë minimale 6.4 kg ose 66 cm gjatësi, por jo më shumë se 7% të sasisë së zënë nga anijet kroate. Për më tepër, për tonin e zënë nga anijet franceze me grepa me gjatësi më të vogël se 17 m që veprojnë në Gjirin e Biskajës, CPC-ja mund të japë toleranca për të zënë deri në një maksimum 100 ton me një peshë minimale prej 6.4 kg ose, në alternativë, të ketë një gjatësi minimale në bifurkacion prej 70 cm.

35. CPC-të në fjalë do të lëshojnë autorizime specifike për anijet që peshkojnë sipas përjashtimeve të përmendura në paragrafin 34. Përveç kësaj, peshqit poshtë këtyre madhësive minimale, hedhurinë e të ngordhur, do të llogariten brenda kuotës së CPC-ve.

Zëniet aksidentale të peshqve me përmasa nën minimumin e lejuar

36. Për anijet dhe kurthet që peshkojnë në mënyrë aktive tonin e kuq, mund të autorizohen zënie aksidentale maksimumi deri në 5% të individëve të tonit që peshojnë nga 8 deri 30 kg ose me gjatësi në bifurkacion nga 75 deri në 115 cm gjatësi.

Kjo përqindje llogaritet mbi zëniet totale aksidentale si numër individësh të tonit që ndodhen në bord të anijes, pas çdo operacioni peshkimi, në peshën dhe gjatësinë e përmendur më sipër.

Rregullat e përgjithshme mbi bashkëzëniet (*by-catches*)

37. Të gjitha CPC-të do të ndajnë një kuotë specifike për bashkëzëniet (*by-catch*) për tonin. Nivelet e bashkëzënieve të autorizuara, si dhe metodologjia e llogaritjes së këtyre bashkëzënieve në raport me zënien totale (në peshë ose numër të individëve) do të përcaktohen qartë në planet vjetore të peshkimit, të dorëzuara në Sekretariatin e ICCAT-it sipas paragrafit 12 të këtij rekomandimi dhe nuk duhet të kalojë 20% të totalit të sasisë në fund të çdo daljeje për peshkim. Llogaritja e numrit do të zbatohet vetëm për tonin dhe speciet e ngjashme me tonin që menaxhohen nga ICCAT-i. Për anijet e peshkimit të vogël bregdetar sasia e bashkëzënieve duhet të llogaritet në bazë vjetore.

Të gjitha sasitë e bashkëzënieve të tonit të ngordhur, të mbajtur në bord ose të hedhura si hedhurinë, do të zbriten nga kuota e CPC-ve dhe duhet të raportohen në ICCAT. Nëse bashkëzënia e tonit është bërë në ujërat nën juridiksionin e peshkimit të CPC-ve, dhe në rast se legjislacioni vendas i këtyre CPC-ve kërkon që të gjithë peshqit e ngordhur duhet të zbarkohen, ky detyrim për zbarkim duhet të përmbushet edhe nga anijet që lundrojnë me flamuj të huaj.

Nëse nuk ka kuota të alokuara nga CPC-të për anijet dhe kurthet e peshkimit, apo në se është konsumuar kuota, nuk lejohet peshkimi i tonit si bashkëzënie dhe CPC-të duhet të marrin masat e duhura për të garantuar lëshimin e gjallë të tyre. Megjithatë, nëse toni i kuq është i ngordhur, duhet të zbarkohet dhe duhen ndjekur veprimet në përputhje me ligjin kombëtar. CPC-të do të informojnë mbi këto sasi në baza vjetore te Sekretariati i ICCAT-it, i cili do ta vërë atë në dispozicion të SCRS-së.

Procedurat e referuara në paragrafët 89 deri 94 dhe 227 do të zbatohen për bashkëzëniet.

Anijet që nuk peshkojnë në mënyrë aktive për tonin e kuq, çdo sasi të tij që mbajnë në bord duhet ta ndajnë qartësisht nga speciet e tjera për të lejuar kështu që autoritetet kontrolluese të monitorojnë respektimin e këtij rregulli. Procedurat për anijet e paautorizuara në lidhje me eBCD-të, do të veprojnë siç përcaktohet në dispozitën përkatëse të rekomandimit 20-08, shfuqizuar me rec. 21-18.

Peshkimi çlodhës/argëtues dhe peshkimi sportiv

38. Kur CPC-të ndajnë, ku është e përshtatshme, një kuotë specifike për peshkimin sportiv dhe argëtues; kjo kuotë e caktuar duhet të vendoset në peshkimin sportiv dhe argëtues edhe nëse zënia dhe lëshimi i tonit është i detyrueshëm, për të llogaritur peshën e mundshme të peshqve të ngordhur. Çdo CPC duhet të rregullojë peshkimin çlodhës/argëtues duke lëshuar autorizime të peshkimit për këtë qëllim.

39. CPC-të duhet të marrin masat e duhura për të ndaluar zënien dhe mbajtjen në bord, transbordimin ose zbarkimet e më shumë se një individi toni për çdo anije të peshkimit argëtues në ditë.

Ky ndalim nuk aplikohet tek ato CPC, legjislacioni i të cilëve kërkon që të zbarkohet i gjithë peshku i ngordhur, duke përfshirë edhe individët e zënë nga peshkimi sportiv dhe argëtues.

40. Tregtimi i tonit të zënë në peshkimin sportiv dhe argëtues është i ndaluar.

41. Çdo CPC duhet të marrë masa për të regjistruar të dhënat e zënieve duke përfshirë peshën e çdo toni të kapur gjatë peshkimit sportiv dhe argëtues, dhe t'i komunikojë ato në Sekretariatin e ICCAT-it për vitin paraprak deri më 1 korrik të çdo viti.

42. Sasitë e tonit të ngordhur, të zëna nga peshkimi sportiv dhe argëtues, do të llogariten kundrejt kuotës se alokuar për CPC-të, në përputhje me paragrafin 5.

43. Çdo CPC do të marrë masat e nevojshme për të siguruar, në masën më të madhe të mundshme, lëshimin e tonit, sidomos të të

vegjëlve, të kapur gjallë, në kuadrin e peshkimit argëtues dhe sportiv. Çdo ton i zbarkuar duhet të jetë i plotë, i pastruar dhe/ose i prerë.

44. Çdo CPC që dëshiron të kryejë një peshkim "kap dhe lësho" në Atlantikun Verilindor mund të lejojë një numër të kufizuar të anijeve sportive të synojnë tonin me qëllim të "marko/shënjo dhe liro" pa pasur nevojë të alokojë për to një kuotë specifike.

Kjo vlen për ato anije që veprojnë në kuadër të një projekti shkencor të një instituti kërkimi, të integruar në një program kërkimor shkencor, rezultatet e të cilit do t'i komunikohen SCRS-së. Në këtë kontekst, CPC-të kanë detyrimin: a) të paraqesin përshkrimin dhe masat shoqëruese që zbatohen në këtë formë peshkimi si pjesë integrale e planeve të tyre të peshkimit dhe kontrollit siç referohet në paragrafin 12 të këtij rekomandimi; b) të monitorojnë nga afër aktivitetet e anijeve në fjalë për të siguruar përputhshmërinë e tyre me dispozitat ekzistuese të këtij rekomandimi; c) të sigurojë që veprimtaria e markimit dhe lëshimit të tonit të kryhen nga personeli i trajnuar për të siguruar mbijetesën e lartë të peshqve; dhe d) çdo vit të paraqesë një raport mbi aktivitetet shkencore të kryera, të paktën 60 ditë para mbledhjes SCRS të vitit vijues. Çdo ton i kuq që ngordh gjatë aktivitetit të markimit dhe lëshimit do të raportohet dhe të zbritet nga kuota CPC.

45. CPC-të do të vënë në dispozicion, sipas kërkesës nga ICCAT-i, listën e anijeve të peshkimit sportiv dhe argëtues të cilat kanë marrë një autorizim.

46. Formati për një listë të tillë, referuar paragrafin 45 duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin e anijes, numrin e regjistrit;

b) numri e ICCAT-it (nëse ka);

c) emrin e mëparshëm (nëse ka);

d) emrin dhe adresën e pronarit(ve) dhe operatorit(ve).

Përdorimi i mjeteve ajrore

47. Përdorimi i çdo mjeti ajror, duke përfshirë aeroplanë, helikopterë ose çdo lloji të mjeteve ajrore pa ekuipazh për të kërkuar tonin e kuq, është i ndaluar.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

Seksioni A
Regjistri i anijeve, kurtheve dhe fermave

Regjistri i ICCAT-it për anijet e peshkimit

48. CPC-të do të krijojnë dhe mbajnë një regjistër ICCAT-i për të gjitha anijet e peshkimit sipas përcaktimit të paragrafit 3 "a". Ky regjistër duhet të përmbajë listat e mëposhtme:

a) anijet e zënies që peshkojnë aktivisht për ton, sipas paragrafit 3 "g" të këtij rekomandimi; dhe

b) anije të tjera të përfshira në aktivitete të lidhura me tonin e kuq, përveç anijeve të kapjes.

49. Çdo listë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

a) emrin dhe numrin e regjistrit të mjetit lundrues;

b) specifikimin e llojit të mjetit lundrues që diferencon të paktën ndërmjet: anijeve të peshkimi, anijeve tërheqëse, anijeve ndihmëse, anijeve mbështetëse, anijeve përpunuese;

c) gjatësia dhe tonazhi bruto i regjistruar (GRT) ose, kur është e mundur, Tonazhi Bruto (GT);

d) numrin e IMO-s (nëse ka);

e) mjetet e peshkimit të përdorura (nëse ka);

f) flamurin e mëparshëm (nëse ka);

g) emri i mëparshëm (nëse ka);

h) detajet e mëparshme të fshirjes nga regjistrat e tjerë (nëse ka);

i) shenjën e thirrjes ndërkombëtare të radios (nëse ka);

j) emrin dhe adresën e pronarit(ve) dhe operatorit(ve); dhe

k) periudha kohore e autorizuar për peshkimin, operimin dhe/ose transportin e tonit për kultivim.

50. Për anijet me një gjatësi >24 m (pavarësisht rrjetës së përdorur, duke përjashtuar tratat fundore) dhe për anijet me rrethim me koshilok, CPC-të duhet të raportojnë numrin e tyre në Sekretariatin Ekzekutiv, si pjesë e planit të tyre të peshkimit të përcaktuara në paragrafin 12 të këtij rekomandimi.

51. Sekretariati Ekzekutiv i ICCAT-it do të krijojë dhe mirëmbajë regjistrin e ICCAT-it për të gjitha anijet e peshkimit që peshkojnë në mënyrë aktive për ton dhe të gjitha anijet e tjera të autorizuara për të operuar për tonin në Atlantikun Lindor dhe në Mesdhe dhe të marrë çdo masë për të siguruar vlefshmërinë e të dhënave përmes

mjeteve elektronike, duke përfshirë vendosjen e tij në faqen e internetit të ICCAT-it, në përputhje me konfidencialitetin e kërkuar nga CPC-të.

52. Çdo CPC flamur do t'i dorëzojë në mënyrë elektronike çdo vit Sekretariatit të ICCAT-it: i. jo më vonë se 15 ditë përpara fillimit të aktivitetit të peshkimit, listën e anijeve të peshkimit të përmendura në paragrafin 48 "a"; dhe ii. jo më vonë se 15 ditë përpara fillimit të veprimtarisë së tyre, listën e anijeve të tjera të peshkimit të përmendura në paragrafin 48 "b". Dorëzimi do të kryhet në përputhje me formatin e përcaktuar në *Udhëzimet për dorëzimin e të dhënave dhe informacionit të kërkuar* nga ICCAT.

53. Nuk do të pranohen ndryshime të tjera, përveçse kur një anije peshkimi e përfshirë në listë, nuk mund të marrë pjesë për shkak të arsyeve operacionale të legjitimuara ose *shkaqeve madhore*. Në këto rrethana, CPC-ja në fjalë duhet të informojë menjëherë Sekretariatin Ekzekutiv të ICCAT-it, duke dhënë:

a) Detajet e plota të anijeve të peshkimit që synojnë të zëvendësojnë një apo më shumë anije, të përfshira në regjistrat e përmendur në paragrafin 48; CPC-të me më pak se 5 anije në listën e përmendur në paragrafin 48, mund të zëvendësojnë një anije me një anije tjetër që nuk është përfshirë më parë në regjistër, me kusht që CPC-ja në fjalë t'i paraqesë Sekretariatit të ICCAT-it një kërkesë për një numër ICCAT-i që t'i jepet anijes, dhe numri i kërkuar është dhënë;

b) Një përshkrim i kuptueshëm i arsyeve që justifikojnë zëvendësimin dhe çdo fakt apo referencë që mbështet atë.

Sekretariati i ICCAT-it do t'i shpërndajë këto raste midis CPC-ve. Nëse ndonjë CPC njofton se rasti nuk është analizuar mjaftueshëm ose është jo i plotë, ai do të dërgohet në Komitetin e Përputhshmërisë për shqyrtim të mëtejshëm dhe do të mbetet në pritje të miratimit të Komitetit të Përputhshmërisë.

54. Pa paragjykuar paragrafin 37 për qëllimet e këtij rekomandimi, anijet e peshkimit që nuk hyjnë në një nga regjistrat e ICCAT-it, të parashikuara në paragrafin 48, në pikat "a" dhe "b", sugjerohet të mosautorizohen për të peshkuar, mbajtur në bord, transborduar, transferuar, përpunuar apo zbarkuar tonin në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe. Ndalimi për mbajtjen në bord nuk aplikohet për CPC, të cilave legjislacioni i brendshëm u kërkon zbarkimin e të gjithë peshqve të ngordhur, duke siguruar që vlera e tyre është subjekt konfiskimi.

55. Kushtet dhe procedurat e referuara në rekomandimin ICCAT, që ndryshon rekomandimin 13-13 në lidhje me krijimin e një regjistri të ICCAT-it të anijeve me gjatësi të përgjithshme ose më të madhe se 20 metra të autorizuara për të vepruar në zonën e Konventës (rec. 21-14) (përveç paragrafit 3), do të zbatohen pjesë-pjesë (*mutatis mutandis*).

Autorizimet e peshkimit për anijet dhe kurthet e autorizuara për peshkimin e tonit

56. CPC-ja lëshon autorizime të veçanta dhe/ose licencë kombëtare peshkimi për anijet dhe kurthet e përfshira në një prej listave të përshkruara në paragrafët 45, 48 dhe 58. Autorizimet për peshkim do të përmbajnë si informacion minimal atë të paraqitur në shtojcën 13. CPC-të duhet të sigurojnë se informacioni që përmban autorizimi për peshkim të jetë i saktë dhe në përputhje me rregullat e ICCAT-it. CPC-ja do të marrë masat e nevojshme të forcimit të zbatimit të legjislacionit të tyre dhe mund të kërkojë që anija të kthehet menjëherë në një port të caktuar kur kuota individuale është peshkuar.

Regjistri i ICCAT-it për kurthet e autorizuara për të peshkuar tonin e kuq

57. Komisioni krijon dhe mban një regjistër të ICCAT-it për të gjitha kurthet e tonit të autorizuara për peshkimin e tonit në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe. Me qëllim zbatimin e këtij rekomandimi, kurthet e tonit që nuk janë regjistruar, sugjerohet të mosautorizohen për të peshkuar apo mbajtur ton dhe të mos marrin pjesë në aktivitetin e peshkimit, transferimit, zënies apo zbarkimit të tonin.

58. Çdo CPC do të dërgojë në format elektronik në Sekretariatin Ekzekutiv të ICCAT-it, si pjesë e planit të tij të peshkimit, të përcaktuara në paragrafët 14 deri 15, listën (duke përfshirë emrin e kurthit, numrin e regjistrit dhe koordinatat gjeografike të poligonit të kurthit) e kurtheve të autorizuara të tonit sipas paragrafit 56.

59. Çdo CPC do të njoftojë Sekretariatin e ICCAT-it, pas krijimit të regjistrit të kurtheve të ICCAT-it, për çdo shtesë, çdo fshirje nga dhe/ose çdo modifikim të regjistrimit të kurtheve të ICCAT-it në çdo kohë që ndodhin ndryshime të tilla.

60. Sekretariati i ICCAT-it do të marrë çdo masë për të siguruar vlefshmërinë e të dhënave përmes mjeteve elektronike, duke përfshirë vendosjen e tij në faqen e internetit të ICCAT-it në përputhje me konfidencialitetin e kërkuar nga CPC-të.

Regjistri i ICCAT-it i fermave të autorizuara për të kultivuar tonin

61. Sekretariati i ICCAT-it do të mbajë një regjistër të ICCAT-it për të gjitha fermat e tonit të autorizuara për të kultivuar tonin në Atlantikun Lindor dhe Mesdhe. Për qëllimet e këtij rekomandimi, fermat e tonit që nuk janë regjistruar në regjistër konsiderohen se nuk janë të autorizuara për të kultivuar tonin.

62. Çdo CPC me ferma do t'i dorëzojë në mënyrë elektronike Sekretariatit të ICCAT-it, si pjesë e planit të tyre të kultivimit të përcaktuar në paragrafin 12 "d", listën e fermave të saj të autorizuara për ton, duke përfshirë:

i. emrin e fermës;

ii. numrin e regjistrit;

iii. emrat dhe adresat e pronarit(ve) dhe operatorit(ve);

iv. inputet dhe kapaciteti total kultivues i alokuar për çdo fermë;

v. koordinatat gjeografike të zonave të autorizuara për veprimtari kultivuese; dhe

vi. statusin e fermës (aktive ose joaktive).

63. Asnjë aktivitet kultivues, duke përfshirë ushqimin për qëllime majmërie ose vjeljen e tonit të kuq, nuk do të autorizohet jashtë koordinatave gjeografike të miratuara për aktivitetet kultivuese.

64. Çdo CPC do të njoftojë Sekretariatin e ICCAT-it për çdo shtesë, çdo fshirje nga dhe/ose çdo modifikim të Regjistrit ICCAT të fermave në çdo kohë që ndodhin ndryshime të tilla.

65. Sekretariati ICCAT do të marrë çdo masë për të siguruar vlefshmërinë e të dhënave përmes mjeteve elektronike, duke përfshirë vendosjen e tij në faqen e internetit të ICCAT-it, në përputhje me konfidencialitetin e kërkuar nga CPC-të.

66. Çdo CPC do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që asnjë ton nuk vendoset në një fermë të paautorizuar nga CPC-të ose e listuar në Regjistrin e ICCAT-it dhe që fermat të mos marrin ton nga anije që nuk janë përfshirë në Regjistrin e anijeve të ICCAT-it, të përmendura në paragrafin 48. Çdo CPC do të marrë masat e nevojshme, sipas legjislacionit të tyre në fuqi, për të ndaluar çdo veprim në fermat që nuk janë regjistruar në Regjistrin e fermave të ICCAT-it.

Informacion mbi aktivitetin e peshkimit

67. Më 31 korrik të çdo viti, ose brenda 7 muajve të përfundimit të sezonit të peshkimit, për ato CPC që përfundojnë fushatën e tyre të peshkimit në korrik, çdo CPC dërgon një informacion të detajuar mbi zëniet e tonit në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe e cila paraprin periudhën e alokimit të kuotave. Ky informacion duhet të përfshijë:

a) emrin dhe numrin ICCAT të secilës anije peshkimi;

b) periudhën e autorizimit për çdo anije peshkimi;

c) kapjet totale të secilës anije peshkuese, duke përfshirë kthimet zero (pa zënie) gjatë të gjithë periudhës së autorizimit;

d) numrin e përgjithshëm të ditëve të çdo anijeje peshkimi që ka peshkuar në Atlantikun Lindor dhe Mesdhe gjatë të gjithë periudhës së autorizimit; dhe

e) kapjet totale jashtë periudhës së autorizimit të tyre (bashkëzënie).

68. Për të gjitha anijet të cilat nuk janë të autorizuara për të peshkuar në mënyrë aktive për ton në Atlantikut Lindor dhe Detin Mesdhe, por që kanë zënë ton si bashkëzënie:

a) emrin dhe numrin ICCAT apo numrin kombëtar të regjistrit të anijes, nëse nuk është e regjistruar me ICCAT-in;

b) zëniet totale të tonit.

69. Çdo CPC njofton Sekretariatin e ICCAT-it për çdo informacion që ka lidhje me anijet peshkuese që nuk përfshihen në paragrafët 67 "e", 68, por të njohura apo të supozuara që kanë peshkuar për tonin në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe. Sekretariati i ICCAT-it e përcjell pa vonesë këtë informacion te CPC-të, për veprim sipas rastit, si dhe një kopje për informacion CPC-ve të tjera.

Operacionet e përbashkëta të peshkimit

70. Çdo operacion i përbashkët i peshkimit për tonin e kuq autorizohet vetëm me pëlqimin e CPC-ve në fjalë. Do të autorizohet, çdo anije për peshkim me rrethim, e pajisur për të peshkuar tonin e kuq, që ka një kuotë individuale të shpërndarë, dhe për të vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në 71 dhe 73. Kuota e alokuar për një operacion të përbashkët peshkimi (JFO), do të jetë e barabartë me totalin e të gjitha

kuotave të ndara për çdo anije me rrethim që marrin pjesë në këtë JFO. Për më tepër, kohëzgjatja e JFO-së nuk do të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e sezonit të peshkimit për anijet me rrethim, siç referohet në paragrafin 28 të këtij rekomandimi.

71. Në momentin e aplikimit për autorizim, duke ndjekur formatin e aneksit 5, çdo CPC duhet të marrë masat e nevojshme për të marrë nga anijet e tij me rrethim që marrin pjesë në një operacionin të përbashkët peshkimi, informacionin e mëposhtëm:

- periudhën e autorizimit të JFO-së;
- identitetin e operatorëve të përfshirë;
- kuotat individuale të anijeve;
- çelësin ndarës të kuotave ndërmjet anijeve të përfshira në zënie; dhe
- informacion mbi fermat e destinuara ku shkon peshku.

Çdo CPC transmeton gjithë informacionin e përmendur më lart në Sekretariatin e ICCAT-it të paktën pesë ditë para fillimit të sezonit të peshkimit me rrethim siç përcaktohet në paragrafin 28.

Në rastet e ndonjë force madhore, afati i përcaktuar në këtë paragraf nuk zbatohen në lidhje me informacionin mbi fermat ku shkon peshku. Në raste të tilla, CPC-të i sigurojnë Sekretariatit të ICCAT-it një përditësim të këtij informacioni sa më shpejt që të jetë e mundur, së bashku me një përshkrim të ngjarjeve që përbëjnë forcë madhore. Sekretariati përpilon informacionin e përmendur në këtë paragraf, të siguruar nga CPC-ja, për shqyrtim nga Komiteti i Përputhshmërisë.

72. Komisioni krijon dhe mban një regjistër të ICCAT-it për të gjitha operacionet e përbashkëta të peshkimit të autorizuara nga CPC-të në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe.

73. Nuk do të lejohen JFO mes anijeve të peshkimit me rrethim të CPC-ve të ndryshme. Megjithatë, një CPC me më pak se pesë anije të autorizuara të peshkimit me rrethim mund të autorizojë operacionet e përbashkëta të peshkimit me çdo CPC tjetër. Çdo CPC që kryen një JFO do të jetë përgjegjës dhe i përgjegjshëm për zëniet e bëra sipas këtij JFO-je.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

Seksioni B
Zëniet dhe transferimet

Kërkesat e regjistrimit

74. Kapitenët e anijeve të peshkimit duhet të mbajnë një libër zënie në formë ditari (*logbook*) ose *logbook*-u elektronik për operacionet e tyre të peshkimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në seksionin A, të shtojcës 2.

75. Kapitenët e anijeve tërheqëse, ndihmëse dhe përpunuese do të regjistrojnë aktivitetet e tyre në përputhje me kërkesat e përcaktuara në seksionet B, C dhe D të shtojcës 2.

Raportet e zënieve të dërguara nga kapitenët e anijeve dhe operatorët e kurtheve

76. Çdo CPC do të sigurojë që anijet e tij, që peshkojnë në mënyre aktive për ton, gjatë të gjithë periudhës për të cilën ato janë autorizuar të peshkojnë tonin, do të komunikojnë në formë elektronike ose çdo mënyrë tjetër efektive informacione ditore nga *logbook*-et, duke përfshirë datën, kohën, vendin (gjerësi dhe gjatësi gjeografike) peshën dhe numrin e tonit të zënë në zonën e mbuluar nga ky plan, përfshirë edhe lëshimet dhe hedhurinat e peshkut të ngordhur nën minimumin e madhësisë së lejuar, referuar në paragrafin 33. Kapitenët do të dërgojnë këtë informacion me formatin e përcaktuar në aneksin 2, ose përmes kërkesave raportuese të CPC-ve.

77. Kapitenët e anijeve të peshkimit me rrethim duhet të përgatisin raporte sipas paragrafit 76 mbi operacionet e peshkimit, duke përfshirë edhe operacionet ku zëniet janë zero. Raportet do të transmetohet nga operatori te autoriteti CPC i vendit të tij, deri në orën 9:00 (GMT) të ditës tjetër.

78. Zotëruesit e kurtheve ose autoritetet e tyre përgjegjëse për peshkimin e tonit duhet të dërgojnë raport ditor mbi zëniet ditore në format elektronik, në të cilin do të përfshijnë numrin e regjistrit ICCAT, datën, kohën, zëniet (pesha dhe numri i peshkut), duke përfshirë edhe ato ku peshkimi është zero. Ata do të dërgojnë këtë informacion CPC-ve të tyre, brenda 48 orësh në formë elektronike sipas formatit të përcaktuar në aneksin 2 për gjatë të gjithë periudhës që ato janë të autorizuar për të peshkuar tonin.

79. Përveç anijeve të peshkimit me rrethim dhe kurtheve të zënies së tonit, kapitenët e anijeve të tjera, transmetojnë pranë autoriteteve të tyre të kontrollit raportet e përmendura në paragrafin 76, së paku deri në mesditën e së martës për javën e mëparshme që përfundon të dielën.

Portet e caktuara

80. Çdo CPC, të cilit i është alokuar një kuotë e tonit, do të përcaktojë portet në të cilat operacioni i zbarkimit apo i transbordimit të tonit është i autorizuar. Kjo listë do të komunikohet çdo vit në Sekretariatin e ICCAT-it si pjesë e planit vjetor të peshkimit të komunikuar nga çdo CPC. Çdo ndryshim do t'i komunikohet Sekretariatit të ICCAT-it. CPC-të e tjera mund të caktojnë portet në të cilat autorizohet zbarkimi ose transbordimi i tonit dhe të komunikojnë këtë listë të këtyre porteve te Sekretariati i ICCAT-it.

81. Për një port që të përcaktohet si port i caktuar, shteti portual do të sigurojë që kërkesat e mëposhtme të plotësohen:

a) përcaktimin e kohës së zbarkimit dhe transbordimit;

b) përcaktimin e vendit të zbarkimit dhe transbordimit;

c) vendosjen e procedurave të inspektimit dhe të mbikëqyrjes që sigurojnë mbikëqyrje e inspektim gjatë të gjithë kohës dhe në të gjitha vendet e zbarkimit dhe transbordimit në përputhje me paragrafin 85.

82. Ndalohet të zbarkohet ose transbordohet nga anijet e peshkimit, si dhe nga anijet përpunuese dhe anijet ndihmëse, çdo sasi toni të peshkuar në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe, në çdo vend tjetër përveç se porteve të përcaktuara nga CPC-të, në përputhje me paragrafët 80 deri 81. Megjithatë, përjashtimisht, transportimi i tonit të ngordhur të zënë në kurth/kosh, duke përdorur një anije ndihmëse për në anijet e përpunimit, nuk është i ndaluar.

83. Në bazë të informacionit të marrë nga CPC-të sipas paragrafit 80, Sekretariati i ICCAT-it do të mbajë një listë të porteve të përcaktuara në *website*-in e ICCAT-it.

84. Dispozitat e këtij rekomandimi nuk do të ndikojnë në hyrjen në port të një anijeje peshkimi të CPC-ve, në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, për arsye të forcës madhore ose fatkeqësisë.

Njoftimi paraprak i zbarkimeve

85. Para hyrjes në ndonjë port, kapitenët e anijeve të peshkimit, si dhe të anijeve e përpunuese dhe anijeve ndihmëse ose përfaqësuesit e tyre, duhet të njoftojnë autoritetin përkatës të portit, të paktën 4 orë përpara kohës së parashikuar të mbërritjes, me sa vijon::

a) koha e parashikuar për mbërritje;

b) sasia e vlerësuar e tonit të mbajtur në bord;

c) informacioni mbi zonën gjeografike ku është zënë toni.

Nëse zonat e peshkimit janë më pak se katër orë nga porti ku mbërrihet, sasitë e vlerësuara të tonit të mbajtura në bord mund të modifikohen në çdo kohë përpara arritjes në port.

CPC-të mund të vendosin të zbatojnë këto dispozita vetëm për zënie të barabarta ose më të mëdha se tre peshk ose një ton. Ata duhet të japin këtë informacion në planin e kontrollit të tyre të monitorimit dhe inspektimit të përmendur në paragrafin 12.

Autoriteti i shtetit portual mban një regjistër me të gjitha njoftimet paraprake për vitin në vazhdim.

Të gjitha veprimet e zbarkimit dhe zënieve duhet të kontrollohen nga autoritetet përkatës të kontrollit dhe një përqindje e tyre duhet të inspektohet, bazuar në sistemin e vlerësimit të riskut, duke përfshirë kuotën, përmasat e flotës dhe sforcon e peshkimit. Detaje të plota të këtij sistemi kontrollesh të përshtatura nga çdo CPC, duke përfshirë përqindjen e synuar të zbarkimeve që do të inspektohen, duhet të jenë të detajuara në planin e tyre vjetor të inspektimit referuar paragrafit 12 të këtij rekomandimi.

Pas çdo udhëtimi, kapitenët e anijeve të peshkimit, duhet të dorëzojnë brenda 48 orëve një deklaratë zbarkimi tek autoritetet kompetente të CPC-ve ku bëhet ky zbarkim, si dhe shtetit të tij flamur. Kapiteni i anijes së peshkimit të autorizuar është përgjegjës për plotësimin dhe vërtetësinë e deklaratës, e cila duhet të tregojë së paku, sasinë e tonit të zbarkuar dhe zonën ku është zënë. Të gjitha zëniet e zbarkuara duhet të peshohen dhe jo vetëm të vlerësohen. Autoritetet përkatëse do të dërgojnë një regjistrim mbi zëniet në autoritetin përkatës të CPC-ve të anijes së peshkimit, brenda 48 orëve nga përfundimi i zbarkimit.

Raportimi i zënieve nga CPC-ja te Sekretariati i ICCAT-it

86. CPC-të do të dërgojnë raporte dyjavore të zënies për çdo formë e mjet peshkimi, pa vonesë, në Sekretariatin e ICCAT-it, për të siguruar që afati i publikimit të të dhënave të specifikuara më poshtë mund të përmbushet. Në rastin e anijeve me koshilok dhe kurtheve, raportet do të jenë siç përcaktohen në paragrafët 76 deri në 78. Zëniet totale të raportuara do të publikohen nga Sekretariati i ICCAT-it në faqen e internetit të ICCAT-it një zonë të mbrojtur me fjalëkalim, gjatë javës së dytë të çdo muaji.

87. CPC-të do t'i raportojë Sekretariatit të ICCAT-it datën kur e gjithë kuota e tonit është shfrytëzuar. Sekretariati i ICCAT-it duhet t'ia shpërndajë këtë informacion të gjitha CPC-ve.

Verifikimi

88. CPC-të duhet të verifikojnë, si raportet e inspektimit dhe raportet e vëzhguesit, të dhënat e VMS-ve, ku është e mundur të dhënat eBCD, si dhe dorëzimin në kohë të *logbook*-eve dhe informacionin e kërkuar të shënuar në *logbook*-et e anijeve të peshkimit, në dokumentet e transferimit/ transbordimit dhe në dokumentet e zënieve.

Autoritetet kompetente do të kryejnë kontrolle të kryqëzuara sipas specieve në të gjitha zbarkimet, transbordimet, transferimet dhe vendosjes në kosha midis sasive të regjistruara në *logbook*-un e anijeve të peshkimit ose në deklaratën e transbordimit dhe sasive të regjistruara në deklaratën e zbarkimit ose deklaratën e koshave, dhe çdo dokumentacion tjetër përkatës, të tilla si fatura dhe/ose shënime shitjeje.

Transbordimi

89. Operacionet e transbordimit të tonit në Atlantikun Lindor dhe Detin Mesdhe do të lejohen vetëm në portet e caktuara sipas përcaktimeve dhe kushtëzimeve në paragrafët 70 deri 74.

90. Para hyrjes në ndonjë port, anija e peshkimit marrëse (që ka marrë peshkun), ose përfaqësuesi i saj, duhet t'i japë autoritetit përkatës të shtetit portual, të paktën 72 orë përpara kohës së parashikuar të mbërritjes, informacionin e shënuar në shtojcën 3, sipas ligjit kombëtar të shtetit portual. Çdo transbordim kërkon autorizimin paraprak nga CPC-të e anijes së peshkimit transborduese. Për më tepër, kapiteni i anijes së peshkimit transborduese, në kohën e transbordimit, informon CPC-në e tij sipas të dhënave të kërkuara në shtojcën 3.

91. Autoriteti përkatës i shtetit portual duhet të inspektojë anijen marrëse në mbërritje dhe do të kontrollojë ngarkesën dhe dokumentacionin që lidhet me operacionin e transbordimit.

92. Kapitenët e anijeve të peshkimit plotësojnë dhe transmetojnë te CPC-ja e tyre deklaratën e transbordimit jo më vonë se 15 ditë pas datës së transbordimit në port sipas rekomandimit 21-08. Kapitenët e anijeve të peshkimit transborduese plotësojnë deklaratën e transbordimit të ICCAT-it në përputhje me formatin e përcaktuar në shtojcën 3. Deklarata e transbordimit duhet të jetë e lidhur me eBCD për të lehtësuar verifikimin e të dhënave të përmbajtura në to.

93. Organi kompetent i shtetit portual do të dërgojë të dhëna të transbordimit autoritetit të CPC-ve të anijeve të peshkimit transborduese, brenda 5 ditëve pasi transbordimi ka përfunduar.

94. Të gjitha transbordimet do të inspektohen nga autoritetet përkatëse të portit të caktuar nga CPC-të.

PJESA IV
MASAT KONTROLLUESE

Seksioni C
Programet e vëzhguesve

Programi vëzhguesit (mbikëqyrësit) i CPC-ve

95. Çdo CPC siguron mbulimin nga vëzhguesit, për të cilët lëshohet një dokument zyrtar identifikimi, për anijet dhe kurthet aktive në peshkimin e tonit, për të paktën:

- 20% të anijeve aktive me peshkim fundor pelagjik (mbi 15 m);
- 20% të anijeve aktive me linjë grepash (mbi 15 m);
- 20% të anijeve aktive me grepa lundrues (mbi 15 m);
- 100% të anijeve tërheqëse (rimorkiator);
- 100% të operacioneve të zënies me kurthe.

96. CPC-të me më pak se pesë anije sipas tre segmenteve të para të mësipërme, të autorizuara për të peshkuar në mënyrë aktive tonin, duhet të sigurojnë mbulimin me vëzhgues në 20% të kohës që këto anije janë aktive në peshkimin e tonit.

97. Në zbatimin e programit të vëzhguesve, CPC-të duhet të sigurojnë që:

a) mbulimi në kohë dhe hapësirë është përfaqësues për të siguruar që komisioni të marrë të dhëna dhe informacione të përshtatshme dhe të sakta për zëniet, përpjekjet për zënie (sforco) dhe aspekte të tjera shkencore dhe menaxheriale të lidhura me tonin, duke marrë parasysh karakteristikat e flotës dhe peshkimit;

b) janë zbatuar protokolle të fuqishme për mbledhjen e të dhënave;

c) vëzhguesit të CPC-ve i sigurohet, përpara fillimit të vendosjes së tij/saj në anije, një listë e kontakteve brenda autoritetit kompetent të CPC-ve ku duhet të raportojë vëzhgimet;

d) çdo vëzhgues CPC është trajnuar dhe kualifikuar siç duhet përpara dislokimit;

e) për aq sa është praktike, operimet e anijeve dhe kurtheve në fjalë pësojnë ndërprerje minimale;

f) kapiteni i anijes së peshkimit ose operatori i kurthit i lejon vëzhguesit të CPC-ve aksesin në mjetet elektronike të komunikimit në bordin e anijes së peshkimit ose në kurth.

98. Të dhënat dhe informacioni i mbledhur në secilin prej programeve të vëzhgimit nga CPC-të do t'i dërgohen SCRS-së dhe komisionit, në përputhje me kërkesat dhe procedurat që do të hartohen nga komisioni gjatë vitit 2023 duke marrë parasysh kërkesat e konfidencialitetit nga ana e CPC-ve.

99. Për aspektin shkencor të këtij programi, SCRS-ja do të raportojë për nivelin e mbulimit të arritur nga çdo CPC, dhe do të sigurojë një përmbledhje të të dhënave të mbledhura dhe çdo rezultat të rëndësishëm të lidhur me këto të dhëna. SCRS-ja do të japë çdo rekomandim që lidhet me përmirësimin e efikasitetit të programit të vëzhgimit të CPC-ve.

100. Detyrimet, përgjegjësitë dhe detyrat e zbatueshme për vëzhguesit e CPC-ve janë të detajuara në aneksin 6.

Programi Rajonal i Vëzhguesve të ICCAT-it (ROP)

101. Programi Rajonal i Vëzhguesve të ICCAT-it, referuar në aneksin 6, do të zbatohet për të siguruar mbulimin 100% me vëzhgues:

- të të gjithë anijeve me rrethim të tonit;
- gjatë të gjitha transferimeve të tonit nga koshiloku i anijes në koshat transportues;
- gjatë të gjitha transferimeve të tonit nga kurthet në koshat transportues;
- gjatë të gjitha transferimeve nga një kosh ferme në kosha transporti, të cilat më pas tërhiqen në një fermë tjetër;
- gjatë të gjitha kalimeve të tonit në ferma;
- gjatë të gjithë vjeljes së tonit nga fermat; dhe
- gjatë lëshimit të tonit nga fermat.

Pavarësisht nga sa më sipër, kur, për arsye të forcës madhore (p.sh., pandemia) të njoftuara siç duhet në ICCAT, vendosja e një vëzhguesi rajonal nuk është i mundur, anija, kurthi ose ferma mund të funksionojnë pa vëzhguesin. Në raste të tilla, CPC-të do t'i japin përparësi këtyre anijeve, fermave dhe kurtheve për kontroll dhe inspektim.

Përveç kësaj, CPC-të do të zbatojnë një sërë masash alternative të përshtatshme që synojnë arritjen e objektivave të programit të vëzhguesit rajonal, duke përfshirë, aty ku është e mundur, vendosjen e një inspektori kombëtar ose një vëzhguesi kombëtar për të vepruar në vend të vëzhguesit rajonal. CPC-ja në fjalë do t'i dërgojë Sekretariatit të gjitha detajet e masave alternative. Sekretariati përpilon dhe i qarkullon komisionit të gjithë informacionin e marrë për zbatimin e këtyre procedurave. Këto masa alternative dhe veprimet e ndërmarra do të shqyrtohen nga Komiteti i Pajtueshmërisë gjatë çdo takimi vjetor.

102. Si përjashtim i paragrafit 101, vjelja nga fermat deri në 1000 kg në ditë dhe deri në maksimum 50 tonë në fermë në vit për furnizimin e tregut me peshk të freskët mund të autorizohet nga CPC-ja përkatëse me kusht që një inspektor i autorizuar nga CPC-të e fermës është në vend për 100% të vjeljeve të tilla dhe kontrollon të gjithë funksionimin. Inspektori i autorizuar do të vërtetojë gjithashtu sasitë e vjela në sistemin eBCD. Në këtë rast, nënshkrimi i vëzhguesit rajonal nuk duhet të kërkohet në seksionin e vjeljes së eBCD-ve. Ky derogim do të rishikohet, sipas rastit, nga PWG, ndoshta përmes Grupit të Punës të IMM-së, jo më vonë se në vitin 2023.

103. Anijet e peshkimit me rrethim pa një vëzhgues rajonal të ICCAT-it në bord, nuk do të autorizohen për të peshkuar ose të operojnë në peshkimin e tonit.

104. Një vëzhgues rajonal i ICCAT-it do të caktohet në çdo fermë për të gjithë operacionet në kosha. Në rastet e forcës madhore që janë konfirmuar nga autoriteti CPC i fermës, një

vëzhgues rajonal i ICCAT-it mund të ndahet në më shumë se një fermë për të garantuar vazhdimësinë e operacioneve nëse autorizohet nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës dhe me kusht që autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të kërkojë menjëherë vendosjen e një vëzhguesi rajonal shtesë të ICCAT-it.

105. Me përjashtim të paragrafit 104, në rast transferimi ndërmjet dy fermave të ndryshme nën kompetencën e të njëjtit autoritet kombëtar, mund të caktohet një vëzhgues i vetëm rajonal për të mbuluar të gjithë procesin, duke përfshirë transferimin e peshkut në një kosh transporti tërheqës, tërheqja e peshkut nga ferma dhuruese në fermën marrëse dhe kalimi i peshkut në koshin e fermës marrëse. Në këtë rast, një vëzhgues rajonal duhet të vendoset nga ferma e donatorëve dhe kostoja do të ndahet si nga ferma donatore ashtu edhe nga ajo pritëse, përveç nëse përcaktohet ndryshe nga fermat.

106. Si çështje prioritare, vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it nuk duhet të jenë të së njëjtës kombësi me anijen e zënies, anijen tërheqëse, kurthin ose fermën, për të cilat kërkohen shërbimet e tyre. Përveç kësaj dhe për aq sa është e mundur, Sekretariati i ICCAT-it dhe ofruesi përgjegjës për ROP do të sigurojnë që vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it të dislokuar të kenë njohuri të kënaqshme të gjuhës së anijeve, fermës apo kurtheve të CPC-së së caktuar. Nëse nuk është e mundur të gjenden vëzhgues të huaj me aftësitë e duhura gjuhësore ose në rast të forcës madhore, mund të lejohet vendosja e vëzhguesve rajonalë të ICCAT-it të së njëjtës kombësi, me kusht që njoftimi paraprak për Sekretariatin e ICCAT-it të bëhet nga ofruesi përgjegjës për ROP.

107. Detyrimet, përgjegjësitë dhe detyrat e zbatueshme për Vëzhguesin Rajonal të ICCAT-it dhe kurthit dhe fermës CPC përkatëse, janë të detajuara në shtojcën 6.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

Seksioni D
Transferimet e peshkut të gjallë

Dispozita e përgjithshme

108. Ky seksion zbatohet për të gjitha transferimet e përcaktuara në paragrafin 3.i, të këtij rekomandimi.

109. Në përputhje me paragrafin 12 "c" të këtij rekomandimi, çdo CPC do të emërojë një autoritet të vetëm kompetent, në vijim të referuar si "autoriteti kompetent i CPC-ve", i cili do të jetë përgjegjës për koordinimin e mbledhjes dhe verifikimit të informacionit për kontrollin e transferimeve dhe transporteve përkatëse të tonit të kryera nën juridiksionin e tij, dhe për raportimin dhe bashkëpunimin me CPC-të, në fermat e të cilave do të vendoset peshku në kosh.

110. Kapitenët e anijeve të zënies dhe tërheqëse që kryejnë operacione transferimi duhet të raportojnë aktivitetet e tyre të transferimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aneksin 2 (*logbook*).

Numri unik i caktuar për kosh

111. Të gjithë koshave të përdorur në operacionet e transferimit dhe transportet shoqëruese do t'i vendoset një numër, në përputhje me sistemin unik të numërimit të përmendur në paragrafët 147 deri në 150.

Njoftimi paraprak i transferimit

112. Përpara fillimit të një operacioni transferimi, duke përfshirë transferimet vullnetare, kapiteni i anijes së peshkimit ose rimorkiatorit apo përfaqësuesit e tyre ose përfaqësuesit e fermës apo kurthit, ku nis transferimi në fjalë, duhet t'i dërgojë autoritetit të tij kompetent të CPC-ve një njoftim paraprak transferimi, duke treguar, aty ku është e aplikueshme:

- numrin dhe peshën e vlerësuar të tonit që do të transferohet;
- emrin e anijes që e ka peshkuar, anijeve tërheqëse, fermës ose kurthit, dhe numrin përkatës të tyre në regjistrin e ICCAT-it;
- datën dhe vendndodhjen e kapjes;
- datën dhe kohën e parashikuar të transferimit;
- pozicionin e vlerësuar (gjerësia/gjatësia) ku do të bëhet transferimi dhe numrat e koshit të dhuruesit dhe marrësit;

- fermën ku do të shkojë;
- emrin dhe numrin ICCAT të fermës dhuruese, në rastin e një transferimi nga koshi i fermës në një kosh transporti;
- numrat e dy koshave të fermës dhe çdo koshi transporti të përfshirë, në rastin e transferimeve brenda fermës.

Autorizimi i transferimit

113. Brenda 48 orëve pas dorëzimit të njoftimit paraprak të transferimit nga operatori dhurues, autoriteti kompetent i CPC-ve do t'i caktojë dhe komunikojë operatorit donator në fjalë një numër të autorizimit të transferimit për çdo operacion transferimi. Numri i autorizimit të transferimit duhet të përfshijë kodin me tri shkronja CPC, katër numra për vitin dhe tri shkronja për të treguar autorizimin pozitiv (AUT) ose negativ (NEG), të ndjekur nga numrat vijues.

114. Operacioni i transferimit në fjalë nuk do të fillojë përpara se numri i tij specifik i autorizimit të transferimit t'i jetë caktuar dhe komunikuar operatorit dhurues.

115. Autorizimi i transferimit nuk paragjykon konfirmimin e ndonjë operacioni të mëvonshëm transferimi ose kalimi në kosha.

116. Transferimet vullnetare dhe ato të kontrollit nuk i nënshtrohen një autorizimi të ri transferimi.

Refuzimi i një operacioni transferimi dhe rrjedhimisht lirimi i tonit

117. Një operacion transferimi nuk do të autorizohet nga autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues nëse, pas marrjes së njoftimit paraprak të transferimit, ai konsideron se:

a) anija peshkimit ose kurthi që deklaron se ka kapur peshkun nuk ka një autorizim të vlefshëm për peshkimin e tonit, të lëshuar në përputhje me paragrafin 56 të këtij rekomandimi;

b) numri dhe pesha e peshkut që i nënshtrohet transferimit nuk është raportuar siç duhet nga anija e peshkimit ose kurthi;

c) anija e peshkimit ose kurthi që ka kapur peshkun nuk ka kuotë të mjaftueshme;

d) anija tërheqëse e deklaruar për të transferuar dhe/ose transportuar peshkun nuk është e regjistruar në Regjistrin e ICCAT-it si anije të tjera të peshkimit të përmendura në paragrafin 48 (b), ose nuk është e pajisur me një sistem monitorimi të anijeve (VMS) plotësisht funksional;

e) ferma ku do të shkojë toni, nuk raportohet si aktive në Regjistrin e fermave të ICCAT-it të përmendur në paragrafin 61 të këtij rekomandimi.

118. Në rast refuzimi, autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues:

a) të informojë menjëherë operatorin dhurues për refuzimin, si dhe organin kompetent të CPC-ve për anijen e peshkimit, kurthin ose fermën, nëse është një CPC tjetër;

b) kur është e zbatueshme, të lëshojë një urdhër për lirimin e peshkut në fjalë në det, në përputhje me shtojcën 10.

Monitorimi i operacioneve të transferimit me videokamera

119. Përveç transferimeve të koshave ndërmjet dy anijeve tërheqëse, të cilat nuk përfshijnë lëvizjen e tonit të gjallë ndërmjet këtyre koshave, operatori dhurues duhet të sigurojë që operacioni i transferimit të monitorohet me videokamerë në ujë, në përputhje me standardet minimale dhe procedurat e referuara në shtojcën 8, për të përcaktuar numrin e individëve të tonit që transferohen.

120. Çdo CPC do të marrë masat e nevojshme për të siguruar që kopjet identike të regjistrimeve përkatëse video të jepen (ofrohen) pa vonesë nga operatori dhurues:

a) për operacionin e parë të transferimit dhe transferimin vullnetar eventual, te vëzhguesi rajonal i ICCAT-it dhe te anija tërheqëse marrëse dhe, në fund të udhëtimit të peshkimit, te autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues;

b) për transferime të mëtejshme, te vëzhguesi i CPC-ve në bordin e anijes tërheqëse dhuruese, te kapiteni i anijes tërheqëse marrëse dhe, në fund të udhëtimit të tërheqjes, te autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes tërheqëse dhuruese;

c) për transferimet ndërmjet dy fermave të ndryshme, te vëzhguesi rajonal i ICCAT-it, te mjeti tërheqës marrës dhe te autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës dhuruese; dhe

d) nëse një autoritet inspektues kombëtar ose i ICCAT-it është i pranishëm gjatë operacionit të transferimit, inspektori(ët) do të marrin gjithashtu një kopje të regjistrimit përkatës të videos.

121. Pamjet video në fjalë do të shoqërojnë peshkun deri në fermën ku do të dërgohet peshku. Një kopje do të ruhet në bordin e anijes(ve) donatore, nga kurthi(at) ose nga ferma(et) dhe do

të mbetet e aksesueshme për qëllime kontrolli në çdo kohë gjatë fushatës së peshkimit.

122. Kopjet e videoregjistrimeve do t'i jepen SCRS-së sipas kërkesës nga autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues. SCRS-ja do të ruajë konfidencialitetin e aktiviteteve tregtare.

123. Autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues dhe operatori dhurues do t'i ruajnë pamjet video në lidhje me transferimet për të paktën 3 vjet dhe do t'i ruajnë ato për aq kohë sa është e nevojshme për qëllime kontrolli dhe zbatimi.

Transferimet vullnetare dhe të kontrollit

124. Nëse filmimi video nuk plotëson standardet minimale të përmendura në shtojcën 8, dhe veçanërisht nëse cilësia dhe qartësia e tij nuk janë të mjaftueshme për të përcaktuar numrin e peshqve që transferohen, operatori dhurues mund të kryejë transferimin(et) vullnetar(e).

125. Nëse nuk është kryer asnjë transferim(e) vullnetar(e), ose nëse transferimi(et) vullnetar(e) ende nuk lejon përcaktimin e numrit të peshqve që transferohen, autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues do të urdhërojë një transferim kontrolli, i cili do të përsëritet derisa cilësia e regjistrimit video të lejojë vlerësimin e numrit të tonit që transferohet.

126. Transferimi(et) vullnetar dhe/ose kontrolli(et) do të kryhet në një kosh tjetër i cili duhet të jetë bosh. Numri i peshqve të marrë nga transferimi i vlefshëm vullnetar ose i kontrollit do të përdoret për të plotësuar *logbook*-un, Deklaratën e Transferimit të ICCAT-it (ITD) dhe seksionet përkatëse të eBCD-ve.

127. Ndarja e koshit të transportit nga një anije me koshilok, një kurth ose një kosh ferme nuk duhet të ndodhë përpara se vëzhguesi rajonal i ICCAT-it në bordin e anijes, ose i pranishëm në fermë ose kurth, të ketë kryer detyrat e tij.

128. Megjithatë, nëse pas transferimit(ve) vullnetar(e) cilësia e videos nuk lejon përcaktimin e numrit të individëve që transferohen, autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues mund të lejojë ndarjen e anijes me koshilok, kurthit ose koshit të fermës nga koshi(at) e transportit. Në një rast të tillë, autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues do të urdhërojë që dera(dyert) e koshit(eve) të transportit në fjalë, të vulosen në përputhje me procedurën e përcaktuar në shtojcën 14 dhe të kërkojë një transferim kontrolli që të kryhet në një kohë dhe vend të caktuar, në prani të autoritetit kompetent të anijes, kurthit ose fermës.

129. Në rast se autoritetet kompetente të anijes, kurthit ose fermës nuk mund të jenë të pranishme në transferimin e kontrollit, transferimi i kontrollit do të bëhet në prani të një vëzhguesi rajonal të ICCAT-it. Në këtë rast, përgjegjësia për vendosjen e vëzhguesit rajonal do të jetë mbi operatorin e fermës që zotëron tonin e transportuar, i cili duhet të sigurojë që vëzhguesi rajonal të vendoset për të verifikuar transferimin e kontrollit.

Deklarata e transferimit të ICCAT-it (ITD)

130. Në fund të një operacioni transferimi, operatori dhurues duhet të plotësojë një ITD, në përputhje me formatin e përcaktuar në shtojcën 4. Operatori dhurues do t'ia transmetojë ose vërë në dispozicion pa vonesë, ITD-në, autoritetit të tij kompetent të CPC-ve, Vëzhguesit Rajonal të ICCAT-it ku prania e tij është e detyrueshme dhe, sipas rastit, kapitenit të anijes tërheqëse ose fermës që merr peshkun.

131. Autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues do të sigurojë që formulari ITD të jetë i numëruar, duke përdorur kodin CPC me tri shkronja, i ndjekur nga katër numrat që tregojnë vitin dhe tre numrat vijues, të ndjekur nga tri shkronjat ITD (CPC- 20**/xxx/ITD).

132. Origjinali i ITD-së duhet të shoqërojë peshkun e transferuar deri në fermën(at) e destinacionit ku peshku do të vendoset në kosh:

a) në transferimin e parë, origjinali i ITD-së do të kopjohet nga operatori dhurues kur një zënie e vetme transferohet nga koshiloku i anijes ose kurthi në më shumë se një kosh transporti;

b) në rastin e një transferimi të mëtejshëm, kapiteni i anijes tërheqëse dhuruese do të përditësojë ITD-në duke plotësuar pjesën 3 (transferime të mëtejshme) dhe do t'i japë ITD-në e përditësuar anijes tërheqëse marrëse.

133. Një kopje e ITD-së do të mbahet në bordin e anijeve të peshkimit ose tërheqëse të dhuruesit, ose nga kurthi apo ferma e dhuruesit dhe të jetë e aksesueshme në çdo kohë për qëllime kontrolli gjatë kohëzgjatjes së fushatës së peshkimit.

Hetimi nga autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues

134. Autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues do të hetojë të gjitha rastet kur:

a) ka më shumë se 10% diferencë midis numrit të peshkut të raportuar në ITD nga operatori dhurues dhe numrit të peshqve të vlerësuar nga vëzhguesi rajonal i ICCAT-it, ose nga vëzhguesi kombëtar i CPC-ve, sipas rastit; ose

b) kur vëzhguesi rajonal i ICCAT-it nuk ka nënshkruar ITD-në.

Marzhi i gabimit prej 10% i përmendur më sipër do të shprehet si përqindje e shifrave të operatorit dhurues.

135. Kur është e aplikueshme, hetimi do të përfshijë analizën e të gjitha pamjeve përkatëse të videos. Me përjashtim të rasteve të forcës madhore, hetimi do të përfundojë brenda 96 orëve nga fillimi i tij, dhe në çdo rast para mbërritjes së koshit të transportit në fermën e destinacionit.

136. Në fillimin e një hetimi, autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues do të informojë autoritetin kompetent të CPC-ve të anijes(ve) tërheqëse në lidhje me hetimin dhe siguron që, deri në përfundimin e hetimit, të mos lejohet asnjë transferim nga ose në koshin e transportit në fjalë.

137. Për të gjitha operacionet e transferimit ku kërkohet një video, një diferencë e barabartë me ose më e madhe se 10%, midis numrit të tonit të raportuar nga operatori dhurues në ITD dhe numrit të përcaktuar nga autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues në vijim të një hetimi, do të përbëjë një mospërputhje të mundshme (PNC) të anijes së peshkimit, kurthit ose fermës në fjalë.

Ndryshimet në ITD dhe eBCD pas inspektimeve në det ose hetimeve

138. Nëse pas një inspektimi në det ose një hetimi, rezulton se numri i peshqve është më shumë se 10% nga ai i deklaruar në ITD dhe eBCD, eBCD-ja do të ndryshohet nga autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues për të reflektuar rezultatin e hetimit.

Peshqit që ngordhin gjatë operacioneve të transferimit dhe transportit

139. Numri i peshqve që ngordhin gjatë një operacioni transferimi, ose gjatë transportit të peshkut në fermën e destinacionit, raportohet nga operatori dhurues në përputhje me procedurat dhe modelin e përcaktuar në shtojcën 11.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

Seksioni E
Kultivimi në kosha

Dispozitat e përgjithshme

140. Çdo CPC që ka ferma do të emërojë një autoritet të vetëm kompetent, në vijim i referuar si "autoriteti kompetent i CPC-ve për fermën". Ky autoritet do të jetë përgjegjës për koordinimin e mbledhjes dhe verifikimit të informacionit mbi aktivitetet kombëtare të kultivimit në kosha, për kontrollin e aktiviteteve të fermave të kryera nën juridiksionin e tij dhe për raportimin dhe bashkëpunimin me autoritetet kompetente të CPC-ve, anijet me flamur të të cilave ose kurthi i tij, peshkuan tonin e futur në kosha.

141. Kur fermat ndodhen përtej ujërave nën juridiksionin e një CPC-je, dispozitat e këtij seksioni do të zbatohen, *mutatis mutandis*, për CPC-të ku ndodhen personat fizikë ose juridikë përgjegjës për fermën.

142. Të gjitha aktivitetet e fermës do t'i nënshtrohen kontrollit të përshkruar në planin e monitorimit, kontrollit dhe inspektimit të paraqitur sipas paragrafit 12 të këtij rekomandimi.

143. Të gjitha CPC-të e përfshira në aktivitetet e lidhura me kultivimin do të shkëmbejnë informacion dhe do të bashkëpunojnë për të siguruar që numri dhe pesha e tonit të destinuar për futjen në koshat e rritjes janë të sakta, në përputhje me sasitë e kapjes, të raportuara nga anija me koshilok ose nga kurthi dhe të deklaruara në seksionet përkatëse të eBCD-ve.

144. CPC-të me ferma inkurajohen të shkëmbejnë përvojën dhe praktikat më të mira mbi kontrollin dhe inspektimin, në lidhje me aktivitetet e kultivimit, duke përdorur programin pilot për shkëmbimin vullnetar të personelit inspektues sipas rec. ICCAT 19-17.

145. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të sigurojë që operatorët e fermave të mbajnë në çdo kohë një plan të saktë skematik të fermave të tyre, duke treguar numrin unik të të gjithë koshave dhe pozicionin e tyre individual në fermë. Plani duhet t'i vihet në dispozicion në çdo kohë autoritetit kompetent të CPC-ve të fermës për qëllime kontrolli. Çdo modifikim në planin skematik i nënshtrohet njoftimit paraprak të

autoritetit kompetent të CPC-ve të fermës. Plani skematik i fermës do të përshtatet sa herë që ndryshohet numri dhe/ose shpërndarja e koshave të fermës.

146. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës dhe operatori i fermës do të ruajnë të gjithë informacionin, dokumentacionin dhe materialin, në lidhje me aktivitetet e kryera në fermat nën juridiksionin e tij për të paktën 3 vjet, dhe do ta ruajnë informacionin për aq kohë sa është e nevojshme për qëllime të zbatimit.

Numri unik i caktuar për koshat

147. Përpara fillimit të fushatës së peshkimit të tonit, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të caktojë një numër unik dhe të identifikueshëm për çdo kosh të fermës nën juridiksionin e tij, duke përfshirë edhe ato kosha të përdorura për transportimin e peshkut në fermë.

148. Çdo kosh duhet të identifikohet me një sistem unik numërimi që përfshin të paktën tri shkronjat e kodit CPC, të ndjekura nga tre numra. Numrat unik të koshit duhet të stampohen ose të pikturohen në dy anët e kundërta të unazës së koshit dhe mbi vijën e ujit, në një ngjyrë në kontrast me sfondin në të cilin janë pikturuar ose stampuar, dhe duhet të jenë të dukshëm dhe të lexueshëm në çdo kohë për qëllimet e kontrollit.

149. Lartësia e shkronjave dhe e numrave duhet të jetë së paku 20 centimetra me trashësi vije të paktën 4 centimetra.

150. Lejohen metoda alternative për të shënuar numrin unik në kosh, me kusht që të ofrojnë të njëjtën garanci për dukshmëri, lexueshmëri dhe paprekshmëri.

Autorizimi për vendosjen në kosha

151. Çdo operacion vendosjeje në kosha i nënshtrohet një autorizimi për vendosjen në kosha të lëshuar nga autoriteti kompetent i CPC-ve ku ndodhet ferma.

Procedurat e mëposhtme duhet të zbatohen kur:

a) operatori i fermës kërkon autorizimin për vendosjen në kosha tek autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës, duke specifikuar në veçanti numrin dhe peshën (siç përmendet në ITD) të peshqve që do të vendosen në kosha. Kjo kërkesë shoqërohet nga:

i. ITD-të përkatëse;

ii. referenca e eBCD(eve) në fjalë, siç konfirmohet dhe vërtetohet nga autoriteti kompetent CPC të anijes ose të kurthit;

iii. të gjitha raportet mbi peshqit që ngordhin gjatë transportit, të regjistruara në përputhje me shtojcën 11.

b) autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës i njofton informacionin sipas nënparagrafit "a" autoritetit kompetent CPC të anijes ose të kurthit, dhe kërkon konfirmimin që operacioni 'Vendosje në kosha' të autorizohet;

c) brenda 3 ditëve pune, autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes ose të kurthit njoftojnë autoritetin kompetent të CPC-ve të fermës se operacioni i vendosjes në kosha autorizohet ose refuzohet. Në rast refuzimi, autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes ose të kurthit duhet të specifikojë arsyen(et) për refuzimin, dhe refuzimi do të përfshijë urdhrin e lëshimit pasues;

d) autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës lëshon autorizimin 'Vendosje në kosha' menjëherë pas marrjes së konfirmimit nga autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes ose të kurthit. Operacioni 'Vendosje në kosha' nuk do të autorizohet nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës në mungesë të konfirmimit.

152. Asnjë operacion vendosjeje në kosha nuk do të autorizohet nëse dokumentacioni i plotë i kërkuar sipas paragrafit 151 "a" nuk e shoqëron peshkun që i nënshtrohet autorizimit "Vendosje në kosha'.

153. Në pritje të rezultateve të hetimit të përmendur në paragrafët 134 deri 137 të kryera nga autoriteti kompetent i CPC-së së anijes ose të kurthit, Operacioni 'Vendosje në kosha' nuk do të autorizohet dhe seksionet përkatës të zënies dhe tregtisë së gjallë në eBCD nuk do të vërtetohen.

154. Nëse autorizimi 'Vendosje në kosha' nuk është lëshuar nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës brenda 1 muaji pas kërkesës për autorizim të vendosjes në kosha nga operatori i fermës, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të urdhërojë dhe do të vazhdojë me lëshimin e të gjithë peshqve që gjenden në koshin e transportit në fjalë, në përputhje me shtojcën 10. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të informojë, në përputhje me rrethanat, pa vonesë, autoritetin kompetent të CPC-ve të anijes ose të kurthit në fjalë, dhe Sekretariatin ICCAT për lëshimet.

Refuzimi i autorizimi për 'Vendosjen në kosha' nga CPC-të e anijes ose të kurthit

155. Nëse, pas marrjes së informacionit të përmendur në paragrafin 151 (a) autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes ose të kurthit konsideron se:

a) anija zënëse ose kurthi i deklaruar që ka zënë peshkun kishte kuotë të pamjaftueshme për të zënë tonin që do të futet në kosha;

b) peshku që do të vendoset në kosha nuk është raportuar siç duhet nga anija ose kurthi dhe nuk është marrë parasysh për llogaritjen e çdo kuotë që mund të jetë e zbatueshme;

c) anija zënëse ose kurthi i deklaruar se ka zënë peshkun nuk ka një autorizim të vlefshëm për të peshkuar ton, i lëshuar në përputhje me paragrafin 56 të këtij rekomandimi;

ai do të përcaktojë numrin e peshqve për të cilët refuzohet vendosja në kosha dhe do t'i kërkojë pa vonesë autoritetit kompetent të CPC-ve të fermës të vazhdojë me sekuestrimin e peshqve në fjalë dhe t'i lirojë menjëherë në det, në përputhje me shtojcën 10.

Operacioni i 'Vendosjes në kosha'

156. Në momentin e mbërritjes së anijes tërheqëse në afërsi të fermës, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të sigurojë që:

a) anija tërheqëse në fjalë mbahet në një distancë prej të paktën 1 milje detare nga çdo objekt i fermës derisa autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës të jetë fizikisht i pranishëm; dhe

b) pozicioni dhe aktiviteti i anijes tërheqëse përkatëse monitorohet gjatë të gjithë kohës.

157. Asnjë operacion 'Vendosje në kosha' nuk do të fillojë:

a) përpara se të jetë autorizuar siç duhet nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës;

b) pa praninë e autoritetit kompetent të CPC-ve të fermës dhe vëzhguesit rajonal të ICCAT-it;

c) përpara se seksionet e zënies dhe të tregtisë së gjallë të eBCD-ve të plotësohet dhe vërtetohet nga autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes ose të kurthit.

158. Ankorimi i koshave të transportit si kosha ferme, pa lëvizje të peshkut për të lejuar regjistrimin me kamerën stereoskopike është i ndaluar.

159. Pas transferimit të tonit nga koshi i tërheqjes në koshin e fermës, autoriteti i kontrollit të CPC-ve të fermës duhet të sigurojë që koshat e fermave që përmbajnë ton janë të mbyllura gjatë të gjithë kohës. Zhvulosja do të jetë e mundur vetëm në prani të autoritetit kompetent të CPC-ve të fermës dhe pas autorizimit të tij. Autoriteti i kontrollit të CPC-ve të fermës do të krijojë protokolle për vulosjen e koshave të fermave, duke siguruar përdorimin e vula zyrtare dhe se këto vula vendosen në mënyrë të tillë që të pengojnë hapjen e dyerve pa thyerjen e vulave.

160. CPC-të e fermave duhet të sigurojnë që zëniet e tonit vendosen në kosha të veçantë, ose seri koshash, dhe të ndara në bazë të CPC-ve të anijes së peshkimit dhe vitit të kapjes. Me përjashtim, nëse toni është zënë në kontekstin e një operacioni të përbashkët peshkimi (JFO), zëniet në fjalë do të vendosen në kosha të veçanta ose seri koshash dhe të ndara në bazë të JFO-ve dhe vitit të zënies.

161. Të gjitha operacionet e mbylljes do të përfundojnë përpara datës 22 gusht të çdo viti, përveç rasteve kur CPC-të e fermës së peshkut ofron arsye të vlefshme, duke përfshirë forcën madhore. Këto arsye duhet të dokumentohen dhe raportohen në raportin e vendosjes në kosha, të përmendur në paragrafin 186. Në çdo rast, asnjë ton nuk do të vendoset në kosha pas 7 shtatorit. Afatet e mësipërme nuk zbatohen në rastin e transferimeve ndërmjet fermave.

Regjistrimi i operacioneve të vendosjes në kosha nga kamerat e kontrollit

162. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të sigurojë që çdo operacion i grumbullimit të tonit në fermat e tij është regjistruar nga operatori i fermës duke përdorur kamera konvencionale dhe stereoskopike. Të gjitha pamjet video duhet të jetë në përputhje me standardet minimale të përcaktuara në shtojcën 8, me përjashtim të pikës 1 "d" për pamjet e kamerave stereoskopike.

163. Nëse cilësia e xhirimeve video të kamerës së kontrollit përdoret për të përcaktuar numrin dhe/ose peshën e tonit të mbyllur në kosha nuk përputhet me standardet minimale të aneksit 8, autoriteti kompetent për CPC-të e fermës do të urdhërojë një kontroll të koshit derisa të jetë i mundur përcaktimi i numrit dhe/ose peshës. Përsëritja e operacionit të vendosjes në kosha nuk i nënshtrohet një autorizimi të ri të për vendosjen në kosha.

164. Në rastin e kontrollit të koshit, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të sigurojë që koshi i fermës dhuruese është i mbyllur dhe se

koshi nuk mund të manipulohet përpara operacionit të ri të vendosjes në kosha. Koshat e fermës marrëse që përdoren për kontrollin e koshit duhet të jenë bosh.

165. Në përfundim të operacionit të vendosjes në kosha, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të sigurojë që Vëzhguesi Rajonal i ICCAT-it ka akses të menjëhershëm në të gjitha videot dhe pamjet nga kamerat stereoskopike dhe konvencionale, dhe lejohet të bëjë një kopje nëse synon të përfundojë detyrën e tij për të analizuar pamjet në një kohë apo vend tjetër.

166. CPC-të me ferma aktive të tonit dhe SCRS-ja inkurajohen të marrin pjesë në prova duke përdorur Inteligjencën Artificiale (AI) për analizën e pamjeve stereoskopike të kamerave, me qëllim automatizimin e përcaktimit të numrit dhe/ose peshës së tonit të mbyllur në kosha, në mënyrë që të reduktohet ngarkesa e punës dhe të shmanget paragjykimi i mundshëm njerëzor.

Ngordhjet e peshkut gjate vendosjes në kosha

167. I gjithë toni që ngordh gjatë operacionit të vendosjes në kosha duhet të raportohet nga operatori i fermës, në përputhje me rrethanat, procedurat dhe formatin e përcaktuar në shtojcën 11.

Deklarata e vendosjes në kosha

168. Çdo autoritet kompetent i CPC-ve të fermës do të sigurojë që, për çdo operacion të vendosjes në kosha, operatori i fermës paraqet një deklaratë të vendosjes në kosha brenda 1 jave pasi është kryer operacioni aktual i vendosjes në kosha, duke përdorur formularin e përcaktuar në shtojcën 12.

Analiza e pamjeve video stereoskopike nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës

169. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të përcaktojë numrin dhe peshën e tonit që do të vendoset në kosha, duke analizuar pamjet video të çdo operacioni 'Vendosje në kosha' të ofruar nga operatori i fermës. Për të kryer këtë analizë, autoritetet do të ndjekin procedurat e përcaktuara në pikën 1, të shtojcës 9.

170. Kur ka një diferencë prej më shumë se 10% ndërmjet numrit dhe/ose peshës së përcaktuar nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës dhe shifrat përkatëse të raportuara në deklaratën e vendosjes në kosha, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të nisë një hetim për të identifikuar arsyet për ketë mospërputhje, dhe bën rregullimin eventual të numrit dhe/ose peshës së peshkut që ka qenë i mbyllur në kosha.

171. Marzhi i gabimit prej 10% i përmendur më sipër do të shprehet si përqindje e shifrave të operatorit të fermës.

Komunikimi i rezultateve të vendosjes në kosha CPC të anijes zënëse ose të kurthit

172. Pas përfundimit të një operacioni të vendosjes në kosha ose, në rastin e një JFO-je ose kurtheve të të njëjtit shtet anëtar të CPC/BE, të operacionit të fundit të vendosjes në kosha të lidhur me atë JFO ose ato kurthe, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do t'i dërgojë autoritetit kompetent të CPC-ve të anijes ose kurthit, rezultatet e operacioneve të vendosjes në kosha përmendura në shtojcën 9, pika 2, nën "a" dhe "b".

173. Çdo autoritet kompetent i CPC-ve të fermës do të dorëzojë procedurat dhe rezultatet në lidhje me programin e kamerës stereoskopike (ose metodat alternative) në SCRS deri më 31 tetor çdo vit. SCRS-ja duhet të vlerësojë procedurat dhe rezultatet e tilla dhe t'i raportojë komisionit në mbledhjen e ardhshme vjetore.

Investigimet e ndërmarra nga CPC-të e anijes zënëse ose të kurthit

174. Kur, për një operacion të vetëm zënie, numri i tonit që vendoset në kosh, siç komunikohet nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës, në përputhje me paragrafin 172, ndryshon me 10% ose më shumë nga ato të raportuar në ITD ose në seksionin zënie dhe/ose transferuar te eBCD-të, autoriteti kompetente i CPC-ve të anijes zënëse ose të kurthit do të fillojë një hetim për të përcaktuar peshën e saktë të zënies që do të zbritet nga kuota kombëtare e tonit, në përputhje me paragrafët 180 deri 182 (përvetësimi i kuotave).

175. Në mbështetje të këtij hetimi, autoriteti kompetente i CPC-ve të anijes zënëse ose të kurthit do të kërkojë të gjithë informacionet plotësuese dhe rezultatet e analizës përkatëse të pamjeve video të kryera në përputhje me këtë rekomandim nga autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes zënëse dhe fermave që kanë qenë përfshirë në transportin dhe operacionin e vendosjes në kosha.

176. Të gjitha autoritetet kompetente të CPC-ve, përfshirë ato anijet e të cilëve janë përfshirë në transportin e peshku, do të bashkëpunojnë në mënyrë aktive, duke përfshirë shkëmbimin e të

gjithë informacionit dhe dokumentacionit në dispozicion të tyre.

177. Autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes zënëse ose të kurthit do të përfundojë hetimin brenda 1 muaji nga komunikimi i rezultateve të vendosjes në kosha nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës.

178. Një ndryshim i barabartë ose më i madh se 10% midis numrit të tonit të raportuar të zënë nga anija ose kurthi në fjalë dhe numrit të përcaktuar nga autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes zënëse ose të kurthit si rezultat i hetimit, do të përbëjë një mospërputhje të mundshme (PNC) të anijes ose kurthi në fjalë.

179. Marzhi i gabimit prej 10% i përmendur më sipër do të shprehet si përqindje e shifrave të raportuara nga kapiteni i anijes së peshkimit ose përfaqësuesi i kurthit dhe do të zbatohet në nivel individual të operacionit të 'Vendosjes në kosha'.

Marrja e kuotave

180. Autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes zënëse ose të kurthit do të përcaktojë peshën e tonit që zbritet nga kuota e tij kombëtare duke marrë parasysh sasitë e vendosura në kosha, të llogaritura në përputhje me dispozitat e shtojcës 9, i cili siguron që pesha në kosha të llogaritet bazuar në raportin e gjatësi/peshë për peshqit e egër dhe vdekshmëritë e raportuara, në përputhje me dispozitat e shtojcës 11.

181. Megjithatë, për ato raste kur hetimi i përmendur në paragrafin 174 arrin në përfundimin se individët e tonit mungonin në kuptimin e paragrafit 2, të shtojcës 11, pesha e peshkut të munguar do të zbritet nga kuota kombëtare në përputhje me shtojcën 11, duke aplikuar pesha mesatare individuale në kosha të komunikuar nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës, tek numri i tonit në peshkim siç përcaktohet nga autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes zënëse ose të kurthit që rezulton nga analiza e tij e filmimeve të transferimit të parë në kuadër të hetimit.

182. Pavarësisht nga paragrafi 181, pas konsultimit me autoritetin(et) kompetent të CPC-ve të përfshira në transportin e peshkut deri në fermën e destinacionit, CPC-të e anijes zënëse ose të kurthit mund të vendosin të mos e zbresin nga kuota kombëtare peshkun e përcaktuar në hetim nëse ka qenë humbur, kur humbjet janë dokumentuar siç duhet si "forcë madhore" nga operatori (d.m.th., fotografitë e koshit të dëmtuar, raportet meteorologjike), i është komunikuar informacioni përkatës autoritetit kompetent të CPC-ve menjëherë pas ngjarjes dhe humbjet nuk kanë rezultuar në vdekshmëritë e ditura.

Lëshimet e lidhura me operacionet e vendosjes në kosha

183. Përcaktimi i peshkut që lirohet do të bëhet në përputhje me dispozitat e shtojcës 9, paragrafi 4.

184. Nëse pesha e tonit që futet në kosha është më e madhe se sa ishte deklaruar si i kapur dhe/ose të transferuara, autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes zënëse ose të kurthit do të lëshojë një urdhër lirimi dhe t'i a komunikojë atë pa vonesë autoritetit kompetent të CPC-ve të fermës në fjalë. Urdhri i lirimit do të ndjekë dispozitat e shtojcës 9, paragrafi 4, duke marrë parasysh kompensimin e mundshëm në nivel JFO-je ose kurthi, në përputhje me shtojcën 9, paragrafi 5.

185. Operacioni i lëshimit do të kryhet në përputhje me protokollin e përcaktuar në shtojcën 10.

Raportimi i vendosjes në kosha

186. Brenda 15 ditëve pas përfundimit të urdhrave për lirim, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të lëshojë një raport për vendosjen në kosha për çdo operacion të vetëm të vendosjes në kosha, ose në rastin e një JFO-je ose kurthe të së njëjtës CPC/BE, për grupin e plotë të operacioneve të vendosjes në kosha në lidhje me atë JFO ose ato kurthe. Raporti i vendosjes në kosha duhet të përfshijë informacionin e përmendur në aneksin 9, paragrafi 3, dhe t'i komunikohet autoritetit kompetent të CPC-ve të anijes zënëse ose të kurthit dhe Sekretariatit të ICCAT-it.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

Sektori F
Vjelja

187. Anijet përpunuese që synojnë të operojnë në ferma ose kurthe duhet të dërgojnë një njoftim paraprak në fermë ose autoritetet kompetente të CPC-ve të paktën 48 orë para mbërritjes së anijes në fermë/apo kurth. Njoftimi paraprak duhet të përfshijë të paktën datën dhe kohën e parashikuar të mbërritjes dhe informacionin nëse anija e përpunimit ka tashmë ton në bord dhe, nëse po, të

jepen detaje mbi ngarkesën, duke përfshirë sasitë në peshën e përpunuar dhe peshën e gjallë dhe detajet e origjinës së tonit në bord (fermë/kurth dhe CPC).

188. Çdo operacion vjeljeje në ferma ose kurthe do t'i nënshtrohet një autorizimi nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës ose kurthit. Për këtë qëllim, ferma ose operatori i kurthit që synon të vjelë tonin duhet t'i paraqesë autoritetit kompetent të CPC-ve një kërkesë, e cila duhet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- datën ose periudhën e vjeljes;
- sasitë e parashikuara që do të vilen në numër individësh dhe kg;
- numrin eBCD të lidhur me tonin që do të vilet;
- detajet e anijeve ndihmëse të përfshira në operacion;
- destinacionin e tonit të vjelë (anija përpunuese, eksporti, tregu lokal, etj.)

189. Përveç individëve të tonit që janë afër ngordhjes, nuk do të kryhet asnjë operacion vjeljeje i paautorizuar përpara se rezultatet e marrjes së kuotës, në përputhje me paragrafët 180 deri në 182, të përcaktohen dhe janë kryer lëshimet shoqëruese.

190. Operacionet e vjeljes nuk do të zhvillohen pa praninë e një vëzhguesi të CPC-ve në rastin e kurtheve, ose një vëzhguesi rajonal të ICCAT-it në rastin e vjeljes në ferma. Për peshqit e dorëzuar në anije përpunuese, CPC-të ose vëzhguesit rajonal të ICCAT-it mund të kryejnë detyrat e tyre përkatëse në anijen përpunuese.

191. Autoritetet e kontrollit të CPC-ve të fermave ose kurtheve duhet të verifikojnë dhe kontrollojnë rezultatet e të gjitha vjeljeve që zhvillohen në ferma dhe kurthe nën autoritetin e saj, duke përdorur të gjithë informacionin përkatës. Autoritetet e kontrollit të CPC-ve të fermave ose kurtheve do të inspektojnë të gjitha operacionet e vjeljes së tonit të destinuara për anije përpunimi dhe një përqindje e pjesës tjetër të operacioneve të vjeljes bazohet në analizën e rrezikut.

192. Kur destinacioni i tonit është një anije përpunimi, zotëruesi ose përfaqësuesi i tij duhet të plotësojë një deklaratë përpunimi. Kur toni i vjelë do të jetë i zbarkuar direkt në port, ferma ose operatori i kurthit duhet të plotësojë një deklaratë vjeljeje. Deklaratat e përpunimit dhe të vjeljes do të vërtetohen nga vëzhguesi rajonal i ICCAT-it ose CPC-ve, i pranishëm në operacionin e vjeljes.

193. Deklarata e përpunimit dhe të vjeljes duhet të përmbajnë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- datën e vjeljes;
- fermën ose kurthin;
- numri(at) e koshit;
- numrin e individëve të vjelë;
- peshën e gjallë dhe peshën e përpunuar në kg të tonit të vjelë;
- numri(at) eBCD të lidhur me tonin e vjelë;
- detajet e anijeve ndihmëse të përfshira në operacion;
- destinacionin e tonit të vjelë (d.m.th., eksporti, tregu vendas, apo të tjera);
- vërtetimin nga vëzhguesi rajonal i ICCAT-it ose vëzhguesi i CPC-ve, sipas rastit.

194. Deklaratat e përpunimit dhe të vjeljes do t'i dërgohen me *email* autoriteteve kompetente të CPC-ve të fermës brenda 48 orëve nga operacioni i vjeljes.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

Sektori F
Kontrolli pas vendosjes në ferma

Transferimi brenda fermës

195. Transferimi brenda fermës nuk do të bëhet pa autorizimin dhe praninë e autoritetit kompetent t[CPC-ve të fermës. Çdo transferim do të regjistrohet nga kamerat e kontrollit për të konfirmuar numrin e transferuar të individëve të tonit. Pamjet video duhet të jenë në përputhje me standardet minimale të përcaktuara në shtojcën 8. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të monitorojë dhe kontrollojë transferimet, duke siguruar që çdo transferim brenda fermës të regjistrohet në sistemin eBCD.

196. Pavarësisht nga përkufizimi i vendosjes në kosha në paragrafin 3(s), zhvendosja e tonit midis dy vendndodhjeve të ndryshme në të njëjtën fermë (transferim brenda fermës) duke përdorur një kosh transporti, nuk do të konsiderohet si 'Vendosje në kosha' për qëllimet e kërkesave të përcaktuara në seksionin E.

197. Gjatë transferimeve brenda fermës, rigrupimi i peshqve sipas origjinës dhe të njëjtit JFO, mund të bëhet i autorizuar nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës, duke siguruar

gjurmueshmërinë, siç përcaktohet në paragrafi 5 të rekomandimit 18-13, dhe zbatueshmëria e normave të rritjes së SCRS-së ruhet.

198. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës dhe operatori i fermës do të ruajnë pamjet video nga transferimet brenda fermës të ndërmarra në fermat nën juridiksionin e tyre për një minimum prej 3 vjetësh dhe të mbajnë informacion për aq kohë sa është e nevojshme për qëllime të zbatimit.

Sasia e mbetur (tepricë e mbartur)

199. Përpara fillimit të sezonit të ardhshëm të peshkimit me koshilok dhe kurth, Autoriteti i CPC-ve të fermave kompetente do të vlerësojë tërësisht tonin e gjallë të mbartur (mbetur) në fermat nën juridiksionin e saj. Për këtë qëllim, toni i gjallë në fjalë do të transferohet në një kosh bosh dhe monitorohet duke përdorur kamera(at) e kontrollit për të përcaktuar numrin dhe peshën e peshkut të transferuar.

200. Si përjashtim, mbartja e tonit nga vitet dhe koshat ku nuk ka pasur vjelje do të kontrollohet çdo vit duke zbatuar procedurën e kontrollit të rastësishëm të përmendur në paragrafët 207 deri në 214.

201. Toni i gjallë i mbartur do të vendoset në kosha të veçantë ose seri koshash në fermë, në bazën e vitit të zënies dhe JFO/të njëjtin kurth sipas CPC-ve të origjinës.

202. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të sigurojë që pamjet video të kamerës së kontrollit për vlerësimin e transferimeve të mbartura janë në përputhje me kërkesat përkatëse të shtojcës 8 dhe përcaktimi i numrit dhe peshës së peshkut të bartur është në përputhje me shtojcën 9, pika 1, të këtij rekomandimi.

203. Derisa SCRS-ja të zhvillojë një algoritëm për të kthyer gjatësinë në peshë për peshqit e fermës dhe/ose të kultivuar, përcaktimi i peshës së peshkut të transportuar do të vlerësohet duke përdorur rritjen në tabelat më të përditësuara të prodhuara nga SCRS-ja.

204. Një ndryshim sipas numrit të individëve të tonit ndërmjet numrit që rezulton nga vlerësimi i mbartjes dhe numrit të pritur pas vjeljes do të hetohen siç duhet nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës dhe i regjistruar në sistemin eBCD. Në rastin e sasisë së tepërt, Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të urdhërojë lirimin e numrit përkatës të peshqve. Operacioni i lirimit do të kryhet në përputhje me shtojcën 10. Kompensimi për diferencat ndërmjet koshave në fermë nuk do të lejohen. Një marzh gabimi deri në 5% ndërmjet numrit të individët që rezultojnë nga vlerësimi i mbartjes dhe numri i pritshëm në kosha, mund të lejohet nga autoriteti kompetent i CPC-ve. Kjo përqindje do të rishikohet, sipas rastit, nga IMM-ja më së voni deri në vitin 2023. Komisioni do të shqyrtojë rishikimin e përqindjes bazuar në rekomandim nga IMM-ja.

205. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të mbajë pamjet video dhe të gjithë dokumentacionin përkatës nga vlerësimet e mbartjes të kryera në fermat nën juridiksionin e tyre për të paktën 3 vjet, dhe ruan këtë informacion për aq kohë sa është e nevojshme për qëllime të zbatueshmërisë.

Deklaratë e sasisë së mbartur (*Carry-over declaration*)

206. CPC-të e fermave do të plotësojnë dhe transmetojnë, si një aneks i planit të rishikuar të menaxhimit të veprimtarive në fermë, një deklaratën vjetore të mbartjes në Sekretariatin e ICCAT-it brenda 15 ditëve pas përfundimit të operacionit të vlerësimit. Një deklaratë e tillë përfshin:

a) Flamurin CPC;

b) Emrin dhe numrin ICCAT të fermës;

c) Vitin e zënies;

d) Referencat e eBCD-ve që korrespondojnë me zëniet e mbartura;

e) Numrat e koshave;

f) Sasitë (të shprehura në kg) dhe numrin e peshkut të transportuar;

g) Peshën mesatare;

h) Informacion për secilin prej operacioneve të vlerësimit të mbartjes: datën dhe numrat e koshit;

i) Informacion mbi transferimet e mëparshme brenda fermës, kur është e aplikueshme.

Raporti i kamerës stereoskopike, kur është e aplikueshme, i bashkëngjitet deklaratës së mbartjes.

Kontrollet rastësore

207. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të kryejë kontrolle të rastësishme në fermat nën juridiksionin e tyre. Kontrollet e rastësishme do të kryhen në ferma ndërmjet kohës së përfundimit të operacioneve të vendosjes në kosha nga koshi i parë i vitit pasardhës. Këto kontrolle përfshijnë transferimet e detyrueshme të të gjithë peshqve nga koshat e fermës në koshat e tjerë të fermës, në mënyrë që numri i individëve të tonit të mund të

jetë i numëruar me anë të regjistrimit të videove të kontrollit.

208. Çdo CPC e fermës do të vendosë një numër minimal kontrollesh të rastësishme që do të kryhen në secilën fermë nën sovranitetin e saj. Numri i kontrolleve të rastësishme duhet të mbulojë të paktën 10% të numrit të koshave në secilin fermë pas përfundimit të operacioneve të mbylljes, gjithmonë duke përfshirë të paktën një kontroll për fermë dhe të rrumbullakosura lart aty ku duhet. Përzgjedhja e koshave që do të kontrollohen do të bazohet në analizën e rrezikut. Planifikimi për kontrollet e rastësishme që do të kryhen duhet të pasqyrohet në planin e kontrollit të CPC-ve të përmendura në paragrafin 12 të këtij rekomandimi.

209. Edhe pse nuk kërkohet, ferma(t) në fjalë mund të informohen nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës me një njoftim paraprak maksimal prej dy ditësh kalendarike se kontrolli(et) i/e rastësishme do të bëhet. Koshi(at) e përzgjedhur do t'i komunikohen operatorit të fermës vetëm nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës me mbërritjen në fermën përkatëse.

210. Kur jepet njoftim paraprak, operatorët e fermave duhet të sigurojnë që të gjitha mjetet janë në dispozicion për këtë kontroll të rastësishëm që mund të kryhen nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës në çdo kohë dhe në çdo kosh në fermë. Nëse nuk jepet njoftim paraprak, operatorët e fermave duhet të ndërmarrin të gjithë hapat e duhur për të lehtësuar operacionet e kontrollit të rastësishëm.

211. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të përpiqet të zvogëlojë afatin kohor ndërmjet njoftimit për kontroll të rastësishëm dhe kohës kur kryhet operacioni i kontrollit. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të sigurojë që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar që operatori nuk ka mundësi për të manipuluar koshat në fjalë derisa të bëhet kontrolli i rastësishëm.

212. Pas kontrollit të rastësishëm, çdo ndryshim midis numrit të tonit që përcaktohet nga kontrollet e rastësishme dhe numrit që pritet të jetë i pranishëm në kosh do të hetohen siç duhet dhe të regjistrohen në sistemin eBCD. Në rastin e numrit të tepërt, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të urdhërojë lëshimin e numrave përkatës. Operacioni i lëshimit do të kryhet në përputhje me shtojcën 10. Kompensimi për diferencat ndërmjet koshave të ndryshëm në fermë nuk duhet të lejohet. Një marzh gabimi prej 5% midis numrit të individëve që rezulton nga transferimi i kontrollit dhe numri i pritshëm në kosha, mund të lejohet nga autoriteti kompetent i CPC-ve. Kjo përqindje do të rishikohet, sipas rastit, nga IMM-ja më së voni deri në vitin 2023. Komisioni do të konsiderojë rishikimin e përqindjes bazuar në rekomandimin e IMM-së.

213. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të mbajë të gjitha pamjet video nga kontrollet e rastësishme të ndërmarra në fermat nën juridiksionin e tyre për një minimum prej 3 vjetësh dhe ruajë këtë informacion për aq kohë sa është e nevojshme për qëllime të zbatimit.

214. Rezultatet e kontrolleve të rastësishme do t'i komunikohen Sekretariatit të ICCAT-it përpara fillimit të sezonit të ri të peshkimit me koshilok, e zbatueshëm për çdo CPC në përputhje me paragrafin 28, për njoftim në Komitetin e Përputhshmërisë.

Transferimi ndërmjet fermave

215. Transferimi i tonit të gjallë ndërmjet dy fermave të ndryshme nuk do të bëhet pa shkresë paraprake autorizimi nga autoritetet kompetente të CPC-ve të të dyja fermave.

216. Transferimi nga koshat e fermës dhuruese në koshat e transportit duhet të jetë në përputhje me kërkesat e seksioni D (transferimet e peshqve të gjallë), të këtij rekomandimi, duke përfshirë një videoregjistrim për të konfirmuar numrin e individëve ton të transferuar, plotësimin e një ITD-je dhe verifikimin e operacionit nga një Vëzhgues Rajonal i ICCAT-it. Pavarësisht sa më sipër, në rastet kur i gjithë koshi duhet të zhvendoset në fermën marrëse, nuk do të jetë e nevojshme të regjistrohet në video operacioni dhe koshi do të transportohet i vulosur në fermën e destinacionit.

217. Mbajtja e koshave të tonit në fermën e destinacionit do t'i nënshtrohet kërkesave për operacionet e vendosjes në koshat e përcaktuara në paragrafët 156 deri në 171, duke përfshirë një regjistrim video për të konfirmuar numrin dhe peshën e tij në kosha dhe verifikimi i operimit nga një Vëzhgues Rajonal i ICCAT-it. Përcaktimi i peshës për peshqit e mbyllur në kosha nga një fermë tjetër, nuk do të zbatohet derisa SCRS-ja të ketë zhvilluar një algoritëm për të kthyer gjatësinë në peshë për peshqit e rritur dhe/ose të kultivuar.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

Sektori G
Sistemi i Monitorimi të Anijeve (VMS)

218. CPC-të do të zbatojnë një Sistem Monitorimi të Anijeve (VMS) për anijet e tyre të peshkimit me një gjatësi të barabartë ose më shumë se 15 m të përmendura në paragrafin 3 "a" të këtij rekomandimi, në përputhje me rekomandim nga ICCAT-i, në lidhje me standardet minimale për sistemet e monitorimit të anijeve në Zonat e Konventës ICCAT (rec. 18-10), duke përfshirë detyrimin për të transmetuar të paktën një herë në orë për çantë anijeje me koshilok dhe të paktën një herë në dy orë për të gjitha anijet e tjera të peshkimit.

219. Pavarësisht nga sa më sipër, të gjitha anijet tërheqëse të përdorura për transportin e tonit të gjallë, pavarësisht nga gjatësia e tyre, instalojnë dhe përdorin VMS, në përputhje me rec. 18-10 dhe transmetojnë mesazhe të paktën një herë në orë.

220. Transmetimi i të dhënave VMS në Sekretariatin e ICCAT-it nga çdo anije peshkimi e autorizuar që i nënshtrohet VMS-së sipas këtij rekomandimi, do të:

a) të fillojë të paktën 5 ditë përpara dhe të vazhdojë të paktën 5 ditë pas periudhës së autorizimit të tyre, përveç nëse anija hiqet nga listat e anijeve të autorizuara nga autoriteti kompetent i CPC-ve; dhe

b) të mos ndërpritet kur anija është në port, për qëllime kontrolli, përveç rasteve kur ekziston një sistem breshëri brenda dhe jashtë portit.

221. Sekretariati ICCAT do të informojë menjëherë CPC-të e anijes për çdo vonesë ose mos marrje të transmetimit VMS dhe do shpërndajë raporte mujore për të gjitha CPC-të me informacion specifik mbi natyrën dhe shtrirjen e këtyre vonesave. Këto raporte do të dërgohen çdo javë gjatë periudhës 1 maj deri më 30 korrik.

222. Referuar mjeteve tërheqëse gjatë transportit të tonit në një fermë, në rast të një defekti teknike të VMS-së së tij, anija tërheqëse në fjalë do të zëvendësohet nga një anije tjetër tërheqëse me një VMS plotësisht funksionale. Nëse nuk ka asnjë anije tjetër tërheqëse, do të instalohet një sistem i ri operativ VMS-je në bord ose përdoret nëse është instaluar tashmë, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 72 orë, me përjashtim të rastit të forcës madhore, që duhet t'i komunikohet Sekretariatit të ICCAT-it. Ndërkohë, kapiteni ose përfaqësuesi i tij, duke filluar nga momenti kur është zbuluar dhe/ose informuar ngjarja, komunikon me autoritetet e kontrollit të CPC-ve çdo 1 orë duke përditësuar koordinatat e anijes tërheqëse me mjete të përshtatshme telekomunikacioni.

Përdorimi i të dhënave VMS për qëllime kontrolli dhe inspektimi

223. Sekretariati ICCAT do të vërë në dispozicion pa vonesë informacionin e marrë sipas këtij seksioni G për CPC-të me një prani aktive inspektimi në Atlantikun Lindor dhe Mesdhe dhe në SCRS, me kërkesën e saj.

224. Me kërkesë nga CPC-të e angazhuara në operacionet e inspektimit në det në zonën e Konventës, në përputhje me skemën e ICCAT-it të Inspektimit të Përbashkët Ndërkombëtar të përmendur në paragrafët 228 deri 231 të këtij rekomandim, Sekretariati i ICCAT-it duhet të vërë në dispozicion mesazhet e marra nga të gjithë anije e peshkimit sipas *paragrafit 3 të rekomandimit nga ICCAT që ndryshon rekomandimin 07-08, në lidhje me formatin dhe protokollin e shkëmbimit të të dhënave në lidhje me Sistemin e Monitorimit të Anijeve (VMS) për Peshkimin e tonit në zonën e Konventës ICCAT (rec. 21-16).*

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

Sektori H
Zbatimi

Zbatimi

225. CPC-të marrin masat e duhura të zbatimit në lidhje me një anije peshkimi, në përputhje me ligjin e saj, në rastin kur aktiviteti i anijes së tij të peshkimit nuk përputhet me dispozitat e këtij rekomandimi.

Masat duhet të jenë në përpjesëtim me peshën e veprës penale dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të ligjit kombëtar në mënyrë të tillë që të sigurohet që ato i privojnë ato në mënyrë efektive, përgjegjës për përfitimin ekonomik që rrjedh nga cenimi i tyre pa paragjykuar ushtrimin e profesionit të tyre. Këto sanksione do të jenë gjithashtu në gjendje të prodhojnë rezultate proporcionale me

seriozitetin e një shkeljeje të tillë, duke dekurajuar në mënyrë efektive vepra të tjera të të njëjtit lloj.

226. CPC-të e fermës do të marrin masat e duhura të zbatimit në lidhje me një fermë, ku kanë konstatuar, në përputhje me ligjin e saj, se ferma nuk është në përputhje me dispozitat e këtij rekomandimi.

Në varësi të peshës së veprës penale dhe në përputhje me dispozitat përkatëse kombëtare masat e tilla mund të përfshijnë, në veçanti, pezullimin e autorizimit ose tërheqjen nga regjistri i ICCAT-it për objektet e kultivimit të tonit të krijuar në përputhje me paragrafin 61, të rekomandimi 21-08 dhe/ose gjobat.

PJESA IV
MASAT E KONTROLLIT

Sektori I
Masat e tregtimit

Masat e tregtimit

227. Në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre sipas ligjit ndërkombëtar, duke eksportuar dhe importuar CPC-të, do të marrë masat e nevojshme:

- të ndalojnë tregtinë e brendshme, zbarkimin, importet, eksportet, vendosjen në kosha, rieksportet dhe transbordimet e tonit të Atlantikut Lindor dhe Mesdheut që nuk shoqërohen me dokumentacionin e saktë, të plotë dhe të vërtetuar të kërkuar nga ky rekomandim, rekomandimi i ICCAT-it që ndryshon rekomandimin 18-13 duke zëvendësuar rekomandimin 11-20 mbi një program dokumentacioni të ICCAT-it për zënien e tonit (rec. 21-19) dhe rekomandimi nga ICCAT-i duke ndryshuar rec. 20-08, mbi aplikimin e sistemit eBCD (rec. 21-18) mbi Programin e Dokumentimit të zënieve të tonit;

- të ndalojnë tregtinë e brendshme, importet, zbarkimet, vendosjen në kosha, përpunim, eksport, rieksportim dhe transbordimet brenda juridiksionit të tyre, të tonit të Atlantikut Lindor dhe Mesdheut i zënë nga anije peshkimi ose kurthe, CPC-të e të cilëve nuk kane një kuotë ose kufi peshkimi për ato specie, sipas kushteve të masave të menaxhimit dhe ruajtjes së ICCAT-it, ose kur mundësitë e peshkimit të CPC-ve janë shterur, ose kur kuotat individuale të anijeve zënëse të përmendura në paragrafin 4 janë ezauruar;

- për të ndaluar tregtinë e brendshme, importet, zbarkimet, përpunimin dhe eksportet e tonit të Atlantikut Lindor dhe Mesdheut nga fermat që nuk përputhen me dispozitat që lidhen me kultivimin, të specifikuara në këtë rekomandim.

PJESA V
SKEMA E INSPEKTIMIT TË PËRBASHKËT NDËRKOMBËTAR ICCAT

228. Në kuadrin e Planit Shumëvjeçar të Menaxhimit për Tonin, secila Palë Kontraktuese bie dakord, në përputhje me nenin IX, paragrafi 3, të Konventës ICCAT, të zbatojë skemën ICCAT të Inspektimit të Përbashkët Ndërkombëtar të miratuar gjatë takimit të tij të 4-të të rregullt, mbajtur në nëntor 1975 në Madrid, të modifikuar në shtojcën 7.

229. Skema e përmendur në paragrafin 228 do të zbatohet derisa ICCAT-i të miratojë një monitorim, kontroll dhe skemën e mbikëqyrjes e cila do të përfshijë një skemë ICCAT-i për inspektim të përbashkët ndërkombëtar, bazuar në rezultatet e Grupit të Punës për Masat e Integruara të Monitorimit, i krijuar me Rezolutën nga ICCAT-i për Masat e Integruara të Monitorimit (rec. 00-20).

230. Kur në çdo kohë, më shumë se 15 anije peshkimi të njërës Palë Kontraktuese janë të angazhuara në aktivitetin e peshkimit të tonit në Atlantikun Lindor dhe në Mesdhe, zona e Konventës, Pala Kontraktuese në bazë të vlerësimit të rrezikut do të ketë një anije inspektimi në zonën e Konventës, ose do të bashkëpunojnë me një Palë tjetër Kontraktuese për të operuar bashkërisht një anije inspektimi. Nëse një Palë Kontraktuese nuk vendos anijen e saj të inspektimit ose nuk kryen operacione të përbashkëta, Pala Kontraktuese do të raportojë rezultatin e vlerësimit të rrezikut dhe masat e tij alternative në planin e tij të inspektimit të përmendur në paragrafin 12.

231. Në rastet kur duhet të merren masa për forcimin e ligjit si rezultat i një inspektimi, kompetencat e inspektorëve të Palës Kontraktuese të anijes së peshkimit, fermës ose kurthit që i nënshtrohet inspektimit do të mbizotërojnë gjithmonë në territorin e tyre, në ujërat e tyre në juridiksion dhe në inspektimin në bord të tyre.

PJESA VI
DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Disponueshmëria e të dhënave për SCRS-në

232. Sekretariati ICCAT do të vërë në dispozicion të SCRS-së të gjitha të dhënat e marra në përputhje me këtë rekomandim. Të gjitha të dhënat do të trajtohen në mënyrë konfidenciale.

Masat mbrojtëse

233. Kur, si rezultat i një vlerësimi shkencor, qëllimi i ruajtjes së biomasës rreth B0.1 (të jetë e arritur me peshkim në ose më pak se F0.1) nuk arrihet dhe objektivat e këtij plani janë në rrezik, SCRS-ja do të ofrojë këshilla të reja për TAC-të për vitin e ardhshëm.

Klauzola e rishikimit

234. Për herë të parë në vitin 2023 dhe, në çdo rast, pas vlerësimit të stokut të tonit për Atlantikun Lindor dhe Mesdheun që konfirmon rikuperimin e plotë të stokut, komisioni, në vijim të këshillave shkencore të ofruara nga SCRS-ja, do të vendosë për vazhdimësinë e këtij plani menaxhimi ose për një rishikim të mundshëm të tij.

235. Pavarësisht nga paragrafi 234, ICCAT-i do të mbajë një mbledhje ndërsesionale të panelit 2 çdo vit, në mars, me qëllim që:

a) të rishikojë, dhe nëse është e përshtatshme, të miratojë planet vjetore të peshkimit, menaxhimin e kapaciteteve të peshkimit, kultivimin dhe planet e inspektimit të dërguara në ICCAT sipas paragrafit 12 të këtij rekomandimi;

b) të diskutojë çdo dyshim të mundshëm në lidhje me interpretimin e këtij rekomandimi dhe, sipas rastit, propozon projektamendamentet e tij për shqyrtim në mbledhjen vjetore.

Vlerësimi

236. Të gjitha CPC-të, me kërkesë të Sekretariatit të ICCAT-it duhet të paraqesin, rregulloret dhe dokumentet e tjera të ndërlidhura të miratuara prej tyre për zbatimin e këtij rekomandimi. Për të pasur një transparencë më të madhe në zbatimin e këtij rekomandimi, Sekretariati i ICCAT-it do të përpunojë çdo dy vjet një raport mbi zbatimin e këtij rekomandimi.

Përjashtimet për CPC-të për detyrimin e zbarkimit të tonit

237. Dispozitat në këtë rekomandim që ndalojnë mbajtjen në bord, transbordimin, transferimin, zbarkimin, transportin, ruajtjen, shitjen, ekspozimin ose ofrimin për shitje të tonit nuk zbatohen për CPC-të me një legjislacion vendas të prezantuar përpara vitit 2013, që kërkon që të gjithë peshqit e ngordhur të zbarkohen, me kusht që vlera e këtij peshku të konfiskohet për të mos lejuar që peshkatarët të tërheqin ndonjë fitim tregtar nga peshq të tillë. CPC-të përkatëse do të marrin masat e nevojshme për të parandaluar që peshku i konfiskuar të eksportohet në CPC të tjera. Sasitë e tonit që tejkalojnë kuotën e alokuar për CPC-të, në përputhje me këtë përjashtim, do të zbriten vitin e ardhshëm nga kuota CPC në përputhje me paragrafin 10.

Periudha kalimtare për zbatimin e vulosjes së koshave të tonit

238. Për zbatimin e masave lidhur me vulosjen e koshave të peshkut të tonit të përcaktuara në paragrafët 128, 159, 164, 216, aneksi 4, aneksi 6 dhe aneksi 14, një periudhë kalimtare deri në vitin 2023, mund t'u jepet atyre CPC-ve që tregojnë në planet e tyre të peshkimit një nevojë të tillë për të siguruar siç duhet zbatimin e masave. Një vlerësim i zbatimit të kësaj mase gjatë sezonit të peshkimit 2022 do të kryhet nga CPC-të e prekura, me synimin për të diskutuar mbi zbatimin dhe rishikimin ose përditësimin e mundshëm, në Takimin Ndërsektorial të Panelit 2 të marsit 2023 dhe, nëse bie dakord nga komisioni, takimi i 15-të i Grupit të Punës të IMM-së në 2023-shin.

Shfuqizimet

239. Ky rekomandim:

- shfuqizon dhe zëvendëson rekomandimin e ICCAT-it që ndryshon rekomandimin 18-02 që përcakton një plan shumëvjeçar menaxhimi për tonin në Atlantikun Lindor dhe në Mesdhe (rec. 19-04);
- shfuqizon rekomandimin e ICCAT-it për kultivimin e tonit (rec. 06-07);
- shfuqizon paragrafët 5, 7 dhe 8, të rekomandimit të ICCAT-it, duke zëvendësuar rekomandimin 11-20 mbi një program dokumentacioni ICCAT për zënien e tonit (rec. 18-13);
- shfuqizon rekomandimin e ICCAT-it që ndryshon rekomandimin 19-04 për krijimin e një plani menaxhimi shumëvjeçar për tonin në Atlantikun Lindor dhe Mesdheun (rec. 20-07).

SHTOJCË 1
KUSHTET SPECIFIKE QË APLIKOHEN PËR ANIJET E PESHKIMIT TË PARASHIKUARA NË PARAGRAFIN 34

1. CPC-të duhet të kufizojnë:

- Numrin maksimal të barkave me grepa (*baitboat* dhe *trolling boat*) të autorizuara për të peshkuar në mënyrë aktive tonin me numrin e anijeve që kanë marrë pjesë në peshkimin direkt për tonin gjatë vitit 2006;

- Numrin maksimal të anijeve të saj të peshkimit artizanal të autorizuar për të peshkuar në mënyrë aktive tonin në Mesdhe me numrin e anijeve që kanë marrë pjesë në peshkimin e tonit në 2008-n;

- Numrin maksimal të anijeve të peshkimit të autorizuara për të peshkuar në mënyrë aktive tonin në Detin Adriatik me numrin e anijeve që kanë marrë pjesë në peshkimin e tonit gjatë vitit 2008. Çdo CPC do t'i alokojë kuota individuale anijeve në fjalë.

CPC-të do të lëshojnë autorizime specifike për anijet e cilësuara në paragrafin 1 të kësaj shtojce. Këto anije duhet të tregohen në listën e anijeve të peshkimit të treguar në paragrafin 48(a) të këtij rekomandimi, atëherë kur zbatohen kushtet për ndryshim.

2. Çdo CPC do të alokojë jo më shumë se 7% të kuotave të saj për tonin për barkat me grepa (*baitboat* dhe *trolling* boat).

3. Çdo CPC mund të alokojë jo më shumë se 2% të kuotave të saj për tonin për peshkimin artizanal bregdetar të peshkut të gjallë në Mesdhe.

Çdo CPC mund të alokojë jo më shumë se 90% të kuotave të saj për anijet peshkuese në Adriatik për qëllime kultivimi.

4. CPC-të, anijet me grepa, linje grepash, grepa dore dhe grepa tërheqës të të cilave janë të autorizuara të peshkojnë tonin në Atlantikun Lindor dhe në Detin Mesdhe duhet të përcaktojnë kërkesat për shënjimin e bishtit si më poshtë:

a) shënjimi i bishtit duhet të fiksohet në çdo ton të peshkuar menjëherë pas nxjerrjesh nga uji;

b) çdo shenjë e bishtit duhet të ketë një numër unik identifikimi që duhet të përfshihet në dokumentin e zënies dhe të shkruar lexueshëm në pjesën e jashtme të çdo paketimi që përmban ton.

SHTOJCË 2
KËRKESAT E *LOGBOOK*-ut

A – Anijet e peshkimit

Specifikimet minimale për librin e anijes

1. Libri i anijes duhet t'i ketë faqet e numëruara;

2. Libri i anijes duhet të plotësohet çdo ditë (mesnatë) ose përpara mbërritjes në port;

3. Libri i anijes duhet të plotësohet në rastet e inspektimit në det;

4. Njëra nga kopjet e faqeve duhet të mbetet e ngjitur në librin e anijes;

5. Libri i anijes duhet të mbahet në bord në mënyrë që të mbulojë aktivitetin e kryer gjatë një viti.

Informacionet minimale standarde në librin e anijes

1. Emri dhe adresa e kapitenit;

2. Data dhe porti i nisjes, data dhe porti i mbërritjes;

3. Emri i anijes, numri i regjistrit, numri i ICCAT-it, sinjali i thirrjes ndërkombëtare në radio dhe numri IMO (nëse ka).

4. Veglat e peshkimit:

a) lloji i kodit sipas FAOs;

b) madhësia (gjatësia, madhësia e syzeve, numri i grepave...).

5. Aktiviteti në det me një rresht (minimumi) për ditë peshkimi, duke dhënë:

a) aktivitetin (peshkim, lundrim...);

b) pozicionin: pozicioni ekzakt ditor (në gradë dhe minuta), regjistruar për çdo aktivitet peshkimi ose në mesditë kur nuk ka pasur peshkim gjatë ditës;

c) regjistrimin e zënieve që përfshin:

i. kodin e FAOs;

ii. peshën e rrumbullakosur (RWT) në kilogram për ditë;

iii. numrin e individëve për ditë.

Për anijet e peshkimit me rrethim (koshilok) kjo duhet të regjistrohet për çdo operacion peshkimi duke përfshirë edhe kthimet bosh.

6. Sigla e kapitenit.

7. Mënyra e matjes së peshës: vlerësim, peshimi në bord, numërimi.

8. Libri i anijes mbahet në peshë të gjallë ekuivalente peshku dhe përmendet faktori i konversionit të përdorur në vlerësim.

Minimumi i informacionit në librin e anijes në rast zbarkimi ose transbordimi

1. Data dhe porti i zbarkimit, transbordimit / transferimit.

2. Produkti:

a) speciet dhe paraqitja sipas kodit FAOs;

b) numri i individëve apo i kutive dhe sasia në kilogram.

3. Sigla e kapitenit apo e agjentit të anijes.

4. Në rastin e një transbordimi, emrin e anijes marrëse, flamurin e saj dhe numrin ICCAT.

Minimumi i informacionit për librin e anijes në rastin e transferimit në kosha:

1. Date, koha dhe vendi (gjatësi dhe gjerësi gjeografike) i transferimit.

2. Produktet:

a) speciet e identifikuara sipas kodit FAO;

b) numri i peshqve dhe sasia në kg e transferuar në kosha;

3. Emri i anijes transportuese, flamuri i saj dhe numri ICCAT.

4. Emri i fermës ku shkon dhe numri i saj ICCAT.

5. Në rast të Operacioneve të Përbashkëta të Peshkimit (JFO) si shtesë e informacionit të dhënë në pikat 1 deri 4, kapiteni duhet të regjistrojë në librin e tij të anijes:

a) për sa i përket anijes peshkuese që kalon peshkun në kosha:

- sasinë e zënieve të marra në bord;
- shumën e zënieve të numëruara kundrejt kuotës individuale;
- emrat e anijeve të tjera të përfshirë në JFO;

b) për sa i përket anijeve të tjera peshkuese që nuk përfshihen në transferimin e peshkut:

- emrin e anijeve të tjera të përfshirë në JFO, sinjalet e radios të thirrjes ndërkombëtare të tyre dhe numrat e ICCAT-it;
- që asnjë zënie nuk është marrë në bordin ose është transferuar në kosha;
- shuma e zënieve të numëruara kundrejt kuotave të tyre individuale;
- emrin dhe numrin ICCAT të anijes peshkuese të përmendur në "a".

B – Anijet rimorkiator (tërheqëse)

1. Kapitenët e anijeve rimorkiator regjistrojnë në ditarin e tyre ditor datën, kohën dhe pozicionin e transferimit, sasitë e transferuara (numri i peshqve dhe sasia në kg), numri i koshit, si dhe emri i anijes peshkuese, flamuri dhe numri ICCAT, emri i anijeve të tjera të përfshira dhe numri i tyre ICCAT-it, ferma e destinacionit dhe numri ICCAT i saj, si dhe numri i deklaratës së transferimit të ICCAT-it.

2. Transferimet e mëtejshme në anijet ndihmëse ose anijet e tjera tërheqëse duhet të raportohen duke përfshirë të njëjtin informacion si në pikën 1, si dhe emrin e anijes ndihmëse ose të mjetit tërheqës, flamurin dhe numrin ICCAT dhe numrin e deklaratës së transferimit të ICCAT-it.

3. Libri i anijes përmban detajet e të gjitha transfertave të kryera gjatë sezonit të peshkimit. Libri i anijes duhet të mbahet në bord dhe të jetë i arritshëm në çdo kohë për qëllime kontrolli.

C – Anijet ndihmëse

1. Kapitenët e anijeve ndihmëse regjistrojnë çdo ditë aktivitetet e tyre në librin e tyre, duke përfshirë datën, kohën dhe pozicionet, sasitë e tonit të marra në bord dhe anijen e peshkimit, fermën ose emrin e kurthit që veprojnë në bashkëpunim.

2. Libri i anijes duhet të përmbajë detajet e të gjitha aktiviteteve të kryera gjatë sezonit të peshkimit. Libri i anijes duhet të mbahet në bord dhe të jetë i arritshëm në çdo kohë për qëllime kontrolli.

D – Anijet përpunuese

1. Kapitenët e anijeve përpunuese duhet të raportojnë në librin e tyre të anijes,] datën, kohën dhe pozicionin e veprimtarive dhe sasitë e transborduara, numrin dhe peshën e tonit të marrë nga ferma, kurthe ose anije peshkuese aty ku është e aplikueshme. Ata gjithashtu duhet të raportojnë emrat dhe numrat ICCAT të atyre fermave, kurtheve ose anijeve të peshkimit.

2. Kapitenët e anijeve përpunuese duhet të mbajnë një libër të përpunimit ditor duke specifikuar peshën e rrumbullakosur dhe numrin e peshqve të transferuar ose transboduar, faktorin e konvertimit të përdorur, peshat dhe sasitë sipas prezantimit të produktit.

3. Kapitenët e anijeve përpunuese duhet të mbajnë një plan depozitimi që tregon vendndodhjen dhe sasitë e secilës specie dhe paraqitjen.

4. Libri i anijes duhet të përmbajë detajet e të gjitha transbordimeve të kryera gjatë sezonit të peshkimit. Libri ditori i anijes, libri i përpunimit, plani i depozitimit, origjinali i deklaratave të transbordimeve ICCAT duhet të mbahen në bord dhe të jenë të arritshme në çdo kohë për qëllime kontrolli.

SHTOJCË 3

Nr. i dokumentit

DEKLARATA E ICCAT-it PËR TRANSFERIMIN/TRANSBORDIMIN

Anija rimorkiuese/mbajtëse (*tug/carrier vessel*)	**Anija e peshkimit**	**Qendra e kultivimit**	**Kurthi i tonit**
Emri i anijes dhe sinjali i thirrjes në radio Flamuri: Nr. i autorizimit të Shtetit flamur: Nr. i regjistrit kombëtar Nr. i regjistrit ICCAT Nr. IMO	Emri i anijes dhe sinjali i thirrjes në radio Flamuri: Nr. i autorizimit të Shtetit flamur: Nr. i regjistrit kombëtar Nr. i regjistrit ICCAT Shenjat identifikuese të jashtme Nr. i faqes së librit të anijes së peshkimit	Emri Numri i regjistrit të ICCAT-it	Emri Numri i regjistrit të ICCAT-it

dita muaji ora viti |2_|0_|__|__| emri kapitenit/përdoruesit të kurthit: emri i kapitenit të rimorkiuesit: VENDI I TRANSFERIMIT
Nisja |__|__| |__|__| |__|__| nga |_____|
Kthimi |__|__| |__|__| |__|__| në |_____| firma: firma:
Transf./transh. |__|__| |__|__| |__|__| |_____|
Për transferimin, trego peshën në kg ose njësi të përdorura (p.sh. kuti, kosha) dhe peshën e zbarkuar në kg të kësaj njësie: |___| kilogram.
Në rast transferte peshku të gjallë trego numrin e njësive dhe peshën e gjallë

Porti	Deti gjer. gjat.		Llojet	Numri i njësive të peshqve	Lloji i prodhimit i gjallë	Lloji i prodhimit i plotë	Lloji i prodhimit pastruar	Lloji i prodhimit pa kokë	Lloji i prodhimit fileto	Lloji i prodhimit	transferim/të mëtejshme
											Data: Vendi/pozicioni: Nr. CP i autorizimit. Nënshkrimi i kapitenit të anijes transferuese: Emri i anijes marrëse: Flamuri Nr. i regjistrit të ICCAT-it Nr. IMO Nënshkrimi i kapitenit
											Data: Vendi/pozicioni: Nr. CP i autorizimit. Nënshkrimi i kapitenit të anijes transferuese: Emri i anijes marrëse: Flamuri Nr. i regjistrit të ICCAT-it Nr. IMO Nënshkrimi i kapitenit

Nënshkrimi i vëzhguesit të ICCAT-it (nëse është e mundur). Detyrime në raste transferimi:

1. Origjinali i deklaratës së transferimit duhet t'i jepet anijes marrëse (tërheqëse/përpunuese/transporti).
2. Kopja e deklaratës së transferimit duhet të mbahet nga anije peshkuese ose në kurthin korrespondues.
3. Aktivitete të mëtejshme transferimi do të autorizohet nga CP-ja, e cila autorizon anije për të ushtruar aktivitetin.
4. Origjinali i deklaratës së transferimit duhet të mbahet nga anija marrëse, e cila mban peshkun, deri në qendrën e kultivimit ose të vendit të zbarkimit.
5. Aktivitetet e transferimit do të regjistrohen në librin e çdo anijeje të përfshirë në këtë aktivitet.

SHTOJCË 4

Nr. i dokumentit		**Deklarata e transferimit ICCAT**	
1.TRANSFERIMI I BFT-ve TË GJALLË TË DESTINUAR PËR NË FERMË			
Emri i anijes së peshkimit: Sinjali i thirrjes: Flamuri: Nr. i regjistrit ICCAT: Identifikimi i jashtëm: Nr. i autorizimit të transferimit: *Logbook* nr.: JFO nr.: eBCD nr.:	Emri i fermës: Nr. i regjistrit ICCAT: Emri i fermës dhënëse(1): Nr. i regjistrit ICCAT:	Emri i anijes së parë tërheqëse: Flamuri: Nr. i regjistrit ICCAT: Identifikimi i jashtëm: Numri i koshit transportues:	Emri i fermës së destinacionit: Nr. i regjistrit ICCAT:
		Emri i anijes së dytë tërheqëse: Flamuri: Nr. i regjistrit ICCAT: Identifikimi i jashtëm: Numri i koshit transportues:	Emri i fermës së destinacionit: Nr. i regjistrit ICCAT:
		Emri i anijes së tretë tërheqëse: Flamuri: Nr. i regjistrit ICCAT: Identifikimi i jashtëm: Numri i koshit transportues:	Emri i fermës së destinacionit: Nr. i regjistrit ICCAT:
2.INFORMACIONI PËR TRANSFERIMIN E PARË			
Datë: __/___/_____		Vendi ose pozicioni: Porti: Gjatësi.: Gjerësi:	
Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg) në koshin e parë (4): Transferimi i parë: Transferim vullnetar: Transferim kontrolli: BFT të ngordhura gjatë transferimit (5)	Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg) në koshin e dytë (4): Transferimi i parë: Transferim vullnetar: Transferim kontrolli: BFT të ngordhura gjatë transferimit (5)	Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg) në koshin e tretë (4): Transferimi i parë: Transferim vullnetar: Transferim kontrolli: BFT të ngordhura gjatë transferimit (5)	
Emri dhe Firma e kapitenit të anijes/operatorit të kurthit/operatorit të fermës:	Kapiteni i anijes marrëse, emri dhe firma: Anija e parë marrëse: Anija e dyte marrëse: Anija e tretë marrëse:	Emri i observatorit, nr. ICCAT dhe firma:	
Prani e observatorit: Po/jo Numri i individëve i vlerësuar nga Observatori rajonal: Numri i vulave (6):	Arsyet e mosdakordësisë:	Rregullat ose procedurat që nuk janë respektuar:	
3.TRANSFERIM I MËTEJSHËM (7)			
TRANSFERIM I MËTEJSHËM 1			

Datë: __/___/_____ Numri ITD		Vendi ose pozicioni: Porti: Gjatësi.: Gjerësi:	
Emri i anijes tërheqëse dhuruese: Emri i anijes tërheqëse dhuruese:	Sinjali i thirrjes: Sinjali i thirrjes:	Flamuri: Flamuri:	Nr. i regjistrit ICCAT: Nr. i regjistrit ICCAT:
Nr. Autorizimit të transferimit:	Identifikimi i jashtëm:	Koshi nr.:	Emri dhe firma e kapitenit të anijes dhënëse: Emri dhe firma e kapitenit të anijes marrëse:
Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg)		Nr. i BFT-ve të ngordhura gjatë transferimit:	
TRANSFERIM I MËTEJSHËM 2			
Datë: __/___/_____ Numri ITD		Vendi ose pozicioni: Porti: Gjatësi.: Gjerësi:	
Emri i anijes tërheqëse dhuruese: Emri i anijes tërheqëse dhuruese:	Sinjali i thirrjes: Sinjali i thirrjes:	Flamuri: Flamuri:	Nr. i regjistrit ICCAT: Nr. i regjistrit ICCAT:
Nr. i autorizimit të transferimit:	Identifikimi i jashtëm:	Koshi nr.:	Emri dhe firma e kapitenit të anijes dhënëse: Emri dhe firma e kapitenit të anijes marrëse:
Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg)		Nr. i BFT-ve të ngordhur gjatë transferimit:	
TRANSFERIM I MËTEJSHËM 3			
Datë: __/___/_____ Numri ITD		Vendi ose pozicioni: Porti: Gjatësi.: Gjerësi:	
Emri i anijes tërheqëse dhuruese: Emri i anijes tërheqëse dhuruese:	Sinjali i thirrjes: Sinjali i thirrjes:	Flamuri: Flamuri:	Nr. i regjistrit ICCAT: Nr. i regjistrit ICCAT:
Nr. i autorizimit të transferimit:	Identifikimi i jashtëm:	Koshi nr.:	Emri dhe firma e kapitenit të anijes dhënëse: Emri dhe firma e kapitenit të anijes marrëse:
Nr. i individëve dhe pesha e vlerësuar (kg)		Nr. i BFT-ve të ngordhura gjatë transferimit:	

1. Plotësohet në rast transferimi midis dy fermave të ndryshme.
2. Plotësohet në rast se zëniet transferohen në më shumë se një kosh transporti.
3. Plotësohet në rast se koshat e transportit janë të destinuara në më shumë se një fermë.
4. Numri i individëve dhe pesha e vlerësuar nga operatori donator për transfertën që konsiderohet e vlefshme. Në rast se operacioni duhet të përsëritet, tregoni si N/A në rreshtin përkatës (p.sh. nëse transferimi i parë dhe transferimi vullnetar nuk ofruan një video të përshtatshme: Transferimi i parë: N/A, transferimi vullnetar: N/A, kontrolli transferimi: 1030 copë, 123,600 kg).
5. Numri i individëve që kanë ngordhur dhe pesha e vlerësuar.
6. Të plotësohet nga vëzhguesi rajonal i ICCAT-it në rast se koshi i transportit do të vuloset në përputhje me paragrafin 128 dhe aneksin 14.
7. Të plotësohet nga operatori dhurues për secilën prej transferimeve ndërmjet anijeve tërheqëse, të cilat bëhen pas transferimit të parë.

SHTOJCË 5
AKTIVITETE TË PËRBASHKËTA PESHKIMI

Shteti flamur	*Emri i anijes*	*Nr. ICCAT*	*Kohëzgjatja e aktivitetit*	*Identiteti i operatorëve*	*Kuotat individuale të anijeve*	*Çelësi i alokimit për anije*	*Destinacioni për në fermat e majmërisë e të rritjes*	
							CPC	*Nr. ICCAT*

Data . . . . . .
Certifikimi i shtetit flamur . . . . . .

SHTOJCË 6
PROGRAMET E VËZHGUESVE

Programi i vëzhguesit CPC

1. Detyrat e vëzhguesit të CPC-ve do të jenë, në përgjithësi, të monitorojnë përputhshmërinë me këtë rekomandim të anijeve të peshkimit dhe kurtheve.

2. Kur vendoset në bordin e një anijeje peshkuese, vëzhguesi i CPC-ve regjistron dhe raporton mbi aktivitetin e peshkimit, i cili do të përfshijë, ndër të tjera, sa vijon:

i. vlerësimin e tyre për numrin dhe peshën e tonit të peshkuar (përfshirë zënien e rastësishme);

ii. mënyrën e regjistrimit të peshkut, si i mbajtur në bord, i hedhur i ngordhur ose i lëshuar i gjallë;

iii. zona e peshkimit sipas gjerësisë dhe gjatësisë;

iv. masa e përpjekjes (sforco) (p.sh. numri i rrethimeve, numri i grepave, etj.), siç përcaktohet në Manualin e ICCAT-it për mjetet e ndryshme të peshkimit;

v. datën e zënies;

vi. të verifikojë konsistencën e shënimeve të bëra në *logbook* me vlerësimin e tij të zënies.

3. Kur vendoset në një anije tërheqëse:

a) në rast të një transferimi të mëtejshëm që përfshin lëvizjen e peshkut midis dy koshave të transportit:

i. pa vonesë, analizon pamjet video të transferimit të mëtejshëm në fjalë, për të vlerësuar numrin e individëve që janë transferuar;

ii. t'i komunikojë menjëherë Autoritetit Kompetent të CPC-ve të anijes tërheqëse dhuruese vëzhgimet e tij/saj, duke përfshirë numrin e individëve të vlerësuar nga vëzhguesi i CPC-ve dhe numrin përkatës të raportuar në ITD nga kapiteni i anijes tërheqëse dhuruese; dhe

iii. përfshijë rezultatet e analizës së tij në raportin e tij të vëzhguesit drejtuar autoritetit kompetent të CPC-ve të anijes tërheqëse dhuruese;

b) regjistron dhe raporton në raportin e tij të vëzhguesit të gjithë tonin e ngordhur gjatë udhëtimit të transportit;

c) të shikojë dhe regjistrojë anijet që mund të peshkojnë në kundërshtim me masat e ruajtjes së ICCAT-it; dhe

d) t'i komunikojë raportin e vëzhguesit autoritetit kompetent të CPC-ve të anijes tërheqëse dhuruese pa vonesë në fund të udhëtimit të tërheqjes.

4. Kur vendoset në një kurth për zënien e tonit:

a) verifikon autorizimin e vjeljes të lëshuar nga autoriteti kompetent i CPC-ve të kurthit;

b) vërteton informacionin në deklaratat e përpunimit dhe/ose vjeljes të bëra nga kapiteni ose përfaqësuesi i anijes përpunuese ose operatori i kurthit.

5. Gjithashtu, vëzhguesi i CPC-ve do të kryejë punë shkencore, si mbledhja e të gjitha të dhënave të nevojshme të kërkuara nga Komisioni, bazuar në rekomandimet e SCRS-së.

Programi Rajonal i Vëzhguesve të ICCAT-it

- Çdo CPC duhet t'u kërkojë kurtheve, fermave dhe anijeve të saj me rrethim (koshilok) siç referohen në paragrafin 101 për të vendosur një vëzhgues rajonal ICCAT-i.

- Sekretariati i Komisionit duhet t'i emërojë vëzhguesit para 1 prillit ose sa më shpejt të jetë praktike për çdo vit, dhe do t'i vendosë ato në kurthe, ferma dhe në bord të anijeve me rrethim që kanë flamurin e një CPC-je të ICCAT-it që zbatojnë programin e vëzhguesit të ICCAT-it. Një kartë vëzhguesi e ICCAT-it do të lëshohet për çdo vëzhgues.

- Sekretariati do të lëshojë një kontratë që liston të drejtat dhe detyrimet e vëzhguesit dhe të kapitenit të anijes, kurthit apo të përdoruesit të fermës së kultivimit. Kjo kontratë do të nënshkruhet nga të dyja palët e përfshira.

- Sekretariati do të hartojë një manual të programit të vëzhguesve të ICCAT-it.

Kualifikimi i vëzhguesve rajonalë të ICCAT-it

Vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it duhet të kenë kualifikimet e mëposhtme për të përmbushur detyrat e tyre:

- eksperiencë të mjaftueshme për të identifikuar llojet dhe veglat e peshkimit;

- njohje të kënaqshme të masave konservuese dhe menaxhuese të ICCAT-it, të bazuar mbi udhëzimet e trajnimit të ICCAT-it;

- aftësi për të vëzhguar dhe regjistruar në mënyrë të saktë;

- aftësi për të analizuar pamjet e regjistrimit video;

- një njohje të kënaqshme të gjuhës së shtetit flamur të anijes apo të shtetit të fermës së vëzhguar, sa të jetë e mundur.

Detyrimet e vëzhguesit

6. Vëzhguesi duhet:

a) të ketë plotësuar trajnimet teknike të kërkuara nga udhëzimet e hartuara nga ICCAT-i;

b) të ketë kombësinë e njërës nga CPC-të dhe, aty ku është e mundur, jo të shtetit ku është ferma, kurthi apo të anijes me rrethim;

c) të jetë i aftë në kryerjen e detyrave të përcaktuara në pikën e mëposhtme 7;

d) të jetë i përfshirë në listën e vëzhguesve që mbahet nga Sekretariati i Komisionit;

e) të mos ketë aktualisht interesa financiarë apo përfitimi nga peshkimi i tonit.

- Vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it do ta trajtojnë si konfidencial të gjithë informacionin në lidhje me operacionet e peshkimit dhe transferimit të kryera nga anijet me rrethim, fermat dhe kurthe, dhe e pranojnë këtë kërkesë me shkrim si kusht për t'u emëruar si vëzhgues rajonal i ICCAT-it.

- Vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it duhet të respektojnë kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe rregulloret e CPC-ve që ushtron juridiksionin mbi anijen, fermën ose kurthin në të cilin është caktuar vëzhguesi rajonal i ICCAT-it.

- Vëzhguesit rajonalë të ICCAT-it do të respektojnë hierarkinë dhe rregullat e përgjithshme të sjelljes që zbatohen për të gjithë personelin e anijeve, fermave dhe kurtheve, me kusht që rregulla të tilla të mos ndërhyjnë në detyrat e vëzhguesit rajonal të ICCAT-it sipas këtij programi dhe me detyrimet e anijes, fermës dhe personelin e kurthit të përcaktuar në këtë shtojcë.

Detyrat e vëzhguesit rajonal të ICCAT-it

- Detyrat e vëzhguesve rajonalë të ICCAT-it do të jenë në veçanti:

Detyrat e përgjithshme:

i. të vëzhgojnë dhe monitorojnë përputh-shmërinë e operacioneve të peshkimit dhe kultivimit të tonit me masat përkatëse të ruajtjes dhe menaxhimit të ICCAT-it;

ii. të kryejnë punë të tilla shkencore, të tilla si: mbledhja e mostrave ose të dhënave të detyrës 2, siç kërkohet nga Komisioni, bazuar në rekomandimet e SCRS-së;

iii. të shikojnë dhe regjistrojnë anijet që mund të peshkojnë në kundërshtim me masat e ruajtjes dhe menaxhimit të ICCAT-it;

iv. të verifikojnë dhe regjistrojnë emrin e anijes së peshkimit në fjalë dhe numrin e saj ICCAT;

v. të ushtrojnë çdo funksion tjetër të përcaktuar nga Komisioni;.

Për sa i përket anijeve me koshilok ose aktivitetit të kurtheve:

vi. të vëzhgojnë dhe raportojnë mbi aktivitetet e peshkimit të kryera;

vii. të vëzhgojnë dhe vlerësojnë zëniet dhe verifikojnë shënimet e bëra në *logbook*;

Për sa i përket transferimit të parë nga një anije me koshilok ose kurth në kosh(at) transportues:

viii. të regjistrojnë dhe raportojnë mbi realizimin e aktiviteteve të transferimit;

ix. të verifikojnë pozicionin e anijes kur angazhohet në një transferim;

x. të shqyrtojnë dhe analizojnë të gjitha pamjet video që lidhen me operacionin e transferimit në fjalë, aty ku është e aplikueshme;

xi. të vlerësojnë numrin e peshqve të transferuar dhe të regjistrojnë rezultatin në ITD;

xii. të nxjerrin një raport ditor të aktiviteteve të transferimit të anijeve me koshilok;

xiii. të regjistrojnë dhe raportojnë mbi rezultatin e analizave të tilla;

xiv. të verifikojë hyrjet e bëra në autorizimin paraprak të transferimit, të përmendur në paragrafin 112, në ITD të përmendur në paragrafët 130 deri në 133 dhe në eBCD;

xv. të verifikojë që ITD-ja e përmendur në paragrafët 130 deri në 133, t'i transmetohet kapitenit të anijes tërheqëse ose përfaqësuesit të fermës ose kurthit;

xvi. në lidhje me transferimet e kontrollit, verifikojnn numrin e identifikimit të vulave dhe sigurohen që vulat të vendosen në mënyrë të tillë që të parandalojnë hapjen e dyerve pa thyer vulat;

Për sa i përket operacioneve të vendosjes së tonit në kosha:

xvii. të rishikojnë pamjet e videokamerës të vendosjes së tonit në kosh për të vlerësuar në kohën e duhur numrin e peshqve të futur në kosh, për të lejuar operatorin e fermës, të plotësojnë deklaratën përkatëse;

Për sa i përket verifikimit të të dhënave:

xviii. të verifikojnë dhe vërtetojnë të dhënat e përfshira në ITD, deklaratat e vendosjes në kosha dhe e BCD-të, duke përfshirë analizën e regjistrimeve video;

xix. të nxjerrin një raport ditor të aktiviteteve të transferimit të anijeve me koshilok, fermave dhe kurtheve;

xx. të firmosin ITD-të, deklaratat e vendosjes në kosha dhe eBCD-të, me emrin dhe numrin e ICCAT-it të shkruar qartë, kur operacioni përkatës është në përputhje me masat e ruajtjes dhe menaxhimit të ICCAT-it dhe informacioni që përmban këto dokumente është në përputhje me vëzhgimet e tij/saj. Në rast mosmarrëveshjeje, vëzhguesi rajonal i ICCAT-it do të tregojë praninë e tij/saj në deklaratat përkatëse të ITD-së dhe deklaratat e vendosjes në kosha dhe/ose eBCD-në përkatëse, dhe arsyet e mosmarrëveshjes, duke cituar në mënyrë specifike rregullin(at) ose procedurën(at) që pikëpamja(et) e tij/saj nuk është (janë) respektuar;

Për sa i përket lëshimeve (lirimeve):

xxi. për sa i përket lëshimeve përpara mbylljes në kosh, të vëzhgojnë dhe raportojnë për operacionin e lëshimit nga rrjeta e koshilokut ose koshi i transportit, në përputhje me protokollin e lëshimit në aneksin 10;

xxii. për sa i përket lëshimeve pas mbylljes në kosh, të vëzhgojnë dhe raportojnë për ndarjen paraprake të peshkut dhe operacionin e mëpasshëm të lirimit, në përputhje me protokollin e lëshimit në aneksin 10, duke përfshirë verifikimin që cilësia e pamjeve video të ndarjes së mëparshme plotëson standardet minimale të aneksit 8 dhe duke vlerësuar numrin e peshqve të liruar;

xxiii. në të dyja rastet, të verifikojnë urdhrin e lirimit të lëshuar nga autoriteti kompetent dhe vërtetojnë informacionin në deklaratën e lëshimit të bërë nga dhuruesi ose operatori i fermës;

Për sa i përket veprimtarisë së vjeljes në ferma:

xxiv. të verifikojnë autorizimin e vjeljes të lëshuar nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës;

xxv. të vërtetojnë informacionin në deklaratat e përpunimit dhe vjeljes të bëra nga kapiteni ose përfaqësuesi i anijes së përpunimit ose nga operatori i fermës;

Për sa i përket raportimit:

xxvi. të regjistrojnë dhe verifikojnë praninë e çdo lloj markimi (*tag*), duke përfshirë shenjat natyrore, dhe njoftojnë çdo shenjë të fundit për heqjen e etiketës. Për të gjithë individët e markuar elektronikisht, kryen kampionim të plotë biologjik (otolite, shtyllë kurrizore dhe kampion gjenetik) duke ndjekur udhëzimet nga SCRS-ja;

xxvii. të krijojnë raporte të përgjithshme duke përpiluar informacionin e mbledhur në përputhje me këtë paragraf dhe t'i sigurojnë kapitenit të anijes dhe operatorit të fermës mundësinë për të përfshirë në to çdo informacion përkatës;

xxviii. të dorëzojnë raportin e përgjithshëm të lartpërmendur te ofruesi përgjegjës për ROP, për transmetim të mëvonshëm në Sekretariatin e ICCAT-it, brenda 20 ditëve nga përfundimi i periudhës së vëzhgimit;

xxix. në rastet kur vëzhguesi rajonal i ICCAT-it vëren një mospërputhje të mundshme me një rekomandim të ICCAT-it, ai/ajo duhet t'ia dorëzojë këtë informacion pa vonesë ofruesit përgjegjës për ROP, i cili do t'ia përcjellë pa vonesë autoritetit kompetent të CPC-ve të anijes, kurthit ose fermës në fjalë dhe Sekretariatit të ICCAT-it. Për këtë qëllim, ofruesi përgjegjës për ROP do të krijojë një sistem përmes të cilit ky informacion mund të komunikohet në mënyrë të sigurt;

xxx. të marrin sa më shumë që të jetë e mundur prova (p.sh. foto, video) të mospërputhshmërisë së mundshme të zbuluar dhe t'i bashkëngjisin ato në raportin e tij/saj.

Detyrimet e CPC-ve të anijes, kurthit dhe fermës:

- CPC-të e anijes, fermës dhe kurthit duhet të sigurojnë që, veçanërisht, vëzhguesi rajonal i ICCAT-it:

a) t'i lejohet qasja në anijen me koshilok, në fermë dhe kurth, si dhe te pajisjet e peshkimit, pajisjet e koshave, si dhe pamjet e kamerës stereoskopike dhe videokamerës konvencionale;

b) me kërkesë dhe për të kryer detyrat e tyre të përcaktuara në këtë Program, lejohet aksesi në pajisjet e mëposhtme, nëse janë të pranishme në anijet në të cilat janë caktuar:

i. pajisjet e navigimit satelitor;

ii. ekranet e radarit kur është në përdorim;

iii. mjetet elektronike të komunikimit;

c) t'i ofrohet akomodim në anije, duke përfshirë fjetje dhe ushqimin dhe në objektet adekuate sanitare, të barabarta me ato të oficerëve të anijes;

d) të pajiset me hapësirë adekuate në urë ose në kabinën e pilotimit për punë zyre, si dhe hapësirë adekuate në kuvertë për kryerjen e detyrave të vëzhguesit; dhe

- CPC-të e anijes, kurthit dhe fermës duhet të sigurojnë që kapiteni, ekuipazhi, ferma, kurthi dhe pronarët e anijeve të mos pengojnë, frikësojnë, ndërhyjnë, influencojnë, japin ryshfet ose tentojnë t'i japin ryshfet një vëzhguesi rajonal të ICCAT-it në kryerjen e detyrave të tij/saj;

- Sekretariatit të ICCAT-it, në përputhje me çdo kërkesë konfidencialiteti të zbatueshëm, i kërkohet t'i ofrojë CPC-ve të anijes, kurthit ose fermës, kopje të të gjitha të dhënave të papërpunuara, përmbledhjeve dhe raporteve që kanë të bëjnë me udhëtimin. Sekretariati i ICCAT-it do t'i dorëzojë raportet e vëzhguesve rajonalë të ICCAT-it Komitetit të Përputhshmërisë dhe SCRS-së;

- Autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes, fermës ose kurthit ku vëzhguesi rajonal i ICCAT-it ofron shërbimet e tij/saj, mund të kërkojë që vëzhguesi të zëvendësohet nëse ata kanë dëshmi se vëzhguesi rajonal i ICCAT-it nuk i përmbush detyrimet e tij ose nuk i kryen në mënyrë adekuate detyrat e përcaktuara në këtë rekomandim. Çdo rast i tillë do t'i raportohet Panelit 2.

Tarifat dhe organizimi

- Kostot e zbatimit të këtij programi do të financohen nga operatorët e fermave dhe kurtheve, si dhe pronarët e anijeve me koshilok. Tarifa do të llogaritet në bazë të kostove totale të Programit dhe do të paguhet në një llogari të veçantë të Sekretariatit të ICCAT-it. Sekretariati ICCAT do të menaxhojë llogarinë për zbatimin e programit;

Asnjë vëzhgues rajonal i ICCAT-it nuk do të caktohet në një anije, kurth ose fermë për të cilën tarifat, siç kërkohet në këtë shtojcë, nuk janë paguar.

SHTOJCË 7
SKEMA E ICCAT-it MBI INSPEKTIMIN E PËRBASHKËT NDËRKOMBËTAR

Në përputhje me pikën 3, të nenit IX të Konventës, Komisioni i ICCAT-it rekomandon hartimin e marrëveshjeve të mëposhtme për kontrollin ndërkombëtar jashtë ujërave që janë në juridiksionet kombëtare, me qëllim sigurimin e aplikimit të Konventës dhe masave që janë në fuqi nën të:

I. Shkeljet e rënda

1. Për qëllimet e kësaj procedure, me shkelje të rënda kuptohen shkeljet e mëposhtme të dispozitave të masave konservuese dhe menaxhuese të ICCAT-it të adoptuara nga Komisioni:

a) peshkimi pa një licencë, leje apo autorizim të lëshuar nga CPC-të flamur;

b) mosmbajtja e të dhënave të mjaftueshme mbi zëniet apo lidhur me zëniet në përputhje me kërkesat mbi raportimin e Komisionit apo keq raportime domethënëse të këtyre të dhënave mbi zëniet apo lidhur më zëniet;

c) peshkimin në zona të ndaluara për peshkim;

d) peshkimi gjatë periudhës së ndalimit të peshkimit;

e) marrja ose mbajtja në mënyrë të qëllimshme e llojeve në kundërvajtje me masat konservuese dhe menaxhuese në fuqi të adoptuara nga ICCAT-i;

f) shkeljet domethënëse të limiteve të zënieve dhe kuotave në fuqi që janë përcaktuar nga rregullat e ICCAT-it;

g) përdorimi i veglave të peshkimit të ndaluara;

h) falsifikimi ose fshehja në mënyrë të qëllimshme e shenjave, identitetit apo regjistrimit të një anijeje peshkimi;

i) fshehja, ngatërrimi apo eliminimi i provave që lidhen me hetimin e një shkeljeje;

j) shkelje të shumëfishta të cilat, të marra së bashku, përbëjnë një mosvlerësim domethënës të masave në fuqi që lidhen me ICCAT-in;

k) sulmimi, rezistenca, frikësimi, ngacmimi seksual, ndërhyrja, bllokimi apo vonimi i padrejtë i një vëzhguesi apo inspektori të autorizuar;

l) çaktivizimi apo manipulimi në mënyrë të qëllimshme i sistemit të vëzhgimit të anijeve;

m) shkelje të tjera që mund të përcaktohen nga ICCAT-i, pasi ato të jenë përshirë dhe qarkulluar në një version të rishikuar të këtyre procedurave;

n) peshkimi me ndihmën e avionëve vrojtues;

o) ndërhyrja në sistemin e monitorimit satelitor dhe/apo veprimi pa sistemin e sistemit të vëzhgimit të anijeve;

p) aktiviteti i transferimit pa deklaratë transferimi;

q) transbordimi në det.

2. Në rastin e ngjitjes në bord dhe inspektimit të një anijeje peshkimi gjatë të cilës inspektorët e autorizuar vërejnë një aktivitet apo gjendje që do të përbënte një shkelje të rëndë, siç është përcaktuar në pikën 1 të mësipërme, autoritetet e anijes inspektuese duhet të njoftojnë menjëherë autoritetet e anijes së peshkimit si në mënyrë direkte ashtu dhe nëpërmjet sekretariatit të ICCAT-

it. Në situata të tilla, inspektori duhet të njoftojë gjithashtu çdo anije inspektimi të shtetit flamur të anijes së peshkimit që dihet të jetë në afërsi.

3. Inspektorët e ICCAT-it duhet të regjistrojnë inspektimet e ndërmarra dhe shkeljet e zbuluara (nëse ka) në librin e anijes së peshkimit.

4. CPC-të flamur duhet të sigurojnë që, pas inspektimit të kryer sipas pikës 2 të kësaj shtojce, anija e peshkimit në fjalë të ndalojë të gjitha aktivitetet e peshkimit. CPC-të flamur duhet t'i kërkojnë anijes së peshkimit t'i drejtohet brenda 72 orëve në një port të përcaktuar nga ai, ku do të kryhet dhe hetimi.

5. Në rastin kur një inspektim ka zbuluar një aktivitet ose kusht që do të përbënte një shkelje të rëndë, anija duhet të rishikohet sipas procedurave të përshkruara në rekomandimin nga ICCAT-i mbi krijimin e një liste të anijeve që supozohet të kenë kryer Aktivitetet e Peshkimit të Paligjshëm, të Paraportuar dhe të Parregulluar (IUU) (rec. 18-08[9]) duke marrë parasysh çdo veprim përgjigjeje dhe ndjekje të tjera.

II. Kryerja e inspektimit

6. Inspektimi do të kryhet nga inspektorët e shërbimit të kontrollit të peshkimit të qeverisë kontraktuese. Emrat e agjencive qeveritare të autorizuara dhe të inspektorëve të përcaktuar për këtë qëllim nga qeveritë përkatëse duhet t'i njoftohen Komisionit.

7. Anijet që kryejnë detyra ndërkombëtare të imbarkimit dhe inspektimit në përputhje me këtë shtojcë do të mbajnë një flamur ose flamur të veçantë të miratuar nga Komisioni dhe të lëshuar nga Sekretariati i ICCAT-it. Emrat e anijeve të përdorura për këtë qëllim do t'i njoftohen Sekretariatit të ICCAT-it sa më shpejt që të jetë e mundur përpara fillimit të aktiviteteve të inspektimit. Sekretariati do të vërë informacionin në lidhje me anijet e përcaktuara të inspektimit të vlefshëm për të gjitha CPC-të, duke përfshirë postimin në faqen e tij të internetit të mbrojtur me fjalëkalim.

8. Çdo inspektor duhet të mbajë një dokument identiteti të lëshuar nga autoritetet e shtetit flamur në formën e treguar në pikën 20 të kësaj shtojce.

9. Në zbatim të marrëveshjes së pranuar në pikën 15 të kësaj shtojce, një anije e përdorur gjatë periudhës së përcaktuar në peshkimin për ton apo lloje të ngjashme me tonin në zonën e Konventës së mbuluar nga ICCAT-i jashtë ujërave të juridiksionit të saj kombëtar do të ndalojë kur i jepet një sinjal i tillë në Kodin Ndërkombëtar të Sinjaleve nga një anije që ka në bord një inspektor të përshkruar në paragrafin 7, përveçse kur është duke kryer aktivitet peshkimi, në këtë rast ajo duhet të ndalojë sapo ka mbaruar këtë aktivitet. Kapiteni i anijes do të lejojë palën inspektuese, siç është specifikuar në paragrafin 10 të kësaj shtojce, të hyjë në bord dhe duhet të sigurojë një shkallë ngjitjeje. Kapiteni duhet t'i mundësojë palës së inspektimit që të bëjë një ekzaminim të tillë të pajisjeve, kapjes ose pajisjes dhe çdo dokument përkatës që inspektori i konsideron të nevojshme për të verifikuar pajtueshmërinë me rekomandimet e Komisionit të ICCAT-it në fuqi, në lidhje me shtetin flamurin të anijes që inspektohet. Më tej, një inspektor mund të kërkojë shpjegime që ai ose ajo i konsideron të nevojshme.

10. Madhësia e grupit të inspektimit duhet të përcaktohet nga zyrtari komandues i anijes inspektuese duke marrë parasysh rrethanat përkatëse. Pala inspektuese duhet të jetë sa më e vogël të jetë e mundur për të përmbushur detyrat e përcaktuara në këtë shtojcë në mënyrë të sigurt dhe pa rreziqe.

11. Pas hipjes në anije, inspektorët duhet të paraqesin dokumentacionin e identifikimit të përshkruar në paragrafin 8 të këtij aneksi. Inspektorët duhet të respektojnë rregulloret, procedurat dhe praktikat ndërkombëtare të pranuara në përgjithësi, në lidhje me sigurinë e anijes që inspektohet dhe ekuipazhin e saj, dhe do të minimizojë ndërhyrjen në aktivitetet e peshkimit ose depozitimin e produktit dhe, në masën që është e mundur, të shmangë veprimet që do të ndikojnë negativisht në cilësinë e peshkut të kapur në bord; Inspektorët do të kufizojnë hetimet e tyre në konstatimin e respektimit të rekomandimeve të Komisionit të ICCAT-it në fuqi në lidhje me shtetin flamurin e anijes në fjalë. Gjatë kryerjes së inspektimit, inspektorët mund t'i kërkojnë kapitenit të anijes së peshkimit për çdo ndihmë që ai mund të kërkojë. Inspektorët duhet të hartojnë një raport të inspektimit në një formë të miratuar nga Komisioni i ICCAT-it. Inspektorët e nënshkruajnë raportin në praninë e kapitenit të anijes, i cili ka të drejtë të shtojë ose t'i ketë shtuar raportit çdo vërejtje që ai ose ajo mund të mendojë të

[9] Zëvendësuar nga rec. 21-13.

përshtatshme dhe duhet të nënshkruajë këto vërejtje.

12. Kopjet e raportit do t'i jepen Kapitenit të anijes dhe qeverisë së palës inspektuese, e cila i transmeton kopjet autoriteteve përkatëse të shtetit flamur të anijes së inspektuar dhe Komisionit ICCAT. Kur zbulohet ndonjë shkelje e rekomandimeve të ICCAT-it, inspektori duhet, kur është e mundur, gjithashtu, të informojë çdo anije inspektuese të shtetit flamur të anijes së peshkimit që njihet dhe që është në afërsi.

13. Rezistenca ndaj inspektorëve ose mosrespektimi i udhëzimeve të tyre do të trajtohen nga shteti flamur i anijes së inspektuar në një mënyrë të ngjashme me sjelljen e kryer në lidhje me një kontroll inspektimi kombëtar.

14. Inspektori duhet të kryejë detyrat e tij nën këtë marrëveshje në përputhje me rregullat e hartuara në këtë rekomandim, por ato duhet të qëndrojnë nën kontrollin operacional të autoriteteve kombëtare të tyre dhe duhet të jenë përgjegjës ndaj tyre.

15. Qeveritë kontraktuese do të marrin në konsideratë dhe do të veprojnë në raportet e inspektimit, duke shikuar fletët e informacionit sipas rec. 19-09 dhe deklaratat që rezultojnë nga inspektimet e dokumentuara të inspektorëve të huaj sipas këtyre marrëveshjeve, në një bazë të ngjashme në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar ndaj raporteve të inspektorëve kombëtarë. Dispozitat e këtij paragrafi nuk do të imponojnë asnjë detyrim ndaj një qeverie kontraktuese që t'i japë raportit të një inspektori të huaj një vlerë më të lartë dëshmie se sa do të kishte në vendin e vet të inspektorit. Qeveritë Kontraktuese do të bashkëpunojnë në mënyrë që të lehtësojnë procedurat gjyqësore ose të tjera që rrjedhin nga një raport i një inspektori sipas këtyre marrëveshjeve.

a) Shtetet kontraktuese duhet të informojnë Komisionin e ICCAT-it deri më 15 shkurt të çdo viti të planeve të tyre të përkohshme për kryerjen e aktiviteteve inspektuese sipas këtij rekomandimi në atë vit kalendarik dhe Komisioni mund të bëjë sugjerime për shtetet kontraktuese, për koordinimin e veprimeve kombëtare në këtë fushë, duke përfshirë numrin e inspektorëve dhe anijet që mbartin inspektorë;

b) Marrëveshjet e hartuara në këtë rekomandim dhe planet për pjesëmarrjen do të aplikohen midis shteteve kontraktuese, përveçse kur kanë marrëveshje tjetër midis tyre, dhe kjo marrëveshje duhet t'i bëhet e ditur Komisionit të ICCAT-it. Megjithatë, zbatimi i kësaj skeme do të pezullohet ndërmjet dy shteteve kontraktuese, kur secili nga to ka njoftuar Komisionin e ICCAT-it për të, në pritje të plotësimit të marrëveshjes;

16. a) Rrjetat e peshkimit do të maten në përputhje me rregullat në fuqi për nënzonën në të cilën kryhet inspektimi. Inspektorët do të deklarojnë nënzonën për të cilën bëhet inspektimi dhe një përshkrim të çdo shkeljeje të gjetur në raportin e inspektimit;

b) Inspektorët do të kenë autoritetin për të inspektuar të gjitha veglat e peshkimit në përdorim apo në kuvertë.

17. Inspektori do të ngjisë një shenjë identifikuese të aprovuar nga Komisioni i ICCAT-it për çdo vegël peshkimi të inspektuar që dyshohet të jetë në kundërvajtje me rekomandimet në fuqi të Komisionit të ICCAT-it, në lidhje me shtetin flamur të anijes në fjalë dhe duhet t'i regjistrojë këto fakte në raportin e tij.

18. Inspektori mund të fotografojë mjetet e peshkimit, pajisjet, dokumentacionin dhe çdo element tjetër që ai e konsideron të nevojshëm në mënyrë të tillë që të zbulojë ato karakteristika që sipas mendimit të tyre nuk janë në përputhje me rregulloren në fuqi, në të secilin rast subjektet e fotografuara duhet të jenë të listuara në raport dhe kopjet e fotografive duhet t'i bashkëngjiten kopjes së raportit të CPC flamurit.

19. Inspektorët, sipas nevojës, inspektojnë të gjitha zëniet në bord për të përcaktuar pajtueshmërinë me rekomandimet e ICCAT-it.

20. Modeli i propozuar për kartën e identitetit të inspektorit.

a) Dimensionet: gjerësia 10.4 cm, lartësia 7 cm


INTERNATIONAL COMMISSION FOR THE CONSERVATION OF ATLANTIC TUNA

AT

ICCAT

Inspector Identity Card

Photograph

Contracting Party:

Inspector Name:

Card nº:

Issue Date: Valid five years

AT

ICCAT

The holder of this document is an ICCAT inspector duly appointed under the terms of the Scheme of Joint International Inspection and Surveillance of the International Commission for the Conservation of the Atlantic Tuna and has the authority to act under the provision of the ICCAT Control and Enforcement measures.

ICCAT Executive Secretary
Issuing Authority

Inspector

SHTOJCË 8
STANDARDET MINIMALE PËR PROCEDURAT E REGJISTRIMIT TË VIDEOVE TË ZBATUESHME PËR OPERACIONET E TRANSFERIMIT, VENDOSJES NË KOSHA DHE/OSE LËSHIMIT

1. Çdo CPC e anijes, kurthit dhe fermës në fjalë do të sigurojë që procedurat e mëposhtme të zbatohen për të gjitha regjistrimet video të operacioneve të transferimit, futjes në kosha dhe/ose lëshimit të referuara në këtë rekomandim:

a) në fillim dhe/ose në fund të çdo videoje, kur kërkohet, do të shfaqet numri i autorizimit të transferimit, ose autorizimit të vendosjes në kosha ose urdhri i lëshimit sipas ICCAT-it;

b) ora dhe data e videos do të shfaqen vazhdimisht gjatë çdo regjistrimi video;

c) regjistrimi i videos duhet të jetë i vazhdueshëm pa asnjë ndërprerje dhe prerje, dhe të mbulojë të gjithë operacionin e transferimit, vendosjes në kosha dhe/ose lëshimit;

d) përpara fillimit të operacionit të transferimit, vendosjes në kosha dhe/ose lëshimit, videoregjistrimi duhet të përfshijë hapjen dhe mbylljen e rrjetës/portës së koshit dhe, për operacionet e transferimit dhe të vendosjes në kosha, të tregojë nëse koshi (koshat) marrës dhe dhurues përmbajnë ton;

e) regjistrimi i videos duhet të jetë i një cilësie të mjaftueshme për të përcaktuar numrin dhe, sipas rastit, peshën e tonit që transferohet, futet në kosh dhe/ose lëshohet;

f) regjistrimi origjinal i videos do të mbahet në bordin e anijes dhuruese, ose nga ferma ose operatori i kurthit, sipas rastit, gjatë të gjithë periudhës së autorizimit për të operuar;

g) shpërndarja e kopjeve të videoregjistrimeve do të ndjekë dispozitat e përmendura në paragrafët 120 deri në 123 të këtij rekomandimi;

h) pajisja elektronike që përmban regjistrimin origjinal të videos duhet t'i jepet menjëherë vëzhguesit rajonal të ICCAT-it dhe/ose kombëtar të CPC-ve pas përfundimit të operacionit të transferimit, vendosjes në kosha dhe/ose lëshimit. Vëzhguesi rajonal i ICCAT-it dhe/ose vëzhguesi i CPC-ve duhet ta inicializojnë menjëherë atë për të shmangur çdo manipulim të mëtejshëm.

2. Çdo CPC e anijes, kurthit dhe fermës në fjalë do të marrë masat e nevojshme për të shmangur çdo zëvendësim, botim ose manipulim të regjistrimeve origjinale të videos.

Cilësi e pamjaftueshme e regjistrimit të videos

3. Nëse regjistrimi video është i cilësisë së pamjaftueshme për të përcaktuar numrin dhe, sipas rastit, peshën e tonit që transferohet, futet në kosh dhe/ose lëshohet, operacioni do të përsëritet derisa cilësia e videos të jetë e përshtatshme, duke ndjekur procedurat më poshtë:

a) për një transferim, operacioni i transferimit në fjalë do të përsëritet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në paragrafët 124 deri në 129 të këtij rekomandimi (transferime vullnetare dhe kontrolli). Ky transferim vullnetar ose i kontrollit do të kryhet në një kosh tjetër i cili duhet të jetë bosh.

Për ato transferime ku origjina e peshkut është një kurth, toni tashmë i transferuar nga kurthi në koshin pritës mund të kthehet përsëri në kurth dhe transferimi vullnetar anulohet nën mbikëqyrjen e vëzhguesit rajonal të ICCAT-it;

b) për një operacion 'Vendosjeje në kosha', operacioni në fjalë do të përsëritet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në paragrafët 163 deri në 164 të këtij rekomandimi.

Operacioni i ri i 'Vendosje në kosha' duhet të përfshijë lëvizjen e të gjithë tonit nga koshi i fermës pranuese në një kosh tjetër ferme, i cili duhet të jetë bosh;

c) për lëshimet, veçimi i peshkut që do të lëshohet do të përsëritet në përputhje me Protokollin e Lirimit të përcaktuar në aneksin 10 të këtij rekomandimi.

SHTOJCË 9
STANDARDET DHE PROCEDURAT PËR SISTEMET E KAMERAVE STEREOSKOPIKE NË KONTEKSTIN E OPERACIONEVE TË FUTJES SË TONIT NË KOSHA

1. Përdorimi i sistemit të kamerave stereoskopike

Përdorimi i sistemeve të kamerave stereoskopike në kontekstin e operacioneve të 'Vendosjes në kosha' të tonit do të kryhet në përputhje me dispozitat e mëposhtme:

i. intensiteti i marrjes së mostrave të peshqve të gjallë nuk duhet të jetë nën 20% të sasisë së peshkut të vendosur në kosha. Kur është e mundur teknikisht, marrja e mostrave të peshqve të gjallë duhet të jetë në vijim, duke matur një në çdo pesë ekzemplarë. Një mostër e tillë do të përbëhet nga peshq të matur në një distancë prej 2 deri në 8 metra nga kamera;

ii. dimensionet e portave të transferimit që lidhin koshin dhënës dhe koshin pranues duhet të jenë në gjerësi maksimale prej 8–10 metrash dhe lartësi maksimale prej 8–10 metrash;

iii. vlerësimi i matjeve të gjatësisë stereoskopike duhet të ndërmerret përpara secilit operacion të vendosjes në kosha duke përdorur një shirit shkalle në distancë prej 2 dhe 8 m;

iv. kur matjet e gjatësisë së peshkut paraqesin një shpërndarje multi-modale (dy ose më shumë kohorte të madhësive të ndryshme), mund të përdoret më shumë se një algoritëm konvertimi për të njëjtin operacion të hedhjes në kosha;

v. algoritmi më i përditësuar i krijuar nga SCRS-ja do të përdoret për të kthyer gjatësinë në pendën e bishtit në pesha të përgjithshme, sipas kategorisë së madhësisë së peshkut të matur gjatë operacionit të grumbullimit;

vi. marzhi i gabimit për përcaktimin e peshës, i natyrshëm për specifikimet teknike të sistemit të kamerës stereoskopike, nuk duhet të kalojë një interval prej +/- 5 për qind;

vii. raporti mbi rezultatet e programit stereoskopik duhet të përfshijë detaje mbi të gjitha specifikimet teknike të mësipërme, përfshirë intensitetin e mostrës, mënyrën e metodologjisë së marrjes së mostrës, distancën nga kamera, përmasat e portës së transferimit dhe algoritmet (relacionin gjatësi–peshë). SCRS-ja do të shqyrtojë këto specifikime, dhe nëse është e nevojshme të japë rekomandime për t'i modifikuar ato.

2. Rezultatet e 'Vendosjes në kosha' të tonit

Në përfundim të një operacioni të vendosjes në kosha, ose setit të plotë të operacioneve të të vendosjes në kosha nën një JFO ose në kurthe të të njëjtit shtet anëtar të CPC/BE, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do t'i komunikojë informacionin e mëposhtëm autoritetit kompetent të CPC-ve të anijes ose kurthit:

a) një raport teknik në lidhje me sistemin e kamerës stereoskopike, i cili duhet të përmbajë në veçanti:

- informacione të përgjithshme: speciet, vendndodhja, koshi, data, algoritmi;
- informacion statistikor për përmasat: pesha dhe gjatësia mesatare, pesha dhe gjatësia minimale, pesha dhe gjatësia maksimale, numri i peshkut të kampionuar, shpërndarja e peshës, shpërndarja e madhësisë;
- algoritmi i përdorur për të kthyer gjatësinë në peshë;
- marzhi i gabimit të sistemit të kamerës stereoskopike të përdorur. Në rastin kur softueri i kamerës nuk ka një metodë automatike për llogaritjen e këtij kufiri gabimi, ai do të llogaritet siç detajohet në pikat 1 deri në 4 të aneksit së kësaj shtojce;

b) një raport faktik në lidhje me operacionin e vendosjes në kosha, i cili duhet të përmbajë në veçanti:

- rezultatet e detajuara të programit të marrjes së mostrave, me numrin dhe peshën totale të tonit të kuq në kafaz, si dhe madhësinë dhe peshën e çdo peshku që u mor në kampion;
- deklaratat përkatëse të vendosjes në kosha;
- përcaktimi i rasteve kur mospërputhjet prej më shumë se 10% midis numrit të individëve të koshit dhe numrit të raportuar si të kapur në ITD kërkojnë hetim nga autoriteti kompetent i CPC-ve flamur ose kurth në përputhje me paragrafin 174,

dhe rastet kur rezultatet e vendosjes në kosha tregojnë se kjo zënie nuk është në përputhje me paragrafët 33 deri në 35;

- informacion i përgjithshëm mbi operacionin e vendosjes në kosha: numri i operacionit të vendosjes në kosha, emri i fermës, numri i koshit, numri eBCD, numri ITD, emri dhe flamuri i anijes së peshkimit, emri dhe flamuri i anijes tërheqëse, data e funksionimit të sistemit të kamerës stereoskopike dhe emri i skedarit të filmimit;

- krahasimi midis sasive të deklaruara në eBCD dhe sasive të gjetura me sistemin e kamerës stereoskopike, në numrin e peshqve, peshën mesatare dhe peshën totale (formula e përdorur për llogaritjen e diferencës do të jetë: (sistemi stereoskopik-eBCD)/sistemi stereoskopik* 100).

3. Raporti i vendosjes në kosha

Raporti i vendosjes në kosha të përmendur në paragrafin 186 të këtij rekomandimi do të përfshijë:

a) rezultatet e vendosjes në kosha të përmendura në pikën 2;

b) raportet përkatëse të operacioneve të lëshimit, të kryera në përputhje me aneksin 10.

4. Përdorimi i rezultatit të kamerës stereoskopike

Duke aplikuar marzhin e gabimit të natyrshëm për specifikimet teknike të sistemit të kamerës stereoskopike të përdorur, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të përcaktojë limitet (vlerën më të ulët dhe më të lartë) e peshës totale të tonit në kosh, në përputhje me pikën 5 të aneksit të kësaj shtojce. Zbatimi i aneksit i nënshtrohet rishikimit të metodës së propozuar nga SCRS-ja.

Kur merren rezultatet e analizës së pamjeve video të kamerës stereoskopike dhe limitet (vlera më e ulët dhe më e lartë) e peshës totale të tonit në kosh, të komunikuara nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës, Autoriteti Kompetent Shtetëror i CPC-ve të anijes peshkimit ose kurthit/anëtar i BE-së do të marrë masat e mëposhtme:

a) të zbatojë masat e mëposhtme në lidhje me lëshimet dhe përshtatjen e seksioneve eBCD për anijet e peshkimit që operojnë në kuadër të një operacioni individual peshkimi (jashtë një JFO-je);

i. kur pesha totale e deklaruar nga anija e peshkimit në eBCD është brenda intervalit të rezultateve të sistemit të kamerës stereoskopike;

- nuk do të urdhërohet lirimi;

- eBCD-ja do të ndryshohet si në numër (duke përdorur numrin e peshqve që rezulton nga përdorimi i sistemit të kamerës stereoskopike) dhe peshën mesatare, ndërsa pesha totale nuk do të ndryshohet;

ii. kur pesha totale e deklaruar nga anija e peshkimit në seksionin e zënies së eBCD-së është nën shifrën më të ulët të limitit të rezultateve të sistemit të kamerës stereoskopike:

- do të urdhërohet një lëshim duke përdorur shifrën më të ulët në diapazonin e rezultateve të sistemit të kamerës stereoskopike;

- operacionet e lëshimit do të kryhen në përputhje me procedurën e përcaktuar në aneksin 10;

- pasi të kryhen operacionet e lëshimit, eBCD-ja do të modifikohet si në numër (duke përdorur numrin e peshqve që rezulton nga përdorimi i sistemit të kamerës stereoskopike minus numrin e peshqve të lëshuar) dhe peshën mesatare, ndërsa pesha totale nuk do të modifikohet;

iii. kur pesha totale e deklaruar nga anija e peshkimit në seksionin e zënies së eBCD-së tejkalon shifrën më të lartë të limitit të sistemit të kamerës stereoskopike:

- nuk do të urdhërohet lëshimi;

- eBCD-ja do të modifikohet për peshën totale (duke përdorur shifrën më të lartë të limitit të rezultateve të sistemit të kamerës stereoskopike), për numrin e peshqve (duke përdorur rezultatet nga sistemi i kamerës stereoskopike) dhe peshën mesatare në përputhje me rrethanat;

b) të sigurojë që për çdo modifikim përkatës të eBCD-ve, vlerat (numri dhe pesha) e futur në seksionin 2 do të jenë në përputhje me ato në seksionin 6 dhe vlerat në seksionet 3, 4 dhe 6, nuk do të jenë më të larta se ato në seksionin 2.

5. Dispozitat e zbatueshme për JFO-në dhe kurthe

1. Vendimet që vijnë si pasojë e dallimeve midis raportit të zënies dhe rezultateve nga programi i sistemit të kamerës stereoskopike do të merren nga autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes ose kurthit:

a) bazuar në krahasimin midis totalit të peshave që rezultojnë nga programi i sistemit të kamerës stereoskopike të të gjitha operacioneve të vendosjes në kosha të tonit nga një JFO/kurthe, me totalin e peshave të zënieve të deklaruara nga anijet pjesëmarrëse në atë JFO ose nga ato kurthe dhe, në rastin e JFO-ve dhe kurtheve që përfshijnë një CPC të vetëm dhe/ose shtet anëtar të BE-së;

b) në nivelin e operacioneve të vendosjes në kosha për JFO-të që përfshijnë më shumë se një CPC dhe/ose shtet anëtar të BE-së, përveç rasteve kur bihet dakord ndryshe nga të gjitha autoritetet kompetente të CPC-ve/shtetit anëtar të BE-së të anijeve të peshkimit të përfshira në JFO.

2. Në rast të kompensimit të diferencave në peshë midis asaj që është përcaktuar nga kamera stereoskopike dhe zënies korresponduese të gjetur në të gjitha raportet individuale të vendosjes në kosha nga një JFO ose kurthe të të njëjtit shtet anëtar të CPC/BE, pavarësisht nëse është kërkuar apo jo urdhër lëshimi, të gjitha eBCD-të përkatëse do të modifikohen në bazë të limitit më të ulët të rezultateve të sistemit të kamerës stereoskopike.

3. eBCD-të në lidhje me sasitë e tonit të lëshuar do të modifikohet gjithashtu për të pasqyruar peshën dhe numrin përkatës të peshkut të çliruar. eBCD-të në lidhje me tonin që nuk është lëshuar, por për të cilin rezultatet nga sistemet e kamerave stereoskopike ose teknikat alternative ndryshojnë nga ato të raportuara të zënies dhe të transferimit, gjithashtu do të ndryshohet për të pasqyruar këto dallime.

4. eBCD-të e zënies nga ku është kryer operacioni i lëshimit do të modifikohet gjithashtu për të pasqyruar peshën/numrin e lëshuar.

ANEKSI I SHTOJCËS 9
METODA PËR LLOGARITJEN E MARZHIT TË GABIMIT DHE DIAPAZONIT TË SISTEMIT TË KAMERËS STEREOSKOPIKE

Në përputhje me atë që u ra dakord në Mbledhjen Ndërsesionale të Panelit 2 (mars 2020) "Sqaromi seksionit 2, të aneksit 9, të rec. 19-04, paragrafi "iii", në lidhje me përcaktimin e diapazonit të përqindjes", përdoret metoda e mëposhtme për llogaritjen e marzhit të gabimit dhe diapazonit të sistemit të kamerës stereoskopike:

1. Llogaritja e diapazonit të gjatësisë në bifurkim (FLi) për çdo kampion (i) duke marrë parasysh kufirin e gabimit FL të dhënë nga sistemi (gabim%):

Diapazoni i gjatësisë identifikohet për çdo mostër (i) nga [FLmin,*i*, FLmax,*i*]

$FL_{min,i}$ = FLi-(FLi*error%): është vlera minimale për diapazonin e gjatësisë në bifurkim për çdo mostër (i)

$FL_{max,i}$ = FLi+ (FLi*error%): është vlera maksimale për diapazonin e gjatësisë në bifurkim për çdo mostër (i)

2. Konvertimi i diapazonit të gjatësisë në një peshë të rrumbullakët (RTW) për çdo mostër (i) duke aplikuar algoritmin e përdorur për të kthyer gjatësinë në peshë:

Diapazoni i peshës së rrumbullakët identifikohet për kampion (i) nga [RTWmin,*i*, RTWmax,*i*]

RTWmin,i: është vlera minimale e diapazonit të peshës së rrumbullakët për çdo kampion (i)

RTWmax,i: është vlera maksimale e diapazonit të peshës së rrumbullakët për çdo kampion (i)

3. Llogaritja e diapazonit mesatar të peshës së rrumbullakosur:

diapazoni mesatar i peshës së rrumbullakët për «n» mostra identifikohet nga:

[$RTWaverage_{min}$, $RTWaverage_{max}$]

RTWaveragemin = $\mathbf{1n}\Sigma\boldsymbol{RTW}min,i=\mathbf{1}$: është vlera minimale për diapazonin mesatar të peshës rrumbullakosur

RTWaveragemax = $\mathbf{1n}\Sigma\boldsymbol{RTW}max,i=\mathbf{1}$: është vlera maksimale për diapazonin mesatar të peshës rrumbullakosur

4. Llogaritja e përqindjes së marzhit të gabimit (%) të sistemit:

$$\frac{(\boldsymbol{RTWaverage}max - \boldsymbol{RTWaverage}2}{\boldsymbol{RTWaverage}} \mathbf{x100}$$

RTWaverage: është pesha mesatare e ofruar nga kamera stereoskopike

5. Zbritja e diapazonit të sistemit të kamerës stereoskopike:

Gama e sistemit të kamerës stereoskopike përcaktohet nga:

[Shifra më e ulët e diapazonit, shifra më e lartë e diapazonit]

Më parë, pesha totale llogaritet duke shumëzuar peshën mesatare të dhënë nga kamera stereoskopike me numrin e peshqve që rezultojnë nga përdorimi i kamerës stereoskopike, dmth: ***RTWtotal = (RTWaverage* Number BFT)***

Kështu, kufijtë e diapazonit llogariten si më poshtë:

Shifra e diapazonit më të ulët = RTWtotal – (sistem marzhi i gabimit * RTWtotal/100)

Shifra më e lartë e diapazonit = totalRTW + (marzhi i sistemit të gabimit *RTW total /100)

SHTOJCË 10
PROTOKOLLI I LËSHIMIT

Lëshimi i urdhrave për lirim

1. Urdhrat e lëshimit përpara se të vendosen në kosh do të lëshohen:

a) nga autoriteti kompetent i operatorit dhurues kur, në bazë të njoftimit paraprak të transferimit, autoriteti kompetent i CPC-ve të operatorit dhurues refuzon operacionin e transferimit sipas paragrafit 117; ose

b) nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës kur, në përputhje me paragrafin 154, autorizimi i vendosjes në kosha nuk është lëshuar nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës brenda 1 muaji pas kërkesës për autorizim.

2. Urdhrat e lëshimit pas vendosjes në kosh do të lëshohen:

a) nga autoriteti kompetent i CPC-ve të anijes ose kurthit kur, sipas procedurave në paragrafët 180 deri 182, konstatohet se pesha e vendosur në kosh tejkalon atë të raportuar të zënë. Urdhri i lirimit do t'i njoftohet autoritetit kompetent të CPC-ve të fermës, i cili ia transmeton atë operatorit të fermës në fjalë; ose

b) nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës kur, pas vjeljes, peshku i mbetur nuk mbulohet nga një eBCD, ose kur një vlerësim i mbartjes (*carry-over*) ose transferimi i kontrollit ka identifikuar një tepricë të peshkut.

Për rastet sipas seksionit 2 (a) më sipër, pesha totale e tonit të kuq që lëshohet do të konvertohet në një numër korrespondues individësh duke aplikuar peshën mesatare që rezulton nga analiza e pamjeve video të kamerës stereoskopike, në lidhje me operacionin përkatës të vendosjes në kosha, të bëra nga autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës në përputhje me paragrafin 169 të rekomandimit.

Ndarja e peshkut përpara operacionit të lëshimit

3. Përpara lirimit nga koshi i fermës, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës duhet të sigurojë që:

- peshku që do të lëshohet ndahet dhe zhvendoset në një kosh transporti bosh, dhe transferimi i peshkut në koshin e transportit monitorohet nga kamera e kontrollit në ujë, në përputhje me standardet minimale të përcaktuara në aneksin 8;
- numri i peshqve të ndarë për lirim korrespondon me urdhrin e lëshimit.

4. Ndarja paraprake e peshkut që lëshohet do të kryhet në prani të një vëzhguesi rajonal të ICCAT-it.

Regjistrimi i operacionit të lëshimit nga videokamera

5. Lëshimi i tonit të kuq nga transporti ose kafazet e fermës në det duhet të regjistrohet me kamera kontrolli. Të gjitha operacionet e lëshimit në det do të vëzhgohen nga një vëzhgues rajonal i ICCAT-it.

Raportimi

6. Për çdo operacion lëshimi të kryer, dhuruesi ose operatori i fermës, përgjegjës për lëshimin, duhet të plotësojë një raport lëshimi, duke përdorur formatin bashkangjitur kësaj shtojce.

7. Vëzhguesi rajonal i ICCAT-it do të vërtetojë informacionin në deklaratën e lëshimit. Dhuruesi ose operatori i fermës duhet t'ua dorëzojë deklaratën e lëshimit autoriteteve të tij brenda 48 orëve nga fillimi i operacionit të lëshimit për t'ia transmetuar Sekretariatit të ICCAT-it.

Dispozitat e përgjithshme

8. Operacionet e lëshimi nga koshiloku, kurthi ose koshi i transportit duhet të kryhen menjëherë pas marrjes së urdhrit të lëshimit.

9. Operacionet e lëshimit nga fermat duhet të kryhen brenda 3 muajve nga operacioni i fundit i vendosjes në kosh të peshkut në fjalë dhe në një distancë minimale prej 10 miljesh nga ferma. Për lëshimet e më pak se 5 mt ton, autoriteti kompetent i CPC-ve i fermës mund të caktojë një distancë më të shkurtër, prej të paktën 5 miljesh, për lëshimin.

10. Kapiteni i anijes tërheqëse ose operatori i fermës do të jetë përgjegjës për mbijetesën e peshkut derisa të kryhet operacioni i lëshimit.

11. Autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës mund të zbatojë çdo masë shtesë që ata e gjykojnë të nevojshme për të garantuar që operacionet e lëshimit të zhvillohen në kohën dhe vendin më të përshtatshëm në mënyrë që të rritet probabiliteti i kthimit të peshkut në rezervë.

Raporti ICCAT për lëshimet

Raporti ICCAT për lëshimet	**Nr. i dokumentit**
1. Të dhënat mbi zëniet/vendosjen në kosha	
Ferma/anija/kurthi/anije tërheqëse që kryen lëshimin: Numri i regjistrit ICCAT: Referenca e urdhrit të lëshimit: Anije/kurth (1): Numri JFO: Numri i autorizimit të vendosjes në kosha (1): Numri i koshit të lëshimit: Referencat e eBCD (s) Numri i autorizimit të lëshimit:	
2. Të dhëna mbi operacionet e lëshimit	
Lloji i lëshimit (3): Data e operacionit: Emri i anijes tërheqëse: Numri i regjistrit të ICCAT-it: Flamuri: Ndarja e peshkut përpara operacionit të lëshimit: Numri i koshit të verifikimit: Numri i koshit të lëshimit: Numri i individëve BFT të liruar: Pesha e BFT-së së lëshuar (kg):	
Emri i operatorit, data dhe nënshkrimi (2):	Emri i vëzhguesit, nr. ICCAT, data dhe nënshkrimi:

1. Vetëm për lëshimet nga fermat.
2. Nënshkrimi i operatorit të fermës për lëshimet nga fermat, ose kapiteni të anijes së peshkimit për lëshimet e urdhëruara për anijet zënëse ose anijet tërheqëse.
3. Lëshimi pas përfundimit të raporteve të vendosjes në kosha (shtojca 9, paragrafi 4); toni i mbetur pas vjeljes që nuk është mbuluar nga një eBCD; teprica e tonit të gjetur pas një transferimi kontrolli ose vlerësimi të mbartjes.

SHTOJCË 11
TRAJTIMI I PESHKUT TË NGORDHUR DHE/OSE TË HUMBUR

Regjistrim i tonit të ngordhur ose të humbur

1. Sasia (numri) i tonit që ngordh gjatë çdo operacioni të rregulluar në këtë rekomandim do të raportohet nga operatori dhurues në rastin e një operacioni transferimi dhe transporti shoqërues, ose operatori i fermës në rastin e një operacioni të vendosjes në kosh ose aktivitetit të kultivimit, dhe zbritet nga kuota e CPC-ve përkatëse.

2. Për qëllimet e kësaj shtojce, peshqit e humbur i referohen individëve të munguar të tonit, të cilët, pas diferencave të mundshme të zbuluara gjatë hetimit të përmendur në paragrafin 174, nuk janë justifikuar si të ngordhur.

Trajtimi i peshqve që ngordhin gjatë transferimit të parë

3. Toni që ngordh gjatë transferimit të parë nga një anije me koshilok ose kurth do të regjistrohet në *logbook*-un e anijes me koshilok ose në raportin ditor të zënies së kurthit dhe raportohet në deklaratën e transferimit të ICCAT-it (ITD) dhe në seksionin e transferimit të eBCD-ve.

4. eBCD-ja do t'i jepet anijeve tërheqëse me seksionin 2 (zënie totale), seksionin 3 (tregtia e peshkut të gjallë) dhe seksionin 4 (transferimi – duke përfshirë peshqit "të ngordhur") të përfunduar.

5. Sasitë totale të raportuara në seksionet 3 dhe 4 do të jenë të barabarta me sasitë e raportuara në seksionin 2, pas zbritjes së të gjitha ngordhjeve të vëzhguara ndërmjet zënies dhe përfundimit të transferimit.

6. eBCD-ja do të shoqërohet nga ITD-ja në përputhje me dispozitat e këtij rekomandimi. Numri i tonit të raportuar në ITD (transferuar drejtpërdrejt), duhet të jetë i barabartë me numrin e raportuar në seksionin 3 në eBCD-në përkatëse.

7. Një ndarje e eBCD-së me seksionin 8 (informacioni tregtar) do të plotësohet dhe do t'i jepet anijes ndihmëse e cila do të transportojë tonin e ngordhur në breg (ose do të mbahet në anijen e zënies ose kurth nëse zbarkohet drejtpërdrejt në breg). Ky peshk i ngordhur dhe eBCD-ja e ndarë duhet të shoqërohet me një kopje të ITD-së.

8. Për sa i përket eBCD-së, peshqit e ngordhur do t'i ndahen anijes së peshkimit që ka bërë kapjen ose, në rastin e JFO-ve, anijeve pjesëmarrëse në zënie

Trajtimi i peshqve që ngordhin dhe/ose humbasin gjatë transferimeve të mëtejshme dhe operacioneve të transportit

9. Anijet tërheqëse duhet të raportojnë, duke përdorur formatin bashkangjitur kësaj shtojce, të gjithë tonin e ngordhur gjatë transportit. Linjat individuale do të plotësohen nga kapiteni sa herë që zbulohet ngordhje ose humbje.

10. Në rast transferimesh të mëtejshme, kapiteni i anijes tërheqëse dhuruese duhet t'i japë origjinalin e raportit kapitenit të anijes tërheqëse që merr peshkun ton, duke mbajtur një kopje në bord për kohëzgjatjen e fushatës.

11. Me mbërritjen e një koshi transporti në fermën e destinacionit, kapiteni i anijes tërheqëse do t'i dorëzojë autoritetit kompetent të CPC-ve të fermës setin komplet të raporteve të peshqve të ngordhur, duke përdorur formatin e bashkangjitur kësaj shtojce.

12. Për qëllimin e kapjes së kuotës që do të përcaktohet nga CPC-të e anijes ose kurthit, pesha e peshkut që ngordh ose humbet gjatë transportit vlerësohet si më poshtë:

a) për peshqit e ngordhur:

i. në rastin e zbarkimit, do të zbatohet pesha efektive në zbarkim;

ii. në rastin kur peshku i ngordhur hidhet, pesha mesatare e vendosur në kohën e mbylljes në kosh do të zbatohet për numrin e individëve të hedhur;

b) për peshqit që konsiderohen ndryshe si të humbur në momentin e hetimit të përmendur në paragrafin 174, pesha mesatare individuale e vendosur në kohën e mbylljes së koshit do të zbatohet për numrin e individëve që konsiderohen të humbur, siç përcaktohet Autoriteti Kompetent i CPC-ve të anijes ose kurthit që rezulton nga analiza e tij e filmimit të parë të transferimit të videos në kontekstin e hetimit.

Trajtimi i peshqve që ngordhin gjatë operacioneve të vendosjes në kosha

13. Peshqit që ngordhin gjatë operacioneve të vendosjes në kosha raportohen nga operatori në deklaratën e përkatëse. Autoriteti Kompetent i CPC-ve të fermës do të sigurojë që numri dhe pesha e peshkut që ngordh të raportohet në fushën përkatëse të seksionit 6 të eBCD-së.

Trajtimi i peshqve që ngordhin dhe/ose humbasin gjatë aktiviteteve të rritjes në kosha

14. Peshqit e ngordhur ose të humbur në ferma ose ata që zhduken nga fermat, duke përfshirë peshqit e supozuar të vjedhur ose të arratisur, duhet të raportohen nga operatori i fermës tek autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës menjëherë pasi të jetë zbuluar ngjarja. Raporti i operatorit të fermës shoqërohet me provat e nevojshme mbështetëse (ankesë për peshkun e vjedhur, raport dëmtimi në rast dëmtimi të kafazit, etj.). Pas marrjes së një raporti të tillë, autoriteti kompetent i CPC-ve të fermës do të zbatojë ndryshimet e nevojshme ose anulimin e eBCD-së në fjalë (duke ndjekur zhvillimet e nevojshme në sistemin eBCD).

SHTOJCË 12
DEKLARATA ICCAT PËR VENDOSJEN NË KOSHA

Deklarata ICCAT për vendosjen në kosha	Nr. i dokumentit
1. Vendosja në kosha e tonit	
Emri i fermës: Numri i regjistrit të ICCAT-it: Numri i autorizimit të vendosjes në kosh: Numri i koshit të transportit: Numri i koshit të fermës: Data e mbylljes:	Emri i anijes tërheqëse: Numri i regjistrit të ICCAT-it: Flamuri: Numri JFO: Numri(at) eBCD: Numri(at) e deklaratës së transferimit (ITD):
Toni që ngordh gjatë transportit (1):	

2. Informacion për vendosjet në kosha – operator i fermës dhe vëzhgues ICCAT (2)		
	Operator i fermës	Vëzhgues ICCAT-i
Numri i individëve		
Sasia në kg		N/A
Numri dhe sasia e tonit të ngordhur gjatë vendosjes në kosha		
Emri, data dhe nënshkrimi i operatorit të fermës:	Emri i vëzhguesit, nr. ICCAT, data dhe nënshkrimi:	
Prania e vëzhguesit: (Po/Jo)	Arsyet e mosmarrëveshjes:	Rregullat ose procedurat e parespektuara:

1. Informacion për vendosjen në kosha- Autoriteti i CPC-ve të fermës	
Numri i individëve	Sasia në kg
Zyrtari i autoritetit të CPC-ve, data dhe nënshkrimi:	

1. Numri total dhe pesha (kg) e BFT-së së raportuar e ngordhur nga kapiteni(ët) e anijes(ve) tërheqëse që kanë transportoi peshkun në kosha.

2. Sasitë e përcaktuara nga operatori i fermës dhe vëzhguesi i ICCAT-it pas analizimit të kamerës stereoskopike, pamjet e operacionit të mbylljes.

3. Sasitë e përcaktuara nga autoritetet e fermës CPC për funksionimin aktual të vendosjes në kosha kur të dhënat janë të disponueshme.

SHTOJCË 13
MINIMUMI I INFORMACIONI TË AUTORIZIMIT PËR PESHKIM

A. Identifikimi
1. Numri i regjistrit ICCAT
2. Emri i anijes së peshkimit
3. Numri i jashtëm i regjistrimit (germa dhe numra)
B. Kushtet e peshkimit
4. Data e lëshimit të autorizimit
5. Periudha e vlefshme
6. Kushtet e autorizimit të peshkimit, duke përfshirë kur është e mundur, speciet, zonën e peshkimit, rrjetat e peshkimit dhe çdo kusht tjetër të aplikueshëm që rrjedh nga ky rekomandim dhe ose legjislacioni kombëtar

	Nga.....në	**Nga..... në**	**Nga..... në**	**Nga..... në**	**Nga..... në**
Zonat					
Speciet					
Mjetet e peshkimit					
Kushte të tjera					

SHTOJCË 14
PROCEDURA PËR OPERACIONET E MBYLLJES (VULOSJES) SË KOSHAVE TË TRANSPORTIT

Përpara vendosjes së tyre në një anije me koshilok, një kurth ose një anije tërheqëse, ofruesi përgjegjës për ROP dhe autoritetet kompetente kombëtare duhet të sigurojnë një minimum prej 25 vulash ICCAT për çdo vëzhgues rajonal dhe kombëtar të ICCAT-it nën përgjegjësinë e tyre dhe të mbajnë një regjistër të vulave të ofruara dhe të përdorura.

Operatori dhurues do të jetë përgjegjës për vulosjen e koshave. Për këtë qëllim, në secilën derë të koshit duhet të vendosen të paktën tri vula, të vendosura në mënyrë që të pengojnë hapjen e dyerve pa thyer vulat.

Operacioni i vulosjes do të regjistrohet në video nga operatori dhurues dhe do të lejojë identifikimin e vulave dhe verifikimin nëse vulat janë vendosur siç duhet. Videoja duhet të jetë në përputhje me paragrafin 1 "a", "b", "c", të aneksit 8. Një kopje e pamjeve video duhet t'i vihet në dispozicion vëzhguesit rajonal të ICCAT-it në bordin e anijes me koshilok ose në kurth, ose vëzhguesit kombëtar, në anijen tërheqëse marrëse, për t'i transmetuar autoritetit kompetent të CPC-ve ose vëzhguesit rajonal të pranishëm në transferimin e mëpasshëm të kontrollit.

Pamjet video të transferimit të mëvonshëm të kontrollit do të përfshijnë operacionin e zhvulosjes, i cili do të kryhet në mënyrë të tillë që të lejojë identifikimin e vulave dhe verifikimin që vulat nuk janë ngacmuar.

VENDIM
Nr. 235, datë 22.9.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "SMART TRADE & CONSULTING" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 173, DATË 26.10.2017

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 13, si dhe nenit 16, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë

17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1539/3 prot., datë 19.9.2022, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë 'Smart Trade & Consulting' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017",

konstatoi se:

- Shoqëria "Smart Trade & Consulting" sh.p.k., është mbajtëse e licencës nr. 389, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.

- Bazuar në kërkesën dhe aplikimin e shoqërisë, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 215, datë 24.8.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Smart Trade and Consulting" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- ERE ka dërguar njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës të nisur me vendimin nr. 215/2022, në datat 25.8.2022 dhe 26.8.2022. Në përfundim të afatit të pritjes së objeksioneve të mundshme nga të tretët (data e fundit 8.9.2022), nuk ka rezultuar që të ketë të tilla. Gjithashtu, me shkresën nr. 1384/2 prot., datë 25.8.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me shkresën "Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni".

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1384/3 prot., datë 7.9.2022, shoqëria "Smart Trade & Consulting" sh.p.k. ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues të aplikimit.

- Pas shqyrtimit të sa depozituar, rezulton se mbetet ende informacion/dokumentacion për t'u depozituar, ndaj ERE-s iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1384/4, datë 15.9.2022. Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1384/5 prot., datë 19.9.2022, shoqëria ka plotësuar dhe pjesën e mbetur të dokumentacionit.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.

- Shoqëria ka shlyer ndaj ERE-s të gjitha detyrimet për sa i përket pagesave të rregullimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 389, seria T17, të shoqërisë "Smart Trade & Consulting" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 173, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar ky afat nga data 27.10.2022.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 236, datë 22.9.2022

MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË "BINDI" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 170, DATË 26.10.2017

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", nenit 13, si dhe nenit 16, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në

sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të rregullores Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1539/5 prot., datë 19.9.2022, "Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë 'BINDI' sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017",

konstatoi se:

- Shoqëria "Bindi" sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 387, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 218, datë 1.9.2022, vendosi të fillojë procedurën për rinovimin e licencës së shoqërisë "Bindi" sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- ERE ka dërguar njoftimin në median e shkruar për fillimin e procedurës të nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 218/2022, i cili u publikua në datat 2.9.2022 dhe 3.9.2022. Në përfundim të afatit të pritjes së objeksioneve të mundshme nga të tretët (data e fundit 16.9.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla.
- Me shkresën nr. 1385/4 prot., datë 7.9.2022, ERE iu drejtua shoqërisë "Bindi" sh.p.k. me shkresën "Njoftim vendimi dhe kërkesë për plotësim dokumentacioni", ndërsa me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1385/5 prot., datë 13.9.2022, shoqëria ka depozituar dokumentacionin plotësues të aplikimit.
- Shoqëria "Bindi" sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit në zbatim të përcaktimeve të aneksit A, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.
- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.
- Shoqëria "Bindi" sh.p.k. ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit ndaj ERE-s.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të rinovojë licencën nr. 387, seria T17, të shoqërisë "Bindi" sh.p..k, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 170, datë 26.10.2017, për një afat 5-vjeçar, duke filluar nga data 27.10.2022.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 237, datë 22.9.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "EZ-5 ENERGY" SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 10 MW, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE NR. 3038, FSHATI POVELÇË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER, QARKU I FIERIT

Në mbështetje të neneve 16, nenit 37, pika 2, germa "a", dhe nenit 38, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 10, pika 3 të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit

Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1539/4 prot., datë 19.9.2022, "Mbi licencimin e shoqërisë 'EZ-5 Energy' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 10 mw, me vendndodhje në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 202, datë 10.8.2022 vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 mw, për një afat 25-vjeçar.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure në datat 12.8.2022 dhe 13.8.2022 dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 25.8.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.

- Me shkresën nr. 1387/1 prot., datë 18.8.2022, ERE iu drejtua shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k. për ta njoftuar mbi fillimin e procedurës, nisur me vendimin e Bordit nr. 202/2022 dhe dokumentacionin e konstatuar të munguar apo të plotësuar pjesërisht.

- Shoqëria ka depozituar dokumentacion plotësues të aplikimit me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387/3 prot., datë 25.8.2022. Pas shqyrtimit të dokumentacionit, rezultoi se mbetej ende informacion/dokumentacion pa plotësuar, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 1387/5 prot., datë 12.9.2022 për plotësimin e tij. Në vijim shoqëria "EZ-5 Energy" sh.p.k. ka depozituar dokumentacion plotësues me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387/6 prot., datë 13.9.2022.

- ERE me shkresën nr. 1387/2 prot., iu drejtua dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), duke i kërkuar informacion mbi nënshkrimin e kontratës përkatëse me shoqërinë "EZ-5 Energy" sh.p.k., sikurse përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 417, datë 15.6.2022 "Për miratimin e ndërtimit të centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku i Fierit, nga shoqëria "EZ-5 Energy" sh.p.k." dhe sqarim në lidhje me krijimin e shoqërisë për qëllime të veçanta, të parashikuar në këtë VKM.

- MIE ka kthyer përgjigje me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1387/4 prot., datë 31.8.2022, ku është shprehur se në zbatim të VKM-së nr. 417, datë 15.6.2022, ka nënshkruar kontratën përkatëse me shoqërinë "EZ-E Energy" sh.p.k., si dhe ka specifikuar se referuar pikës 1, germa "iii" të VKM-së nr. 417/2022, krijimi i shoqërisë për qëllime të veçanta është një e drejtë dhe jo detyrim i shoqërisë "EZ-5 Energy" sh.p.k.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të aneksit A, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është tërësisht i plotësuar.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa "a", të ligjit "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe nenit 5, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga studimi i fizibilitetit për ndërtimin e impiantit fotovoltaik 10 mw rezulton se jetëgjatësia e burimit është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë "EZ-5 Energy" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga

centrali gjenerues i energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 mw, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 238, datë 22.9.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "EGNATIA HYDROPOWER" SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa "e", nenit 5, pika 1, germa "e", dhe nenit 13, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15, të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 1539/2 prot., datë 19.9.2022, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Egnatia Hydropower' sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 170, datë 28.6.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Egnatia Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
- Në vijim të kësaj vendimmarrje ERE me shkresën nr. 70/27 prot., datë 30.6.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 13.7.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla.
- Duke qenë se nga shoqëria ishte plotësuar pjesa më e madhe e dokumentacionit dhe mbetej pa u plotësuar vetëm dy sqarime lidhur me kapitalin që ortaku i vetëm vinte në dispozicion të ushtrimit të veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike dhe të dhëna mbi sasinë e energjisë që shoqëria parashikon të tregtojë gjatë secilit vit për 5 vjetët e ardhshëm, në zbatim të nenit 14, pika 3 e rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 201, datë 10.8.2022 vendosi të shtyjë me 30 ditë punë vendimmarrjen e tij për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, në mënyrë që t'i jepej mundësia shoqërisë për të plotësuar pjesën e mbetur të dokumentacionit.
- Shoqëria "Egnatia Hydropower" sh.p.k. ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e këtij aplikimi, në zbatim të përcaktimeve të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin/njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar.
- Shoqëria "Egnatia Hydropower" sh.p.k. ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike në zbatim të aneksit A, të rregullores "Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Egnatia Hydropower" sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 239, datë 22.9.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E KONTRATËS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES OSSH SHA

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar; nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "f", të rregullores "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike me nr. 1539 prot., datë 13.9.2022, "Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.",

konstatoi se:

- ERE, me vendimin e Bordit nr. 257, datë 21.12.2020 ka miratuar Programin e Pajtueshmërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, OSSH sh.a.

- Në pikën 1.2 dhe pikën 2 të Programit të Pajtueshmërisë parashikohet, se: OSSH sh.a. përcakton, zyrtarin e pajtueshmërisë, i cili më pas miratohet me vendim të Bordit të ERE-s.

- Duke qenë se në zbatim të përcaktimeve si më sipër OSSH sh.a. nuk kishte caktuar zyrtarin e pajtueshmërisë, ERE me vendimin nr. 18/2022 vendosi që brenda 30 ditëve pune nga marrja e këtij vendimi dhe pas miratimit nga organet drejtuese të shoqërisë, OSSH sh.a. duhet të përcillte për miratim në ERE kontratën për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë, duke përfshirë si pjesë integrale dhe kriteret përzgjedhëse të tij.

- Në vijim, duke u bazuar te kërkesa e OSSH sh.a., e depozituar përpara përfundimit të këtij afati, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 69, datë 11.4.2022 vendosi të zgjasë afatin për depozitimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë deri më 30.6.2022.

- Ky vendim i është njoftuar shoqërisë me shkresën nr. 289/3 prot., datë 21.4.2022 dhe me shkresën nr. 289/4, datë 23.6.2022 i është rikujtuar detyrimi për të depozituar në afat dokumentacionin e kërkuar. Rezulton që edhe pas përfundimit të afatit OSSH sh.a. nuk ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Nisur nga nevoja për të emëruar zyrtarin e pajtueshmërisë, i cili do të monitorojë dhe do të raportojë mbi zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë u vlerësua që ERE, me nismën e saj të hartojë kontratën për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë, së bashku me kriteret e përzgjedhjes së tij, dhe të fillojë procedurën për miratimin e saj.

- Ky dokument është hartuar duke u bazuar dhe në procedura të mëparshme të ngjashme, si kontrata për ofrimin e shërbimit të zyrtarit të pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Transmetimit, OST sh.a., si dhe zyrtarit të përputhshmërisë së OST-së të gazit natyror.

- Në këtë dokument përcaktohen dhe detyrat/shërbimet e zyrtarit të pajtueshmërisë, i cili ka për detyrë monitorimin e zbatimit të Programit të Pajtueshmërisë dhe për raportimin e këtij zbatimi

sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, dhe në vetë Programin e Pajtueshmërisë.

- Në kontratë gjejnë parashikim në mënyrë të detajuar të drejtat dhe detyrimet e palëve, duke përfshirë shërbimet që duhet të ofrojë zyrtari, të drejtat e zyrtarit, të drejtat dhe detyrimet e OSSH sh.a., pagesat dhe detyrimet financiare për shërbimet e zyrtarit, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve. Për sa i përket pagesës së zyrtarit të pajtueshmërisë, ajo duhet të caktohet nga OSSH sh.a.

- Kjo kontratë hyn në fuqi në datën kur ajo nënshkruhet nga palët dhe mandati i zyrtarit të pajtueshmërisë fillon ditën tjetër të punës pas nënshkrimit. Kjo kontratë është e vlefshme për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e nënshkrimit.

- Në shtojcën 1, përfshihen kriteret përzgjedhëse të zyrtarit të pajtueshmërisë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e kontratës për ofrimin e shërbimeve të zyrtarit të pajtueshmërisë të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a. dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 240, datë 22.9.2022

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 194, DATË 21.7.2022, "MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË 'GREEN ENERGY BILISHT' SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME VENDNDODHJE NË ZONËN BITINCKË, BILISHT, QARKU KORÇË, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 mw, PËR NJË AFAT 25-VJEÇAR"

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"; dhe të nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.9.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1539/7 prot., datë 20.9.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, "Mbi një ndryshim në vendimin nr. 194, datë 21.7.2022, 'Mbi licencimin e shoqërisë 'Green Energy Bilisht' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë, me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar'",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 194, datë 21.7.2022, vendosi të licencojë shoqërinë "Green Energy Bilisht" sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike. Në pikën 3 të dispozitivit të këtij vendimi përcaktohet se: "3. Shoqëria "Green Energy Bilisht" sh.p.k. të depozitojë në ERE, brenda 30 ditëve pune nga marrja dijeni, dokumentacion për mbulimin e pjesës së mbetur të investimit për ndërtimin e centralit fotovoltaik.".

- Me shkresën nr. 448/6 prot., datë 27.7.2022, ERE ka njoftuar shoqërinë për këtë vendimmarrje, duke i kujtuar detyrimin për të plotësuar kushtin, sikurse përcaktuar në vendimin nr. 194/2022.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 448/8, datë 13.9.2022, shoqëria ka depozituar

dokumentacionin e kërkuar, duke plotësuar kështu kushtin e vendosur në pikën 3 të vendimit të sipërcituar.

- Me plotësimin e kushtit, pika 3 e vendimit nr. 194/2022 shfuqizohet.

- Në nenin 113, të "Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 3, të vendimit nr. 194, datë 21.7.2022, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Green Energy Bilisht' sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me vendndodhje në zonën Bitinckë, Bilisht, qarku Korçë me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar".

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 243, datë 23.9.2022

MBI KËRKESËN E OST SHA, PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR VITIN 2023 DHE PERIUDHËN 2023–2025

Në mbështetje të neneve 16, 19, germa "c", pika "i", nenit 21 dhe nenit 55, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike"; të nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa "c" dhe pika 3, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017, si dhe të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 244, datë 26.11.2018, "Për miratimin e sistemit të njehsuar dhe të standardizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal të energjisë elektrike"; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 23.9.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1522/1 prot., datë 21.9.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve "Mbi kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023 dhe periudhën 2023–2025",

konstatoi se:

- Shoqëria "Operatori i Sistemit të Transmetimit" (OST sh.a.) me shkresën nr. 5303 prot., datë 31.8.2022 (protokolluar me tonën me nr. 1522 prot., datë 6.9.2022), ka paraqitur në ERE kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023, si dhe për periudhën 2023–2025, e cila është në përputhje me afatet e parashikuara në pikën 1, të nenit 21, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016.

- ERE, me anë të vendimit të Bordit nr. 72, datë 13.4.2022, ka miratuar tarifën e shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike prej 0.85 lekë/kWh, për periudhën rregullatore 1 maj 2022–31 dhjetor 2024.

- Shoqëria OST sh.a. ka paraqitur për miratim në ERE tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023, si dhe për periudhën 2023–2025, në shumën prej 2.18 lekë/kWh.

- Aplikimi i shoqërisë OST sh.a., i paraqitur në ERE për miratim, i referohet një periudhe të re rregullatore 3-vjeçare (2023–2025), e ndryshme nga ajo e kërkuar nga shoqëria dhe e miratuar nga ERE me vendimin e sipërcituar, e cila nuk mbështetet në parashikimet e "Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit", për sa i përket parimeve rregullatore dhe qëndrueshmërisë së tarifave në kohë.

- Në këtë aplikim konstatohet se OST sh.a. ka rishikuar të gjitha kostot apo komponentët e të ardhurave të kërkuara në rritje, nga ato të vlerësuara dhe miratuara nga ERE me vendimin e Bordit nr. 72, datë 13.4.2022. Ndryshe nga sa parashikohet në metodologjinë sipërcituar, OST sh.a. nuk ka paraqitur elementet e korrigjueshme/axhustueshme të tarifës mesatare tavan apo të të ardhurave të kërkuara, të cilat në zbatim të pikës 7, të nenit 11 të saj, parashikon që kryhet axhustim/korrigjim në tarifën mesatare tavan në vitin e ardhshëm, pavarësisht se axhustimet bëhen në periudhën rregullatore pasardhëse.

- Me VKM-në nr. 456/2022, kostoja e blerjes së energjisë për humbjet do të mbulohet nga shoqëria KESH sh.a., përgjatë gjithë kohëzgjatjes së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, me çmimin e blerjes së energjisë nga prodhuesit ekzistues me përparësi, çmim i cili ka vlerën tavan prej 8.5652 lekë/kWh.

- Masat e marra nga qeveria shqiptare, lidhur me gjendjen e emergjencës për furnizim, të cilat janë parashikuar në dispozitat e VKM-së nr. 456/2022, lidhur me prokurimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a., si dhe të ardhurat e tjera të realizuara gjatë kësaj periudhe, i mundësojnë shoqërisë të përballojë këtë shpenzim, duke mos ndikuar në tarifën mesatare të transmetimit, të miratuar me vendimin nr. 72/2022, të Bordit të ERE-s.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 230, datë 12.9.2022, ka miratuar kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike midis Shoqërisë Publike të Prodhimit, e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik "KESH sh.a." dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit "OST sh.a.", për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit për periudhën kohore 2.7.2022 deri në datën 31.12.2022.

- Ndër të tjera, metodologjia parashikon në pikën 10, të nenit 11, se në rast të një ngjarjeje të "forcës madhore" që çrregullon sistemin e transmetimit, OST sh.a. mund t'i paraqesë në çdo kohë ERE-s një kërkesë për leje për të axhustuar pagesën e energjisë në tarifën e transmetimit në mënyrë që OST sh.a. të arkëtojë një shumë specifike shtesë të ardhurash por duke synuar të arrijë tarifa transmetimi të qëndrueshme dhe të parashikueshme.

- Për aq kohë sa shoqëria nuk është përballur me një shpenzim të jashtëzakonshëm apo me një ngjarje të forcës madhore, atëherë në zbatim të parashikimeve të metodologjisë, komponentët të cilët do të jenë të korrigjueshëm në vitin e dytë të periudhës rregullatore (2023) janë ato të cilët lidhen me: koston e humbjeve, realizimin dhe kapitalizimin e investimeve, si dhe sasinë e energjisë së lëvruar në rrjet, elemente të cilat mund të kenë pësuar ndryshime eksponenciale në vitin bazë të periudhës rregullatore (viti 2022) nga ato të parashikuara në vendimin për tarifën e transmetimit për periudhën rregullatore 3-vjeçare 2022–2024.

- Metodologjia e llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nuk lejon korrigjimin e kostove të tjera operative dhe kapitale, vit pas viti, brenda periudhës rregullatore.

- Bordi i ERE-s, në konstatimet e vendimit nr. 72/2022, është shprehur se OST sh.a. duhet të paraqesë planin e investimeve për periudhën rregullatore 2022–2024 dhe përditësimin e planit të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për periudhën 10-vjeçare, 2015–2025, në zbatim të "Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017 dhe përcaktimeve të pikës 3, të VKM-së nr. 584/2021.

- OST sh.a. nuk ka përcjellë në ERE për shqyrtim planin e investimeve për periudhën në të cilën shtrihet periudha rregullatore 2022–2024, si dhe përditësimin e "Planit 10-vjeçar të zhvillimit të

rrjetit të transmetimit (2015–2025)" të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 212, datë 28.12.2017. OST sh.a., me shkresën nr. 3788, datë 15.6.2022, përcolli në ERE kërkesën për miratimin e planit të investimeve të vitit 2022, ndryshe nga sa lënë detyrë në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 72, datë 13.4.2022, të sipërcituar.

- Në kushtet kur shoqëria OST sh.a. nuk është përballur me shpenzime të jashtëzakonshme dhe ngjarje të forcës madhore për vitin 2022, kërkesa e shoqërisë për aplikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023 dhe periudhën rregullatore 2023–2025, vlerësohet si e paarsyetuar dhe e pa mbështetur në parashikimet e legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës, për aplikimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2023, si dhe për periudhën 2023–2025, prej 2.18 lekë/kWh.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË
Nr. 613/4, datë 26.9.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit 'Studim projektim rruga Berat–Ballaban' (faza II)",

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim për pasuritë, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", për pasuritë e llojit "tokë truall", "tokë bujqësore", "livadhe/kullota" dhe "tokë pyjore", sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 2,105,516 (dy milionë e njëqind e pesë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahimi

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "STUDIM PROJEKTIM RRUGA BERAT–BALLABAN" (FAZA II)

Nr.	Pronari						Të dhëna (mbi pasurinë sipas ASHK-së)				Vlerësimet për shpronësim sipas llojit			Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri	Adresa e pasurisë	Rrethi	Indeksi i hartës	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pas.	Sipërfaqja totale	Sip. (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
1	BASHKËPRONARËT CENO			Drobonik	Berat	K-34-112(239-D)	1559	9/26	Ullishte	3262.1	29	203	5887	5887	Konf. nga ASHK Berat
2	BESNIK	PETREF	SALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(239-D)	1559	9/20	Pemëtore + tr.	750	21	203	4263	4263	Konf. nga ASHK Berat
3	JETNOR	ETEM	QORRAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/12	Arë	535	167	203	33901	33901	Konf. nga ASHK Berat
4	FERDINANT	ETEM	QORRAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	74/11	Arë	640	187	203	37961	37961	Konf. nga ASHK Berat
5	SALIH	RUSTEM	KUÇI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	93/4	Arë	5275	121	203	24563	24563	Konf. nga ASHK Berat
6	SELMAN	SKËNDER	DELIBASHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/108	Pemëtore	1000	352	203	71456	71456	Konf. nga ASHK Berat
7	BASHKËPRONARËT TALLAS, MERDARI			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/39	Pemëtore	2950	201	203	40803	40803	Konf. nga ASHK Berat
8	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	95/93	Pemëtore	940	114	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
9	MENTOR	ALI	KADILLARI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/18	Ullishte	4653	300	203	60900	60900	Konf. nga ASHK Berat
10	SELAM	VELI	KADILLARI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/17	Ullishte	1047	148	203	30044	30044	Konf. nga ASHK Berat
11	SHYQO	NUREDIN	TALLA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/9	Ullishte	5000	283	203	57449	57449	Konf. nga ASHK Berat
12	SELMAN	SKËNDER	DELIBASHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/11	Ullishte	1613	188	203	38164	38164	Konf. nga ASHK Berat
13	BARIE	ADEM	KUÇI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	36/15	Ullishte	2420	346	203	70238	70238	Konf. nga ASHK Berat
14	DEMIR	RUSHIT	GJELI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	35/20	Ullishte	2200	305	203	61915	61915	Konf. nga ASHK Berat
15	MUSTAFA	ALUSH	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	84/45	Arë	1000	5	203	1015	1015	Konf. nga ASHK Berat
16	XHEMIL	JONUS	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	60/1	Arë	3350	145	203	29435	29435	Konf. nga ASHK Berat
17	PETRIT	REXHEP	ZILFAJ	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	91/3	Arë	2675	68	203	13804	13804	Konf. nga ASHK Berat
18	FATMIR	HASAN	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	295/1	Arë	4172	32	203	6496	6496	Konf. nga ASHK Berat
19	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	307/78	Ullishte	3675	558	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
20	ALI	RRAPO	DELIBASHI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	307/82	Ullishte	4875	20	203	4060	4060	Konf. nga ASHK Berat
21	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	307/79	Ullishte	2050	287	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
22	SEFER	MYFTAR	QORRI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	307/85	Ullishte	2550	96	203	19488	19488	Konf. nga ASHK Berat
23	BP. POÇI, HAJDËRI, XHALILI			Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	287/77	Pemëtore	3000	38	203	7714	7714	Konf. nga ASHK Berat
24	YLLI	MITAT	TOSKA	Drobonik	Berat	K-34-124(15-B)	1559	287/71	Pemëtore	1025	16	203	3248	3248	Konf. nga ASHK Berat
25	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	305/21	Arë	750	95	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
26	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	305/1	Arë	3100	12	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
27	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	305/2	Arë	2575	80	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
28	SHTET			Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	305/5	Arë	1400	44	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
29	TAJAR	SEFER	XHERIMEJA	Drobonik	Berat	K-34-112(255-D)	1559	305/29	Arë	5750	12	203	2436	2436	Konf. nga ASHK Berat
30	DASHMIR	VELI	KADILLARI	Drobonik	Berat	K-34-112(255-B)	1559	31/16	Ullishte	1058	41	203	8323	8323	Konf. nga ASHK Berat
31	SHTET			Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-C)	1110	268/13	Arë	950	13	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
32	FLUTURA	SKENDER	LUZI	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	283/40	Arë	2100	42	203	8526	8526	Konf. nga ASHK Berat
33	AVDYL	HASAN	SELENICA	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	283/41	Arë	2180	270	203	54810	54810	Konf. nga ASHK Berat
34	TAFIL	HAXHI	SELENICA	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(15-B)	1110	287/2	Pemëtore	2250	161	203	32683	32683	Konf. nga ASHK Berat
35	AVDYL	HASAN	SELENICA	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(15-B)	1110	287/3	Pemëtore	1450	29	203	5887	5887	Konf. nga ASHK Berat
36	SHTET			Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-C)	1110	276	Kullotë	5100	839	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
37	SHTET			Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-C)	1110	277	Pyll	4950	365	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
38	SHTET			Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-C)	1110	278	Kullotë	2600	451	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
39	TAFIL	HAXHI	SELENICA	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-C)	1110	279/9	Arë	4150	162	203	32886	32886	Konf. nga ASHK Berat
40	SHTET			Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-C)	1110	274/7	Kullotë	8850	97	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
41	SHTET			Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-C)	1110	279/10	Kullotë	1700	1416	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
42	SHTET			Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	285	Kullotë	11100	2485	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
43	GEZIM	JAÇE	LLAPI	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(15-B)	1110	287/9	Pemëtore	400	4	203	812	812	Konf. nga ASHK Berat

44	LUAN	JAÇE	LLAPI	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(15-B)	1110	287/10	Pemëtore	900	155	203	31465	31465	Konf. nga ASHK Berat
45	RAMADAN	JAÇE	LLAPI	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(15-B)	1110	287/11	Pemëtore	1350	129	203	26187	26187	Konf. nga ASHK Berat
46	SHTET			Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	287/15	Kullotë	2180	605	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
47	BASHKIM	AHMET	ALIJA	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	287/31	Pemëtore	1950	284	203	57652	57652	Konf. nga ASHK Berat
48	KRENAR	YZEDIN	BARDHAJ	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(15-B)	1110	287/30	Pemëtore	1800	106	203	21518	21518	Konf. nga ASHK Berat
49	LUTO	MUHARËM	GJONI	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(15-B)	1110	287/35	Pemëtore	600	21	203	4263	4263	Konf. nga ASHK Berat
50	VASIL	JORGO	PLAKU	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(15-B)	1110	287/34	Pemëtore	800	101	203	20503	20503	Konf. nga ASHK Berat
51	SHTET			Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	397/11	Ullishte	400	94	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
52	TAFIL	HAXHI	SELENICA	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	397/10	Ullishte	5000	389	203	78967	78967	Konf. nga ASHK Berat
53	FATMIR	ASLLAN	TEPELENA	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	397/9	Ullishte	5000	63	203	12789	12789	Konf. nga ASHK Berat
54	PERPARIM	LUTO	GJONI	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	397/8	Ullishte	5300	12	203	2436	2436	Konf. nga ASHK Berat
55	KUJTIM	SAMI	GJONI	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	397/5	Ullishte	12850	476	203	96628	96628	Konf. nga ASHK Berat
56	ALI	SAMI	GJONI	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	397/4	Ullishte	6200	251	203	50953	50953	Konf. nga ASHK Berat
57	KRENAR	YZEDIN	BARDHAJ	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	397/3	Ullishte	680	1	203	203	203	Konf. nga ASHK Berat
58	EQEREM	QEMAL	HYRAJ	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	397/2	Ullishte	4000	5	203	1015	1015	Konf. nga ASHK Berat
59	AGRON	HEKURAN	BARDHAI	Bardhaj i Ri	Berat	K-34-124(16-A)	1110	275/14	Arë	2000	1071	203	217413	217413	Konf. nga ASHK Berat
60	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(65-D)	3584	277	Kullotë	52500	355	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
61	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(65-D)	3584	278	Kullotë	35500	411	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
62	AVNI	MALIQ	LLAPI	Tërpan	Berat	K-34-125(81-B)	3584	725	Pemëtore	2600	513	203	104139	104139	Konf. nga ASHK Berat
63	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(81-B)	3584	747	Truall	2700	348	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
64	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(81-B)	3584	745	Truall	750	207	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
65	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(81-B)	3584	729	Truall	750	5	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
66	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(81-B)	3584	736	Truall	5650	9	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
67	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(81-B)	3584	707	Pemëtore	15700	369	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
68	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(81-B)	3584	712	Kullotë	55000	7	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
69	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(65-D)	3584	211	Kullotë	120000	441	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
70	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(65-D)	3584	213	Kullotë	7000	102	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
71	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(65-A)	3584	175	Kullotë	64000	231	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
72	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(49-C)	3584	23	Kullotë	43800	200	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
73	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(65-A)	3584	945	Kullotë	1750	15	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
74	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(65-A)	3584	948	Kullotë	16500	338	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
75	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(65-A)	3584	949	Kullotë	13500	24	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
76	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(65-A)	3584	938	Kullotë	46200	191	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
77	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(81-B)	3584	759	Truall	1900	47	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
78	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-125(81-B)	3584	762	Truall	5800	1436	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
79	SHTET			Tërpan	Berat	K-34-124(64-D)	3584	8	Kullotë	10750	999	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
80	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-124(32-D)	3930	484	Kullotë	6400	2256	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
81	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-124(32-D)	3930	368/2	Kullotë	5250	216	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
82	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-124(48-B)	3930	464/3	Arë	2400	2	0	0	0	Bllokuar në favor të ATP-së në bazë të VKM-së nr. 770, datë 12.11.2014
83	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-124(48-B)	3930	467/4	Pyll	25750	638	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
84	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-124(48-B)	3930	572/7	Arë	10000	903	0	0	0	Bllokuar në favor të ATP-së në bazë të VKM-së nr. 770 datë 12.11.2014
85	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-124(32-D)	3930	486/1	Vreshta	163100	1253	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
86	SALI	ALI	RUÇI	Zhitom i Madh	Berat	K-34-124(48-B)	3930	572/4	Arë	12000	347	203	70441	70441	Konf. nga ASHK Berat
87	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-124(48-B)	3930	573/3	Kullotë	2100	98	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
88	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-124(48-B)	3930	589/1	Kullotë	16000	437	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
89	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-C)	3930	615/26	Kullotë	4600	521	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
90	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-C)	3930	623/2	Kullotë	42500	1080	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
91	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-A)	3930	623/1	Pyll	46900	60	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
92	SHEFQET	BEKTASH	TOSKA	Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-C)	3930	634/10	Arë	4900	815	203	165445	165445	Konf. nga ASHK Berat
93	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-C)	3930	636/1	Kullotë	7000	1468	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat

94	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-C)	3930	643/1	Arë	4400	184	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
95	SHEME	AMZA	RUÇI	Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-C)	3930	643/2	Arë	3550	356	203	72268	72268	Konf. nga ASHK Berat
96	MYRTEZA	SHYQYRI	TOSKA	Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-C)	3930	643/8	Arë	3000	13	203	2639	2639	Konf. nga ASHK Berat
97	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(49-A)	3930	643/9	Arë	250	142	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
98	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(49-A)	3930	645/1	Kullotë	3300	56	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
99	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(49-A)	3930	647	Kullotë	10300	529	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
100	RRAPO	ZAIM	RUÇI	Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(49-A)	3930	648/3	Arë	3700	1475	203	299425	299425	Konf. nga ASHK Berat
101	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(49-A)	3930	656/1	Kullotë	56100	2929	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
102	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-C)	3930	629/4	Pyll	21200	203	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
103	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-C)	3930	629/6	Pyll	32500	1232	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
104	SHTET			Zhitom i Madh	Berat	K-34-125(33-C)	3930	636/2	Kullotë	2600	360	0	0	0	Konf. nga ASHK Berat
	TOTALI												2,105,516	2,105,516	
	Shënim	Çmimet për llojin e pasurisë janë marrë bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".													

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2022 - Numri: 130
Datë: 2022/09/29 16:28:04
ea567d23-7d50-451a-932d-2a3c24211eff

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 768 lekë